

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKËKOHORE
ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ
FACULTY OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

STUDIME TË DOKTORATËS - CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

ANËTARËSIMI NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE:
ASPEKT KOMPARATIV NË MES TË KOSOVËS DHE PALESTINËS

KANDIDATI:
Mr. Sc. Selim Daku

MENTORI:
Prof. Dr. Abdulla Azizi

Tetovë, korrik 2019

DEKLARATË

Bazuar në rregulloren për ciklin e tretë të studimeve akademike – Studimeve të Doktoratës, nën përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj se disertacioni me titull “ANËTARËSIMI NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE: ASPEKT KOMPARATIV NË MES TË KOSOVËS DHE PALESTINËS” është punim origjinal i zhvilluar nga unë në mbikëqyrjen e mentorit Prof. Dr. Abdulla Azizi.

Punimi si tërësi, apo ndonjë pjesë e tij nuk janë paraqitur për vlerësim apo botim në asnjë institucion tjetër më parë. Të gjitha burimet e përdorura në këtë disertacion janë cituar në përputhje të plotë me rregullat akademike dhe kërkesat institucionale.

Lekturoi: Ph.d.C. Shqipe Morina

Mr. Sc. Selim Daku

UEJL - SEEU

4 korrik, 2019

FALËNDERIMET

Përgatitja dhe përfundimi i këtij disertacioni do të ishte i pamundur pa kontributin e një numri të konsiderueshëm të personave të përfshirë. Para së gjithash, dua të shprehë mirënjohjen dhe falënderimin tim ndaj mentorit Prof. Dr. Abdulla Azizi, i cili ishte i gatshëm në çdo kohë për bashkëpunim dhe ofroi ndihmën e tij të pakursyer në shërbim të pasurimit me vlera shkencore të këtij punimi.

Për mbështetje morale dhe financiare, falënderoj pa masë prindërit dhe vëllain, të cilët më inkurajuan për përfundimin me sukses të këtij projekti të rëndësishëm. Veçanërisht, falënderoj bashkëshorten time për përkrahjen dhe mirëkuptimin e vazhdueshëm.

Për konsultimet e vazhdueshme, falënderoj të gjithë miqtë dhe kolegët që me shërbimet e tyre bënë që punimi im të marrë formë. Gjithashtu, shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë pjesëmarrësit që pranuan të kontribuojnë në përpjekjet e mia shkencore përmes realizimit të intervistave dhe plotësimit të pyetësorit.

Tabela e përmbajtjes

DEKLARATË.....	2
FALËNDERIMET	3
Abstrakt.....	8
Abstract.....	9
Lista e tabelave.....	10
Lista e shkurtesave.....	11
I. HYRJE	13
1.1. Qëllimi i hulumtimit	15
1.2. Pyetjet hulumtuese	15
1.3. Hipotezat	16
1.4. Rëndësia e punimit.....	17
1.5. Metodologjia e hulumtimit.....	17
1.5.1. Popullata dhe kampioni	17
1.5.2. Vendi i studimit	18
1.5.3. Procesi dhe instrumentet e hulumtimit.....	18
1.5.4. Analizimi i të dhënave.....	19
II. KONTEKSTI HISTORIK I STATUSIT TË KOSOVËS DHE PALESTINËS	20
2.1. Kosova në kuadër të Serbisë dhe çështja e Palestinës	21
2.1.1. Vendimet e Konferencës së Londrës.....	21
2.1.2. Marrëveshja Sykes – Picot dhe Deklarata e Balfourit	23
2.1.3. Konferenca e Paqes në Paris, San Remo dhe Sistemi i Mandateve	24
2.1.4. Kosova dhe Palestina deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.....	26
2.1.5. Kosova si provincë autonome në Jugosllavi dhe krijimi i Izraelit.....	32
2.2. Avancimi e suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe Pavarësia e Palestinës.....	41
2.2.1. Rasti i Kosovës - Kushtetuta e vitit 1974.....	41
2.2.2. Lufta e vitit 1973 dhe Marrëveshja e Camp-Davidit	44
2.2.3. Intifada e parë dhe Pavarësia e Palestinës	48
2.2.4. Suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe rezistenca	50
2.3. Ndërkombëtarizimi i Çështjes së Kosovës dhe përpjekjet për paqe në Lindje të Mesme.....	53
2.3.1. Konferenca e Hagës (1991) dhe Konferenca Arabo - Izraelite e Madridit (1991)	53

2.3.2.	Komisioni i Badinterit mbi Jugosllavinë (1992)	55
2.3.3.	Konferenca e Londrës (1992)	56
2.3.4.	Marrëveshja Izraelito – Palestineze e Oslos (1993)	57
2.3.5.	Marrëveshja Taba (Oslo II, 1995)	59
2.3.6.	Konferenca e Dejtonit (1995).....	61
2.4.	Vazhdimi i rezistencës	62
2.5.	Ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë dhe procesi i paqes në Lindje të Mesme	66
2.5.1.	Konferenca e Rambujesë (1999)	67
2.5.2.	Intervenimi i NATO-s dhe çlirimi i Kosovës	68
2.5.3.	Samiti i Camp Davidit (2000).....	70
2.5.4.	Intifada e dytë (2000 -2005)	71
2.5.5.	Administrimi ndërkombëtar në Kosovë	77
2.5.6.	Akti i shpalljes së Pavarësisë dhe krijimi i shtetit të Kosovës	80
2.5.7.	Vazhdimi i përpjekjeve për paqe në Palestinë	81
2.6.	Roli i faktorit ndërkombëtar pas Pavarësisë së Kosovës	83
III.	NJOHJA NDËRKOMBËTARE E SHTETEVE	85
3.1.	Njohja.....	85
3.2.	Teoritë e njohjes së shtetit	88
3.3.	Llojet e njohjes	91
3.3.1.	Njohjet de jure dhe de facto	92
3.3.2.	Njohjet shprehimisht dhe heshtazi	95
3.3.3.	Njohjet individuale dhe kolektive	97
3.3.4.	Njohja me kushte dhe pa kushte	100
3.4.	Motivet e njohjes dhe mosnjohjes	104
3.5.	Marrëdhëniet e Izraelit me Rusinë dhe SHBA-të	122
3.5.1.	Marrëdhëniet e Izraelit me Rusinë	122
3.5.2.	Marrëdhëniet e Izraelit me SHBA-të.....	125
3.6.	Marrëdhëniet e Serbisë me SHBA-të dhe Rusinë.....	129
3.6.1.	Marrëdhëniet e Serbisë me SHBA-të	129
3.6.2.	Marrëdhëniet e Serbisë me Rusinë.....	132
3.7.	Qasja e shteteve të Amerikës Latine ndaj Kosovës dhe Palestinës.....	136
3.8.	Efekti i kulturës dhe zhvillimeve globale në njohje të shteteve	139

IV. SUBJEKTIVITETI NDËRKOMBËTAR	143
4.1. Legjitimiteti ndërkombëtar i pavarësisë së Kosovës dhe Palestinës.....	143
4.2. Subjektiviteti i Kosovës dhe Palestinës	150
4.3. Integriteti territorial i Kosovës dhe i Palestinës	155
4.4. Sovraniteti i Palestinës dhe paralelizmi me Kosovën	161
4.5. Palestina dhe Kosova në marrëdhëniet ndërkombëtare	167
4.6. Suksedimi në rastin e Kosovës dhe Palestinës	173
V. PROCESI I ANTARËSIMIT NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE.....	177
5.1. Pjesëmarrja dhe anëtarësimi i Kosovës dhe Palestinës në nismat rajonale	177
5.2. Bashkimi Evropian dhe Kosova	185
5.3. Anëtarësimi dhe qëndrimi i NATO-së në rastin e Kosovës dhe Palestinës	188
5.4. Organizata e Bashkëpunimit Islamik, Kosova dhe Palestina	194
5.5. Këshilli i Evropës, Kosova dhe Palestina.....	197
5.6. Anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB).....	202
5.7. Anëtarësimi në organizatat e tjera ndërkombëtare	206
5.8. Politika e Jashtme e Kosovës dhe Palestinës	209
5.8.1. Orientimi gjeostrategjik i Kosovës dhe Palestinës	213
5.8.2. Roli i Shqipërisë për Kosovën dhe vendeve arabe për Palestinën	216
5.9. Serbia dhe Izraeli si pengesa për Kosovën dhe Palestinën	220
5.9.1. Mjetet e politikës së jashtme të Serbisë dhe Izraelit	221
5.9.2. Tërheqja e njohjeve	223
VI. PJESA EMPIRIKE	227
6.1. Të dhënat sasiore	227
6.2. Të dhënat cilësore	243
6.2.1. Pozicioni ndërkombëtar i Kosovës dhe Palestinës.....	243
6.2.2. Gjeopolitika e Fuqive të Mëdha dhe roli i faktorëve kulturorë	246
6.2.3. Impakti i sovranitetit të brendshëm në sovranitetin e jashtëm	248
6.2.4. Rruga sfiduese drejt OKB-së.....	250
6.2.5. Roli i organizatave rajonale.....	251
6.2.6. Negociatat si zgjedhje për zgjidhje	253
6.3. Diskutim.....	256
PËRFUNDIME	263

REKOMANDIME.....	266
BIBLIOGRAFIA	269
SHTOJCA A – PYETJET PËR STUDIUES, EKSPERTË, OJQ, MEDIA	298
SHTOJCA B – PYETJET PËR POLITIKANË, AMBASADORË, ZYRTARË	299
SHTOJCA C – PYETËSOR I PËRGJITHSHËM.....	300
SHTOJCA D – LISTA E TË INTERVISTUARVE	305

Abstrakt

Anëtarësimi i Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare është proces i rëndësishëm, që ndikon në minimizim të kontestimit të shtetësisë dhe forcim të subjektivitetit ndërkombëtar të tyre.

Në këtë studim, janë bërë krahasime në mes të Kosovës dhe Palestinës, në rrugëtimin e tyre për anëtarësim dhe njohje ndërkombëtare, sfidat dhe pengesat për realizimin e qëllimeve të tyre, duke treguar për secilën veç e veç, se ku qëndrojnë të përbashkëtat dhe veçantitë ndërmjet tyre.

Përmes metodës së analizës dhe krahasimit, si dhe zbatimit të pyetësorit dhe intervistave me ekspertë, njohës të politikave ndërkombëtare, përfaqësues të organizatave joqeveritare, medieve, ambasadorë dhe zyrtarë shtetërorë, brenda e jashtë vendit, përmes këtij hulumtimi janë vërejtur disa dallime të konsiderueshme në mes të Kosovës dhe Palestinës në maratonën e tyre për forcim të subjektivitetit ndërkombëtar, por edhe disa ngjashmëri.

Edhe pse Kosova dhe Palestina kanë ambicie të njëjta, ato janë raste të ndryshme. Të dy shtetet e kontestuara kanë orientime gjeostrategjike të kundërta dhe aleatë të ndryshëm. Përderisa, Kosova ka në krah SHBA-të dhe vendet e Evropës Perëndimore, Palestina ka përkrahje të fragmentuar nga vendet arabe dhe Rusia. Fuqitë e mëdha janë përcaktuese për realizimin e ambicieve të këtyre shteteve për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Fjalët kyçe: *anëtarësim, organizata ndërkombëtare, njohje, subjektivitet ndërkombëtar.*

Abstract

Kosovo and Palestine membership in international organizations is an important process, which affects the minimization of the contestation of citizenship and the strengthening of their international subjectivity.

This study, compares Kosovo and Palestine, in their journey to membership and international recognition, challenges and obstacles to realize their goals, pointing to each one separately where are the similarities and peculiarities between them.

Through the method of analysis and comparison, as well as conducting questionnaires and interviews with experts, international policy-makers, representatives of non-governmental organizations, media, ambassadors and state officials inside and abroad, this research has managed to find some significant differences between Kosovo and Palestine in their marathon for strengthening international subjectivity, but also some similarities.

Although Kosovo and Palestine have the same ambitions, they are different cases. Both contested countries have opposite geostrategic orientations and different allies. While Kosovo has support from the United States and Western European countries, Palestine has fragmented support from Arab countries and Russia. The Great Powers are those that determine the realization of these countries' ambitions for membership in the United Nations.

Key words: *membership, international organizations, recognition, international subjectivity.*

Lista e tabelave

Tabela 1. Lista e shteteve që kanë njohur Palestinën dhe nuk e kanë njohur Kosovën.....108-109

Tabela 2. Lista e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën.....109-110

Tabela 3. Lista e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe nuk e kanë njohur Palestinën.....111

Lista e shkurtesave

AP – Autoriteti Palestinez

AKP - Autoriteti Kombëtar Palestinez

BB – Banka Botërore

BE – Bashkimi Evropian

CEFTA – Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore

DEP – Deklarata e Parimeve

EULEX – Misioni i BE-së për sundim të ligjit në Kosovë

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

GJND – Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

ICO - Zyra Civile Ndërkombëtare

IDF – Forcat Mbrojtëse të Izraelit

IPCRI - Qendra për Hulumtim dhe Informim Izrael-Palestinë

ISG - Grupi Ndërkombëtar Drejtues

KBR - Këshilli për Bashkëpunim Rajonal

KE – Këshilli i Evropës

KFOR – Kosovo Force (Misioni i udhëhequr nga NATO)

KLA – Komiteti i Lartë Arab

KLP – Këshilli Legjislativ Palestinez

KMKK – Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës

KRG – Kurdistan Regional Government

KS – Këshilli i Sigurimit

KSAK – Krahina Socialiste Autonome e Kosovës

KSM – Këshilli Suprem Mysliman

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës

LKCK – Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës

LRBSH – Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve

MSA – Marrëveshja për Stabilizim - Asociim

NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

OBI – Organizata për Bashkëpunim Islamik

OÇP - Organizata për Çlirimin e Palestinës

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PCN - Zyra Civile Ndërkombëtare

PKJ – Partia Komuniste e Jugosllavisë

PKSH – Partia Komuniste e Shqipërisë

PSBE - Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian

PSSP – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

CEI - Iniciativa e Evropës Qendrore

RAKM – Republika Autonome e Kosovës dhe Metohisë

REDWG - Grupi Punues për Zhvillimin Ekonomik Rajonal

RPS – Republika Popullore e Serbisë

RSFJ – Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

TRNC - Republika Turke e Qipros Veriore

UNESCO – Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara

UÇK – Ushtria Çlirimtare e Kosovës

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. HYRJE

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare është synim i të gjitha shteteve të botës. Ato shihen si struktura përmes të cilave shtetet synojnë realizimin e qëllimeve të tyre, duke dhënë pak nga sovraniteti i tyre dhe duke marrë ngapak sovranitet nga të gjitha shtetet anëtare.

Superfuqitë kanë ndikimin më të lartë në organizatat ndërkombëtare, ndërkaq, shtetet si Kosova dhe Palestina anëtarësimin në organizata ndërkombëtare mund ta shfrytëzojnë si jetësim dhe siguri të qenësisë së shtetit të tyre.

Punimi ka për trajtesë krahasimin në mes të Kosovës dhe Palestinës në rrugën e tyre për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare. Ndërkaq, zhvillimi i trajtesës është bërë në mënyrë kronologjike duke filluar nga kontestet historike të Kosovës dhe Palestinës, burimit të problemeve, rolit të organizatave ndërkombëtare në zgjidhjen e problemeve të të dy shteteve, përpjekjet për paqe dhe menaxhim të konflikteve, ndërhyrjet ndërkombëtare, shpalljen e pavarësisë së tyre, procesin e njohjes së shteteve, konsolidimin e brendshëm dhe procesin e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Trajtesa ndahet në pjesën teorike dhe empirike. Për realizimin e pjesës teorike është përdorur literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj, materiale nga konferenca, simpoziume, revista, monografi të ndryshme shkencore; për grumbullimin e tyre janë vizituar librari dhe biblioteka vendore dhe të huaja; janë shfrytëzuar burime dhe dokumente (studime, raporte, rezoluta dhe publikime të tjera) të përshtatshme, të cilat kontribuojnë që punimi të plotësohet me sa më shumë burime të besueshme.

Pjesa e teorike e punimit është ndërtuar në pesë kapituj. Në kapitullin e parë, kemi paraqitur qëllimin, pyetjet hulumtuese, hipotezat, rëndësinë, metodologjinë e trajtesës, kampionin, vendin dhe mënyrën e analizimit të të dhënave hulumtuese.

Në kapitullin e dytë trajtohen në mënyrë kronologjike ngjarjet që janë zhvilluar në territoret e Kosovës dhe Palestinës prej pikës së parë të përbashkët, rënies së Perandorisë Osmane e deri në ditët e sotme.

Kapitulli i tretë trajton çështjet pas shpalljes së pavarësisë së Palestinës dhe Kosovës dhe rrugën që kanë ndjekur këto shtete për të marrë njohje nga subjektet e së drejtës ndërkombëtare.

Në kapitullin e katërt trajtohet çështja e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe Palestinës, ku përfshihet trajtesa që i bëjnë subjektet e së drejtës ndërkombëtare këtyre dy shteteve; trajtohet gjithashtu legjitimiteti ndërkombëtar i shteteve, integriteti territorial dhe ndikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në subjektivitetin ndërkombëtar.

Në kapitullin e pestë trajtohet krahasimi i procesit të anëtarësimit të Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare, duke filluar nga nismat rajonale deri në sfidat për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Pjesa e dytë empirike e punimit është trajtuar në kapitullin e gjashtë, dhe përbën analizën e të dhënave të grumbulluara nga respondentët. Aty janë të përfshira të dhënat sasiore që derivojnë nga anketimi i individëve të përcaktuar dhe të dhënave cilësore që rrjedhin nga realizimi i intervistave.

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Bazuar në të dhënat shkencore, hulumtimi ka për qëllim të vë në pah ngjashmëritë dhe dallimet që Kosova dhe Palestina kanë gjatë trajtimit të synimeve të tyre për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Hulumtimi tenton të pasqyrojë realitetet e të dy anëve, sfidat konkrete me të cilat ballafaqohen dhe faktorët me impakt të lartë në anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në organizata ndërkombëtare.

Hulumtimi do të ofrojë të dhëna për rëndësinë e njohjes ndërkombëtare të Kosovës dhe Palestinës nga subjektet e së drejtës ndërkombëtare, rëndësinë e sovranitetit të brendshëm dhe rëndësinë e orientimeve gjeostrategjike për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Punimi pretendon të identifikojë pengesat kryesore të anëtarësimit të Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare, si dhe rrugën komplekse që Kosova dhe Palestina duhet ta ndjekin për realizimin e këtyre qëllimeve.

1.2. Pyetjet hulumtuese

1. A janë raste të njëjta Kosova dhe Palestina dhe si i trajton komuniteti ndërkombëtar?
2. Cili është orientimi gjeostrategjik i Kosovës dhe Palestinës në raport me politikën e jashtme të tyre dhe a ndikon ky orientim për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare?
3. Cili është impakti i Serbisë, përkatësisht Izraelit në anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare?
4. Cili është roli i superfuqive në anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare?
5. Si ndikojnë faktorët ideologjikë, historiko-gjeografikë dhe kulturorë në anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare?
6. A ndikon numri i njohjeve dhe sovraniteti i brendshëm në anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare?
7. Çfarë roli kanë luajtur organizatat ndërkombëtare dhe Fuqitë e Mëdha në raport me anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në nismat rajonale?
8. Cili është rezultati i negociatave të gjata që kanë zhvilluar Kosova dhe Palestina?

9. Si ndikon hyrja e këtyre shteteve në traktatet ndërkombëtare në fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar?

1.3. Hipotezat

Hipotezat kryesore dhe mbështetëse:

1. Kosova dhe Palestina pavarësisht se kanë disa ngjashmëri, me gjasa, janë raste të ndryshme sepse edhe Bashkësia Ndërkombëtare i trajton si të tilla.
 - 1.1. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare i Kosovës dhe Palestinës varet nga shkalla e përkrahjes së superfuqive globale ndaj dyja vendeve.
 - 1.2. Numri i njohjeve, anëtarësimeve dhe statusi i Palestinës në OKB për dallim nga Kosova, është më i lartë dhe më i avancuar, me gjasa nga trajtimi i Palestinës si rast dekolonizimi, ndërsa në rastin e Kosovës, numri i tyre është më i ulët nga trajtimi i saj si rast i shkëputjes nga një shtet sovran.
 - 1.3. Anëtarësimi i Kosovës dhe Palestinës në organizata ndërkombëtare varet nga lloji i orientimit të tyre gjeopolitik. Me gjasa, Kosovën e njohin më shumë shtetet e Orientimit Perëndimor, liberal dhe demokratik, ndërsa Palestinën, shtetet autoritariste dhe me botëkuptime më antiamerikane.
 - 1.4. Njohja dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare stagnon me shkallën e pritshmërisë për marrëveshje në mes të dy palëve.
2. Krahasuar me Serbinë, ndikimi i presionit diplomatik të Izraelit kundër Palestinës është shumë më i lartë nga përkrahja e fuqishme e diplomacisë amerikane.
3. Mosnjohja, mosanëtarësimi dhe kundërshtimi i një shteti të kontestuar varet nga shkalla e kompleksitetit të kontesteve të brendshme të shtetit njohës.

1.4. Rëndësia e punimit

Punimi ka dobi shkencore për faktin se trajtesa që zhvillohet nuk është mjaftueshëm e hulumtuar dhe si e tillë është një risi që shpresojmë se do të sjellë një kontribut simbolik për fushën e studimit. Krahasimi i procesit të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe Palestinës si shtete me karakteristika të veçanta do të shtojë gamën e punimeve me qasje dhe këndvështrime të reja.

Kosova dhe Palestina kanë disa tipare të ngjashme, mirëpo kanë shumë të tjera që bëjnë këto raste të jenë esencialisht të dallueshme. Prandaj, informacioni që buron nga kërkimet shkencore është një pasurim i ideve për sfidat e ndryshme që këto shtete ballafaqohen në realizimin e qëllimeve të tyre për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Krahasimi dhe analizimi i rolit dhe sjelljes së faktorit ndërkombëtar në rastin e Kosovës dhe Palestinës është dobiprurës dhe ndërlidhet me nevojat e shoqërisë për më shumë informacion.

1.5. Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit është realizuar duke përdorur kombinimin e të dhënave sasiore dhe cilësore. Ne kemi bashkëdyzuar zbatimin e pyetësorit dhe intervistave.

1.5.1. Popullata dhe kampioni

Hulumtimi është fokusuar në disa grupe të ndryshme dhe të rëndësishme për nxjerrjen e rezultateve konkrete. Grupet e synuara përfshijnë: njohësit e çështjeve të dy shteteve, ekspertë nga universitete të ndryshme, drejtues të politikave të jashtme të dy shteteve, organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe medie.

Madhësia e mostrës është e përbërë prej 100 respondentësh. Për shkak të specifikave të trajtesës , numri i respondentëve është i kufizuar. Jette, Grover dhe Keck (2003) sugjeruan se ekspertiza në temën e zgjedhur mund të zvogëlojë numrin e pjesëmarrësve të nevojshëm në një studim - përderisa Lee, Woo dhe Mackenzie (2002) sugjerojnë që studimet që përdorin më shumë

se një metodë kërkojnë më pak pjesëmarrës, siç bëjnë edhe studimet që përdorin intervista të shumëfishta me të njëjtin pjesëmarrës (p.sh. studimet longitudinale ose studimet panel) (Mason, 2010).

Zgjedhja e pjesëmarrësve nuk është e rastësishme, dhe ka përfshirë të gjitha kategoritë e e synuara për pjesëmarrje në hulumtim. Në hulumtim kanë marrë pjesë 28 respondentë të kategorisë: Ekspertë të pavarur, OJQ dhe media, 21 subjekte që përfaqësojnë qeveritë përkatëse, 23 subjekte të tjera nga ambasadat apo përfaqësues të tjerë diplomatikë; dhe 28 respondentë nga radhët e institucioneve kërkimore, shkencore dhe arsimore.

Të dhënat cilësore janë të ndara në dy kategori intervistash: e para për studiues, ekspertë, OJQ dhe media, në kuadër të së cilës janë realizuar nëntë intervista, dhe e dyta, për politikanë, ambasadorë dhe zyrtarë të tjerë shtetërorë në kuadër të së cilës janë realizuar gjashtë intervista.

1.5.2. Vendi i studimit

Për shkak se pjesa më e madhe e hulumtimit është realizuar në mënyrë elektronike, qoftë përmes rrjeteve sociale, e-mailit apo video-intervistave, personat e përfshirë në hulumtimin tonë janë nga lokacione, shtete (Kosovë, Palestinë, Serbi, Izrael, Angli, SHBA, Gjermani, Suedi, Australi, Iran etj.) dhe kontinente të ndryshme. Ata kanë moshë, gjini dhe status të ndryshëm social e profesional. Përzgjedhja është bërë duke u bazuar edhe në kriterin e përkatësisë kombëtare.

1.5.3. Procesi dhe instrumentet e hulumtimit

Realizimi i hulumtimit është zhvilluar në një periudhë njëvjeçare kohore, për shkak se intervistimi dhe anketimi në nivelin e synuar nga projekti ynë kërkonte kohë të mjaftueshme për respondentët.

Hulumtimi është realizuar në mënyrë direkte dhe përmes formave të ndryshme që mundëson interneti. Grumbullimi i të dhënave është bërë gjatë periudhës tetor 2017-tetor 2018.

Realizimi dhe grumbullimi i të dhënave është realizuar në disa faza:

1. Faza e parë ishte kontaktimi, njoftimi dhe konfirmimi/refuzimi i subjekteve potenciale për intervistë gjysmë të strukturuar;

2. Faza e dytë ishte zhvillimi i intervistimit gjysmë të strukturuar në takime direkte, përmes e-mailit, telefonit, rrjeteve sociale me respondentë të kategorisë: studiues, ekspertë, OJQ dhe medie;
3. Faza e tretë ishte zhvillimi i intervistimit gjysmë të strukturuar në takime direkte, përmes emailit, telefonit, rrjeteve sociale me respondentë të kategorisë: politikanë, ambasadorë, zyrtarë;
4. Faza e katërt ka shërbyer për identifikimin dhe zgjerimin e subjekteve për realizim të pyetësorit;
5. Faza e pestë ka shërbyer për zbatimin e pyetësorit me respondentë nga kategoria që përfaqësojnë qeveritë e shteteve që lidhen me synimin tonë dhe respondentët që përfaqësojnë rrjetin diplomatik;
6. Faza e gjashtë ka shërbyer për aplikimin e pyetësorit me respondentë nga kategoria që përfaqësojnë: Institucionet kërkimore, shkencore, arsimore dhe atyre nga ekspertët e pavarur, OJQ-ve dhe medie.

Intervistat janë zhvilluar kryesisht në mënyrë elektronike, ndërkaq disa prej tyre edhe në takime direkte dhe kanë zgjatur prej 45 deri në 60 minuta, ndërkaq të gjithë pyetësorët janë plotësuar në mënyrë elektronike dhe kanë zgjatur deri në 30 minuta.

1.5.4. Analizimi i të dhënave

Për kryerjen e analizës së të dhënave është përdorur programi statistikor Excel, Word dhe SPSS, përmes të cilëve janë paraqitur të dhënat në tabela dhe grafikone. Të dhënat cilësore janë analizuar pas një procesi të kodimit, klasifikimit, interpretimit dhe përshkrimit.

II. KONTEKSTI HISTORIK I STATUSIT TË KOSOVËS DHE PALESTINËS

Kosova dhe Palestina janë dy vende të cilat kanë një të kaluar të ndërlikuar me disa karakteristika të përbashkëta. Bashkëpunimet e shqiptarëve dhe arabëve datojnë herët, por zhvillimi më i madh është arritur gjatë sundimit të Perandorisë Osmane.

Shqiptarët dhe Arabët në atë periudhë kanë patur sunduesin e përbashkët, kanë zhvilluar edhe politika të përbashkëta, herë në kuadër të Perandorisë Osmane e së voni edhe kundër saj. E rëndësishme në këtë kontekst është se nuk është vetëm aspekti fetar që llogaritet si një e përbashkët në mes të dy popujve. Luftërat, sakrifica dhe përpjekjet për liri janë pjesë të të përbashkëtave historike të dy shteteve. Sado të përafërta janë fatkeqësitë e shtypjes historike rasti i shtetësisë së Kosovës dhe Palestinës në trajtesa të marrëdhënieve dhe së drejtës ndërkombëtare do të mbetet qartësisht i dallueshëm. Problemi i Kosovës është rezultat i një shkëputjeje, ndërsa ai i Palestinës, proces i dekolonizimit.

Çështja e Kosovës do të problematizohej sidomos pas kryengritjeve të shumta të shqiptarëve në katër vilajete kundër Perandorisë Osmane në prag të shpërbërjes së saj. Ishte viti 1912 kur lufta antiosmane u zgjerua, por edhe Luftërat Ballkanike i dhanë formë e përmbajtje këtyre ngjarjeve. Vendin e Perandorisë Osmane në Kosovë do ta zinte me forcë më të organizuar ushtarake sidomos Serbia. Në këtë periudhë po vinte edhe shpërthimi i luftës së parë botërore, pas përfundimit të së cilës do të krijohet Mbretëria Serbo-Kroate-Slllovene ku Kosova do të ishte një territor nën të dhe pa ndonjë fuqi mëvetësie. Nga dobësimi dhe rënia e Perandorisë Osmane ngjarjet do të ndikonin edhe në fatin e Palestinës.

Në vitin 1916 Fuqitë e Mëdha ndanë territoret arabe për t'i administruar, ndërsa Palestina mbeti nën administrimin e Britanisë së Madhe. Në fillim të muajit nëntor të vitit 1917, ministri i jashtëm britanik Balfouri, në emër të qeverisë kishte shpallur themelimin e një vatre kombëtare hebreje në Palestinë (Duroselle & Kaspi, 2011, p. 39). Kjo ishte edhe pikënisja e problemit të Palestinës, që arriti të konkretizohet si çështje e ndjeshme në arenën ndërkombëtare, veçmas pas aktit të krijimit të shtetit të Izraelit.

2.1. Kosova në kuadër të Serbisë dhe çështja e Palestinës

2.1.1. Vendimet e Konferencës së Londrës

Pas dobësimit të pushtetit të Perandorisë Osmane në trojet shqiptare dhe në Ballkan, kryengritësit shqiptarë, më 28 nëntor 1912 shpallën pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë. Një pjesë e madhe e hapësirave shqiptare mbetën nën pretendimet dhe pushtimet territoriale nga fqinjët, e veçanërisht nga Serbia. Pas luftërave ballkanike dhe problemeve tjera në Londër në dhjetor të vitit 1912 u thirr Konferencë e Ambasadorëve të fuqive të mëdha.

Konferenca e Ambasadorëve, që u kryesua nga Ministri i Jashtëm Britanik Eduard Grej, ishte e ndarë midis Austro-Hungarisë dhe Italisë, që ishin në favor të Shqipërisë si <<protezhë>> e tyre në Ballkan, ndërsa Rusia dhe Franca, që përkrahnin synimet e Serbisë, gjykonin se nacionalizimi shqiptarë ishte krijesë e Vjenës. (Castellan, 1997)

Në këtë konferencë nuk merrnin pjesë palët për të cilat u vendoste direkt për fatin e tyre. Shtetet ballkanike të cilat ishin në aleancë e që kërkonin copëtimin e trojeve shqiptare i përfaqësonte Rusia dhe Franca, ndërkaj interesat e shqiptarëve pjesërisht i përfaqësonte Austro-Hungaria dhe Italia. Por, që kjo e para do të shpërbëhej bashkë me Perandorinë Osmane në dy dekadat e para të shek. XX. Në këtë konferencë priteshin kompromise të dhimbshme, të cilat nuk shkonin në dëm të asnjërës nga palët prezente.

Më 22 mars 1913 Konferenca u mblodh për të sanksionuar marrëveshjen përfundimtare të Fuqive mbi kufijtë e veriut. Në kundërshtim të hapur me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsisë vendase, nga trangu i Shqipërisë u shkëputen Kosova dhe tokat e Shqipërisë Lindore (të quajtura Maqedonia Perëndimore) (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007, p. 25). Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër nën udhëheqjen e Ministrit të Jashtëm të Britanisë së Madhe, i irrituan shqiptarët në përgjithësi e ata të Kosovës në veçanti.

Edhe pse ishin të dërmuar nga një luftë e gjatë kundër Perandorisë Osmane, shqiptarët e Kosovës tani i ishin nënshtruar një spastrimi sistematik nga trupat pushtuese serbo-malazeze. Rezistenca shqiptare do të vazhdonte kundër pushtimit nga shtetet ballkanike. Nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër e këtë, problemi i Kosovës ka vazhduar dhe kjo vetëm ka ndërruar formë në perioda të ndryshme kohore. Në librin e tij për Kosovën, Oliver Schmitt

thekson: Zhvillimet e luftës nuk u karakterizuan me sulmet lokale dhe të shtënat me armë, por spastrimet e gjera dhe masakrat në popullsinë civile. (Schmitt, 2012, p. 137)

Shqiptarët mbetën në gjendje të mjerueshme politike, ekonomike dhe sociale edhe në sytë e vetë serbëve. Shtypi socialdemokrat serb dhe personalitetet e Partisë Socialdemokrate Serbe si Dimitrije Tucoviçi, theksonin ato ditë se shqiptarët ngritën krye ngaqë u vunë para alternativës “vdekje nga plumbi ose nga uria” (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007, p. 428).

Situata edhe më tej do të përkeqësohej në Kosovë, por më vonë dukshëm edhe në Palestinë, me politikat e vendosjes së kolonëve pa miratimin e popullsisë lokale.

Në mars të vitit 1914 Kryeministri e ministri i jashtëm serb Nikolla Pashiçi, deklaronte se qeveria serbe parashikonte të vendoste në tokat e të shpërngulurve mbi 250 000 emigrantë ekonomik serbë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007, p. 428). Demografia e trojeve Shqiptare ndryshonte, përderisa populli ballafaqohej me dëme të papara pas luftërave të shumta.

Ndodhitë që zhvilloheshin në Evropë dhe Ballkan, padyshim që do të reflektonin edhe në pjesët tjera të botës osmane e pasosmane. Fillimi i rënies së saj në Evropë u manifestua edhe në vendet arabe. Pretendimet e popujve arabë për pavarësi padyshim se do të diskutoheshin nga Fuqitë e Mëdha dhe sipas marrëveshjes së tyre, do të krijoheshin shtete apo territore të administruara nga superfuqitë e kohës.

Gjatë luftës së Parë Botërore, Kosova u kthye në arenë luftimesh, pushtimesh e ripushtimesh nga shtetet fqinje ballkanike dhe të tjera. Serbia pasi nisi luftën me Bullgarinë, përfitoi nga rasti për të depërtuar në Shqipëri. Pas disfatave në fillim trupat gjermane, austro-hungareze bashkë me Bullgarinë arritën ta mposhtin armatën serbe (Schmitt, 2012, p. 143). Trojet shqiptare gjatë këtyre viteve qëndruan nën pushtimin austro-hungarez dhe bullgar. Në tetor të vitit 1918 forcat Jugosllave kishin pushtuar hapësirën shqiptare, sipas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës. Pushtuesit Serbë shpejtuan të vendosnin “pushtetin civil” në viset e ripushtuara shqiptare, sepse kishin frikë se mos çështja e Kosovës do të vihej në rendin e ditës në Konferencën e Versajës. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2007, p. 444)

2.1.2. Marrëveshja Sykes – Picot dhe Deklarata e Balfourit

Krijimi i shteteve të reja arabe dhe raportet ndërmjet tyre, do të vareshin nga ndikimet dhe interesat e Fuqive të Mëdha. Rol të rëndësishëm në Lindjen e Mesme do të luante Britania e Madhe. Fati i palestinezëve dhe izraelitëve do të lidhej edhe me qasjet e Britanisë së Madhe.

Në maj të vitit 1916 në marrëveshjen Sykes-Picot u ra dakord për t'i dhënë Britanisë së Madhe Irakun dhe Haifan në Palestinë. Ndërsa Libani dhe Siria u vendosën nën kolonializmin francez. Palestina do të mbetet nën mbikëqyrjen ndërkombëtare për shkak të mospajtimeve dhe dëshirave të të gjitha palëve për të kolonizuar këtë perlë të Mesdheut. (Salih D. M., 2002)

Kjo marrëveshje do të krijonte mundësi të realizimit të ideve mbi Palestinën, si territor në të cilin do të realizoheshin pretendimet sioniste për ndërtimin e shtetit Hebre të Izraelit.

Më 2 nëntor të vitit 1917, Ministri britanik i punëve të jashtme Arthur James Balfour me një letër drejtuar baronit Rothschild paraqet qëndrimin se Qeveria Britanike e sheh Palestinën si shtëpi kombëtare për popullin hebre dhe do të bëjë ç'është e mundur për të lehtësuar arritjen e këtij objekti, kuptohet qartë se asgjë nuk do të bëhet që mund të dëmtojë të drejtat civile dhe fetare të bashkësive ekzistuese jo-hebraike në Palestinë apo të drejtat dhe statusin politik që gëzojnë hebrenjtë në çdo vend tjetër. (Jewish Virtual Library, 2018)

Deklarata e Balfourit shihet si rast tepër me rëndësi në botën hebraike. Nga ky moment e tutje, izraelitët do të fillonin konkretizimin e ideve të tyre për shtetin e ri në territoret palestineze, edhe pse jetësimi i synimeve të tyre ishte shumë i vështirë.

Që para fillimit të luftës çifutë të shumtë kishin emigruar në Palestinë; megjithatë më 1914, ata përfaqësonin vetëm një të dhjetën e popullsisë (Grimberg, 2005). Kur deklarata u botua si letër e lordit Balfour dërguar lordit Rothschild, që sipas Golda Meir ishte gurthemeli i shtetit hebraik, në të njëjtën kohë trupat britanike të prira nga gjenerali Allenby filluan ta pushtojnë Palestinën nga osmanlinjtë (Sinani, 2010, p. 45). Sikur shqiptarët e Kosovës, edhe palestinezet po përjetonin fatin e njëjtë në territore të ndryshme. Për ta do të diskutohej në nivele të larta botërore dhe çështja e tyre varej nga interesat e Fuqive të Mëdha.

2.1.3. Konferenca e Paqes në Paris, San Remo dhe Sistemi i Mandateve

Më 18 janar 1919, u hap në Versajë Konferenca e Paqes; pikërisht kjo do t'i jepte formë shtetit të Jugosllavëve (Castellan, 1997, p. 422). Çështja e territoreve osmane në vendet arabe do të ishte debat i nxehtë në këtë takim vendimmarrës ndërkombëtar. Në Paris do të diskutohej edhe çështja e territoreve të tjera osmane në vendet arabe. Në këtë konferencë shqiptarët ishin paraqitur me disa delegacione, por kryesori ishte ai i qeverisë së Durrësit i cili kishte përcjellë disa kërkesa në konferencë. Në mes të tjerash ishte edhe kërkesa që t'i ktheheshin shtetit shqiptar viset shqiptare që i ishin dhënë Serbisë me vendimet e konferencës së Londrës të vitit 1913 (Culaj, 2010, p. 87). Dobësia e paraqitjes së shqiptarëve në Paris ishte edhe mungesa e unifikimit të përfaqësuesve të tyre, por nuk ishte përcaktuese për vendimet që do t'i nxirrte konferenca.

Duke shpresuar se Konferenca e Versajës do t'i bashkonte trojet e robëruara shqiptare e shtetin e pavarur shqiptar, kërkohej që të caktohej një komision amerikan, i cili do të hulumtonte padrejtësitë që u ishin bërë shqiptarëve në këto vise (Historia e Popullit Shqiptar III, 2007, p. 460). Duke parë zhvillimet dhe pretendimet e Italisë, përfaqësuesit e Jugosllavisë përmes memorandumit të paraqitur për Shqipërinë thanë "interesi i përgjithshëm, paqja dhe qetësia në Gadishullin Ballkanik kërkojnë që territori shqiptar me kufijtë që i caktoi Konferenca e Londrës, të formojë një shtet të pavarur në përputhje me frymën e vendimeve të kësaj Konference" (Çami & Verli, 2015, p. 122). Loja politike serbe me këso qëndrimesh tentonte të shmangte pretendimet e Italisë dhe të mënjanonte diskutimet për Kosovën dhe trojet tjera të ndara shqiptare. Nga Konferenca e Versajës trojet shqiptare mbetën të ndara.

Më 1919-1920 territore të tjera shqiptare po bëheshin kurban për hir të vendosjes së një balance ndërmjet fituesve të luftës në pellgun e Adriatikut dhe më gjerë (Culaj, 2010, p. 292). Konferenca nuk ofroi rezultatet e pritura për shqiptarët dhe si rrjedhojë ajo legalizoi pretendimet e Serbisë mbi Kosovën.

Duhet të theksojmë se në bazë të shënimeve zyrtare serbe, të KMKK dhe të shënimeve të mbledhura në terren, del se, vetëm në periudhën tetor 1918-1921, në rajonet e Kosovës kishin ndodhur mbi 12,346 vrasje, mbi 22,160 persona ishin burgosur, 1,635 ishin rrahur dhe mbi 6,125 shtëpi ishin djegur ndërkaq 10,515 shtëpi të tjera ishin plaçkitur (Rushiti, 1995, pp. 93-94).

Konferenca e Paqes në Paris nuk solli ndonjë risi, të dhënat e mësipërme tregojnë për përkeqësim të jashtëzakonshëm të gjendjes së popullsisë shqiptare nën sundimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene.

Sikurse shqiptarët, edhe arabët, u paraqitën me disa delegacione në konferencë, ndërkaq Lëvizja Sioniste ishte aktive në avokimin e ideve të tyre për shtet që bazoheshin në premtimin e Balfourit.

Gjendja e palestinezëve po ashtu nuk ishte e mirë në periudhën midis dy Luftërave Botërore dhe se vendimet e pikëpamjet e Fuqive të Mëdha nuk përputheshin me kërkesat e dëshirat e tyre. Po ashtu, me ndikim do të ishin edhe liderët e shtetit arab siç ishte në atë periudhë Amir Faisal.

Në Konferencën e Paqes në Versajë Faisali u përpoq të forconte pozitën e tij në Siri. Kërcënimi më i madh ndaj pushtetit të tij vinte prej premtimit tjetër të dhënë nga Britania në kohë lufte. Faisal ra dakord me Deklaratën e Balfourit dhe në janar 1919 nënshkroi një marrëveshje me liderin sionist Chaim Weizmann duke i lëshuar Palestinën lëvizjes sioniste me kusht që kërkesat e tij për një Mbretëri Arabe të pranoreshin nga Fuqitë evropiane (Fawcett, 2005, p. 34). Gjatë një paraqitje në Këshillin Suprem të Konferencës së Paqes së Parisit (6 shkurt 1919) ndër të tjera pranoi ndërhyrjen e huaj në Palestinë për të ndërmjetësuar midis kërkesave hebreje dhe arabe (Fawcett, 2005, p. 34). Paraqitja e tij në Konferencë tregonte gatishmërinë arabe për pranueshmërinë e hebrenjve në tokat palestineze.

Fati i Palestinës mbeti i diskutueshëm nga Fuqitë e huaja. Presidenti Amerikan Uillson dërgoi që prej qershorit, në Siri dhe në Palestinë, një komision hetimi amerikan (i ashtuquajtur i King-Crane) i cili dorëzoi raportin e tij, më 28 gusht. Ky raport ishte kundër programit sionist, sikurse edhe ndaj pretendimeve arabe mbi Silisinë. Ai shprehej në favor të sistemit të mandateve (Duroselle & Kaspi, 2011, p. 39). Sipas raportit të Komisionit King dhe Crane bënë thirrje për kufizime më të mëdha të kolonive sioniste në Palestinë, duke theksuar se “më shumë se 72 për qind – nga një total prej 1350 – e peticioneve në të gjithë Sirinë drejtoreshin kundër programit sionist”. (Fawcett, 2005, p. 36)

Mbretëria e Bashkuar, sikurse e përmendem më herët, e ndjekur edhe nga Franca, në këtë kohë do të bëheshin ndër fuqitë më vendimmarrëse evropiane për peizazhin e Lindjes së Mesme.

Fuqitë evropiane interesat e tyre do t'i ndanin përmes konferencave ndërkombëtare, kështu në Konferencën e San Remos, e mbajtur në vitin 1920, Lindja e Afërt do të ndahej në zona të kontrollit britanik dhe francez, ku Siria do të administrohej nga francezët, ndërsa Palestina nga britanikët. Mandati britanik mbi Palestinën do të ishte mandat i autorizuar nga Lidhja e Kombeve (Bilalli, 2011, p. 77). Arabët palestinezë nuk ishin paraqitur në San Remo, por ata i bënë ndjenjat e tyre të qarta në trazirat kundër hebrenjve që kishin shpërthyer në Palestinë dy javë më parë. (Macmillan, 2006, p. 484)

2.1.4. Kosova dhe Palestina deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore

Situata e shqiptarëve ndërmjet dy Luftërave Botërore, ishte mjaft e rëndë. Bazuar në dokumente dhe libra të ndryshëm mbi historinë e këtyre ngjarjeve, kjo periudhë ishte karakterizuar me lëvizje masive të popullsisë, raportet e tensionuara ndëretnike, zhvendosje të popullsisë mbi baza nacionaliste etj.

Serbët lirshëm vazhduan veprimet e tyre kriminale ndaj popullatës shqiptare duke bërë nxitjen dhe imponimet e shpërnguljeve të shqiptarëve nga Kosova për në Turqi ose në Shqipëri; derdhja e lumenjve të kolonistëve serbë dhe malazezë në drejtim të Kosovës; vendosja e formacioneve ushtarake në Kosovë (divizioni i Kosovës); sajimi i programeve për ndërrimin e strukturës etnike të popullsisë së Kosovës me mënyra dhe mjete nga më të çoroditurat (Zajmi, 1993, p. 242). Të gjitha këto veprime ishin të sinkronizuara në bazë të planeve zyrtare të qeverisë serbe përmes dokumenteve si “Nacertanie” e Ilia Garashaninit, Dekret ligji mbi Reformën Agrare dhe Kolonizimin, memorandumun “Dëbimi i Shqiptarëve” të Vasa Çubrilloviçit dhe dokumenteve të tjera.

Sipas të dhënave, Hakif Bajrami shkruan për afro 280 mijë shqiptarë të emigruar në Turqi në vitet 1919-1940 e mbi 28 mijë të tjerë në Shqipëri thuajse të njëjtën periudhë, ndërkaq Noel Malcolm jep një shifër më të ulët po për këto vite e që shkon nga 90-150 mijë (Milo, 2013, p.

864). Kolonizimi i Kosovës vazhdoi dhe vetëm në zbatim të platformës së Çubrilloviçit 13,938 familje u vendosën forcërisht si kolonë në Kosovë deri në vitin 1935 si dhe mijëra shtëpi u ndërtuan për kolonët në Kosovë (Bashkurti, 2008, pp. 111-112). Nga mbi 80-90% shqiptarë që ishte përbërja e popullsisë në vitin 1912 në trojet etnike shqiptare në vitin 1941 ajo kishte rënë në 60-70% (Verli, 2014, p. 29).

Shqiptarët e Kosovës përgjatë kohës, përmes mekanizmave të ndryshëm organizativ kërkuar udhëheqje të pavarur dhe liri në veprimet e tyre. Në këtë periudhë kohore në Kosovë kishte shtrirë ndikim edhe Partia Komuniste Jugosllave, idetë e së cilës i kishin përqafuar një numër i konsiderueshëm i banorëve duke pretenduar në të drejtën për vetëvendosje të popujve. Vlen të përmendet edhe kërkesa e organizatës së partisë në Kosovë, që të kishte Komunitetin e vet krahinor, si organin më të lartë politik dhe udhëheqës, që filloi të realizohej që nga viti 1937. (Lipa, 1993, p. 214)

Me shpartallimin e Jugosllavisë më 1941, trojet shqiptare të ish-Jugosllavisë u copëtuan në tri shtete, në bazë të marrëveshjes së Vjenës të ministrave të Punëve të Jashtme të Gjermanisë dhe Italisë (Rexhepi, 1993, p. 201). Në këtë periudhë kohore u thirr edhe një Kuvend i Shqiptarëve në Prizren, i njohur si Lidhja e Dytë e Prizrenit. Kuvendi u mbledh në Prizren, nga data 16-20 shtator 1943. Në të morën pjesë 45 delegatë të zgjedhur nga Kosova dhe trevat tjera shqiptare. Lidhja kishte edhe organin e vet “Lidhja e Prizrenit”, në faqen e të cilit propagandohej ideja e krijimit të Shqipërisë etnike dhe denoncoheshin krimet e kryera nga serbomëdhenjtë ndaj shqiptarëve të Kosovës (Historia e Popullit Shqiptar IV, 2008, p. 139). Qëllimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit nuk dallon nga organizimet paraprake të shqiptarëve. Ata zhvillonin organizimin për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve dhe bashkimin e trojeve kombëtare.

Shqiptarët e Kosovës dhe viseve të tjera në ish-Jugosllavi, duke u mbështetur në Kartën e Atlantikut, ku garantohej e drejta e popujve për vetëvendosje në bazë të pjesëmarrjes në luftën kundër fashizmit, në premtimet e PKJ dhe PKSH, iu përgjigjën thirrjes së PKJ për t’u hedhur në luftë të armatosur kundër fashizmit, më shpresë se do të realizonin të drejtën për vetëvendosje dhe për bashkim kombëtar (Rexhepi, 1993). Idetë për respektimin e parimit të vetëvendosjes, i nxitën shqiptarët në aktivitet. Ata filluan organizimin e tyre duke tentuar për të shfrytëzuar situatën e krijuar për realizimin e aspiratave të tyre kombëtare.

Një ndër aktet më të rëndësishme në historinë e re të popullit shqiptar në Kosovë, të miratuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, e përbën padyshim Rezoluta e Konferencës Krahinore Nacionalçlirimtare, që u miratua në Bujan, më 31 dhjetor dhe më 1 e 2 janar 1944 (Lipa, 1993).

Lufta e shqiptarëve kundër fashistëve e nxitur nga Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe Shqipërisë solli rezultatet e saj. Komunistët me një veprim nxitës realizonin dy qëllime: në njërin anë, banorët nuk pranonin fashistët dhe interesat e tyre dhe, në anën tjetër, të konsumonin energjinë e banorëve shqiptarë në mënyrë që pas përfundimit të luftës ata të mos kishin fuqi për të kundërshtuar idetë komuniste serbe për dominimin sllav të Kosovës.

Pas Konferencës së Bujanit dhe me mbarrimin e Luftës së Dytë Botërore, me mbizotërimin politik serb, çështja e Kosovës u orvat të mbyllej shpejt e shpejt. Pas rezolutës së Bujanit strukturat politike dhe ushtarake serbe filluan aktivitetin për të legjitimuar veprimet për aneksim të Kosovës. Ata organizuan *Konferencën e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e Metohisë* në Prizren, e cila u mbajt prej 8-19 korrik 1945. Nga 142 delegatë që morën pjesë në këtë Konferencë, vetëm 33 ishin shqiptarë. Aty u aprovua "*Projektrezoluta për aneksimin e Kosovës e Metohisë në Serbinë Federale*" (Arifi-Bakalli, 2015, p. 112). Veprime të tilla jo që nuk ishin në përputhje me rezolutën e parë të konferencës, por as me parimet bazë kombëtare të shqiptarëve. Shqiptarët që jetonin në territorin e Kosovës mbetën si pjesë pa status të definuar në Jugosllavi. Kjo nxiti zemërimin e mëtejshëm që kulmoi me rezistencë të armatosur në vitet 1998-1999.

Në dukje të parë, politikat e vendosjes së kolonëve në Kosovë e Palestinë, ishin mjete thuajse ngjashëm të përdorura për qëllime politike, demografike dhe krijimin e situatave të reja në terren.

Në vitin 1925, në Palestinë, u vendosën edhe rreth 35.000 kolonë hebre, apo e ashtuquajtura valë e katërt e Aliotëve (Bilalli, 2011). Në vitin 1929, organizata e quajtur Jewish Agency (Agjensioni Hebraik) kishte fituar statusin e përfaqësimit të të gjithë hebrenjve në Palestinë dhe ishte legjitime për mandatin britanik. (Bilalli, 2011).

Në gusht 1929, një incident i lidhur me "Murin e Vajtimeve" ishte shkak i një kryengritje të dhunshme kundër hebrenjve në disa qytete të Palestinës, ku u vranë rreth 133 prej tyre (Duroselle & Kaspi, 2011, p. 158). Në shtator të 1929 për të parë arsytet e rritjes së tensioneve u

themelua një komision i drejtuar nga Sir Walter Shaw, dhe gjeti se arsyet e konfliktit dhe trazirave ishin frika e arabëve nga mbetja pa tokë, dëbimi dhe sionizmi. Komisioni sugjeroi emigrim të kontrolluar hebre, një politikë saktësisht të përcaktuar arabe, dhe ndërprerje të dëbimit të arabëve nga transferimet e tokës. Sionistët u tronditën me konkluzionet e Shaw dhe kërkuan formimin e një komisioni të ri. Imigracioni hebre u pezullua përkohësisht dhe Kryeministri britanik Ramsay MacDonald bëri thirrje për një hetim të ri. (Harms & Ferry, 2005, pp. 98-99)

Pasi në këto territore kishin filluar komplikimet, u formua edhe një komision i ri. Komisioni Hope-Simpson dërguar nga Britania pak kohë më pas, theksoi problemin e rritjes së popullsisë arabe të pa tokë dhe rekomandoi kontrollin e blerjes së tokës dhe imigrimit hebre. Këto rekomandime janë sjellur përmes Letrës së Bardhë Passfield të vitit 1930 (Berry & Philo, 2006, p. 12). Megjithatë, këto zhvillime u konsideruan si një pengesë serioze nga sionistët që përmes lobimit arritën ti ndryshonin kushtet e Letrës së Bardhë. Ka pasur dy arsye që sionistët fuqimisht kundërshtuan rekomandimet e komisionit: së pari, ata donin ta mbanin Palestinën të hapur si një vend për imigrim masiv, posaçërisht duke pasur parasysh persekutimin e hebrenjve në Evropë dhe, së dyti, kishin frikë se pa imigrim masiv ata do të mbeten një pakicë brenda Palestinës nën kontrollin e shumicës arabe. (Berry & Philo, 2006, p. 12)

Ndërsa evropianët racistë i shtypnin hebrenjtë, ligjet diskriminuese të emigracionit perëndimor i kanalizonin në Palestinë, ku ata u bënë pjesë e një procesi kolonial që zhvendoste arabët. Jamal al Hussein, anëtar i një familje udhëheqëse palestineze i tha New York Times në qershor të vitit 1936: *"Na vjen keq për hebrenjtë në Evropë, por nuk mund të shohim se pse ne duhet të jemi viktimat të zgjerimit të tyre kolonial"*. (Davidson, 2001, p. 108)

Pas një rënie të përkohshme midis viteve 1927 dhe 1931, imigrimi hebre u rrit ndjeshëm prej vitit 1932 veçanërisht nga Polonia dhe zonat e afërta të saj. Në vitin 1933 u numëruan 37.337 imigrantë, 45.267 në vitin 1934, duke arritur kulmin në 66.472 të tjerë në vitin 1935. Gjatë vitit 1933, në Jerusalem dhe Jaffa pati demonstrata të mëdha arabe kundër valës në rritjes të imigrimit hebre të cilat u shtypën nga aksionet e policisë britanike. (Bose, 2007, pp. 219-220)

Dhuna sporadike ndezi një rebelim të plotë arab në vitet 1936 dhe 1939. Një pjesë e revoltës përfshinte rezistencë paqësore, duke përfshirë një grevë mbarëkombëtare gjashtëmujore dhe mospagesë të gjerë të taksave. Ajo gjithashtu përfshinte dhunë të gjerë në

të cilën palestinezët u formuan në grupe dhe shkatërruan pemët dhe kulturat bujqësore, minuan rrugët dhe sabotuan infrastrukturën dhe tubacionet e naftës. Ata sulmuan dhe vranë hebrenjtë, dhe gjithashtu synonin arabë që nuk ofruan mbështetje ose që dyshoheshin për bashkëpunim. (Berry & Philo, 2006, p. 13)

Situata e krijuar bëri që të formohet edhe një komision tjetër për të vlerësuar gjendjen. Komisioni Peel me raportin e tij të vitit 1937 konsideroi mandatin e paarritshëm dhe në fund të fundit sugjeroi që zgjidhja e konfliktit ishte ndarja e Palestinës në shtete të ndara arabe dhe hebraike. Çifutëve ju caktua 20 për qind e territorit, zona veriore dhe bregu i sipërm. Arabëve iu dha pjesa tjetër e Palestinës duke u bërë pjesë e Transjordanisë (Harms & Ferry, 2005). Komiteti i Lartë Arab, i formuar në vitin 1936 nga disa parti politike arabe si një zë për interesat arabe, e quajti propozimin e ndarjes një shkelje të të drejtave natyrore të arabëve dhe të vetëvendosjes së tyre. Agjencia hebraike e përshëndeti atë, por nuk e braktisi qëllimin e saj për të marrë të gjithë Palestinën. (Quigley, 2005, p. 24)

Aktiviteti diplomatik nuk u ndal, por edhe ndërhyrja me forcë nuk përjashtohej. Pas pakënaqësive të palëve, trazirave arabe dhe jo qëndrueshmërisë politike, Mbretëria e Bashkuar detyrohet të paraqes një qëndrim të ri përmes një letre tjetër të bardhë. Kështu, kryengritja u përtëri me rritje të furishme, vetëm se tani ajo u drejtua gjithashtu edhe kundër Myftiut, opozitës së brendshme arabe e veçanërisht Nashashibit. Nga ana e tyre, britanikët përpiqeshin të qetësonin situatën përmes përdorimit të njëkohshëm të karotës dhe shkopit. Nga njëra anë, ata e shtypën kryengritjen me forcë të ashpër - duke imponuar dënime kolektive, duke bombarduar fshatrat dhe duke ekzekutuar guerilët. KLA-ja ishte e jashtëligjshme, dhe myftiu i cili u shkarkua nga presidenca e Këshillit Suprem Musliman, u largua nga vendi së bashku me disa nga krerët kryesorë të tij. (Karsh, 2002, p. 17)

Më tej, britanikët përpiqeshin të mbanin edhe anën e palestinezëve, me disa deklarata, qëndrime e duke ushqyer shpresa të reja politike.

Qeveria Britanike, në maj të vitit 1939 lëshoi një letër të bardhë si deklaratë e re politike. Brenda dhjetë vjetësh në Palestinë duhet të ekzistojë një shtet i pavarur për t'u "qeverisur në mënyrë të tillë që të sigurojë që interesat thelbësore të çdo komuniteti të mbrohen". Imigrimi i

hebrenjve duhej të kufizohej në një total prej 75,000 për pesë vitet e ardhshme, dhe pas kësaj nuk do të kishte më imigracion pa pranimin e bashkësisë arabe. (Quigley, 2005, p. 27)

Por as palestinezët, e as hebrenjtë, nuk ishin të kënaqur me zhvillimet, madje as me britanikët, që për shumicën e arabëve, konsideroheshin në anën e izraelitëve.

Agjencia Çifute politikën e re e mori si braktisje të Sionizmit dhe e zemëruar e refuzoi atë. Agjencia theksoi se "hebrenjtë do të luftonin në vend se t'i nënshtroheshin sundimit arab"... u organizuan demonstrata masive brenda qytetit. Agjencia hebraike filloi të organizonte një krah ushtarak për të luftuar ushtrinë britanike, dhe Irgun mori përsipër një seri sulmesh me bomba që kishin për qëllim arabët - si në shtëpi filmike, në kafene, në sheshe publike. (Quigley, 2005, p. 27)

Ngjarjet e këtilla ndikuan jo mirë në raportet politike në mes të britanikëve dhe izraelitëve. Sionistët filluan të kërkonin shtigje të reja që do të ndikojnë në përkrahjen e qëllimeve të tyre.

Në maj të vitit 1942, sionistët u takuan në New York për të mbajtur Konferencën Sioniste Amerikane, ku nxorën Rezolutën e Biltmore-it, duke kërkuar krijimin e një "Republike Hebraike" në të gjithë Palestinën, dhe filluan të ushtrojnë presion ndaj udhëheqësve politikë amerikanë për të mbështetur kushtet e saj. (Berry & Philo, 2006, p. 19)

Sionistët orientuan lobimin e tyre në SHBA si fuqia e re botërore dhe kjo do të ishte ndër aleancat më të forta deri në ditët e sotme.

Nga viti 1944 e tutje Irgun dhe dega e saj edhe më militare, Stern Gang, kreu një valë sulmesh me bomba dhe vrasje kundër zyrtarëve dhe personelit britanik, duke arritur kulmin në vitet 1946 dhe 1947. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, çështja e Palestinës mbeti në harresë, duke pritur zgjidhjen (Bose, 2007, p. 233). Pas dështimit të negociatave në Konferencën e Londrës, më 18 shkurt të vitit 1947, e irrituar nga kushtet serioze të përkeqësimit në Palestinë dhe bllokimi në Konferencë, Britania e referoi Palestinën në OKB pa rekomandime për të mbrojtur marrëdhëniet e saj me të dyja palët. (El-Eini, 2006, p. 364)

2.1.5. Kosova si provincë autonome në Jugosllavi dhe krijimi i Izraelit

Statusi i Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, dhe me krijimin e Jugosllavisë, ndryshoi nëpër periudha të ndryshme historike.

Pas shtypjes së kryengritjeve dhe përndjekjes së kundërshtarëve të idesë për bashkim të Kosovës si krahinë e Serbisë në Jugosllavi, Titoja tentoi që me disa veprime të qetësoj shqiptarët në kuadër të Jugosllavisë. Në kuadër të këtyre veprimeve futet edhe krijimi i Trevës Autonome të Kosovës dhe Metohisë në kuadër të Serbisë brenda Jugosllavisë, i bazuar në vendimin që nxori në Prizren Këshilli Nacionalçlirimtar i Kosovës. Përfundimisht, më 3 shtator 1945, ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë, “Mbi caktimin dhe ndërtimin e Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë” sanksiononte juridikisht Kosovën si njësi autonome. Ky sanksionim përsëritej edhe në Kushtetutën Jugosllave të janarit 1946. (Historia e Popullit Shqiptar IV, 2008, p. 342)

Të drejtat e shqiptarëve të Kosovës një vit pas Luftës së Dytë Botërore ishin mjaft të kufizuara në vendimmarrje, por edhe në përdorimin e simboleve kombëtare, gjuhës dhe arsimimit.

Me kushtetutën e vitit 1946 Kosova ishte si njësi autonome në kuadër të Serbisë, megjithëse nuk kishte përparim në përdorimin e gjuhës dhe shkollave. Kosovë-Metohia u rendit si Rajon Autonom, ku njësive të saj administrative vendore iu mohua çdo lloj vendimmarrje e pavarur; nuk kishte as legjislaturë të pavarur, as Gjykatë të Lartë si Vojvodina (Vickers, 2004, pp. 183-184). Kjo kushtetutë bëri që shqiptarët të vazhdojnë kundërshtinë e tyre ndaj komunistëve serbë e jugosllavë. Ata nuk panë se me këtë kushtetutë po realizoheshin premtimet e komunistëve dhe u ndien të fyer e tradhtuar. Burime të ndryshme shqiptare llogarisin që gjatë viteve 1944-46, 36 mijë deri ndoshta 47 mijë shqiptarë ishin viktimat e ekzekutimeve sistematike masive nga komunistët gjatë ditëve të etheve revolucionare, dhe më vonë të misionëve ‘kërko dhe shkatërro’ dhe programeve të ‘paqëtimit’, ‘çarmatosjes’ dhe ‘rehabilitimit’, torturave të policisë dhe epidemive të tifos që kapnin njësitë ushtarake. (Vickers, 2004, p. 185)

Statusi politik, juridik, ekonomik dhe kulturor i shqiptarëve të Kosovës, pas vitit 1945 kur edhe përfundoi Lufta e Dytë Botërore varej direkt dhe indirekt nga marrëdhëniet bilaterale dhe

multilaterale të ish-Jugosllavisë me ish-Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e tjera komuniste, duke përfshirë edhe shtetin amë të shqiptarëve të Kosovës.

Titoja si udhëheqës komunist mbante raporte të shkëlqyera me Stalinin, Enver Hoxhën dhe liderët tjerë komunistë. Bashkëpunimi i ngushtë i tyre cenohej herë pas here për shkak të mos përshtatjes së interesave. Situata në Kosovë ndryshonte prej politikave rajonale, prandaj, nuk kishte stabilitet të qëndrueshëm. Fushata e organizuar antishqiptare shtetërore jugosllave u thellua dhe pas *Rezolutës të Byrosë Informative* (qershor 1948) me ç’ rast Jugosllavia përkatësisht Partia Komuniste e Jugosllavisë u përjashtua nga kjo organizatë politike, që do të thoshte shkëputje dhe armiqësi me Bashkimin Sovjetik dhe armiqësi të hapur me Shqipërinë. (Arifi-Bakalli, 2015, p. 113). Kjo ndikoi në rritjen e agresivitetit serb ndaj shqiptarëve të Kosovës, si rezultat i dyshimeve të tyre të trilluara për bashkëpunim me agentë të Shqipërisë komuniste. Për këtë u ndërmorën shumë aksione, u bënë ndjekje, u zhvilluan tortura dhe u dënuan individë e grupe të ndryshme të shqiptarëve në Kosovë.

Në këtë periudhë kohore situata politike reflektoi edhe atë socio-ekonomike. Në këtë mënyrë u hap rruga për serbët që të shfrytëzonin situatën për të vazhduar idetë për spastrimin etnik të shqiptarëve. Ideja e Vasa Çubriloviq, për ndryshimin e strukturës demografike në Kosovë vazhdoi me regjistrimin e shqiptarëve si turq e më pas edhe me nisjen e shpërnguljeve masive të tyre. Kështu vlerësohet se mes viteve 1945 dhe 1966, përafërsisht 246 mijë veta emigruan në Turqi nga mbarë Jugosllavia. (Malcolm, 2011, p. 407)

Një nga periudhat mjaftë të rënda për qasjen jugosllave ndaj shqiptarëve të Kosovës, konsiderohet ajo që shpesh populli i referohet si “koha e Rankoviçit” – ish-Ministrit të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë. Në këtë kohë është i njohur edhe aksioni famëkeq i grumbullimit me forcë të armëve. Kjo periudhë ishte mjaft diskriminuese ndaj shqiptarëve të Kosovës, sikurse e pohon autori Lazar Nikolić.

Periudha midis viteve 1945 dhe 1966 u karakterizua nga dominimi i grupeve komuniste serbe dhe diskriminimi ndaj shqiptarëve, dhe me largimin nga Kosova gjatë luftës të një pjese të serbëve kthimi i të cilëve u pengua më pas nga Partia Komuniste e RSFJ-së (Nikolić, 2005, p. 58).

Se çfarë të drejta do të kishin shqiptarët e Kosovës dhe çfarë vendimmarrjesh, do të varej edhe nga vetë koncepti i organizimit administrativ. Federatat socialiste si ish-RFJ, kishin karakter

centralizmi, ku një qendër pushteti kontrollonte të gjitha nivelet e tjera hierarkike dhe kjo ndikonte edhe në kundërshtimin e bartjes së vendimmarrjes nga lart-poshtë, përkatësisht kundërshtoj transferi i kompetencave të gjera të vendimmarrjes për shqiptarët e Kosovës e të tjerët. Ligjet jugosllave kishin karakter kontroll centralist.

Ligji Kushtetues i RFP të Jugosllavisë i vitit 1953 sanksiononte procesin e decentralizimit që kishte filluar në RFP të Jugosllavisë dhe në bazë të të cilit një pjesë të të drejtave të federatës kalonin në republikat e federuara, duke zgjeruar kompetencat e tyre. Konkretisht për RAKM, lidhjet e tij me Federatën Jugosllave u dobësuan, ndërsa kontrolli i RP të Serbisë mbi të u rrit (Historia e Popullit Shqiptar IV, 2008, p. 345). Kjo periudhë ishte tepër e rëndë për shqiptarët. Periudha më e keqe për shqiptarët e Kosovës në Jugosllavinë Socialiste ishte 1953-56, kulmi i fushatës për 'riatdhesim' në Turqi dhe shoqërimi i saj me terrorin policor. (Clark, 2000, p. 37) Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1963 e forcoi më tej tendencën e shndërrimit të RAKM në subjekt ekskluziv të Republikës Serbe. Zgjerimi i mëtejshmë i të drejtave të Serbisë, si republikë, gjatë procesit të decentralizimit të federatës, nuk u shoqërua dhe me zgjerimin e të drejtave të RAKM. (Historia e Popullit Shqiptar IV, 2008, p. 346)

Kjo kushtetutë në raport me Kosovën kishte mjaft kufizime, përmes të cilave Serbia rriste kontrollin mbi Kosovën. Po ashtu, u bë edhe një ndarje tjetër të shqiptarët e Kosovës, vija etnike tejkalonte vijën klasore.

Kjo solli një ndarje në shoqërinë shqiptare midis udhëheqësve të Partisë Komuniste lokale dhe masave që nuk e duruan brutalitetin e policisë. Kështu, identiteti kombëtar mbeti më i fortë se ndjenjat e klasës. (Nikolić, 2005, p. 59)

Karakter i Federatës Socialiste të ish-Jugosllavisë, pavarësisht se ishte me theks të veçantë centralist ajo do t'i përshtatej rrethanave dhe zhvillimeve lokale politike.

Në vitin 1966 ajo u klasifikua si një provincë autonome. Sidoqoftë, megjithëse Jugosllavia ishte konstituuar si federatë, ishte pothuajse e pakonceptueshme që nën "centralizmin demokratik" republikat dhe provincat autonome mund të ndikonin në vendimet e qeverisë federale komuniste. Vetëm presioni përmes kërkesave në rritje për pavarësi rajonale dhe kombëtare, bëri që partia dhe shteti gradualisht të federalizohen nga fundi i viteve '60-ta. (Calic, 2000, p. 21)

Periodha pas shkarkimit të Rankoviçit prej vitit 1966 e deri në demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, për shqiptarët shënon kthesa të mëdha në zgjerimin e të drejtave kombëtare, kushtetuese, politike, arsimore dhe kulturore. Në historinë e kaluar 100 vjeçare të Kosovës, kjo mund të vlerësohet si periodha më e artë e të drejtave të shqiptarëve, të cilën e tejkalon vetëm periodha e fundit e çlirimit dhe lirisë pas vitit 1999, kur edhe kulmoi me shpalljen e deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Atmosfera politike në Kosovë u bë dukshëm më e lirë dhe më e relaksuar pas përjashtimit të Aleksandar Rankoviç në korrik 1966. Rënia e Rankoviçit u perceptua si një pengesë serioze për serbët, kjo rriti besimin kosovar si dhe paranojën serbe. (Bideleux & Jeffries, 2007, p. 528)

Dy vjet pas ikjes së Rankoviçit, shpërtheu entuziazmi për kërkesat politike nga shqiptarët në Kosovë, të cilat u manifestuan edhe me demonstratat e njohura të vitit 1968.

Nga fundi i vitit 1968, studentët - disa që shënuan njëqindvjetorin e Skënderbeut me simbolin e shqiponjës dykrenarëshe - ishin në rrugë duke kërkuar “Duam Republikë” dhe duke thirrur slogane pro-Tiranase. Gjatë demonstratave të tetorit dhe nëntorit të vitit 1968, në gjashtë qytete të Kosovës kishte përleshje të dhunshme, madje në Prishtinë policia vrau një student demonstrues. (Clark, 2000, pp. 38-39)

Por le t’i kthehemi menjëherë rrethanave pas Luftës së Dytë Botërore në territorin e Palestinës, për të tërhequr krahasimet me situatën politike të shqiptarëve në Kosovë.

Pas dërgimit të çështjes së Palestinës në OKB nga Britania e Madhe, më 29 nëntor të vitit 1947, tridhjetë vite që kur ishte proklamuar Deklarata e Balfourit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së do ta miratonte planin për ndarjen e Palestinës. Më 29 nëntor të vitit 1947 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi rezolutën për ndarjen e territorit të Palestinës në dy shtete atë Arab dhe Hebre. Rezoluta përcakton rrugën deri te pavarësia e shteteve, territoret e tyre dhe statusin e veçantë juridik të qytetit të Jerusalemit. (United Nations, 1947)

Në vitin 1948, gjersa në Kosovë, ishte etabluar tashmë pushteti i ish-Jugosllavisë dhe Partisë Komuniste Jugosllave, në Palestinë po kundërshtojë rreptë dhe me forcë krijimi i shtetit të Izraelit i cili po këtë vit bëri edhe datën zyrtare të lindjes së shtetit të ri. Po këtë vit të shumëpritur të izraelitëve, shqiptarët e Kosovës e përjetuan edhe një moment të ri kompleks në

marrëdhëniet me shtetin e tyre amë, pas prishjes së marrëdhënieve në mes të ish-Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë të udhëhequr nga Enver Hoxha.

Gjendja në territorin e Palestinës ishte e tensionuar dhe tashmë kishte filluar lufta në mes të hebrenjve dhe arabëve palestinezë. Në ditën kur trupat britanike u larguan nga Palestina, në mbrëmjen e 14 majit të vitit 1948, David Ben-Gurion lexoi Deklaratën e Themelimit të Shtetit të Izraelit në muzeun e Tel Avivit. Deklarata e balanconte me kujdes legjitimitetin e shtetit në bazë të pretendimeve historike dhe mënyrës se si këto ishin njohur nga bashkësia ndërkombëtare (Strawson, 2010, p. 133). Kjo do të nxiste reagime të ashpra në mesin e shumicës së arabëve dhe në Lindjen e Mesme në përgjithësi.

Më 15 maj të vitit 1948, trupat ushtarake të Egjiptit, të Transjordanisë, Sirisë, Irakut dhe Libanit do të sulmonin bazat izraelite. Edhe pse me një fuqi numerike më të madhe se sa forcat e mbrojtjes së Izraelit, koalicioni i shteteve arabe do të përjetonte një disfatë të turpshme. (Bilalli, 2011, pp. 80-81)

Deri në kohën e arritjes së marrëveshjeve të armëpushimit me vendet fqinje në vitin 1949, Izraeli kishte zgjeruar kontrollin e tij mbi disa zona, që në planin e ndarjes së OKB-së të vitit 1947 u caktuan në shtetin e mundshëm arab (DellaPergola, 2015, p. 5). Arabët e humbën luftën dhe i krijuan Izraelit mundësinë për zgjerimin e territorit, e cila do të shkaktonte lëvizje të mëdha të popullsisë palestineze, të cilat edhe do të regjistroheshin si pjesë e kujtimeve tragjike kolektive.

Në po të njëjtin vit, rreth 750,000 palestinezë ikën nga shteti i ri i Izraelit në të ashtuquajturën *naqbah* (katastrofa); numri i fshatrave të tyre të braktisura ose të shkatërruara vlerësohet në mes të 250 dhe 530 sosh. Institucionet që patën mandatin në administratë u absorbuan në shtetin e ri izraelit, kufijtë e të cilit përfshinë rreth 80 përqind të zonës tokësore të Palestinës së Mandatit Britanik (20,700 km², duke përfshirë 12,000 km² të shkretëtirës Negev). (Home, 2008, pp. 195-296)

Gjatë luftës reagues edhe Kombet e Bashkuara me Rezolutën 212 të nëntorit të vitit 1948, përmes së cilës falënderuan shtetet dhe organizatat për ndihmën e ofruar dhe kërkuan që të ndihmohet tutje në shpëtimin e jetëve të qenieve njerëzore, në mënyrë që të shmanget katastrofa. Kërkohet të ndahet një shumë e konsiderueshme e mjeteve si ndihmë për refugjatë,

gjithashtu u bënë thirrje shteteve që të kontribuojnë me fondet e tyre vullnetare. (United Nations, 1948)

Gjithashtu, pak ditë më vonë OKB-ja miratoi Rezolutën 194 të dhjetorit të vitit 1948 me anë të së cilës formon një komision të pajtimit, i cili do të zhvillonte negociata në mes të palëve në konflikt, për të gjetur një zgjidhje përfundimtare. Kjo rezolutë vendosë që vendet e shenjta të jenë të qasshme, të lira dhe të mbrojtura; Jerusalemi dhe pjesët e tjera rreth tij të kalonin nën kontroll të OKB-së. Gjithashtu, vendoste që refugjatët e interesuar të ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe të jetonin në paqe, dhe atë, në afate sa më të hershme kohore, autoritetet përgjegjëse do të duheshin të paguanin kompensimin për pronat e humbura ose të dëmtuara. (United Nation, 1948)

Izraeli një vit pas krijimit si shtet, u bë anëtar i OKB-së. Përderisa Palestina ishte shndërruar në një arenë përplasjesh, shteti hebre po forcohej. Izraeli ndërkohë u njoh nga një numër në rritje i shteteve dhe u bë anëtar i Kombeve të Bashkuara në vitin 1949. (Strawson, 2010, p. 153)

Të kundrojmë edhe se si ishte situata politike në Palestinë, veçmas në dy dekadat e para të pas-Luftës së Dytë Botërore. Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës u bënë njësi gjeografike të veçanta si rezultat i armëpushimit të vitit 1949 që ndau shtetin e ri hebraik të Izraelit nga pjesët e tjera të Palestinës së Mandatit. Në vitet 1948-67, Bregu Perëndimor, duke përfshirë Jerusalemin Lindor, ishte qeverisur nga Jordania, e cila aneksoi zonën në vitin 1950 dhe zgjeroi shtetësinë të palestinezët që jetonin atje. (Beinin & Hajjar, 2014, p. 17)

Një ngjashmëri në mes të Kosovës dhe Palestinës në këtë periudhë, ishte sa i përket ndalimeve të rrepta të kalimit ndërkufitar e ndërfaqinjësor. Edhe shqiptarët e Kosovës për shkak të shkëputjes së raporteve diplomatike të Jugosllavëve socialistë me udhëheqësinë komuniste të Shqipërisë do të kishin pasoja të rënda, nëse do të kalonin kufirin. Ngjashëm me ta, Izraeli kishte raporte të tejtensionuara me fqinjët, njësoj siç kishte Jugosllavia me Shqipërinë. Këto relacione do të ndikonin edhe në fatin e palestinezëve dhe shqiptarëve për ekskomunikim me fqinjët, edhe për nga përkatësia e tyre etnike, fetare dhe kulturore ishin të njëjtë.

Shtetet arabe vendosën bojkote ekonomike, kurse Egjipti i ndaloi anijet izraelite të kalonin përmes kanalit të Suezit ndonëse ai lejonte kalimin e anijeve të huaja të paracaktuara për të

shkuar në Izrael. Midis viteve 1948 dhe 1956, tensionet ndërkufitare ishin të forta dhe shkaktuan përplasje të herëpashershme midis Izraelit dhe fqinjëve të tij: Sirisë, Jordanisë dhe Egjiptit. (Fawcett, 2005, p. 220)

Në Lindje të Mesme dhe Palestinë, në këtë periudhë kohore, ngjanin shumë zhvillime dramatike, duke u destabilizuar një pjesë e madhe e rajonit, e jo vetëm territoret izraelito-palestineze. Rol me rëndësi luante Kanali i Suezit si një nga zonat më gjeostrategjike.

Në kohën e fushatës Sinai të vitit 1956, Franca dhe Britania luftuan së bashku me Izraelin kundër shtetëzimit të Kanalit të Suezit nga Egjipti. (Yacobi & Newman, 2004, p. 181)

Izraeli dhe Palestina, por edhe Jugosllavia e Kosova, do të vareshin shumë edhe nga zhvillimet globale, e veçanërisht konfliktet e sundimit politik e ideologjik, ndërmjet Lindjes Komuniste dhe Perëndimit kapitalist e demokratik.

Forcat izraelite kapën Gazën dhe Gadishullin e Sinait, por u detyruan të evakuhon përsëri në linjat e armëpushimit, si rezultat i presionit të OKB-së të udhëhequr nga SHBA dhe Bashkimi Sovjetik (në një shfaqje jo-karakteristike të bashkëpunimit për të shmangur konfliktet e mëtejshme në Lindjen e Mesme). Deri në fillim të viteve 1960, megjithatë, rajoni po bëhej një vend i nxehtë i rivalitetit të Luftës së Ftohtë, pasi SHBA dhe Bashkimi Sovjetik po konkurronin me njëri-tjetrin për fuqinë dhe ndikimin global. (Beinin & Hajjar, 2014, p. 16)

Në këtë kohë, përpjekjet palestineze, ashtu siç ishin përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës u bënë për zgjerimin e të drejtave politike dhe ndryshimin e statusit të tyre, por me një dallim të konsiderueshëm të palestinezëve, të cilët aktivitetin e tyre e nisën në mërgatë, duke krijuar organizatën më me ndikim në jetën e palestinezëve, Lëvizjen Fatah. Ndërkohë, fillimet e organizimit, mobilizimit dhe rezistencës masive ndaj ish-Jugosllavisë, nga shqiptarët e Kosovës, pikërisht në mërgatë, do të nisnin në fillim të viteve të '90-ta të shekullit XX, rreth tri dekada më vonë se ajo e palestinezëve.

Ndërkohë, në Palestinë po zhvilloheshin lëvizje të reja nga të cilat u formuan Lëvizja Fatah dhe Organizata për Çlirimin e Palestinës. Lëvizja Fatah u krijua në Kuvajt (1959) nga një grup refugjatësh palestinezë të kryesuar nga Yasser Arafat, në dritën e zhgënjimit në rritje të lidërshit tradicional palestinez dhe mungesës së promovimit të problemit palestinez nga shtetet arabe. Lëvizja u zhvillua dhe u identifikua me Doktrinën e Luftës së Armatosur. (The Reut Institute, 2006)

Gjatë viteve pati tensione të vazhdueshme në mes të palëve në konflikt. Në vitin 1967 arabët me retorikën e tyre tentuan që të hakmerreshin ndaj hebrenjve pas disfatës së vitit 1956. Manovrat pararendëse të Nasserit janë bërë të shumta, duke kërkuar tërheqjen e forcave paqeruajtëse të OKB-së të futura në Gadishullin e Sinait, si pjesë e shkëputjes pas vitit 1956. (Chan, 2017, p. 54)

Pas saj ai vazhdoi, më 22 maj, njoftoi vendimin që do të bëhej shkaku i drejtpërdrejtë i Luftës së Gjashtë Ditëve: mbylljen e Ngushticave të Riranit në hyrje të Gjirit të Akbës për transportet izraelite, duke bllokuar kështu edhe një herë tjetër portin e Elatit. (Stoessinger, 2015, p. 265)

Veprimi popullor i udhëheqësit të Egjiptit u ndërkombëtarizua dhe situata tensionuese dhe kundër hebrenjve në rajon bëri që Izraeli të përgatitej për t'u mbrojtur nga një sulm eventual i shteteve arabe. Pas aktivizimit të të gjithë mekanizmave në ushtrinë izraelite, shtetet arabe u befasuan me një sulm të rrufeshëm të forcave ushtarake izraelite.

Në orën 7:45 të mëngjesit të së hënës së 5 qershorit filloi Lufta e Gjashtë Ditëve. Forcat izraelite goditën aerodromet egjiptiane në një seri goditjesh të rrufeshme. Nga fundi i javës forcat e armatosua të Izraelit pushtuan Gadishullin e Sinait, Rripin e Gazës, tërë Bregun Perëndimor të Jordanisë, gjithë qytetin e Jerusalemit dhe Lartësitë Golan... Izraeli kishte shkatërruar apo kapur 430 aeroplan, 800 tanke dhe iu kishte shkaktuar 15, 000 viktima trupave arabe. (Stoessinger, 2015, p. 267)

Për të qetësuar gjërat ndërhyri OKB-ja përmes Këshillit të Sigurimit, që nxori Rezolutën 242, përmes së cilës shprehej papajtueshmëria për fitimin e territoreve nga lufta, kërkohej tërheqja e Izraelit na territoret e pushtuara, garantimin e lirisë së lëvizjes nëpër ujërat ndërkombëtare dhe garantimin e paprekshmërisë territoriale dhe pavarësisë politike të çdo shteti. (United Nation, 1967)

Lufta gjashtëditore ngriti lart vetëbesimin e popullit hebre dhe shkatërroi shpresën arabe e palestineze. Ajo tregoi superfuqinë e Izraelit në rajon dhe dobësitë e popujve arabë.

Nga kjo situatë palestinezët e kuptuan se riorganizimi i tyre politik e ushtarak, ishte i domosdoshëm për t'iu kundërvënë Izraelit, duke mos u mbështetur vetëm në ndihmën e vëllezërve të tyre arabë.

Në vitin 1968, Arafatit iu dha kontrolli i Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP), një organizatë deri tani e paefektshme e krijuar nga Lidhja Arabe në vitin 1964, e cila pagoi vetëm shërbime boshe "për çlirimin" e tokave që palestinezët lakmuan. Arafati shpejt e pozicionoi OÇP-në, nën udhëheqjen e organizatës së tij Fatah, si i vetmi entitet që kërkoi në mënyrë aktive për të mposht Izraelin. (Schanzer, 2008, p. 16)

OÇP-ja fillimisht u karakterizua nga vullneti i saj për të marrë një përfaqësim të plotë "të brendshëm" (në lidhje me popullsinë) dhe një njohje të vërtetë "të jashtme" si (më vonë: e vetme) përfaqësuese e popullsisë palestineze përmes veprimeve të saj politike dhe ushtarake. (Guarino, 2012, p. 21)

Edhe në vitet e ardhshme, palestinezët do të gjenin metoda e rrugë të ndryshme politike e të rezistencës së armatosur për të çuar përpara aspiratat e tyre për shtet, vetëvendosje, çlirim e liri, ndonëse me suksese të zbehta, mjaft të ngadalshme dhe me shumë sakrifica unike. Por edhe Izraeli kishte mjaft sfida në legjitimitetin e politikës së tij ndaj palestinezëve, por edhe në marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet e ndryshme veç e veç, për shkak të çështjes së ndërlikuar në lindje të mesme.

Nëse krahasojmë rrethanat politike të Kosovës dhe Palestinës në vitet e '70-ta të shekullit XX, mund të theksojmë se, shqiptarët dukshëm avancojnë në statusin e saj juridik-kushtetues të vendit të tyre për dallim nga palestinezët. Dekada e kësaj periudhe për shqiptarët e Kosovës paraqet zhvillim të konsiderueshëm, me themelimin e universitetit publik, institucioneve të ndryshme kërkimore-shkencore, autonominë me Kushtetutën e vitit 1974 etj., për dallim nga Palestina, e cila avancimet e brendshme dhe të jashtme, do t'i arrinte shumë më vonë.

2.2. Avancimi e suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe Pavarësia e Palestinës

2.2.1. Rasti i Kosovës - Kushtetuta e vitit 1974

Vitet 1970-ta nga shqiptarët e Kosovës shihen si epokë e artë. Ata ishin më të lirë se kurdoherë në Jugosllavi, ishin më shumë të arsimuar dhe patën kujdes më të lartë shëndetësor sesa kishin patur në tërë historinë e tyre. Natyrisht kjo nuk ishte një epokë e artë vetëm për Kosovën, por edhe për Jugosllavinë gjithashtu. (Judah, 2008, p. 55)

Shumë veprime institucionale u ndërmorën pas demonstratave të vitit 1968 dhe një nga hapat e progresit ishte në fushën e arsimit. Parlamenti serb miratoi një kushtetutë të re për Kosovën në janar 1969, duke zgjeruar më tej autonominë e krahinës dhe duke krijuar Universitetin e pavarur të Prishtinës. (Herscher, 2010, p. 54)

Mbi çdo çështje tjetër, ishte avancimi i Kosovës në nivel kushtetues, si Krahinë Autonome në kuadër të ish-Jugosllavisë.

Kulmi i këtyre përmirësimeve ishte Kushtetuta Jugosllave e vitit 1974, në kuadër të saj si Vojvodina, edhe Kosova u shpall provincë autonome e Serbisë. Statusi i Krahinës Autonome ishte pothuajse i njëjtë me statusin e republikës. Si një provincë autonome, Kosova kishte administratën, asamblenë dhe gjyqësorin e vet dhe ishte anëtare e të dyja institucioneve si serbe edhe atyre federale - Presidenca kolektive dhe Parlamenti federal, në të cilin kishte të drejtën e vetos. (Oxford University Press, 2000, pp. 35-36)

Por, jo të gjithë ishin të kënaqur me këto përparime, pasi që ekzistonin lëvizje ilegale shqiptare në Kosovë, të cilat frymëzoheshin nga Shqipëria komuniste amë dhe kishin karakter anti-jugosllav dhe marksist-leninist, të cilat i kundërviheshin titizmit dhe kërkonin çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë.

Gjatë viteve 1975 dhe 1976, shumë kosovarë (përfshirë Demaçin) morën dënime të gjata burgimi për organizimin ose bashkëpunimin me lëvizjet ilegale separatiste me emra të tillë si Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës, Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve dhe Partinë Komuniste Marksist-Leniniste të Shqiptarëve në Jugosllavi. (Bideleux & Jeffries, 2007, p. 529)

Zgjerimi i të drejtave të shqiptarëve të Kosovës nga ish-Jugosllavia shihej edhe me druajtje, pasi që mendonin se Krahina Autonome do të kërkonte gjithnjë e më shumë pavarësinë, madje edhe shkëputjen nga Federata, siç shkruan edhe Larry Wentz.

Kundërshtimi i Serbisë ndaj Kosovës duke u larguar nga ajo çoi në frikën se shqiptarët përfundimisht do të realizonin ambicien e tyre për të lënë plotësisht Jugosllavinë (një frikë që Tito e pranoi kur hezitoi që ta bënte Kosovën një republikë pasi ata do të kishin të drejtën teorike të shkëputeshin). (Wentz, 2002, p. 59)

Viti 1981 sërish shënon momentin kur vihen në pah shumë brishtësi ekonomike, politike dhe juridike të ish-sistemit jugosllav. Nga viti 1974 e deri në vitet 1980-ta, Kosova u bë vatër e trazirave sociale. Liria e shprehjes u rrit, por përqindja më e lartë e të burgosurve politikë në Jugosllavi ishte në Kosovë... (Tatum, 2010, p. 118)

Vdekja e ish-Udhëheqësit të Jugosllavisë, Josip Broz Tito, e shoqëruar me faktorë të tjerë të brendshëm e të jashtëm, për të cilat ende shkruhet e supozohet, ndikoi në situatën politike në Kosovë, e veçmas janë të njohura demonstratat e studentëve shqiptarë në vitin 1981 në Prishtinë.

Çrregullimi në Kosovë në vitin 1981 i frikësoi serbët e Kosovës. Hapësira që la vdekja e Titos në Jugosllavi hapi mundësi për ambicie politike për të eksperimentuar forma të reja apelimi. (Perritt, Jr., 2010, p. 24)

Shqiptarët rritën kërkesat për republikë, ndërkaq serbët për revokim të të drejtave të Shqiptarëve. Në vitin 1981, pas vdekjes së Titos, një sërë demonstrimesh shqiptare kërkuan edhe njëherë ngritjen e statusit të Kosovës në një republikë brenda federatës. Demonstratat u shtypën brutalisht nga forcat speciale të policisë dhe ushtrisë. Ishte shpallur gjendje e jashtëzakonshme dhe janë ndjekur një sërë procesesh gjyqësore kryesisht ndaj të rinjve shqiptarë, duke i dënuar me burg të rëndë. (Schnabel & Thakur, 2000, p. 33)

Situata eskaloi në të gjitha fushat e jetës së shqiptarëve të Kosovës. U ndërmor një spastrim në Partinë Komuniste, i emërtuar në mënyrë eufemiste "diferencim". Mijëra profesorë universiteti dhe mësimdhënës u shkarkuan. Sigurimi i profesorëve dhe furnizimi me libra në gjuhën shqipe u ndaluan. (Oxford University Press, 2000, pp. 38-39)

Raportet ndëretnike shqiptare-serbe, relacionet e shqiptarëve me ish-Jugosllavinë, dhe besimi në institucionet e federatës, nisën gradualisht të çakordohen. Gjendja shkonte duke u përkeqësuar, ndërkaq, gjatë viteve 1981-1989, 584,323 shqiptarë kosovarë, gjysma e të rriturve, u arrestuan dhe u morën në pyetje. (Tatum, 2010)

Maja e tensionimit të situatës në Kosovë erdhi veçanërisht me ardhjen në pushtet të Slllobodan Millosheviçit, që do të kishte faturën më të rëndë të kohës, suprimimin e Autonomisë së Kosovës në vitin 1989, e që më pastaj do të rezultonte me luftëra e fillimin e madh të shpërbërjes së ish-Federatës Socialiste të Jugosllavisë.

Në fund të viteve 1980-ta në Jugosllavi u ngrit në pushtet Slllobodan Millosheviç, duke nxitur frikën serbe të shqiptarët e Kosovës, dhe vetëm për të qenë arkitekti i shkatërrimit të Jugosllavisë përmes tri luftërave të përgjakshme në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë. Millosheviçi fillimisht ishte një zyrtar ambicioz, por relativisht i zyrtë në Partinë Komuniste Serbe. Ai nuk ishte i njohur për karizëm apo nxitje të retorikës. (Perritt, Jr., 2010, p. 24)

Vetëm tri vjet pas ardhjes në pushtet të Millosheviçit, situata politike në Kosovë dhe rajon po dilte tërësisht jashtë kontrollit. Millosheviçi, i cili më 1986 u bë udhëheqës i Partisë Komuniste Serbe që sundonte, tani Partia Socialiste, e lidhi fatin e tij politik me vendosjen e kontrollit serb mbi Kosovën dhe me marrjen fund të persekutimit të rremë ndaj serbëve dhe malazezëve lokal. (Biberaj, 1993, p. 300)

Fati i Millosheviçit ishte i lidhur ngushtë edhe me dokumentin shovinist të Akademisë së Shkencave të Serbisë të quajtur Memorandumi. Reduktimi drastik i autonomisë së Kosovës, deshqiptarizimi, shpëputja e çdo lidhje me vendin amë dhe ndryshimi i strukturës etnike të popullsisë (Agani, 1993, p. 364), ishin kërkesat kryesore në raport me Kosovën që adresonte ai dokument.

Ky memorandum pasqyron supremacinë serbe përballë shqiptarëve, madje duke bërë thirrje për frenimin e të drejtave të shqiptarëve me një gjuhë të ashpër si: “Shovinizmi agresiv shqiptar në Kosovë, nuk mund të frenohet derisa Serbia të jetë republikë e vetme...”. (Serbian Academy of Arts and Sciences (SANU), 2018)

Gjersa në vitet e '70-ta të shekullit XX kemi progres në disa të drejta të shqiptarëve, stabilitet politik dhe paqe relative në ish-Jugosllavi, në rajonin e Lindjes së mesme dhe Palestinë,

pikërisht në këtë periudhë, zhvillohet një luftë që do të mbahej në mend për kohë të gjatë, Lufta e Yom Kipurit, ku Siria dhe Egjipti sulmuan Izraelin.

2.2.2. Lufta e vitit 1973 dhe Marrëveshja e Camp-Davidit

Pas shumë zhvillimeve për të ruajtur stabilitetin rajonal në një situatë mjaft të tensionuar, erdhi deri te shpërthimi i radhës.

Bllokimi përfundimisht u shkatërrua më 6 tetor 1973, kur Egjipti dhe Siria nisën një sulm të papritur kundër Izraelit. Ai u bë i njohur si lufta e Ramazanit dhe / ose lufta Yom Kippur, sepse ajo ndodhi gjatë festave fetare (myslimane dhe hebraike), varësisht se nga cila anë u bë emërimi... sulmet egjiptiane filluan në pasditen e hershme, duke përmbysur forcat izraelite në bregun lindor të Kanalit të Suezit; dhe afërsisht në të njëjtën kohë, forcat siriane thyen pozicionet izraelite në lartësitë e Golanit. (Zahlan, 2009, p. 53)

Në këtë konflikt edhe superfuqitë globale zhvillonin konkurrencën e tyre në teritoret e lindjes së mesme.

Ishte një riarmatim masiv sovjetik i Egjiptit që nxiti Shtetet e Bashkuara të reagonin me furnizime ajrore të pashembullta për Izraelin. (Harms & Ferry, 2005, p. 125)

Bota arabe nuk qëndronte duarkryq ndaj aleancave të Bllokut Perëndimor me Izraelin, duke u përpjekur të përdornin edhe masa sanksionesh, me qëllim të krijimit të presionit diplomatik mbi aleatët e Izraelit, dhe të pengohej çfarëdo ndihme apo intervenimi ushtarak në dobi të Izraelit.

Në shenjë revolte ndaj qëndrimit të vendeve perëndimore, që ishin aleatë të Izraelit, më 16 tetor të vitit 1973, vendet arabe që njihen si prodhuesit më të mëdhenj të naftës, do të aplikojnin ndaj SHBA-ve dhe Holandës embargon e naftës. (Bilalli, 2011, p. 98)

Pas rreth 20 ditësh sa zgjati lufta, me pasoja të konsiderueshme në njerëz dhe dëme materiale, u arrit edhe armëpushimi. Izraeli edhe pse teknikisht e fitoi luftën, të dyja palët patën humbje të mëdha. Kështu që ato u detyruan që të gjenin një zgjidhje në tavolinë për problemet e kohës. Fillimisht u kërkua armëpushim, Sadati e pranoi armëpushimin me Izraelin, sepse sikurse

është shprehur, nuk kishte pasur aspak dëshirë të luftonte me Shtetet e Bashkuara... kështu më 22 tetor, hyri në fuqi armëpushimi. (Sinani, 2010, p. 101)

Pas luftës së vitit 1973 çështja kaloi edhe në OKB. Me përkrahjen e BRSS-së dhe SHBA-ve Këshilli i Sigurimit në mbrëmjen e datës 21 tetor, duke u gdhirë, votoi rezolutën 338, me 14 vota nga 15 gjithsej (Kina abstenoj) (Duroselle & Kaspi, 2011, p. 463). Rezoluta 338 u bëri thirrje palëve të pushojnë qëllimet dhe veprimet ushtarake jo më vonë se 12 orë pas miratimit të rezolutës, të bëjnë zbatimin e Rezolutës 242 të OKB-së, dhe gjithahtu bëri thirrje që menjëherë të fillonin negociatat për krijimin e një paqeje të qëndrueshme në Lindjen e Mesme. (United Nations, 1973)

Pasi incidentet ushtarake vazhduan, Këshilli i Sigurimit me propozimin e SHBA-ve dhe BRSS-së u mbledh dhe votoi Rezolutën 339, me anë të së cilës u kërkoi palëve ndërprerjen e menjëhershme të të gjitha llojeve të qitjes dhe veprimeve ushtarake, dhe u kërkoi atyre që të ktheheshin në pozicionet e pushtuara në momentin e arritjes së armëpushimit. Gjithashtu KS-ja kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së dërgimin e menjëhershëm të vëzhguesve të Kombeve të Bashkuara për mbikqyrjen e respektimit të armëpushimit. (United Nations, 1973)

Pas Luftës së Tetorit 1973, OÇP-ja filloi të moderonte pozicionin e saj taktikisht, nëse jo në mënyrë strategjike. Palestinezët ishin nën presion nga shtetet e moderuara arabe, të udhëhequr nga Anvar Sadati i Egjiptit, i cili ishte nisur për paqe me Izraelin dhe Perëndimin (Morris, 2009, p. 117). Në vitin 1974, në një takim të kryetarëve të shteteve arabe në Rabat, OÇP-ja u njoh si përfaqësuese e vetme legjitime e popullit palestinez. Çështjes së Palestinës i është dhënë mbështetje institucionale për herë të parë; dhe qëndrimi i saj në politikën arabe u ritheksua. (Zahlan, 2009, p. 82)

Më 14 tetor të vitit 1974, OKB-ja njohu Organizatën për Çlirimin e Palestinës (OÇP) si përfaqësuese e popullit palestinez, duke ftuar përfaqësuesit e saj për të marrë pjesë në diskutimet që do të zhvilloheshin në mbledhjet plenare të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. (United Nations, 1974)

Me arritjen e armëpushimit të vitit 1973, në mes të Izraelit dhe Egjiptit u zhvilluan disa takime, vizita dhe u nënshkruan disa marrëveshje. Në vitin 1977, Presidenti i Egjiptit, Anvar Sadat, bëri një vizitë zyrtare në Izrael dhe deklaroi, se qeveria egjiptiane ishte e gatshme që të zhvillonte bisedime për arritjen e paqes (Filo & Shala, 2002, p. 339). Pas kësaj vizite të befasishme, më 25

dhjetor 1977, Kryeministri izraelit Menahim Begin u takua me presidentin egjiptian në Ismailije. Me atë rast u nënshkrua marrëveshja për formimin e dy komisioneve, njëri ushtarak kurse tjetri politik për zgjidhjen e problemeve ekzistuese ndërmjet tyre. (Sinani, 2010, p. 114)

Ndërkaq, ndër më të rëndësishmet është marrëveshja e cila u nënshkrua në Camp David të SHBA-ve në mes të krerëve të Egjiptit dhe Izraelit, me ndërmjetësimin e Karterit.

Në shtator të vitit 1978 Karteri, duke u përpjekur me të gjitha forcat për të farkëtuar një marrëveshje paqesje midis Beginit dhe Sadatit, i ftoi të dy udhëheqësit në një takim të nivelit të lartë në Kemp Dejvid. (Stoessinger, 2015, p. 281)

Ky takim rezultoi edhe me një marrëveshje të paqes në mes të dyja palëve. Bisedimet e paqes Egjiptiano-Izraelite nën patronatin amerikan në Camp David, Maryland, në shtator të vitit 1978 çuan në nënshkrimin e një traktati të plotë të paqes Egjiptiano-Izraelite më 26 mars 1979, një fakt tjetër që edhe një herë ndryshoi natyrën e konfliktit. (Fischbach, 2003, p. 329)

Traktati përcaktonte disa specifikacione që lidheshin me tërheqjet ushtarake, por edhe me disa aspekte mjaft problematike mbi sovranitetin në territoret palestineze që do të refuzohej kategorikisht nga ana e palestinezëve.

Sipas Traktatit të Paqes, Izraeli do të tërhiqte forcat e veta ushtarake nga gadishulli Sinait (brenda 3 vjetëve) në këmbim të vendosjes së paqes e të njohjes diplomatike nga Egjipti. Në traktat përcaktohej një afat 5 vjeçar për vetëqeverisjen e Bregut Perëndimor të lumit Jordan dhe të Rripit të Gazës. (Filo & Shala, 2002, p. 340)

Ky parashikoi (siç është interpretuar nga Izraeli), kontroll të përhershëm nga Izraeli të Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës. Banorët e Bregut Perëndimor dhe Gazës hodhën poshtë marrëveshjen e Camp David, për arsye se ata nuk kishin asnjë rol në përpunimin e saj dhe nuk mendonin për vetëvendosje. (Quigley, 2005, p. 179)

Nënshkrimi i këtij traktati të paqes nga Egjipti, do t'ia humbte besimin në sytë e palestinezëve dhe shteteve të tjera të botës arabe.

Shtetet tjera arabe dhe islame nënshkrimin e marrëveshjes në Camp David në mes të Egjiptit dhe Izraelit e cilësuan si akt tradhëtie. Mu për këtë Egjipti është përjashtuar nga Liga Arabe nga viti 1979 deri në vitin 1989. (Sinani, 2010, p. 115)

Traktati ishte marrëveshje më shumë për të rregulluar relacionet në mes të Izraelit dhe Egjiptit, e jo në mes të këtyre të parëve dhe palestinezëve.

Marrëveshjet e Camp Davidit, siç pritej, nuk përfaqësonin asgjë më shumë se një paqe të veçantë mes Egjiptit dhe Izraelit. Kjo e hoqi Egjiptin (vendin më të fuqishëm arab), nga linja e konfrontimit me Izraelin. Kryeministri izraelit Begin dhe ministri i tij i mbrojtjes Ariel Sharon mendonin se traktati i paqes me Egjiptin hapi rrugën që ata të zgjidhnin çështjen e Palestinës njëherë e përgjithmonë. (Safty, 2009, p. 245)

Në qershor të vitit 1981, Arabia Saudite paraqiti një plan të paqes, i cili për herë të parë, pranoi se të gjitha shtetet në rajon, duke përfshirë edhe Izraelin, duhet të jetojnë në paqe (pika 7). Pika të tjera ishin se Izraeli do të tërhiqej nga territoret që kishte pushtuar në vitin 1967; që vendbanimet izraelite të shkatërrohen; që palestinezët kishin të drejtën e kthimit; dhe se do të krijohet një shtet i pavarur palestinez (Zahlan, 2009, p. 72). Megjithatë, edhe ky plan nuk pati sukses.

Pasi organizimi palestinez ishte zhvilluar në Liban, Izraeli ndërmori një aksion të madh. Pushtimi në shkallë të gjerë i Libanit nga Izraeli në vitin 1982, i udhëhequr nga ministri i atëhershëm i mbrojtjes Ariel Sharon, ishte i suksesshëm në largimin e udhëheqjes së OÇP-së dhe forcave kryesore të armatosura të saj nga Libani, megjithëse me një kosto të tmerrshme të humbjes së jetëve të libanezëve dhe palestinezëve. (Bose, 2007, p. 243)

Kjo bëri që përkohësisht të stopohej organizimi palestinez, megjithëse ai vazhdoi në shtetet tjera arabe, përveç Egjiptit. Këtu u panë shenjat e para të favoreve që Izraeli kishte fituar nga Marrëveshja me Egjiptin në Camp David.

Në shtator të vitit 1982 Presidenti i SHBA-ve Regan paraqiti një nismë paqeje. Lidhur me Statusin Final, nisma e promovoi idenë e një vetëqeverisje palestineze në bashkëpunim me Jordanin dhe pohoi se rezoluta 242 (1967) e Këshillit të Sigurimit të OKB-së duhet të zbatohet në të gjitha frontet, përfshirë Bregun Perëndimor dhe Gazën. Nisma propozoi që Jerusalemi (Al-Quds) të mbetet i pandarë, por statusi i tij përfundimtar duhet të vendoset nëpërmjet negociatave. Izraeli kundërshtoi ashpërsisht nismën e Reganit, e cila më pas u refuzua nga OÇP-ja. (Saleh, 2003, pp. 292-293)

Dështimet e njëpasnjëshme në bisedimet, takimet dhe marrëveshjet diplomatike e paqësore në mes të Izraelit dhe shteteve arabe nuk sollën pajtimin te popullata palestineze. Kjo, siç do të shohim, do të krijonte ambientin e përshtatshëm për krijimin e një lëvizjeje të re e të armatosur, mjaft radikale në pikëpamje e veprime, taktika e strategji.

Pas planit Regan u paraqitën edhe disa plane të tjera të paqes por që nuk kishin ndonjë efekt. Në këtë periudhë kohore u themelua edhe Lëvizja e Rezistencës Islame. HAMAS u themelua në vitin 1987 si një degë e lëvizjes pan-islamike të Vëllazërisë Myslimane. Ajo kërkoi të adresojë aspiratat dhe ankesat nacionaliste palestineze nga një perspektivë islamike (Herzon, 2006, p. 84). Dështimet e tilla prodhuan zhgënjim, dhe rritën besimin te një pjesë e popullsisë palestineze se pa rezistencë aktive dhe të armatosur nuk do të kishte ndonjë zgjidhje të qëndrueshme.

2.2.3. Intifada e parë dhe Pavarësia e Palestinës

Në kohën kur dukej se Izraeli kishte konsoliduar radhët, sidomos pas Marrëveshjes së Camp Davidit dhe pushtimit të Libanit, situata në territoret palestineze edhe më shumë do të eletrizohej.

Në dhjetor 1987, Intifada e parë (kryengritja) shpërtheu në territoret palestineze të pushtuara nga Izraeli. Intifada u përball me mediat me ndikim perëndimor me lajme të këqija, ose të paktën me atë që Edward Herman dhe Noam Chomsky i quajnë "fakte të papërshtatshme". (Safty, 2009, p. 247)

Disa tipare të kësaj lëvizjeje ishin: aksionet në shkallë të gjerë; hedhja e gurëve mbi forcat ushtarake izraelite; ngritja e barrikadave në rrugë; dorëheqja masive nga postet; demonstrata në rrugë me pjesëmarrjen e të gjithë kategorive të popullsisë; bojkotimi i mallrave izraelite; refuzimi i pagimit të taksave; grevat veçanërisht nga palestinezët që punonin në Izrael; mbyllja e shkollave. Ishte ndaluar përdorimi i armëve. Ishte vendosur që intifada të zhvillohej në formën e mosbindjes civile të rezistencës pasive. (Filo & Shala, 2002, p. 342)

Këto metoda të reagimit intenziv nga palestinezët, patën efekte jo vetëm ndaj qëndrimeve ndaj Izraelit, por edhe në opinionin mbarëbotërorë, duke e ndërkombëtarizuar

çështjen palestineze edhe më tej si çështje e respektimit apo shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtave kombëtare.

Intifada e parë do të shkaktonte pasoja të mëdha në njerëz, por edhe do të konfiguronte sistemin e shumë takimeve ndërkombëtare të ndërmjetësuar sidomos nga amerikanët dhe të tjerët, si dhe do të fuqizonte rolin apo pozicionin palestinez si palë.

Përpjekjet e Izraelit për të shtypur kryengritjen nëpërmjet mijëra arrestimeve, burgosjeve dhe rrahjeve nuk sollën ndonjë rezultat konkret. Sa më i madh bëhej numri i arrestimeve, aq më shumë zgjerohej intifada... nga vera e vitit 1988 shumica e vendeve të botës e vlerësonin Izraelin si një fuqi pushtuese dhe palestinezët si viktimë. (Stoessinger, 2015, p. 287)

Intifada e parë palestineze është zhvillimi vendimtar që udhëhoqi në procesin e paqes të viteve '90. Midis dhjetorit 1987 dhe qershorit të vitit 1991, 983 palestinezë u vranë nga forcat izraelite në territoret e pushtuara, 120,000 pësuan plagosje, rrahje dhe abuzime të tjera, më shumë se 15,000 u arrestuan dhe të paktën 1,882 shtëpi u shkatërruan nga izraelitët si dënim. (Bose, 2007, p. 243)

Pamundësia për ta shtypur Intifadën, ndërmjet viteve 1987-1993, në Bregun Perendimor dhe në Gaza, e detyroi Izraelin që të pranonte një formë ndarjeje të dy komuniteteve, që do të thoshte pranimin e krijimit të një entiteti palestinez që do të rezultonte në një shtet. Ajo bëri që Izraeli të pranonte më në fund bisedimet e drejtpërdrejta me palestinezët në Procesin e Paqes të Madridit, dhe pastaj të njihte Organizatën për Çlirimin e Palestinës si partnere për bisedime (1994). (Sinani, 2010, p. 128)

Nëse për Izraelin, viti 1949 u bë datë jetike për shtetin e tyre, për palestinezët, viti 1988, 40 vjet pas themelimit të Izraelit, do të regjistrohej si një nga momentet më të rëndësishme në destinacionin e tyre për pavarësi.

Në nëntor të vitit 1988, u mbledh Këshilli Kombëtar i Palestinës (parlamenti palestinez në mërgim). Ai shpalli pavarësinë e shtetit palestinez në Bregun Perendimor të Lumit Jordan dhe në Rripin e Gazës. Ky vendim ishte miratim për Rezolutën 181 të Asamblesë së OKB dhe njohjen e shtetit të Izraelit, çka ishte mohuar të kaluarën. (Filo & Shala, 2002, pp. 342-343)

Më 15 nëntor 1988, një muaj pas shpalljes së Pavarësisë së Palestinës, OKB-ja mirëpriti aktin palestinez, duke e shoqëruar edhe me një rezolutë të veçantë. OKB-ja më 15 dhjetor të vitit

1988 miratoi Rezolutën 43/177 përmes së cilës pranon pavarësinë e shtetit të Palestinës të shpallur nga Këshilli Kombëtar i saj dhe konfirmon nevojën për t'i mundësuar popullit palestinez të ushtrojë sovranitetin mbi territorin e tyre të pushtuar që nga viti 1967 (UNGA, 1988). Një bashkëjetesë e negociuar midis popullsive izraelite dhe palestineze u shfaq si i vetmi opcion funksionues. (Kissinger, 2005, p. 260)

2.2.4. Suprimimi i autonomisë së Kosovës dhe rezistenca

Çasti historik i progresit kushtetues të Kosovës në vitin 1974 ishte ndër arritjet më të mëdha të vlerësuara edhe nga ana e shumicës shqiptare. Pas 15 vjetësh, nga një moment ngazëllimi, kosovarët po kalonin në një moment të ri tragjiko-kushtetues. Në vitin 1989 në rrethana të jashtëzakonshme u vendos suprimi i autonomisë së Kosovës me çka filloi edhe një etapë krejtësisht e re për Kosovën e më gjerë. Aq jehonë pati suprimi saqë shumica shqiptare ende e ndanë epokën edhe me këtë vit: Para dhe pas suprimimit të autonomisë së Kosovës.

Në diskutimet për ndryshimet kushtetuese në Kosovë, ku morën pjesë mbi 400 mijë veta, punëtorët, fshatarët dhe inteligjenca shqiptare u deklaruan kundër propozimeve që impononte Serbia dhe kërkuan ruajtjen dhe forcimin e autonomisë. (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2011)

Shfuqizimi i autonomisë u bë sikur të ishte në rrethana lufte. Në këto rrethana, më 23 mars 1989 në Prishtinë u mbajt Mbledhja e Kuvendit të KSA të Kosovës, ndërtesa e të cilit që më parë ishte rrethuar me tanke, ushtri e polici. Në këtë mbledhje u dha pëlqimi për ndryshimin e kushtetutës, që do të thotë se u suprimua autonomia e Kosovës. Më 28 mars 1989 Kuvendi i Serbisë në Beograd miratoi amendamentet kushtetuese, që i dhanë mundësi të shpallte “krijimin e Serbisë unike”. (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2011)

Viti 1989 do të hynte në historinë e Kosovës, si koha e fillimit të jetës e strukturave paralele për shumicën shqiptare. Në këtë kohë, po ashtu do të fillonin ndryshime të mëdha në organizimin dhe mobilizimin qytetar e kombëtar, duke u krijuar shumë forca të reja politike si dhe duke u shpallur edhe projekti i pavarësisë së Kosovës pak vite më vonë. Efektet e tilla mund t'i shohim pak a shumë pas intifadës së parë, kur zgjidhja e çështjes palestineze do të përfitonte në opinion ndërkombëtar si fushë e cenuar e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Ndjeshmëria ndërkombëtare do të rritej nga suprimimi i autonomisë së Kosovës, ngjashëm siç po rritej edhe për çështjen palestineze pas Intifadës së Parë. Opinioni ndërkombëtar, njësoj siç kishte shtuar një vëmendje më të madhe për çështjen palestineze në vitin 1988, ngjashëm do të shtonte edhe për Kosovën, një vit më vonë më 1989. Nëse pas zhgënjimit nga dështimet e njëpasnjëshme të marrëveshjeve ndërkombëtare në mes të shteteve arabe dhe Izraelit - e me ndërmjetësimin edhe të Perëndimit - do të krijohet rezistenca e armatosur e Hamasit në Palestinë, në Kosovë, po ashtu do të lindte një rezistencë, por krejt e kundërt me Hamasin: rezistenca paqësore - e udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Duke e bojkotuar tërësisht sistemin serb, të instaluar në Kosovë që në vitin 1989, shqiptarët e Kosovës arritën ta vinin Serbinë në sytë e ndërkombëtarëve në pozitën e forcës pushtuese, gjë që dallohej nga vizitorët e huaj që me shikimin e parë. (Hasani, 2010, p. 216)

Shqiptarët kishin vendosur që represionit serb të i përgjigjen në mënyrë paqësore. Kështu, në dhjetor 1989, shqiptarët themeluan Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), një lëvizje masive që do të dominonte skenën politike shqiptare të Kosovës në shtatë vitet e ardhshme dhe që mbetet forca më e fuqishme politike deri sot (Ahrens, 2010). Forcat politike në Kosovë kanë ndryshuar konstalacion pas çlirimit dhe pavarësisë së vendit.

Ajo që do të pasonte pas suprimimit të autonomisë, do të ishin një sërë veprimesh nga forcat politike shqiptare të Kosovës si: Deklarata Kushtetuese e Kaçanikut e vitit 1990, referendumi 1991, zgjedhjet e vitit 1992, segregacioni kulturor, ekonomik dhe politik i shumicës shqiptare nga institucionet jugosllave dhe serbe etj.

Më 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës (delegatët shqiptarë) shpalli Deklaratën Kushtetuese sipas së cilës Kosova pavarësohej nga Serbia dhe barazohej me njësitë tjera federale të Jugosllavisë. Po ky kuvend, më 7 shtator 1990 në Kaçanik në kushte të ilegalitetit shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës-me çka përfundoi procesi legjislativ i formimit të shtetit të Kosovës në suaza të Jugosllavisë. (Arifi-Bakalli, 2015, p. 120)

Aktiviteti i Shqiptarëve të Kosovës zhvillohej në mënyrë paralele, duke krijuar institucionet vetëqeverisëse si: Qeverinë, Kuvendin dhe Presidentin. Vendin e gjykatave paralele - si pushtet i tretë gjyqësor në sistemet shtetërore e demokratike, do ta zinin Kuvendet e

Pleqësisë e Pajtit të Gjaqeve – si mosbindje ndaj padrejtësive të ish-Jugosllavisë dhe si nevojë e kohezionit mbarëkombëtar.

Referendumi i organizuar më 26-29 shtator 1991 në të cilin populli i Kosovës u shpreh edhe njëherë për Kosovën e pavarur e sovranë, si dhe zgjedhjet e organizuara pluraliste më 24 maj të vitit 1992, në bazë të vendimit mbi shpalljen e zgjedhjeve të Kuvendit të Kosovës të datës 2 maj 1992 përbëjnë bazën e qëndrueshme juridike dhe politike për Republikën e Kosovës (Sejdiu, 1993). Teknikisht, situata e Kosovës ishte si ajo e Sllovenisë, Kroacisë apo Bosnjës, të cilat vendosën të shkëputen brenda dy viteve të ardhshme. Një ndryshim thelbësor ishte se Kosova nuk kishte fuqi politike ose ushtarake për ta imponuar këtë çështje, pasi ajo ishte ende një “krahinë” dhe jo një “republikë”. Njohja e Kosovës si një entitet i pavarur u mohua nga KE-ja për ato arsye. (Campbell, 2000, p. 153)

Gjersa nisi krijimi i shteteve të pavarura nga fillimi i shkapërderdhjes së ish-Jugosllavisë, bashkë me këtë proces kompleks të ndarjes, do të vinin edhe numër i madh i viktimave në njerëz, dëme të konsiderueshme materiale, konflikte, getoizime ndëretnike etj. Kroacia, Sllovenia Maqedonia dhe Kosova shpallën pavarësinë nga Federata Jugosllave në vitin 1991; Bosnja në vitin 1992, për të mos u pajtuar edhe pakica tjetër e madhe serbe në Republikën Serbe. Mirëpo, referendumi për Kosovën e pavarur, u njoh zyrtarisht vetëm nga Republika e Shqipërisë, e që vetëm më 17 shkurt 2008 shpallja e Deklaratës së Pavarësisë, e jo referendumi i vitit 1991, do të njihej nga më shumë se gjysma e shteteve të botës. Mali i Zi u nda shumë më vonë nga Unioni me Serbinë, në vitin 2006. Vendimet e këtyre akteve për pavarësi, ndikoheshin nga statusi juridik në nivel republikash Jugosllave, nga gjeopolitika globale dhe rajonale, nga vlerësimi i dëmeve të mundshme në njerëz nga qasja e elitave politike të kohës dhe nga shumë rrethana të tjera.

Kështu, një faktor tjetër i madh që e kishte mbajtur Kosovën nga gjakderdhja deri më tani ishte zgjedhja e Ibrahim Rugovës si president i qeverisë nën hije të Kosovës në vitin 1992. Ndryshe nga udhëheqësit e tjerë në Bosnje dhe Kroaci, Rugova është një pacifist i deklaruar i cili i kërkoi zgjedhësve të tij të qëndrojnë të fortë dhe të prisnin që bashkësia ndërkombëtare, e udhëhequr nga Richard Holbrooke dhe grupi i negociatorëve, të vinte në shpëtim. Ata kurrë nuk erdhën. (Campbell, 2000, p. 153)

Edhe pse Pavarësia e Kosovës nuk u njoh ndërkombëtarisht, çështja e saj ishte e njohur. Kjo është e dukshme që në fillim të vitit 1989, kur Presidenti George Bush e paralajmëroi Serbinë se veprimet ushtarake në Kosovë do të përballeshin me forcën amerikane. (Wentz, 2002)

2.3. Ndërkombëtarizimi i Çështjes së Kosovës dhe përpjekjet për paqe në Lindje të Mesme

Kosova kishte filluar ndërkombëtarizimin e çështjes së saj suksesshëm me fillimin e viteve të '90-ta të shekullit të kaluar. Një nga prijësit e kosovarëve, që konsiderohet se kishte dhënë kontribut të çmuar diplomatik, jo vetëm nga autorët vendorë, por edhe ata ndërkombëtar, ishte edhe ish-Presidenti i Kosovës dhe ish-Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova.

Politika themelore e ndjekur nga Rugova dhe LDK që nga viti 1990 ka pasur tri aspekte: së pari, për të penguar revoltën e dhunshme; së dyti, për ta “ndërkombëtarizuar” problemin e Kosovës, dhe, së treti, për të mohuar sistematikisht legjitimitetin e pushtetit serb. (Malcolm, 2011, pp. 434-444)

Në vitet e '90-ta të shekullit XX, shumica e shqiptarëve u larguan nga të gjitha fabrikat, gjykatat, policia dhe institucionet tjera, duke bërë një jetë krejt autonome dhe të shkëputur nga aparati shtetëror jugosllav. Shumë shqiptarë, po ashtu emigruan në vendet e zhvilluara evropiane, e që më pas do të organizoheshin dhe mobilizoheshin në rezistencë paqësore, por edhe në luftë të armatosur kundër strukturave politike, ushtarake dhe policore serbe.

Gjendja në Kosovë në këtë periudhë kohore ishte tepër e rënduar, autoritetet serbe kishin rrënuar gjithçka që ishte ndërtuar. Kështu ata, duke zbatuar një kombinim masash të jashtëzakonshme, dekretesh dhe ligjesh administrative që autorizonin përjashtimin e çdokujt nga puna, i cili kishte marrë pjesë në ndonjë protestë njëditëshe, autoritetet serbe dëbuan shumicën dërrmuese të gjithë shqiptarëve, që kishin qenë në punë shtetërore. (Malcolm, 2011, p. 435)

2.3.1. Konferenca e Hagës (1991) dhe Konferenca Arabo - Izraelite e Madridit (1991)

Fillimi dhe përhapja e luftërave në Ballkanin Perëndimor dhe ish-Jugosllavinë, detyroi Bashkësinë Ndërkombëtare që menjëherë të merrej me fatin përfundimtar të kësaj federate dhe zgjidhjen e ndarjes në mënyrë paqësore, diplomatike dhe në përputhje me të drejtën

ndërkombëtare. Për t'i dhënë fund veprimeve ushtarake në territorin e ish-Jugosllavisë, ministrat e Jashtëm të BE-së vendosën që më 7 shtator 1991 të thirrej Konferenca e Pagues në qytetin holandez të Hagës, në të cilin do të merrnin pjesë përfaqësuesit e të gjitha republikave, nën drejtimin e ndërmjetësve neutralë të BE-së. (Ukshini, 2008)

Kosova nuk gëzonte statusin e republikës dhe rrjedhimisht politikisht përjashtohej nga pjesëmarrja në këtë konferencë. Kosova dhe Vojvodina ishin njësi federative dhe pjesë e Serbisë, ndërkaq, Komuniteti Evropian në këtë konferencë i trajtoi ato vetëm si pjesë të Serbisë. Një trajtim i tillë arsyetohet me faktin se BE-ja ishte e interesuar në zgjidhjen e konfliktit në Slloveni dhe Kroaci, ndërkaq Kosova për momentin nuk ishte zonë e veçantë interesi.

Duhet të theksojmë që, mbështetja ndërkombëtare për pjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës vinte nga Parlamenti Evropian, Kongresi i SHBA-së dhe Këshilli i Evropës. Këto përpjekje për të sjellë Kosovën në Konferencë dështuan. (Ahrens, 2010, p. 317)

Në këtë kontekst kohor dhe historik, nëse tërheqim paralele me situatën ndërkombëtare të Palestinës, do të mund të shkëpusnim një konferencë të rëndësishme për palestinezët, që po mbahej po në këtë vit të trazirave në Ballkanin Perëndimor dhe shpalljes së pavarësisë së disa shteteve ish-jugosllave në vitin 1991.

SHBA-të dhe me përpjekjet e sekretarit të Shtetit James Baker sollën Konferencën Ndërkombëtare të Madridit, të mbledhur në tetor të vitit 1991 ... palestinezët u lejuan për herë të parë të ndiqnin një konferencë të tillë, ndonëse OÇP u përjashtua kurse delegacioni palestinez ishte zyrtarisht pjesë e kontingjentit jordanez. (Fawcett, 2005, p. 232)

Këtu ishin edhe fillesat e para të pjesëmarrjes indirekte të palestinezëve si palë në ndonjë proces. Pavarësisht se zgjidhje nuk pati, ndërkombëtarizimi i çështjes palestineze ishte në nivel më të lartë se më parë, ngjashëm me shtimin e vëmendjes ndërkombëtare për Kosovën. Këtu ekziston një dallim në mes të palestinezëve dhe kosovarëve, pasi që ndonëse u rrit vëmendja ndërkombëtare për të dyja rastet, palestinezët u bënë palë faktorizuese për përfaqësimin e interesave të tyre në diplomacinë ndërkombëtare, ndërsa kosovarët akoma nuk ishin faktorë në “tavolinën” e diskutimeve.

Për herë të parë gjatë dyzet vjetëve, izraelitët, arabët dhe palestinezët u ulën së bashku në një tryezë bisedimesh. Megjithëse secili nga delegatët e përdori këtë ngjarje për të shpallur

përsëri pozicionet e njohura dhe lëshime nuk u bënë, fakti që palët kundërshtare u mbledhën në të njëjtën sallë dhe i dhanë dorën njëra tjetrës përbënte hapin e parë drejt qëllimit për paqe në Lindjen e Mesme, të cilës i mënjanohehin. (Stoessinger, 2015, p. 289)

Pavarësisht konsideratave të para e të rëndësishme për palestinezët si palë në tryeza dhe konferenca diplomatësh ndërkombëtarë, kjo nuk do të thoshte se problemi ishte zgjidhur. Shumica e përpjekjeve për paqe në Lindje të Mesme dhe Palestinë, deri në këtë moment nuk u treguan të suksesshme për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme.

Bisedimet e para publike bilaterale ndërmjet Izraelit dhe fqinjëve të tij (përveç Egjiptit) synonin arritjen e traktateve të paqes ndërmjet tre shteteve arabe dhe Izraelit, ndërsa bisedimet me palestinezët u bazuan mbi një formulë dyfazore; e para përfshinte negociatat për marrëveshjet vetëqeverisëse të përkohshme, që do të pasohej nga negociatat për statusin e përhershëm. (Kjo formulë u ndoq esencialisht në marrëveshjet e mëvonshme të Oslos). (Sinani, 2010, p. 133)

Pas Konferencës së Hagës në vitin 1991, një nga ngjarjet vendimtare në ish-republikat jugosllave ishte edhe puna e Komisionit të Badinterit mbi Jugosllavinë, në vitin 1992. Aty, çështja e Kosovës nuk u trajtua fare. Po ashtu, edhe Konferenca e Londrës e vitit 1992 nuk ofroi zgjidhje për Kosovën.

2.3.2. Komisioni i Badinterit mbi Jugosllavinë (1992)

Shtetet me statusin e republikave në ish-Jugosllavi u morën parasysh në Komisionin e Badinterit, por jo edhe ish-krahinat autonome, si Kosova e Vojvodina.

Në vitin 1992, Komiteti i Arbitrazhit Badinter, një organ i ngritur nga Bashkimi Evropian për të shqyrtuar çështjet ligjore që rrjedhin nga shpërbërja e Jugosllavisë, arriti në përfundimin se gjashtë republikat formale të Jugosllavisë ishin shtete që dëlnin nga kolapsi i federatës dhe kështu mund të njiheshin. Ç'është më e rëndësishmja, megjithatë, Kosova nuk u përmend. (Ker-Lindsay, 2009, p. 11)

Jugosllavia sipas një parimi të përgjithshëm do të duhet të trajtohej në tërësinë e vet komplekse federative dhe kushtetuese. Por Komisioni i Badinterit, juridikisht, Kosovën e trajtonte

siç ishte e përkufizuar në Kushtetutën Federative Jugosllave dhe shqiptarët konsideroheshin si pakicë etnike apo kombësi, e të cilat siç dihet, për dallim nga kombet nuk kishin aftësi shtetbërëse.

Edhe pse Kosova zyrtarisht u paraqit për njohje me një letër drejtuar Lordit Carrington, kryesuesit të Konferencës për Jugosllavinë, një ditë para se të skadonte afati (Weller, Shtetësia e kontestuar, 2011, p. 100). Badinteri mori parasysh pozicionin e Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974, që ishte hibrid në vetvete, e cila e trajtonte atë jo si republikë, por si njësi autonome, ndërsa shqiptarët njiheshin si kombësi. (Ukshini, 2008, p. 125)

Kosova dhe përfaqësuesit e zgjedhur të saj, pritën që ky komision do të trajtonte edhe çështjen e Kosovës, dhe do t'i jepte të drejtë asaj për të qenë një shtet që do të derivonte nga shpërbërja e Jugosllavisë. Verdictet e Komisionit të Badinterit ndikuan edhe në opinionin e shteteve dhe organizatave ndërkombëtare në raport me njohjen e së drejtës së Kosovës për shkëputje dhe shtet të pavarur.

2.3.3. Konferenca e Londrës (1992)

Konferenca e Londrës e vitit 1992 për shqiptarët e Kosovës, i ngjason pak a shumë Konferencës së Madridit të vitit 1991 për palestinezët, ku për herë të parë çështja e Kosovës bëhet objekt trajtese në hapësirën ndërkombëtare.

Konferenca e Londrës për Jugosllavinë nga 26 deri më 27 gusht 1992 nisi të vetmin proces negociatash thelbësore, intensive dhe me ndërmjetësim ndërkombëtar mbi Kosovën që u zhvilluan përpara shpërthimit të konfliktit të armatosur më 1998. Konferenca krijoi [1] një strukturë të posaçme negociatash, [2] një takim premtues ndërmjet Rugovës dhe Paniçit, [3] një deklaratë imponuese ndërkombëtare. (Ahrens, 2010, p. 333)

Në Konferencën e Madridit, palestinezët përfaqësoheshin si pjesë e kontingjentit jordanez, ndërsa përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, ndiqnin punimet e konferencës përmes medias. Kosova mori pjesë në Konferencë në atë që u njoh si “dhoma-jehonë”, ku mund të përcillej transmetimi i drejtpërdrejtë nëpërmjet televizorit dhe herë pas here, Lordi Carrington dhe zyrtarë të tjerë të lartë do ta vizitonin dhomën dhe do të dëgjonin, paksa në mënyrë

arrogante, kërkesat e Rugovës dhe të delegacionit të tij. Mirëpo, nuk kishte angazhim thelbësor për çështjen e Kosovës (Weller, Shtetësia e kontestuar, 2011, p. 104). Përfaqësuesit shqiptarë nga Kosova ishin të zemëruar që, megjithëse të ftuar në Londër, ishin në nivelin e vëzhguesve e jo të pjesëmarrësve. I vetmi rezultat anësor konstruktiv i Konferencës që preku problemin e Kosovës ishte vendimi për të patur vëzhgues të të drejtave të njeriut në Kosovë, Vojvodinë dhe Sanxhak, si dhe për zhvillimin e bisedimeve për çështje arsimore. (Vickers, 2004, p. 321)

As Konferenca e Hagës, as ajo e Londrës, nuk do të zgjidhnin problemin e Kosovës, por vetëm se do të manifestonin avancimin gradual dhe fuqizimin e palës shqiptare për të lobuar, shprehur edhe paraqitur aspiratat e tyre politike e kombëtare.

Edhe pse konferenca e Londrës ishte shpresëdhënëse për shkak të prezencës së përfaqësuesve të Kosovës qoftë edhe në nivel vëzhguesish, ajo nuk arriti pritshmëritë e kosovarëve. Në fund, një "Grup Special" u themelua për të punuar për çështjen e Kosovës, që ia lejoi secilës palë që ta ruante pikëvështrimin e vet për statusin. (Weller, 2011, p. 105)

2.3.4. Marrëveshja Izraelito – Palestineze e Oslos (1993)

Për izraelitet dhe palestinezët, një hap tutje për t'u njohur reciprokisht me njëri-tjetrin ishte edhe Marrëveshja e Oslos.

Para se të nënshkruhej marrëveshja e arritur në Oslo, në vitin 1993 ndodhi njohja e shtetit të Izraelit nga lideri i OÇP-së, dhe gjithashtu Kryeministri i Izraelit Rabin, njohu OÇP-në si përfaqësuese legjitime të popullit palestinez. Arafati i shkroi Rabinit më 9 shtator se OÇP-ja "e njeh të drejtën e shtetit të Izraelit për të ekzistuar në paqe dhe siguri"... dhe në përgjigjen e tij, Rabini i dërgoi një letër të shkurtër duke deklaruar: "Qeveria e Izraelit ka vendosur për të njohur OÇP-në si përfaqësues të popullit palestinez dhe për të negociuar paqen me të." (Morris, 2009, p. 128)

Marrëveshja e Oslos, paraqet ndryshimin më të madh që kanë sjellë deri në atë kohë negociatat për Palestinën dhe Izraelin.

Më 13 shtator 1993, në lëndinën e Shtëpisë së Bardhë, Izraeli dhe OÇP-ja (Organizata Çlirimtare Palestineze) nënshkruan Deklaratën e Parimeve (DEP) për Marrëveshjet e

Vetëqeverisjes Ndërshtetërore. Marrëveshja, e cila u përqendrua në rend të parë dhe të parakohshëm në marrëveshjet politike dhe të sigurisë, përmbante edhe dispozita të rëndësishme për çështjet ekonomike (Lasensky, 2004, p. 219). Marrëveshjet parashikonin një qeveri palestineze autonome *de facto* në territoret e pushtuara, dhe ndërkohë, në mënyrë të heshtur, shërbenin si pikënisje për zgjidhjen përfundimtare të “dy shteteve” të krijuar në kufijtë e parashikuar nga armëpushimi i vitit 1967. Gjatë ceremonisë së shtatorit, Arafati hoqi dorë “nga përdorimi i terrorizmit dhe nga akte të tjera të dhunës”, por Rabini, nga ana e tij, nuk u angazhua të ndalonte ekspansionin e ngulimeve në territoret palestineze. (Brzezinski, 2010, p. 125)

Ripi i Gazës dhe Bregu Perëndimor u targetuan si dy vendshtirjet e Autoritetit Palestinez dhe demilitarizimi i këtyre hapësirave nga forcat izraelite.

Marrëveshja në fjalë bëri thirrje për tërheqjen e forcave izraelite nga Ripi i Gazës dhe Bregu Perëndimor, e në këto zona të ketë një vetëqeverisje të përkohshme nga Autoriteti Palestinez. Madje, edhe kjo vetëqeverisje parashikohej që nga Izraeli të jepej kjo e drejtë vetëm në faza të ndara. (Haziri, 2014, p. 25)

Marrëveshja e Oslos u komplementarizua nga ajo e Kajros, në vitin 1994. Përmes marrëveshjes së re, filloi edhe konkretizimi i veprimeve. Marrëveshja, e njohur gjithashtu si Oslo, përfundimisht u përfundua në Kajro më 4 maj 1994, me anë të së cilës forcat palestineze të policisë hynë në Gazë dhe Jeriko dhe u formua Autoriteti Kombëtar Palestinez (Saleh, 2003, p. 301). Në gusht të vitit 1994, Izraeli dhe OÇP-ja gjithashtu hynë në Marrëveshjen për Fuqitë dhe Përgjegjësitë Përgatitore ("Marrëveshja Erez"). Kjo marrëveshje lejoi transferimin e kufizuar të autoritetit në Palestinë në pjesë të Bregut Perëndimor jashtë zonës së Jerikos. Marrëveshja Erez specifikon se AP nuk do të ketë fuqi mbi Jeruzalemin, vendbanimet, vendet ushtarake apo izraelitët. (Weiner J. , 1999, pp. 249-250)

Marrëveshja tjetër që do të ndikonte rrjedhën e ngjarjeve për Lindjen e Mesme ishte edhe ajo e ashtuquajtura “Marrëveshja Taba” ose “Oslo II”, e mbajtur një vit pas asaj të Kajros.

2.3.5. Marrëveshja Taba (Oslo II, 1995)

Marrëveshja Taba do të kishte rëndësinë e madhe për ndryshimet që do të ndodhnin në vetëqeverisjen palestineze, riorganizimin territorial e administrativ, largimin e ushtrisë izraelite nga disa territore palestineze etj., por edhe për shkak të vëmendjes mediatike e ndërkombëtare, në ceremoninë e mbajtur në Shtëpinë e Bardhë, në SHBA.

Më 24 shtator 1995, në vendpushimin Taba të Detit të Kuq egjiptian, Marrëveshja e Përkohshme e themeluar në DEP të Marrëveshjes së Oslos (Neni VII) ishte negociuar dhe nënshkruar. Katër ditë më vonë, një ceremoni në Shtëpinë e Bardhë me Rabinin, Peresin dhe Arafatin bëri zyrtare atë që u bë e njohur si Oslo II, ose Marrëveshja Taba (e njohur edhe si "Faza e Dytë" ose "Marrëveshja e Përkohshme") (Harms & Ferry, 2005, p. 155). Marrëveshja e parë e Oslos njihet si "Deklarata e Parimeve" (DEP), ndërsa marrëveshja e dytë si "Marrëveshja e Përkohshme".

Marrëveshja parashihte bartjen e kompetencave në autoritetin palestinez dhe ravijëzimin e disa zonave në territore të veçanta.

Ajo siguroi zgjedhjet për një Këshill Palestinez, transferimin e autoritetit legjislativ në këtë Këshill, tërheqjen e forcave izraelite nga qendrat me popullsi palestineze dhe ndarjen e territoreve në tri zona - A, B dhe C. (Shlaim, 2005)

Për palestinezët dhe izraelitët, çështja më e ndjeshme, por edhe për shumë e shumë konteste të tjera ndërkombëtare ndërmjet dy e më tepër palëve, ndër të tjerash mbetet territori.

Pjesa më e diskutueshme dhe e vështirë e Marrëveshjeve ishte ndarja e tokës në Kategoritë A, B dhe C. Toka e kategorisë C ishte e kontrolluar nga izraelitët, por përfundimisht do të kalonte në kategorinë B. Kategoria B e tokës ishte e kontrolluar bashkërisht nga izraelitët dhe palestinezët, por përfundimisht do të kalonte në kategorinë A. Vendi i kategorisë A, pjesa e pakicave rreth qyteteve kryesore palestineze, do të ishte që nga fillimi nën kontrollin e Autoritetit Palestinez. (Chan, 2017, p. 59)

Oslo II në një këndvështrim paraqiste një progres në kompromiset izraelito-palistineze dhe hapte mundësi të reja për zgjidhje, ndonëse jo finale.

Sipas termave të kësaj marrëveshje, Izraeli i dorëzonte palestinezëve kontrollin e thuajse një të tretës së Bregut Perëndimor. Katër për qind e Bregut Perëndimor (përfshirë qytetet e Jeninit, Nablusit, Kalkilyas, Tulkaremit, Ramallahut, Bthlehemit dhe Hebronit) kaluan në kontrollin ekskluziv palestinez dhe 25 për qind të tjera nën kontroll civil-administrativ. Oslo II shënonte pikën e moskthimit mbrapsht në procesin e përfundimit të kontrollit detyrues të Izraelit mbi popullin palestinez. (Fawcett, 2005, p. 250)

Pavarësisht se në këto marrëveshje dhe takime ndërkombëtare flitej për çështjen e Palestinës, interesat izraelite dominon platformën e tyre.

Në terma realë, zonat palestineze formuan enklava të vogla të rrethuara nga shumë pika kontrolli të përhershme "izraelite". Oslo 2 i transferoi zonat e banuara, të cilat e shqetësonin shumë "Izraelin" tek Autoriteti Palestinez, ndërsa të gjithë të tjerët u vendosën nën kontrollin "izraelit". (Saleh, 2003, p. 303)

Në disa pika të tjera që ndërlidheshin me politikat e sigurisë dhe ato të jashtme, statusin e Jerusalemit etj., Marrëveshje Taba nuk përmbante aspiratat palestineze.

Përveç tjerash, Juridiksioni i Këshillit mbulon Bregun Perëndimor dhe Gazën por nuk përfshin çështje që i nënshtrohen negociatave të statusit të përhershëm, gjegjësisht statusin e Jerusalemit, ardhmërinë e vendbanimeve hebraike, përcaktimin e instalimeve ushtarake izraelite, vendosjen e refugjatëve palestinezë, kufijtë dhe marrëdhëniet e jashtme. Përveç kësaj, juridiksioni i Këshillit nuk përfshin funksione për të cilat nuk i është dhënë autoritet sipas Marrëveshjes së Oslo II, si mbrojtja kundër kërcënimeve të jashtme. (Weiner J. R., 1996, p. 668)

Taba u shfrytëzua nga të dy palët pjesëmarrëse në dialog, si fitore historike. Por, forcat opozitare nga të dy vendet akuzuan përfaqësuesit e tyre se kishin shkelur interesat kombëtare.

Pas këtyre marrëveshjeve, në janar të vitit 1996 u mbajtën zgjedhje për Këshillin Legjilativ Palestinez autonom, i cili u bojkotua nga Hamasi dhe 10-të fraksionet e tjera. Fatah dhe mbështetësit e saj fituan rreth tre të katërtat e vendeve. Jasser Arafati u zgjodh President i Autoritetit me 88% të votave (Salih D. M., 2002, p. 514). Marrëveshja nga udhëheqësit e dy popujve u paraqit si arritje për paqe, ndërkaj, nga të dyja anët, grupet e opozitës pohuan se territori ishte 'shitur' dhe se kjo nënkuptonte një kërcënim kundër identitetit dhe ekzistencës. (Schulz, 2004, p. 92)

2.3.6. Konferenca e Dejtonit (1995)

Nën ndikimin e idesë së Ibrahim Rugovës dhe të LDK-së shqiptarët e Kosovës patën pritje të larta që çështja e tyre të trajtohej nga bashkësia ndërkombëtare në Dejton. Sikurse pritjet, ashtu ishte edhe zhgënjimi, pasi që bashkësia ndërkombëtare injoroi çështjen e Kosovës me qëllim të zgjidhjes së problemit emergjent në Bosnjë e Hercegovinë. Pritjet e shqiptarëve ishin të kota. Miranda Vickers thekson se çdo shpresë për zgjidhjen e krizës së Kosovës do të braktisej nga bashkësia ndërkombëtare me qëllim të fitimit të mbështetjes së Beogradit për zbatimin e një marrëveshjeje paqeje për Bosnjën. (Vickers, 2004, p. 345)

Autori i mirënjohur Noel Malcolm, pohon se marrëveshja e Dejtonit në përgjithësi ndikoi në konsolidimin e sundimit të Millosheviçit në Serbi: diplomatët e Perëndimit deklaruan haptazi se ata i ishin atij mirënjohës për përpjekjet e tij “për vendosjen e paqes”, dhe se e konsideronin atë si një forcë konstruktive në rajon, largimi i të cilit mund të shpinte në një “destabilizim” (Malcolm, 2011, p. 441). Përderisa paaftësia e intervenimit në kohë e bashkësisë ndërkombëtare në Bosnjë dhe Hercegovinë, duhej të ishte një alarm zhgënjyes për Ibrahim Rugovën, ai vazhdoi rrugën e tij pacifiste duke tentuar zgjidhjen e statusit të Kosovës me mjete paqësore.

Injorimi i çështjes së Kosovës në konferencën e Dejtonit arsyetohet edhe nga Rudolph Perrina në vitin 1996, si shef i Misioni Diplomatik të SHBA-ve në Beograd. Ai në një takim të mbyllur me zyrtarët e LDK-së thekson se në Dejton janë ftuar ata që kanë luftuar. Dejtoni është një marrëveshje e paqes, e arritur midis palëve të përfshira në luftërat në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë (Shala, 2001, p. 26). Pohimi që bëri zyrtari i SHBA-ve në zyret e LDK-së theksoi nevojën e ri-organizmit politik dhe të funksionimit të shqiptarëve. Ata urgjentisht duhej të ndërronin mënyrën e sjelljes dhe veprimeve në raport me Serbinë.

2.4. Vazhdimi i rezistencës

Pas Konferencës së Dejtonit të vitit 1995, shqiptarët fituan përshtypjen se Çështja e Kosovës nuk po trajtohej seriozisht nga faktori ndërkombëtar dhe se Lëvizja-rezistenca Paqësore nuk po shënonte rezultatet e duhura (Arifi-Bakalli, 2015). Konferenca Hagës, Komisioni Badinterit, Konferenca e Londrës dhe së fundmi Konferenca e Dejtonit dhe rritja intensive e politikës fashiste, të orkestruara nga qeverisja e Millosheviçit, do të godisnin besimin në idenë e zgjidhjes paqësore të problemit të Kosovës, të cilën e proklamonte LDK-ja dhe Presidenti i Republikës së vetëshpallur të Kosovës, Ibrahim Rugova. Zbehja e idesë së Rugovës dërgonte në lindjen e një shprese të re e cila do të mund të ishte më produktive në rezultate.

Në mes të ndjekjes së rrugës pacifiste dhe durimit të represionit serb, popullata civile e Kosovës iu gëzua alternativës së re, duke përkrahur idetë e krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këto rrethana nga mesi i viteve nëntëdhjetë u krijua një lëvizje, e cila në vitet në vijim do ta merrte pothuaj gjithë pushtetin në shoqërinë shqiptare të Kosovës – Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK). Rugova e hetoi rrezikun e konkurrencës dhe grupin gueril në formim e sipër e quajti herë prodhim të fantazisë, herë mjet provokimi të autoriteteve serbe, të cilat po kërkonin shkas për një aksion të ashpër kundër popullsisë civile shqiptare. (Schmitt, 2012, p. 254)

Duke filluar nga viti 1995, anëtarët e saj filluan të kryenin atentate kundër politikanëve e policëve serbë. Radhët e UÇK u shtuan sidomos nga të rinjtë që e shikonin të mbyllur dhe të pasigurt perspektivën e së ardhmes (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008, p. 375).

Në verën e vitit 1996 dhe më pas, u bënë disa sulme, duke përfshirë edhe vrasjen e dy policëve në Mitrovicë, shpërthimin e një bombe në Podujevë, si edhe një sulm kundër rektorit serb të Universitetit të Prishtinës... (Malcolm, 2011, p. 442)

Policia dhe ushtria serbe në vitet e '90-ta ishte mësuar tashmë me përfshirjen e aparatit të tyre shtetëror në luftime të armatosura, në Kroaci, Bosnje etj., por guerilja shqiptare e Kosovës, kishte veçantitë e veta taktike dhe strategjike të sulmeve, ndonëse për Serbinë, ajo nuk ishte gjë tjetër, përveç “grup terrorist”, e për propagandë të jashtme, e kualifikonte edhe si grup fundamentalistësh islamik.

Në këtë situatë Millosheviç, nën pretekstin se po luftonte terroristët filloi bombardimin e fshatrave, djegiet, vrasjet, duke detyruar mijëra kosovarë të largoheshin nga fshatrat e Llaushës,

të Morinës, të Krushës, të Rrekës së Keqe, të Deçanit etj. (Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008)

Kishte zëra të rrallë serbë, të cilët e kundronin çështjen e Kosovës nga një perspektivë krejt tjetër prej regjimit të Millosheviçit. Në një fjalim të mbajtur në qershor të vitit 1996 kryetari i Akademisë së Shkencave Serbe, Aleksandër Despiç, i cili e quajti çështjen e Kosovës *“problemi më i rëndësishëm strategjik i të ardhmes së popullit serb”*, i tronditi dëgjuesit e tij me sugjerimin që, për shkak të superioritetit dërmues demografik të shqiptarëve në Kosovë, ndoshta kishte ardhur koha për një shkëputje ‘paqësore dhe të qytetëruar’ të Krahinës nga Federata (Vickers, 2004, p. 364). Edhe pse kjo deklaratë u cilësua si jo relevante dhe u kritikua ashpër, më vonë vërtetohet se Despiç kishte pasur të drejtë.

Në vitin 1997, me daljen zyrtare të gueriles kosovare në skenë, u krijua një momentum i ri politik edhe brenda vetë faktorit shqiptar, por edhe në rrafshin ndërkombëtar, çështja e Kosovës do të trajtohej edhe më me urgjencë nën gjuhën e huaj diplomatike për destabilitet rajonal etj.

Në shtator, protestuesit studentorë i kishin refuzuar thirrjet e Rugovës për t’i ndalur demonstratat dhe në vend të saj vinin kontakte me UÇK-në. Policia serbe i sulmoi protestuesit e qetë dhe i shtoi arrestimet e aktivistëve (King & Mason, 2007, p. 58). Në fillim të dhjetorit 1997, UÇK-ja bëri shfaqjen e saj të parë publike kur tre pjesëtarë të maskuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të pajisur me armë automatike, mbërritën papritur në varrimin e një mësuesi shqiptar të vrarë nga forcat serbe të sigurimit (Vickers, 2004, p. 375). UÇK-ja doli publikisht më 28 nëntor të vitit 1997.

Ngjarje dramatike që do ishte pikë kthese në historinë e re të Kosovës, ishte sakrifica e njohur e familjes Jashari në Prekaz të Drenicës.

Më 5 mars, serbët do të sulmonin në Prekaz shtëpinë e liderit të UÇK-së për zonën e Drenicës, Adem Jasharit, duke shuar krejtësisht familjen e tij prej 52 anëtarësh (Qose, 2015, p. 266). Rënia e komandantit Adem Jashari e shndërroi atë në emblemë të UÇK-së. Nga ky moment radhët e ushtrisë u shtuan me pjesëtarë nga të gjitha trojet shqiptare, diaspora dhe nacionalitetet tjera. Përderisa UÇK-ja godiste strukturat e sigurisë së Serbisë në Kosovë, forcat jugosllave vazhduan t’i granatonin fshatrat dhe qytetet, duke i detyruar civilët që t’i braktisnin shtëpitë e

tyre (King & Mason, 2007, p. 59). Sa më shumë që rritej intensiteti i sulmeve që bënin njësitë e rregullta ushtarake dhe ato paramilitare serbe, me ritëm shumë herë më të madh rritej përkrahja dhe numri i pjesëtareve të UÇK-së.

Gjatë vitit 1998, konflikti i hapur mes forcave ushtarake dhe policore serbe dhe forcave shqiptare të Kosovës, rezultoi me vdekjen e mbi 1,500 shqiptarëve të Kosovës dhe detyroi 400,000 njerëz të lënë shtëpitë e tyre (Wentz, 2002). Gjatë dimrit 1998/99 UÇK-ja ngriti struktura të reja komanduese. Ajo kishte rekrutuar disa oficerë profesionistë shqiptarë të Armatës Popullore të Jugosllavisë, mes tyre edhe kryeministrin e mëvonshëm Agim Çeku, i cili më parë kishte qenë gjenerallejtënant në Ushtrinë Kroate. (Schmitt, 2012, p. 257)

Në vitin e Konferencës së Dejtonit për Bosnjën dhe zhgënjimin e kosovarëve që nuk po bëheshin temë e këtij takimi ndërkombëtar, një ngjarje e rëndë ndodhi për raportet Izrael-Palestinë.

Në anën tjetër, pas arritjes së marrëveshjeve të rëndësishme për palestinezët dhe izraelitët, duhej të zhvillohej procesi i vështirë i implementimit të tyre. Zbatimin e marrëveshjeve e ngadalësoi vrasja e kryeministrit izraelit Itzhak Rabin, strategu i tratativës diplomatike, në nëntor të vitit 1995 nga një militant i ekstremit të djathtë izraelit. (Grimberg, Historia Botërore dhe Qytetërimi 12, 2005, p. 252)

Vrasja e Rabinit do të shkakonte edhe efekte të tjera direkte dhe indirekte, duke përfshirë këtu edhe atmosferën elektorale.

Rënia e Rabin, siç priste vrasësi, bëri një goditje serioze trupore për të gjithë procesin e paqes. Shimon Peres e ndoqi Rabinin në rrugën e paqes me palestinezët, por përpjekjet e tij u ndërpre në humbja të tij elektorale në maj të vitit 1996. (Shlaim, 2005, p. 254)

Dy vjet pas kësaj vrasjeje, do të ndodhnin zhvillime të reja edhe sa i përket marrëveshjes izraelito-palestineze. Më 15 janar 1997, Netaniahu e Arafati nënshkruan një marrëveshje për tërheqjen e izraelitëve nga katër të pestat e qytetit të Hebronit. Ata caktuan edhe një kalendar të ri takimesh ... megjithatë, përleshjet vazhdonin, edhe në Jerusalem, edhe në territoret e pushtuara. (Duroselle & Kaspi, 2011, p. 708)

Viti 1998, në kohën kur Kosova ishte në luftë, po zhvillohej po ashtu ndërmjetësim jo i zakonshëm për procesin e paqes në Lindjen e Mesme. Presidenti i atëhershëm amerikan, do të kishte një rol mjaft aktiv në ndërmjetësimin e izraelitëve dhe palestinezëve.

Në tetor të vitit 1998... administrata amerikane sponsorizoi dhe ndërmjetësoi një konferencë midis udhëheqësve izraelitë dhe palestinezë në plantacionin e lumit Wye në Maryland, që prodhoi një marrëveshje për zgjerimin e Zonave A dhe B nga 27 për qind në gati 40 për qind të Bregut Perëndimor. Ishte Samiti i Wye, aty ku Presidenti Clinton u përfshi për herë të parë personalisht në detajet e procesit të paqes. (Bose, 2007, p. 256)

Akuza më e shpeshtë dhe më e rëndë ndaj Palestinës, në këtë samit, për shumë vjet, ndërlidhej me aktet terroriste. Në këtë samit, kërkohet që këto veprime të luftoheshin nga vetë palestinezët.

Kjo përcaktoi se palestinezët duhej së pari të luftonin kundër terrorizmit dhe 'nxitjes për dhunë'; për këtë, CIA u caktua për të ofruar trajnime për forcat policore palestineze dhe për të hequr klauzolat ofenduese ndaj Izraelit nga Karta Kombëtare e Palestinës. Në kthim, Izraeli duhej të rivendoste forcat e saj sipas marrëveshjeve të mëparshme, të lejonte hapjen e aeroportit të Gazës, të pushoj nga kërkimet e sigurisë në aeroplanin privat të Arafatit dhe të fillonte bisedimet e statusit përfundimtar sa më shpejt të jetë e mundur. (Karmi, 2007)

Edhe Marrëveshja e lumit Wye, do të rezultonte e pasuksesshme. Si çdo marrëveshje tjetër edhe kjo ishte vështirë e zbatueshme, dhe kabineti izraelit pastaj vendosi të pezullojë zbatimin e Marrëveshjes së lumit Wye më 20 dhjetor 1998 (Salih D. M., 2002, p. 516).

Në vitin 2000, në kohën kur Kosova administrohej nga faktori ndërkombëtar, dhe po bëheshin përpjekjet e para për ndërtimin e institucioneve, në mes të Izraelit dhe Palestinës u arrit një marrëveshje tjetër e re, për implementim të marrëveshjes paraprake Wye.

Ardhja e Partisë Laburiste Majtiste nën Ehud Barak në pushtet ringjalli shpresën palestineze për rifillimin e procesit të paqes. Një marrëveshje u arrit në Sharm El Sheikh, Egjipt, me kusht një kornizë kohore të re për zbatimin e Memorandumit të lumit Wye. Të dyja palët ranë dakord më tej për shtyrjen e vendimit përfundimtar në shtator 2000 në vend të majit 1999 dhe "Izraeli" ra dakord të lirojë disa nga të burgosurit politikë palestinezë. (Saleh, 2003, p. 306)

2.5. Ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë dhe procesi i paqes në Lindje të Mesme

Edhe pse çështja e Kosovës ishte tepër serioze dhe kërkonte ndërhyrje urgjente, ndërkombëtarët provuan rrugën diplomatike të zgjidhjes së problemit. Shqiptarët e Kosovës ballafaqoheshin me shpërngulje masive, dhunime, vrasje, masakra që bota sot i njeh si krime kundër njerëzimit dhe akte të spastrimit etnik. Kjo ndodhte në mes të Evropës dhe bota perëndimore nuk mund të qëndronte indiferente.

Në këto rrethana, Bashkësia ndërkombëtare kishte vendosur të dërgonte në Kosovë një mision vëzhgues të OSBE-së. Misioni vëzhgues Diplomatik i Kosovës, i udhëhequr nga amerikanët, me pjesëmarrje nga Rusia dhe disa shtete evropiane, u dislokua në Kosovë dhe e krijoi lidhjen midis bashkësisë ndërkombëtare dhe UÇK-së. (King & Mason, 2007, p. 59)

Kjo i shërbeu ndërkombëtarëve të kenë qasje edhe në zonat që kontrolloheshin nga UÇK-ja dhe për të shfrytëzuar informacionin që ky formacion ushtarak kishte. Kjo do të ndikonte edhe në nxjerrjen e raporteve sa më objektive nga tereni. Megjithatë, shumë kohë më parë, vëzhguesit e OSBE-së e gjetën veten të pafuqishëm, pasi vrasja e shqiptarëve të Kosovës nga ana e serbëve vazhdoi me një ritëm të ulët por të qëndrueshëm. Në përgjigje, NATO deklaroi se duhej ndërmarrë "të gjitha hapat", përfshirë sulmet ajrore nëse është e nevojshme, për të detyruar pajtimin e serbëve në gjetjen e zgjidhjes në Kosovë. (Lambeth, 2001, p. 7)

Strategjia e Millosheviçit për të fshehur spastrimin etnik si një veprim i ligjshëm i ushtrisë serbe kundër një force guerilase secesioniste, nuk mund të funksiononte pafundësisht: komuniteti ndërkombëtar reagoi dhe më 23 shtator 1998, OKB-ja kërkoi një armëpushim. (Thomas & Mikulan, 2006, p. 48). Millosheviçi pranoi të tërhiqte forcat e tij dhe të lejonte vendosjen e vëzhguesve ndërkombëtarë nën një marrëveshje që e njohu çështjen e Kosovës si një çështje me interes ndërkombëtar. (Murphy, 2007, p. 72)

Gatishmëria për të dërguar vetëm vëzhgues me armatim të lehtë, në vend të trupave luftarake për të mbrojtur Kosovën, në sytë e Millosheviçit u pa si shenjë dobësie e Shteteve të Bashkuara dhe Aleatëve të saj. Millosheviçi dhe grupi i tij i terroristëve kërkuan të qëndrojnë në Kosovë duke i shtyrë shqiptarët e Kosovës jashtë Kosovës. Me fjalë të tjera, ata miratuan një politikë gjenocidi. (Tatum, 2010, pp. 125-126). Veprimet kriminale të regjimit jugosllav kundër popullatës civile në Kosovë, rinisën me pretekstin e luftimit të UÇK-së.

Në janar të vitit 1999, në një hendek afër fshatit Reçak nga gazetarët u gjetën rreth dyzet e pesë trupa shqiptare, prova e masakrës më të madhe të konfirmuar në Kosovë deri më sot. Numri i vdekjeve u rrit në mbi 2.000 (Campbell, 2000, p. 206). Masakra e Reçakut bëri jehonë ndërkombëtare. Pamjet në vendin e ngjarjes të vëzhguesve ndërkombëtarë dhe mediave nuk linin hapësira për manovrim dhe arsyetim të krimeve kundër njerëzimit, spastrimit etnik dhe veprimeve gjenocidale serbe ndaj popullatës civile në Kosovë. Nga ky moment bashkësia ndërkombëtare filloi lëvizjet konkrete për gjetjen e një zgjidhjeje për luftën e Kosovës.

2.5.1. Konferenca e Rambujesë (1999)

Pasi më 31 janar 1999 në Beograd dështuan bisedimet e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, Fuqitë e Mëdha (të bashkuara në Grupin e Kontaktit) thirrën për 6 shkurt 1999 një konferencë në Rambouillet të Francës, në të cilën u ftuan një delegacion i Qeverisë serbe dhe një dërgatë e shqiptarëve të Kosovës, e përbërë prej përfaqësuesve të UÇK-së dhe LDK-së. (Schmitt, 2012, p. 260)

Srebrenica ishte një tragjedi në Evropë, e cila nëse do të përsëritej edhe në Kosovë (!), do të zbehte legjitimitetin e Bashkimit Evropian, NATO-s dhe Perëndimit në përgjithësi, si mekanizma të menaxhimit, ruajtjes dhe kultivimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Duke emuluar formën shtrënguese të diplomacisë që i kishte dhënë fund konfliktit në Bosnje, palëve u ishte thënë se kishin dy javë të bien dakord për detajet e planit të paqes të zhvilluara nga Hill, ose të përballen me pasojat. Për Serbinë kjo nënkuptonte një sulm ushtarak. Për shqiptarët e Kosovës, do të thoshte humbje e mbështetjes së jashtme. (Ker-Lindsay, 2009, p. 14)

Marrëveshja e Rambujesë, për dallim nga marrëveshjet e tjera, por edhe për dallim nga marrëveshjet ku bënin pjesë palestinezët deri në këtë vit, e konsideronte delegacionin shqiptar të Kosovës, për herë të parë si palë negociuese.

Në Rambuje Grupi i Kontaktit propozoi një draft dokument të marrëveshjes potenciale që mund të arrihej në mes të palëve. Të dyja palët fillimisht ishin larg nga dakordimi për marrëveshjen e propozuar. Marrëveshja e nënshkruar nga delegatët shqiptarë të Kosovës në

Rambove ishte që NATO të dërgonte një forcë ndërkombëtare mbrojtëse, KFOR, për një periudhë trevjeçare të “vetëqeverisjes”, gjatë së cilës OSBE do të mbikëqyrë ndërtimin e institucioneve të përbashkëta civile serbo-shqiptare. Administrata civile do të rindërtohet kryesisht nëpër komuna, me një Kuvend të zgjedhur për tërë territorin. Ky Kuvend do të zgjedhë një president dhe do të emërojë një kryeministër dhe gjyqtarët e vendit, duke iu nënshtruar dispozitave që garantojnë përfaqësimin nga grupet etnike. (Clark, 2000)

Një ditë më pas, Serbia nuk pranoi të nënshkruante, duke këmbëngulur se nuk do të merrte parasysh idenë për trupa të huaja në tokën e Kosovës. Më shumë akoma, në të njëjtën ditë kur filloi raundi i dytë i bisedimeve, Millosheviç urdhëroi grumbullimin e forcave ushtarake jugosllave brenda Kosovës dhe atyre rreth saj që kishte filluar muajin e kaluar, në një shenjë të qartë se një lëvizje e madhe kundër UÇK-së dhe kundër civilëve shqiptarë etnikë ishte afër (Lambeth, 2001, p. 9). Kjo nxiti ndërmarrjen e hapave të tjerë nga bashkësia ndërkombëtare, e cila më parë e kishte kërcënuar Millosheviçin se do ta sulmonte ushtarakisht Jugosllavinë.

2.5.2. Intervenimi i NATO-s dhe çlirimi i Kosovës

Pas refuzimit të palës serbe për pranimin e Marrëveshjes së Rambujesë, bashkësisë ndërkombëtare në krye me SHBA-të dhe NATO-në, iu shterën mjetet diplomatike.

Sulmet ajrore të NATO-s që filluan më 24 mars 1999, që synonin t'i jepnin fund dhunës serbe në Kosovë, ishin të shoqëruara nga shkallëzimi i dhunës në terren dhe një largim i madh i refugjatëve që përfshinte dëbimet e organizuara. Brenda nëntë javëve të fillimit të sulmeve ajrore, rreth 860,000 shqiptarë të Kosovës ikën ose u dëbuan nga forcat serbe (Në Shqipëri 444,600), (Në Maqedoni 344,500) dhe (Mal të Zi 69,900). (Muguruza, 2005)

Gjatë fushatës së bombardimeve Millosheviçi urdhëroi zhvillimin e operacioneve të ndryshme paramilitare dhe ushtarake për zhvendosjen, dhunimin, vrasjet dhe masakrat, si akte të dënueshme çnjerëzore ndaj popullsisë civile shqiptare.

Nëse do të bënim krahasim në mes të Palestinës dhe Kosovës, në kontekstin e përmbajtjeve dhe numrit të rezolutave, atëherë Palestina do të printe me numër të konsiderueshëm të rezolutave të OKB-së, ndërsa Kosova do të dallohej veçmas me Rezolutën e

mirënjohur 1244, e cila edhe sot e kësaj dite, 11 vjet pas Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, qëndron si fusnotë në marrëveshjet ndërkombëtare.

Përfundimi i fushatës ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë u kurorëzua me nxjerrjen e Rezolutës 1244 për Kosovën në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Me këtë rezolutë të datës 10 qershor 1999, u vunë kornizat juridiko-politike të një protektorati të llojit të veçantë në Kosovë. (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2011, p. 278)

Rezoluta 1244 e KS të OKB-së pasoi Marrëveshjen ushtarako-teknike të nënshkruar midis NATO-s dhe ish –RFJ-së (9 qershor 1999). Ndër qëllimet themelore theksohej se: “për të vendosur një ndërprerje të qëndrueshme të armiqësive, me asnjë rast, asnjë forcë e FRJ-së dhe Republikës së Serbisë nuk do të hyjë, të kthehet ose mbetet, brenda territorit të Kosovës ose Zonës së Sigurisë Tokësore (ZST) ose Zonës së Sigurisë Ajrore (ZSA) (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2011, p. 280). Kjo marrëveshje ndryshe njihet si Marrëveshja e Kumanovës.

Përfundimisht Kosova u çlirua më 10 qershor të vitit 1999 kur forcat pushtuese serbo-jugosllave u detyruan ta lënë Kosovën. Intervenimi humanitar i NATO-s në Kosovë është diskutuar dhe ka qenë objekt i shumë studimeve mbi legjitimitetin e tij. Disa autorë kanë qasje kundër formës së intervenimit humanitar me argumentin e ruajtjes së sovranitetit të brendshëm të shteteve. Por shumica e autorëve të njohur mendojnë sikurse Rasmus Tenbergen, i cili ndërhyrjen humanitare e përkufizon si "ndërhyrje ushtarake në punët e brendshme të një shteti sovran për [qëllimin] e mbrojtjes së të drejtave të njeriut". Tenbergen po ashtu thekson se ndërhyrjet humanitare janë legjitime kur mbrojnë më shumë të drejta njerëzore se sa dëmtojnë. (Ramet, 2005)

Presidenti i atëhershëm i SHBA-ve Bill Clinton, në një fjalim drejtuar trupave amerikane të KFOR-it, ndërhyrjen humanitare e vlerësoi si akt legjitim dhe të mundshëm. Pas intervenimit në Kosovë dhe fitores së NATO-s ai theksoi se “Nëse mund ta bëjmë këtë këtu, ne, atëherë, mund t’u themi njerëzve në botë, kudo që jetoni, në Afrikë, në Evropën Qendrore, apo kudo tjetër, në rast se dikush përndjek qytetarë të pafajshëm dhe përpiqet t’i vrasë në masë, për shkak të racës, etnisë apo besimit të tyre, e nëse kjo është në fuqinë tonë për ta ndaluar, ne do ta ndalojmë”. (Clinton P. B., 2018)

Në rastin e Kosovës bota vetëm ka ndalur spastrimin etnik dhe veprimet gjenocidale ndaj një popullate të pa mbrojtur. Pra, Bashkësia ndërkombëtare sipas idesë mbi legjitimitetin e ndërhyrjeve humanitare të autorit Tenbergen, ka mbrojtur më shumë të drejta njerëzore sesa ka dëmtuar.

2.5.3. Samiti i Camp Davidit (2000)

Gjersa në vitin 2000, shqiptarët e Kosovës po e përjetonin çlirimin, palestinezët sërish do të kishin një takim ndërkombëtar në përpjekje të vazhdueshme për procesin e pages.

Më 5 korrik 2000, Presidenti Clinton i bëri ftesa Arafatit dhe Barakut për një samit në vendin e tërheqjes presidenciale në Malet Katatonike të Maryland, ku Carter, Begin dhe Sadat ishin mbledhur afërsisht 20 vjet më parë. Samiti filloi më 11 korrik dhe zgjati deri më 25 korrik. Kampi David II ishte dhe ende është i mbuluar me pak mister për shkak të "ndalimit" të shtypit dhe mungesës së ndonjë regjistri të shkruar ose hartës që është prodhuar gjatë procedurës (Harms & Ferry, 2005, p. 165). Sidoqoftë Camp David organizohej si një përpjekje për zgjidhjen finale të konfliktit izraelito-palestinez.

Camp David organizohej si një përpjekje për zgjidhjen finale të konfliktit izraelito-palestinez, por në shumicën prej çështjeve të iniciuara, do të ishte takim pa rezultate konkrete.

Në Camp David, Arafat u largua dhe hodhi poshtë çdo ofertë të njëpasnjëshme. Ai nuk pranoi të bënte kompromis për secilin lëshim të madh kryesor - refugjatët, Jerusalemin, Tempullin, sigurinë izraelite dhe kufijtë. (Morris, 2009, pp. 172-173)

Asnjëra palë nuk po pranonte sistemin e lojës së kompromisit. Pas dy javësh bisedimet u ndërpre në midis akuzave reciproke. Izraeli argumentoi se kishte bërë një 'ofertë bujare' për kthimin e 97 përqind të territoreve të okupuara, të cilën pala tjetër e kundërshtoi duke u kthyer në dhunë për të detyruar koncesione që nuk mund t'i arrinte në tryezën e bisedimeve. (Berry & Philo, 2006, p. 109)

Pavarësisht se Samiti i Camp Davidit ofronte disa kompromise për kontrollin dhe menaxhimin e disa territoreve palestinezeve nga Palestina, sërish nuk arrihej ujdia as për Rripin e Gazës e as edhe për qytetin e shenjtë për tri fetë botërore- Jerusalemin.

Lideri palestinez Arafat në Camp David ishte shumë këmbëngulës. Në dhjetor 2000 - janar 2001 i tha "jo" propozimeve të përmirësuara të Clintonit, të cilat u ofruan shtetësinë palestineze në 100 përqind të Rripit të Gazës, 94-96 përqind të Bregut Perëndimor (me disa kompensime nga territori izraelit për zonat "e ceduara") dhe gjysmën e Jerusalemit (Morris, 2009, p. 173). Fillimi i dështimit të negociatave në samit dhe planit Clinton, do të dërgonte përpjekjet për paqe në një rrugë qorre.

2.5.4. Intifada e dytë (2000 -2005)

Si intifada e parë, edhe intifada e dytë, solli shumë dhunë, viktime dhe tensione në raportet Izrael-palestinë. Ajo nxiti zhvillime të reja diplomatike.

Intifada e dytë, e njohur edhe si Intifada e Al-Aksa (sipas xhamisë ku fillimisht shpërtheu dhuna) është një nga episodet më të gjata dhe më të përgjakshme të konfliktit izraelito-palestinez. (Manekin, 2013, pp. 1275-1276)

Intifada e dytë mori shkas çështjen e ndjeshme fetare-historike për të dyja palët. E ashtuquajtura intifada e al-Aqsa-s shpërtheu më 29 shtator 2000 dhe u shkaktua nga vizita e liderit të Likud Ariel Sharon në malin e tempullit / Haram ash Sharif një ditë më parë. Vizita e Sharonit kishte për qëllim shtimin e kërkesës së Izraelit për një Jerusalem të bashkuar, si dhe minimin e Barakut. (Best, Hanhimaki, Maiolo, & Schulze, 2008)

Kjo vizitë do të komentohej shumë mbi motivet e saj të hapura e të fshehura të Sharonit.

Amos Gilad, kreu i divizionit të zbulimit të Inteligjencës në atë kohë, rekomandoi që Sharon të mos e vizitonte Malin e Tempullit më 28 shtator për shkak të tensionit mbizotërues (Eiland, 2010, pp. 27-28). Sharon realizoi vizitën, duke lënë të nënkuptohet se vizita e tij në xhaminë Al-Aksa ishte një provokim i qëllimshëm i situatës, ndaj së cilës palestinezët zemërimin e tyre do ta manifestonin me dhunë.

Pavarësisht se shkas i Intifadës së dytë u bë një vizitë në një zonë sakrale, zemërimi i rinisë palestineze ishte akumulim i shumë pakënaqësive tjera të përditshme, të cilat ishin mbledhur ndër vite.

Dhuna e përhapur që pasoi ishte rezultat i zemërimit nga prania e Sharonit, por gjithashtu i zhgënjimit afatgjatë palestinez me një proces paqeje të perceptuar si mbështetje të ambicieve

hegjemoniste izraelite, të pakënaqësisë me mungesën e ndryshimeve në jetën e përditshme palestineze, pakënaqësi me udhëheqjen e tyre dhe me tërbim të ndejshëm veçanërisht nga një brez i ri, thellësisht i tjetërsuar. (Best, Hanhimaki, Maiolo, & Schulze, 2008, pp. 444-446)

Në konfliktin e armatosur u përdorën mjete të rënda ushtarake dhe guerile.

Organizatave palestineze përdorën një sërë taktikash të dhunshme kundër ushtarëve dhe civilëve izraelitë, duke përfshirë sulmet me armë zjarri në rrugë dhe vendbanime, shpërthime bombash, sulme me raketa dhe një fushatë terroriste vetëvrasëse në qytetet izraelite... taktikat e kundërzbulimit izraelit përfshinin vrasje të militantëve, bombardime të instalimeve të dyshuara militante, arrestime dhe ndalime të përhapura, shkatërrim të shtëpive dhe kufizime të rrepta të lëvizjes. (Manekin, 2013, p. 1276)

Samiti tjetër me rëndësi për negociatat Izrael-Palestinë ishte edhe ai i Tabas, në vitin 2001.

Samiti i Tabas (2001) - Pas dështimit të negociatave të Camp Davidit dhe pavarësisht nga raundi i ri i dhunës intensive izraelito-palentineze, një seri e re bisedimesh të rëndësishme izraelito-palentineze u zhvillua në Taba, Egjipt, nga 21-27 janar 2001. Të dy palët vazhduan diskutimet e tyre të Camp Davidit. (Fischbach, 2003, p. 355)

Refuzimi i Planit Taba nga pala palestineze është vlerësuar në mënyrë të ndryshme dhe një nga to është kritika e rreptë ndaj Arafatit.

Refuzimi i Planit Taba të vitit 2001 nga Yasir Arafat, nga një përpjekje e fundit e presidentit amerikan Bill Clinton për të shpëtuar procesin e paqes së Oslos, ishte një fatkeqësi e pafalshme për palestinezët. Ky plan, i hartuar në qytetin bregdetar të Egjiptit në Taba, u dha palestinezëve një shtet nën udhëheqjen amerikane, duke përfshirë pothuajse të gjitha tokat në pajtim me Rezolutën 242 të Kombeve të Bashkuara (kufijtë para vitit 1967), duke përfshirë pjesë të vogla të Jerusalemit dhe leje për një numër simbolik të refugjatëve që të kthehen në atdheun e tyre historik. (Schanzer, 2008, p. 9)

Marrëveshjet ndërkombëtare janë të ndikuara shumë edhe nga atmosfera e brendshme elektorale në shtetet përkatëse të qeverive e presidentëve. Një rasti i tillë mund të përmendet edhe ai i Ehud Barakut.

Izraeli paraqiti një ofertë të përmirësuar, por pas një jave, Ehud Barak i ndërpreu bisedimet pa një marrëveshje, duke përmendur afërsinë e zgjedhjeve të përgjithshme izraelite.

Arafati dënoi vendimin për ndërprerjen e bisedimeve dhe akuzoi Izraelin për kryerjen e "një lufte të egër dhe barbare kundër palestinezëve". Megjithatë të dy palët lëshuan një deklaratë ku thuhej se ata kishin bërë përparim dhe si kurrë më parë ishin afër një marrëveshje. (Berry & Philo, 2006, p. 117)

Zmbrapsja e Ehud Barakut nga Plani Taba, ishte veprim i parashikuar nga ai, pasi që në zgjedhjet që do të mbaheshin, do të pësonte debakël prej Ariel Sharonit.

Edhe pse këto bisedime dështuan, ato patën për qëllim zgjidhjen e "statusit final" të Palestinës, dhe arritjen e paqes me Izraelin. Procesi i paqes u cenua kur Kryeministri Ariel Sharon fitoi zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura më 6 shkurt 2001, kundër rivalit të tij Ehud Barak, me një diferencë spektakolare prej më shumë se 25% të votave, gjë që konfirmoi rritjen e ekstremizmit në shoqërinë cioniste. (Salih D. M., 2002, p. 526)

Një vit pas Planit Taba, doli edhe një plan i ri, nën udhëheqjen e Presidentit të ri amerikan, George Bush.

Road Map (2002) - Nën presidencën e *Bushit* u përpilua një plan i ri, i quajtur *Road Map*, për një zgjidhje përfundimtare të konfliktit izraelito-palestinez. Një plan që të realizonte idenë "dy popuj-dy shtete" duke i detyruar palët të kryejnë zotime të përcaktuara qartë dhe në afate kohore të zbatuara me rreptësi: palestinezët duhet t'i jepnin fund çdo veprimi terrorist brenda majit të vitit 2003; brenda 2005-ës lindja e shtetit palestinez; e drejta e refugjatëve palestinezë për t'u kthyer në Izrael; renovimi i lidërshpit palestinez. (Grimberg, Historia Botërore dhe Qytetërimi 12, 2005, p. 523)

"Road Map" e kishte në pakon e tij zgjidhjen dyshtetërore, si dhe përmirësimin e raporteve ndërfqinjësore të Izraelit me shtetet arabe.

Plani kishte tre faza dhe faza e tretë do të merret me çështjet e statusit final: vendosjen e kufijve të përhershëm për një shtet palestinez të "pavarur, demokratik dhe të qëndrueshëm" dhe përfundimin e konfliktit. Shtetet arabe pastaj do të normalizonin plotësisht marrëdhëniet me Izraelin. (Karmi, 2007, p. 156)

Në vitin 2003 sërish u bënë përpjekje për negociata, por edhe vrasjet e civilëve vazhduan edhe në dekadën e parë të shekullit XXI. Vetëvrasja si mjet politik dhe fuqia e palestinezëve për luftë frontale, do ta bënte këtë mënyrë të veprimeve të tyre, si të papranueshme, jo vetëm nga

izraelitët, por edhe nga faktori ndërkombëtar. Në anën tjetër, tejkalimi i dhunës proporcionale nga Izraeli dhe vrasjet e civilëve u refuzuan nga shumë zëra globalë e ndërkombëtarë. Kjo nxiti edhe tensionimin në rritje të palestinezëve, pavarësisht se në fillim shumica e forcave politike palestineze, u dakorduan për një armëpushim që do të siguronte negociatat e reja.

Menjëherë pas kësaj, në fund të qershorit 2003, Hamasi, Xhihadi Islamik dhe Fatahu shpallën një armëpushim tremujor për të lejuar hapësirë për negociata. Megjithatë, armëpushimi nuk qëndroi përballë vrasjeve të tjera të civilëve dhe luftëtarëve palestinezë nga IDF dhe pati një rifillim të bombardimeve vetëvrasëse në Izrael. (Berry & Philo, 2006, p. 124)

Në vitin 2003, Izraeli filloi ndërtimin e murit ndarës për t'u izoluar nga komunitetet palestineze. Izraeli argumentoi se muri ishte i domosdoshëm për të ndaluar bombarduesit vetëvrasës. Shumë tokë palestineze u konfiskua për ndërtimin e murit. Përveç kësaj, muri veçoi plotësisht Jerusalemin Lindor nga pjesa tjetër e komunitetit palestinez ... Gjatë vitit 2004, konflikti në Gaza u përshkallëzua shpejt. Militantët islamikë qëlluan raketa Qassam në territorin izraelit. Izraeli u përgjigj me një sërë bastisjesh të blinduara dhe vrasjes së udhëheqësve të Hamasit. (Al Ja'bari, 2018, p. 32)

Ngjarje e veçantë e me peshë politike në Palestinë, do të ishte vdekja e njërit prej figurave më karizmatike palestineze, Arafatit, në vitin 2004. Po në këtë vit në Kosovë ishte rritur pakënaqësia e shqiptarëve të Kosovës me administrimin ndërkombëtar dhe UNMIK-un; zhgënjimin se pas tre vjetësh nga Rambujeja do të duhej të shpallej pavarësia e Kosovës dhe nuk u shpall si dhe disa arsye tjera të njohura dhe panjohura. Këto çuan në trazirat e njohura të marsit 2004. Situatë pak a shumë e ngjashme me vdekjen e Arafatit, do të ishte edhe vdekja e ish-Presidentit Ibrahim Rugova në Kosovë, dy vjet pas vdekjes së Arafatit – një nga liderët palestinez më të krahasueshëm me Rugovën.

Vdekja e Arafatit të mënjanuar në nëntor 2004 në një spital të Parisit dhe varrimi i tij në Ramallah zor se shkaktoi ndonjë tronditje, përveç se te mbështetësit e tij më të zjarrtë. Udhëheqja e Autoritetit Palestinez tani kaloi te Mahmud Abazi, që pavarësisht nga përpjekjet e tij të guximshme, duket se nuk është në gjendje ta frenojë popullin e tij nga vazhdimi i akteve të terrorizmit kundër Izraelit. (Stoessinger, 2015, p. 301)

Viti 2005, ishte periudha e përfundimit të Intifadës së dytë Palestineze, ndërsa në Kosovë ishte viti i fillimit të negociatave Kosovë-Serbi në Vjenë të Austrisë, e ku do të diskutohej për statusin e Kosovës, tri vjet para shpalljes së pavarësisë.

Abbas dhe Sharon shpallën një armëpushim në shkurt të vitit 2005. Ky armëpushim u refuzua nga Hamasi. Izraeli vendosi të liroj Rripin e Gazës dhe të gjitha vendbanimet izraelite në Gaza do të evakuoeshin. Ky plan i lëshimit u krye në gusht të vitit 2005. Intifada e dytë përfundoi në vitin 2005, pas tërheqjes dhe fillimit të negociatave zyrtare të paqes midis qeverisë izraelite dhe OÇP-së (Al Ja'bari, 2018, p. 32). Në mes të viteve 2000 dhe 2005, më shumë se 3,000 palestinezë dhe më shumë se 1,000 izraelitë u vranë si pasojë e shpërthimit të dhunës. (Manekin, 2013, p. 1276)

Viti 2006 mund të cilësohet si “Vit i Hamasit”, por edhe “Vit i dëshpërimit me autoritetin e deriatëhershëm palestinez”.

Në vitin 2006 palestinezët zhvilluan zgjedhjet e përgjithshme. Më 25 janar 2006, Hamasi fitoi zgjedhjet legislative, duke marrë 74 nga 132 vende. Fitorja e Hamasit nuk ishte domosdoshmërisht rezultat i dëshirës popullore për një shtet islamik, por një pasqyrim se sa të zhgënjyer ishin njerëzit me Fatahun. Zgjedhja e Hamasit ishte një sfidë për kryeministrin izraelit Ehud Olmert, i cili kishte pasuar Sharonin, pasi ky i fundit kishte pësuar një goditje dhe ra në koma më 4 janar 2006. (Best, Hanhimaki, Maiolo, & Schulze, 2008, p. 448)

Një vit më pas, me ndërmjetësimin e sauditëve, do të bashkoheshin forcat e moderuara dhe ato radikale palestineze.

Me iniciativën e Arabisë Saudite në 8 shkurt 2007, Mahmud Abasi bëri një marrëveshje me Hamasin. Në 13 mars 2007 u formua qeveria e re palestineze e unitetit kombëtar. (Sinani, 2010, p. 148)

Hamasi nuk kishte reputacion të mirë ndërkombëtar, e lëre më nga Izraeli, që e sulmonte herë pas here me armatim mjaft të rëndë, me pasoja shumë në njerëz (viktima) dhe dëme materiale.

Izraeli pezulloi të gjitha pagesat për shkak të Hamasit lidhur me detyrimet e tij për t'u paguar pagat një ushtrie me zyrtarë, policë, mësues, si dhe shpenzimet për shëndetin dhe varrimin e palestinezëve, që i përfitonin ato në Gaza. Edhe Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi

Evropian, që e kishin cilësuar Hamasin si një organizatë terroriste, i ndaluan të gjitha ndihmat. (Stoessinger, 2015, p. 303)

Konflikti ndërmjet vet palestinezëve do të kishte efekte të drejtpërdrejta në kauzën e tyre; Por qetësia e parashikueshme, e ndërmjetësuar nuk zgjati shumë. Nuk kishte pothuajse asnjë mënyrë për të fshirë mënjatë dhimbjen dhe armiqësinë që mbeti; gjakderdhja ndërmjet Fatahut dhe Hamasit kishte rezultuar me qindra vdekje dhe plagosje në 2006 dhe 2007. (Schanzer, 2008, p. 103)

Pasojat e konfliktit brendapalestinez, do të jepnin më shumë manovra politike dhe strategjike për Izraelin. Lufta civile palestineze e ndihmoi Izraelin të impononte një bllokadë në Rripin e Gazës në vitin 2007. Çdo gjë që del dhe hyn në Gaza kontrollohet nga Izraeli dhe Egjipti. (Al Ja'bari, 2018, p. 33)

Viti 2007 koinçidon pak a shumë analog për Kosovën dhe Palestinën, sepse po në këtë vit së shpejti do të përmbylej dokumenti ndërkombëtar i njohur me emërtimin Plani Gjithëpërfshirës i Marti Ahtisarit, i cili do të bëhej material i legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Po në këtë vit edhe në Palestinë, po ashtu do të nxitej diskutimi për shtetin e pavarur palestinez.

Konferenca e Anapolisit (2007) - Themelimi i një shteti të pavarur palestinez do të jetë tema kryesore e negociatave të ardhshme. Kjo ka qenë politika zyrtare amerikane që nga viti 2002 ... Takimi i Annapolis, i mbajtur më 27 nëntor 2007, ishte një pjesë e asaj politike. Pas shtatë vjet bisedimesh të ngecura, izraelitët dhe palestinezët u bashkuan në Annapolis në përgjigje të nismës së SHBA-ve. (Bölme, 2007, pp. 1-2)

Themelimi i shtetit palestinez, ishte pjesë e pakos së "Road Map" të Presidentit George Bush. Madje thuhej se pas krijimit të Palestinës si shtet i pavarur, kishte plane edhe për njohje kolektiviste.

Qëllimi i konferencës ishte krijimi i një dokumenti substancial për zgjidhjen e konfliktit izraelito-palestinez përgjatë linjave të Hartës së Rrugës për paqe të presidentit George W. Bush, me vendosjen eventuale nga Autoriteti Palestinez i një shteti palestinez në territoret palestineze. Sipas planit, menjëherë pas kësaj, shteti i ri do të duhej të njihej kolektivisht nga Federata Ruse, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara. (Benoliel & Perry, 2010, p. 84)

Premtimet për statusin përfundimtar palestinez, nuk pushonin asnjëherë.

Deklarata e saj përfundimtare shpalli se, bisedimet izraelito-palestineze mbi marrëveshjen e statusit përfundimtar do të fillonin në mes të dhjetorit dhe do të përfundoheshin një vit më vonë. Zbatimi i marrëveshjes ishte kushtëzuar në përmbushjen e detyrimeve të të dy palëve brenda Hartës Rrugore nën mbikëqyrjen amerikane. (Podeh, 2014, p. 595)

Fundi i vitit 2007 ishte i rëndësishëm edhe në planin zhvillimor ekonomik për Palestinën, pasi që parashihej që të jepeshin mjete financiare për ndërtimin e institucioneve të saj.

Një konferencë ndërkombëtare u mbajt në Paris, Francë, më 17 dhjetor 2007 me qëllim të shqyrtimit të përpjekjeve palestineze për zhvillimin dhe ndërtimin e institucioneve dhe ngritjen e fondeve për të mbështetur këto përpjekje... konferenca u bashkëkryesua nga Norvegjia, Komisioni Evropian dhe përfaqësuesi i kuartetit Tony Blair. Në përgjithësi, 7,4 miliardë dollarë u zotuan nga vendet pjesëmarrëse, prej të cilave 3,4 miliardë dollarë janë premtuar për vitin 2008. (ECF, 2007)

Izraeli dhe Palestina vazhduan konfliktin e tyre, duke tentuar që të realizojnë dy palë qëllime në një territor.

2.5.5. Administrimi ndërkombëtar në Kosovë

Pas përfundimit të bombardimeve dhe tërheqjes së forcave serbe, filloi organizmi i ri i jetës në Kosovë.

Misioni i Kombeve të Bashkuara (KB) UNMIK, forcat e KFOR-it dhe trupat e UÇK-së ishin mekanizmat e parë të huaj e vendorë që do të kujdeseshin për sigurinë dhe fillimin e ndërtimit të institucioneve të reja e të pavarura në Kosovë. UNMIK-u kishte marrë mbi vete të tri komponentet themelore të qeverisjes: koordinimin, udhëheqjen dhe drejtimin, edhe pse mandati i tij me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara përkufizohej në vendosjen e përgjegjësive kryesore të pranisë ndërkombëtare. (Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2011, p. 281)

UNMIK-u dhe KFOR-i mbështetën institucionet e Kosovës për të ndërtuar gradualisht bazat themelore të një shteti e shoqërie demokratike, por edhe të sigurt.

Pas një faze të shkurtër të përkohshme, Kosova u përfshi në procese normale demokratike. Ajo zhvilloi disa zgjedhje të përgjithshme dhe vendore pluraliste, plotësisht të ndershme dhe të lira, duke prodhuar institucione legjitime qendrore dhe lokale. (Bashkurti, 2008, p. 141)

Rezoluta 1244 ishte burimi kryesor i problemeve të ardhshme, që do të paraqiteshin në zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës.

Statusi politik kushtetues i Kosovës, i cili zyrtarisht ka mbetur pjesë përbërëse e RFJ-së, është de facto ende i padefinuar. Udhëheqja politike shqiptare dhe një pjesë e madhe e popullatës së Kosovës vazhdonin të këmbëngulin për pavarësi. (Calic, 2000, p. 30)

Rezoluta 1244, ishte baza e fushëveprimit institucional, për administrim ndërkombëtar të Kosovës për dy dekadat e ardhshme.

Sipas rezolutës 1244 administrata kalimtare e UNMIK-ut do të ishte trasim i rrugës për zgjidhje të statusit përfundimtar të Kosovës. Pas një riorganizimi në Maj të vitit 2001, Shtyllat e parë dhe e dytë që përbëjnë administratën civile, policinë dhe drejtësinë drejtoheshin drejtpërdrejt nga UNMIK-u, ndërsa rindërtimi ekonomik ishte nën juridiksionin e BE-së dhe ndërtimi i institucioneve ishte caktuar për OSBE-në. Në krye të UNMIK-ut ishte Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, i cili gjithmonë njihej si PSSP. (Judah, 2008, p. 94)

Fillimi i ndërtimit të institucioneve, sado sfidues që ishte, nuk krahasohet me problemet dhe vështirësitë që do të dilnin në zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Në prizmin e bashkësisë ndërkombëtare, e në veçanti vendeve të Bashkimit Evropian, zgjidhja e statusit të Kosovës shihej si një shpallje e fituesve në betejën e kaluar të Kosovës, gjë për të cilën ata nuk ishin të interesuar.

Bashkësia Evropiane donte një zgjidhje që do kënaqte të dyja palët apo që nuk do të gëzonte vetëm njërin palë. Kjo është shumë e vështirë për t'u arritur. Nëse aludohej për të balancuar Rusinë dhe Kinën në qëndrimet e tyre për zonën, prap do të ishte një gabim. Ata kurrë nuk do të pajtoheshin me intervenimin dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës, që sipas tyre do të cenonte integritetin territorial të RFJ-së.

Në vitin 2003, misioni i OKB-së në Kosovë miratoi politikën e "standardeve para statusit", gjë që tregonte se njohja si një shtet i pavarur kushtëzohej nga disa standarde të qeverisjes efektive dhe demokratike. (Caspersen, 2012, p. 20)

Në këtë situatë, nisën negociatat e ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian për zgjidhjen e statusit final të Kosovës.

Bisedimet për statusin nisën nga fundi i vitit 2005, ndërmjet liderëve të saj dhe Qeverisë së Serbisë. Negociatat zgjatën deri në fund të 2007-së, me ndërmjetësimin së pari nga Martti Ahtisaari – të cilit iu nda çmimi “Nobel” për Paqe, më 2008 – e më vonë edhe nga të tjerët. Ata dështuan për shkak se Serbia, e përkrahur nga Rusia, insistoi që t’i ruante të drejtat e veta sovrane dhe ia ofroi Kosovës vetëm një shkallë të lartë autonomie, përderisa shqiptarët e Kosovës, të përkrahur në rend të parë nga Washingtoni, nuk pranonin më pak sesa pavarësinë. (Capussela, 2015, p. 25)

Në një raport të vitit 2007, i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Martti Ahtisaari, rekomandoi që Kosovës t’i jepet pavarësia e mbikëqyrur. Kosova do të njihet si një shtet i pavarur, por një mbikëqyrës ndërkombëtar ende do të jetë i pranishëm për të siguruar, në veçanti, se shteti i ri ka përmbushur premtimet e tij lidhur me demokracinë dhe të drejtat e pakicave. (Caspersen, 2012, p. 20)

Roli dhe vendosmëria e SHBA-ve, ishte vendimtare për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Deklarata e Bushit ishte ndër sinjalet më të qarta, më të drejtpërdrejta dhe më konkrete, për fatin e ardhshëm të Kosovës. Kjo ngelet edhe një nga deklaratat më të rëndësishme në kujtesën kolektive të të gjithë shqiptarëve.

Gjatë vizitës së parë të një presidenti amerikan në Shqipëri, në qershor të vitit 2007, Presidenti George W. Bush për Kosovën deklaroi se “Në një moment kohor, më herët sesa më vonë, duhet të thuash se mjaft është mjaft, Kosova është e pavarur”. (Zakaria & Tzortzi, 2007)

2.5.6. Akti i shpalljes së Pavarësisë dhe krijimi i shtetit të Kosovës

Pas një procesi të gjatë të negociatave për statusin, gjërat vetëm se kishin marrë formë dhe vetëm priteshin aktet përfundimtare për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Për shqiptarët nuk ishte e pranueshme asgjë më pak sesa pavarësi, ndërkaq për shtetin e Serbisë asgjë më shumë se një autonomi e zgjeruar. Pas dështimit të shumë raundeve të negociatave, faktori ndërkombëtar nuk mund të prodhonte një zgjidhje të ndërmjetme dhe se duhej marrë vendimet me anë të të cilave do të përfundonte procesin për Kosovën.

Kosova shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt të vitit 2008. Në pikën 1 të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës thuhet: *“Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”*. (Kuvendi i Kosovës, 2008)

Kosova aktin e shpalljes së pavarësisë e kishte bërë në koordinim të plotë me aleatët e saj. Kjo tregonte për gatishmërinë e Kosovës për bashkëpunim, orientimin dhe ambiciet euroatlantike të shtetit të ri. Do të përsëritej në vazhdimësi nga zëra vendorë dhe ndërkombëtarë, se Kosova është rast “siu generis” për të mos shkaktuar “efektin domino” në asnjë pjesë tjetër të botës, e veçmas në Ballkanin Perëndimor.

Deklarata paraqiste se Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është presedan për cilëndo situatë tjetër. Ky pohim në deklaratë mëtonte eliminimin e vlerësimit si precedent të rastit të Kosovës nga rajonet tjera në botë. (Kuvendi i Kosovës, 2008)

Më 15 qershor të vitit 2008, hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ajo përkufizon shtetin e ri si të pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe të pandashëm. Gjithashtu, theksohet se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj. Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti. (Kuvendi i Kosovës, 2008)

Prej shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë e deri në Opinionin GJND-së në vitin 2010, Kosova do të ishte e pranishme me lajmet e vazhdueshme për njohjet e njëpasnjëshme nga shtetet e ndryshme, ndërsa në këtë periudhë kohore, Palestina, edhe ishte me tensione, por edhe me përpjekjet e ndërmjetësimit amerikan për paqen në Lindjen e Mesme.

2.5.7. Vazhdimi i përpjekjeve për paqe në Palestinë

Viti 2009 nuk ishte i lehtë as për palestinezët e as për izraelitët. Sërish kishte konflikte e dhunë.

Edhe pse në vitin 2009 konflikti izraelito-palestinez duket gjithnjë e më i vështirë në nivel zyrtar, me një qeveri izraelite të krahut të djathtë të udhëhequr nga Benjamin Netanjahu dhe me qeveritë thellë të ndara rivale të palestinezëve, ka izraelitë dhe palestinezë të cilët vazhdojnë të vendosin veten në vijë të drejtpërdrejtë për një zgjidhje paqësore të konfliktit dhe një marrëveshje të sigurt dhe të qëndrueshme të paqes. (Hallward, 2011, p. 196)

Roli i SHBA-ve si superfuqi globale mbeti konstant në konfliktin izraelito-palestinez. Përpjekjet për paqe i vazhdoi edhe Presidenti i SHBA-ve Barack Obama.

Më 19 maj 2011, një ditë para ardhjes në Uashington të kryeministrit të Izraelit Benjamin Netanjahu, Obama deklaroi se kufijtë mbizotërues përpara luftës arabo-izraelite të vitit 1967, të përshtatura në një farë mase për të llogaritur vendbanimet izraelite në Bregun Perëndimor, duhet të jenë baza e një marrëveshje. (Landler & Myers, 2011)

Përkundër, pamundësisë për një zgjidhje afatgjate të konfliktit izraelito-palestinez, angazhimet e diplomacisë amerikane nuk pushuan, ndonëse ishin mjaft sfiduese.

Në vitet 2013-2014, Sekretari i Shtetit Xhon Kerri zhvilloi bisedime intensive me secilën palë, duke kërkuar që ato të pranojnë një marrëveshje kuadër si prelud të bisedimeve përfundimtare. Udhëheqja e Bregut Perëndimor, e drejtuar nga Abaz, ka shfaqur dëshirën për të arritur një marrëveshje të tillë. Qeveria e Izraelit, e drejtuar nga Kryeministri Beniamin Netanjahu ka ndeshur me një kundërshtim të fortë nga partnerët e saj të koalicionit të djathtë, që nuk pranojnë braktisjen e kontrollit në Bregun Perëndimor. (Cohen, 2016, p. 369)

Në vitin 2015, sërish regjistrohen viktima në radhët e palestinezëve dhe izraelitëve nga rinisja e përplasjeve nga të dyja radhët.

Gjatë dy javëve të para të tetorit 2015, 32 palestinezë dhe shtatë izraelitë vriten në atë që ishte goditja më e madhe e dhunshme, që është parë në këtë pjesë vitet e fundit. Dhuna shpërthen pjesërisht për atë që palestinezët e shohin si shkelje të shtuar të izraelitëve në xhaminë el-Aksa në malin e Tempullit në Jerusalem, një vend i rëndësishëm për myslimanët dhe hebrenjtë. Megjithatë, dhuna shpejt përhapet përtej Jerusalemit. (Wood, 2016)

Një vit më vonë, vazhdoi përkrahja e pakursyer amerikane ndaj izraelit, dhe atë në vlera marramendëse monetare.

Në shtator të vitit 2016, SHBA pajtohet me paketën e ndihmës ushtarake me vlerë 38 miliardë dollarë gjatë 10 viteve të ardhshme për Izraelin, marrëveshja më e madhe në historinë amerikane. Nga pakti i mëparshëm, i cili do të skadojë në vitin 2018, bëri që Izraeli të marrë \$ 3.1 miliardë në vit. Në dhjetor të po atij viti Izraeli pezullon marrëdhëniet e punës me 12 vendet që votuan për një rezolutë të Këshillit të Sigurimit që dënonte ndërtimin e vendbanimeve, pasi SHBA për herë të parë abstenoj nga votimi në vend që të përdorte veton. (BBC, 2019)

Në vitin 2017 një konferencë e radhës do të organizohej në Francë. Alternativa që u përsërit si zgjidhje në mes të izraelitëve dhe palestinezëve mbetet edhe sot si një nga zgjidhjet më të pranueshme dhe më të besueshme, siç është ajo e zgjidhjes së konfliktit me krijimin e dy shteteve.

Më 15 janar të vitit 2017 me nismën e Francës në Paris u mbajt konferenca e paqes për Lindjen e Mesme. Në këtë konferencë morën pjesë mbi 70 shtete dhe organizata ndërkombëtare. Ajo ofroi një mundësi për të riafirmuar solemnisht angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen me dy shtete, me Izraelin dhe Palestinën që jetojnë krah për krah në paqe dhe siguri, si e vetmja mënyrë për të garantuar paqe të qëndrueshme. (France Diplomatie, 2017)

Përpyekjet për paqe në mes Izraelit dhe Palestinës me ndërmjetësim apo inicim të faktorit ndërkombëtar nuk kanë pushuar. Megjithëse, deri sot ato kanë shërbyer vetëm për qetësim të përkohshëm të situatës dhe nuk kanë prodhuar ndonjë zgjidhje të qëndrueshme. Më vonë, po në këtë vit, kemi një vendim “kontrovers” të presidentit të SHBA-ve z. Donald Trump, i cili Jerusalemin e njeh si kryeqytet të Izraelit, për të ardhur më vonë në vitin 2018 edhe vendimi për

të njohur si pjesë të territorit të Izraelit, Rrafshnaltën e Golanit. Kjo padyshim se do të sillte konflikte të reja dhe do të ndante qëndrimet e fuqive të mëdha. Këto dhe çështje të tjera të kohës do të i shtjellojmë në kapituj vijues të trajtesës së këtij punimi.

2.6. Roli i faktorit ndërkombëtar pas Pavarësisë së Kosovës

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës Misioni i UNMIK-ut shihej i tepërt, ndonëse zyrtarët e këtij misioni raportnin për Kosovën çdo tre muaj në KS të OKB-së, por edhe kishin një rol më të veçantë në komunat me shumicë serbe në veriun e Kosovës. Ai nuk do të kishte më kompetenca ekzekutive dhe se institucionet vendore do t'i merrnin në dorë të gjitha përgjegjësit. Para dhe pas shpalljes së pavarësisë liderët e Kosovës kishin deklaruar se pranonin që bashkësia ndërkombëtare në veçanti Bashkimi Evropian të instaloj misionin civil të saj në Kosovë.

Kosova mori detyrime nga Plan i Ahtisaari-t për ta zbatuar në tërësi, përkundër asaj që Serbia e refuzoi. Kosova mirëpriti po ashtu një prani ndërkombëtare për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaari-t. Për këtë u krijua më 28 shkurt Zyra Civile Ndërkombëtare (PCN). (Hoxhaj, 2016, p. 49)

Pas shpalljes së pavarësisë, njëzet e pesë shtete që e njohën Kosovën si shtet të pavarur formuan Grupin Ndërkombëtar Drejtues (ISG) për Kosovën dhe caktuan një Përfaqësues Civil Ndërkombëtar (PCN) për të kryesuar Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO). PCN u emërua njëkohësisht edhe Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian (PSBE) që përfaqëson një Bashkim Evropian të ndarë (BE), ku 22 shtete njihnin pavarësinë e Kosovës dhe pesë nuk do të vendosnin të bënin një gjë të tillë. Mandati i dyfishtë i PCN / PSBE ishte për të siguruar zbatimin e plotë të Planit të Ahtisarit dhe për ta përgatitur Kosovën për integrimin eventual evropian. (International Civilian Office , 2012)

Në Kosovë, në vitin 2008, u instalua misioni i Bashkimit Evropian, EULEX, i cili do të merrte kompetenca të UNIMK-ut. Misioni i EULEX ishte të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore, agjencitë e zbatimit të ligjit në progresin e qëndrueshmërisë së tyre dhe llogaridhënies, në forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të një sistemi të pavarur shumetnik të drejtësisë policisë dhe doganave, duke siguruar që këto institucione të jenë të lira nga ndërhyrjet

politike dhe duke respektuar standardet dhe praktikat evropiane të njohura ndërkombëtarisht. (European Union Council, 2008)

Shqiptarët e Kosovës pranuan kompetenca ekzekutive, edhe pse parciale për misionin e Bashkimit Evropian, në këmbim të pavarësisë së mbikëqyrur të shtetit të ri. Kjo do të ndikonte në hapat me të cilët do të ecte shteti i ri drejt realizimit të aspiratave për shtetndërtim.

Sipas Oisin Tansey, ndërtimi i institucioneve nën autoritetin ndërkombëtar nuk është as i lehtë as i shkurtër, për faktin që institucionet vendore nuk kanë të gjithë hapësirën që dëshirojnë në politikë dhe për manovrat që ata dëshirojnë ose duhet të bëjnë në politikbërje. (Bislimi, 2012, p. 66)

Dy përgjegjës për një shtet në të njëjtën kohë do të vështirësonin progresin në ndërtimin e institucioneve, funksionalizimin e tyre, në veçanti zhvillimin e proceseve në sektorin e sigurisë dhe të drejtësisë. Megjithatë, institucionet ndërkombëtare në Kosovë, do të luanin rol të rëndësishëm për Kosovën dhe të gjithë qytetarët e saj në realizimin e objektivave euro-atlantike të shtetit të ri.

Më 22 korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) dha mendimin e saj këshillëdhënës mbi çështjen e përputhjes me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë në lidhje me Kosovën. Kjo ishte përgjigje ndaj një ankese nga Serbia në AP të OKB-së. (ICJ, 2010)

Në mars të vitit 2011 Serbia dhe Kosova filluan bisedimet e drejtpërdrejta për të provuar përfundimin e mosmarrëveshjeve të tyre. Këto ishin bisedimet e tyre të para që kur Kosova u pavarësua zyrtarisht nga Serbia. Në dhjetor të po atij viti, Kosova dhe Serbia arrijnë marrëveshje për rregullimin e kalimeve kufitare (BBC, 2018). Dialogu i Kosovës dhe Serbisë vazhdon edhe sot me ndërprerje të kohëpaskohshme. Sidoqoftë, në procesin e dialogut Kosova dhe Serbia kanë arritur disa marrëveshje, të cilat nuk janë respektuar kryesisht nga Serbia. Kosova nuk ka ndalur përpjekjet e saj për njohje dhe anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, sikurse Serbia që nuk ka ndalur lobimin kundër pavarësisë dhe anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

III. NJOHJA NDËRKOMBËTARE E SHTETEVE

3.1. Njohja

Njohja në marrëdhëniet ndërkombëtare është aftësia e një shteti për të njohur ekzistencën e një subjekti tjetër shtetëror, të dallueshëm, me karakteristika të veçanta historike, kulturore, politike e gjeografike, e kështu me radhë. Historia njerëzore njih shumë lloje njohjesh të perandorive, mbretërive dhe shteteve dhe më pas humbje kuptimesh të po këtyre njohjeve, pasi që pas lindjes, janë zhdukur e mbetur vetëm si gjurmë arkeologjike, paleontologjike e historike.

Gjatë historisë janë bërë ndryshime të shumta: disa shtete janë zhdukur si rezultat i okupimit (debellatio), ndarjes në më shumë shtete ose bashkimit me shtete të tjera. Kështu janë krijuar shtete të reja. Territoret e mëparme koloniale dhe shtetet vasale kanë fituar shtetësinë. (Gruda, 2013, p. 78)

E drejta ndërkombëtare e sheh procesin e krijimit të shteteve të reja sikur njohje të një subjekti për ekzistencën e “tjetrit”, edhe kur subjekti njohës nuk e manifeston vullnetin e tij të lartë për deklarimin e njohjes së atij subjekti që synon njohjen nga i pari. Tek e fundit, në të drejtën ndërkombëtare, më shumë se çështje juridike, shteti është ekzistencë faktike, objektive, e dukshme, e pashme dhe e prekshme. E drejta ndërkombëtare nuk studion çështjen e lindjes së shteteve të reja në tërësinë e saj. Ajo nuk studion rrethanat në të cilat lindin këto shtete, as faktorët që përcaktojnë lindjen e tyre. Të gjitha këto janë probleme që i përkasin historisë politike dhe jo së drejtës ndërkombëtare.

E drejta ndërkombëtare merret me këto çështje vetëm nga një pikëpamje: nga pikëpamja se kur lind një shtet i ri, shtrohet patjetër edhe çështja e pozitës së tij në të drejtën ndërkombëtare, në marrëdhëniet me shtetet tjera. (Puto, 2010, p. 167)

Bota vazhdimisht ndryshon, e rrjedhimisht, vazhdimisht ndryshon dhe paraqitet krijimi i shteteve të reja. Shtetet që ekzistojnë në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, janë

subjekte prezente ndërkombëtare, të cilat përcjellin gjithmonë zhvillimet e reja, kontekstet e reja, kontestet e paraqitura në skenën globale dhe marrin vendim për të reaguar, për të mbajtur qëndrime të caktuara, rreth këtyre organizmave të rinj etatistë.

Shtetet vazhdimisht janë në rrjedha të zhvillimeve lokale e globale dhe nuk bëhen sikur asgjë nuk po ndodh rreth tyre. Shtetet edhe kur heshtin gjatë krijimit të shteteve të reja, janë subjekte të vetëdijshme ndërkombëtare, duke qenë të vetëdijshme për ballafaqim, reagim, qëndrime apo vendime të caktuara gjegjëse.

Në teori, funksioni bazë i njohjes është një njohje formale si një fakt i diçkaje që ka pasur status të pasigurt deri në pikën e njohjes formale. Dhënia e njohjes tregon gatishmërinë e shtetit njohës për të pranuar pasojat juridike të veprimit të saj dhe për të hyrë në marrëdhënie normale me shtetin (ose qeverinë) të njohur rishtazi. (Glahn & Taulbee, 2017, p. 145)

Në thelb akti i njohjes përbën një akt politik, ndonëse mund të mbështetet pjesërisht ose tërësisht në kritere juridike. Kështu, vendimi për të bërë apo jo njohjen u përket autoriteteve ekzekutive të çdo shteti dhe do të ndikohet nga vlerësime të karakterit politik, ekonomik dhe juridik. (Dixon, 2011, p. 186)

Me aktin e njohjes subjektet e së drejtës ndërkombëtare pranojnë shtetin e ri si pjesë e tyre, si njëri nga ta. Kjo nuk do të thotë që subjektet tjera që nuk njohin shtetin e ri, nuk përcjellin ndryshimin e rrethanave të reja në arenën ndërkombëtare.

Shtetet që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën i konsiderojnë edhe si subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Ndërkaq, as Kosova e as Palestina nuk kanë arritur synimet për të pranuar njohje të gjerë ndërkombëtare nga shumica e subjekteve, në mënyrë që çështja e tyre të mos jetë ndërkombëtarisht e kontestuar.

Sipas faqes zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, atë e kanë njohur zyrtarisht 116 shtete (MFA, n.d.), ndërsa Palestinën e kanë njohur 137 shtete (Mission of the State of Palestine to the UN, 2018). Në këtë punim është bërë një ndarje e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën, shtetet që kanë njohur vetëm Palestinën dhe shtetet që kanë njohur vetëm Kosovën, për të zhvilluar më pas një analizë mbi motivet e njohjes dhe mosnjohjes.

.




Figura 1. Harta e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën (2019).
Burimi: Mapchart.net

Nga harta në F.1, mund të vërejmë se më shumë mbizotëron ngjyra e kuqe sesa ajo e kaltër, që nënkupton se Palestina ka më shumë njohje se Kosova. Por, nuk duhet të na hutojnë ngjyrat, sepse shtetet që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën që llogariten si njohje të përbashkëta bëjnë numrin më të madh të shteteve, gjithsej 71 shtete. Shtetet që kanë njohur vetëm Kosovën dhe nuk kanë njohur Palestinën janë 45, përkundër, 66 shteteve që njohin Palestinën, por jo Kosovën.

Nëse analizojmë njohjet me bazë politike, socio-ekonomike, atëherë mund të konstatojmë se njohjet e Kosovës kryesisht vijnë nga vendet euro-perëndimore me bazë aleancën me SHBA-të. Njohjet e Palestinës janë e kundërta e atyre të Kosovës. Ato rrjedhin kryesisht nga shtetet që kanë qëndrime mospajtuese me SHBA-të dhe nga shtetet që kryesisht janë përkrah dy superfuqive të tjera botërore Rosisë dhe Kinës. Pasi Kosova dhe Palestina me njohje synojnë anëtarësimin në OKB, sipas shteteve që janë anëtarë të përhershëm të Këshillit të Sigurimit dhe kanë të drejtë të vetos, Kosovën e njohin tri prej tyre, SHBA-të, Britania e Madhe dhe Franca, por të njëjtat nuk njohin pavarësinë e Palestinës; ndërsa Rusia dhe Kina njohin pavarësinë e

Palestinës, por nuk njohin shtetin e Kosovës. Kjo tregon edhe për orientimin gjeopolitik të Kosovës dhe Palestinës, si dhe kompleksitetin e çështjes së tyre karshi anëtarësimit në OKB.

Kosovën dhe Palestinën i njohin edhe disa shtete me impakt rajonal si Turqia, Pakistani dhe Arabia Saudite. Nga vendet e Bashkimit Evropian kryesisht janë shtetet e Evropës Lindore që kanë trashëguar njohjen nga sistemet e kaluara si: Bullgaria, Çekia, Hungaria, Malta dhe së fundmi Suedia - si vendi i parë i Evropës Perëndimore e cila ndërmori hapin për njohjen e Palestinës. Njohja është një proces shumë i rëndësishëm për pranimin dhe konsolidimin ndërkombëtar të shtetit të ri. Edhe pse nuk është përfundimtare, ajo ka ndikimin kryesor në subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit.

3.2. Teoritë e njohjes së shtetit

Në literaturën e së drejtës ndërkombëtare, janë të njohura disa teori rreth njohjes së shtetit. Teoritë janë të interpretueshme gjithmonë, pasi që praktikat e shteteve veç e veç për çdo shtet të sapokrijuar, janë nga më të ndryshmet dhe ndryshojnë vazhdimisht në kontekste të reja gjeopolitike dhe në vetë natyrën e sistemit ndërkombëtar. Dy teoritë kryesore mbi njohjen e shteteve janë: teoria konstituive (themeluese) dhe teoria deklarative (formale).

Teoria konstitutive pohon se është akti i njohjes nga shtetet e tjera që krijon një shtet të ri dhe e pajis atë me personalitet juridik dhe jo procesi me të cilin ai në fakt fitoi pavarësinë (Shaw, 2008, p. 445). Teoria konstituive i jep fuqi vendimmarrëse jo subjektit që deklaron ekzistencën e vet, por të tjerëve përreth tij. Në këtë kontekst, raporti i subjektit me të tjerët është raport asimetrik. Fuqia deklarative e një subjekti të ri nuk e përcakton vullnetin e Bashkësisë Ndërkombëtare apo shteteve veç e veç. Po të nisemi nga kjo teori, vullneti i një shteti varet direkt nga vullneti i shteteve të tjera. Shtetet që janë në ekzistencë, pranojnë apo refuzojnë njohjen e një subjekti të ri. Pra, personaliteti ndërkombëtar i shtetit të ri nuk varet direkt nga kapacitetet e tij, por, nga gatishmëria e subjekteve tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Kjo teori e ka prejardhjen e vet në konceptin voluntaristik të së drejtës ndërkombëtare dhe ka mbizotëruar gjatë shekullit XVIII dhe një pjesë të konsiderueshme të shekullit të XIX. Ajo ka gjetur shprehje në praktikën e shteteve të “civilizuara” evropiane (koncerti evropian), të cilat

vendosnin vetë për pranimin e ndonjë shteti në bashkësinë ndërkombëtare (Gruda, 2013, pp. 78-79). Dobësia më e madhe e kësaj teorie është zbehja e forcës së vetëvendosjes së popujve. Teoria e tillë, nuk i merr për bazë pasojat juridike që krijohen, që me shpalljen e shtetit të ri. Vullneti i popujve për vetëvendosje, për pavarësi dhe liri, vendosmëria dhe këmbëngulja e tyre për njohjen e ekzistencës së vet, kanë më shumë efekt sesa thekson teoria konstituive.

Autori Martin Dixon, thekson se kjo teori krijon probleme teorike dhe praktike të pazgjidhshme. Sipas tij, së pari është jashtë dyshimit që njohja është një akt politik, i udhëhequr vetëm pjesërisht nga prime juridike... së dyti, duhet t'i bëjmë vetës pyetjen nëse është në përputhje me funksionimin e cilitdo sistem juridik fakti që subjektiviteti juridik sipas këtij sistemi varet nga pëlqimi subjektiv i dhënë nga palë të treta.. dhe së treti, sikur të hamendësojmë se po pranojmë teorinë themeluese, lind pyetja se në ç'masë duhet të shtrihet praktikisht kjo njohje, me qëllim që një shtet të konsiderohet "i krijuar" (Dixon, 2011, pp. 189-190). Teoria konstituive, në raste nuk ka objektivitet dhe si e tillë është mjaft e diskutueshme.

Teoria tjetër deklarative, i jep fuqi subjektiviteti të ri dhe nuk e zë me vendimmarrje absolute fuqinë e subjekteve ndërkombëtare që tashmë janë të konsoliduara në rendin ndërkombëtar.

Sipas teorisë deklarative, shteti i ri automatikisht (pra, para njohjes) i fiton të drejtat që i takojnë subjektiviteti ndërkombëtar dhe bëhet anëtar i bashkësisë ndërkombëtare po që se i ka plotësuar kushtet që i parasheh e drejta ndërkombëtare (kur një bashkësi njerëzore, në një territor të caktuar është organizuar faktikisht). (Gruda, 2013, p. 79)

Teoria deklarative njohjen e bën të rëndësishme si akt formal, por nuk e shih vendimmarrëse për krijimin e shtetit të ri. Sipas kësaj teorie, akti i njohjes thjesht shënon njoftimin zyrtar se njësi plotëson kushtet themelore të fakteve të lidhura me shtetësinë, dhe regjistron qëllimin për të trajtuar njësinë si një shtet. "Njohja pranon ekzistencën e një shteti, por nuk e krijon atë." (Glahn & Taulbee, 2017, p. 149)

Sipas praktikave të fundit në marrëdhëniet ndërkombëtare, teoria deklarative është më e përqaftuar. Ajo tashmë konsiderohet si më pranë realitetit faktik e politik. Teoria deklarative është paraqitur më vonë dhe përkrahet gjerësisht gjatë shekullit XX nga shumë autorë dhe praktika diplomatike.

Kësaj pikëpamje i është përmbajtur edhe Instituti i së Drejtës Ndërkombëtare në një rezolutë të vitit 1936. Njohja ka efekt deklarativ, thuhet aty... e njëjta gjë është konfirmuar në disa raste në botën latino-amerikane. “Ekzistenca politike e shtetit është e pavarur nga njohja e shteteve të tjera”. Kjo ka qenë formula që është pranuar herën e fundit në Konferencën e Buenos Airesit të vitit 1967. Konferenca Evropiane për paqen në Jugosllavi... përsërit po ashtu të njëjtën pozitë, duke deklaruar se “ekzistenca ose zhdukja e një shteti është një çështje fakti: njohja nga shtetet e tjera ka efekt thjesht deklarativ”. (Puto, 2010, p. 169)

Nëse bazohemi në teorinë deklarative Kosova dhe Palestina nuk duhet të ishin çështje të trajtesave si shtete me konteste ndërkombëtare. Ato duhet të jenë subjekte të së drejtës ndërkombëtare dhe si të tilla duhet të silleshin si aktorë të përgjegjshëm ndërkombëtarë.

Teoria konstituive duke e bërë vullnetin e shteteve ekzistuese si më të rëndësishmin, dhe më përcaktuesin për pranimin apo refuzimin e një shteti të sapokrijuar, e bën njohjen ndërkombëtare si faktor vendimtar në krijimin e një shteti të ri. Ta zëmë, nëse Kurdistani i Irakut, apo Republika Turke e Qipros Veriore nuk njihen nga shumica dërmuese e shteteve, pavarësisht se njihen nga ndonjë shtet, si Izraeli apo Turqia, atëherë kjo do të thotë se ushtrimi i sovranitetit ndërkombëtar, është i pamundshëm. Në rastin e Kosovës në vitin 1991, pavarësisht se u shpall referendumi për Kosovën Republikë dhe u njoh vetëm nga Republika e Shqipërisë, ajo nuk shkaktoi efekte të mëdha në rendin ndërkombëtar. Madje, as pas mbi 100 njohjeve, fuqia ndërkombëtare e saj, ende nuk është e mjaftueshme. Sipas së njëjtës teorie kontestohet edhe pavarësia e Palestinës. Edhe pse në rastin e Palestinës sot është i kontestueshëm edhe plotësimi i kriterëve për ekzistimin e shtetit.

Sipas kësaj teorie konstituive, roli vendimtar për krijimin e një shteti të ri, nuk është shteti i ri, por Bashkësia Ndërkombëtare, ndërsa sipas teorisë deklarative, Kosova, Qipro Turke, pavarësisht a njihen apo jo nga shumica e shteteve, ato janë shtete të reja, në rast se kanë deklaruar vullnetin e tyre për pavarësi, shkëputje dhe shtetkrijim. Si njëra teori, si tjetra, kanë dobësitë e veta. Në praktikën ndërkombëtare e globale, roli i dyja palëve, qoftë subjektit të ri, qoftë shteteve ekzistuese si subjekte të njohura ndërkombëtare, është përcaktues në krijimin e shteteve të reja. Çdo akt juridik, sado i njëanshëm qoftë, u pranua apo jo zyrtarisht, shkakton pasoja në rendin ndërkombëtar.

Teoria konstituive i jep prioritet njohjes ndërkombëtare, ndërsa teoria deklarative, vullnetit për vetëvendosje. Kombinimi i dyja elementeve, si njohjes ndërkombëtare, si shprehjes së vullnetit nga shteti i ri, e jep një pasqyrë më të qartë për subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit. Pa miratimin e Bashkësisë Ndërkombëtare, shteteve të fuqishme globale, pavarësisht referendumeve, shtetet nuk arrijnë të konsolidohen dhe të faktorizohen si subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Ndonjëherë më përcaktuese se çdo gjë tjetër është njohja e shtetit të ri nga superfuqitë globale dhe rajonale. Nëse një shtet i ri njihet ndërkombëtarisht nga një superfuqi si SHBA, Rusia, Kina etj., atëherë gjasat janë që ndikimi i kësaj njohjeje të ketë efekt zinxhiror edhe në vendet më pak të fuqishme në arenën ndërkombëtare.

Nëse do të krijonim një teori të re, e kombinuar nga këta dy elemente, njohja dhe deklarimi, dhe do të shtonim elementin e “superfuqisë”, do të arrinim në konkludim se, deklarimi i një shteti të ri po që se shoqërohet nga njohja, dhe atë, të merr njohje ndërkombëtare nga disa superfuqi globale, mundësitë e konsolidimit të shtetit të ri në rendin ndërkombëtar janë shumë më të mëdha. Nëse njohja e Kurdistanit të Irakut, do të vinte nga SHBA-të, përveç nga Izraeli, gjasat janë se njohjet e reja nga shtetet e ndikuara nga SHBA-të, do të ishin të pritshme.

3.3. Llojet e njohjes

Njohjet janë klasifikuar në forma e tipologji nga më të ndryshmet. Njohja mund të shprehet në forma nga më të llojllojshmet. Llojet e njohjes varen nga shumë kriterë: karakteri i deklarimit, kushti i pranimit, numri i subjekteve që e njohin ekzistencën e një shteti të ri, koha e pranimit para, gjatë dhe pas lindjes së shtetit të ri si subjekt i ri në marrëdhëniet ndërkombëtare etj.

E drejta ndërkombëtare njeh disa lloje kryesore të njohjes: Njohja *de jure* dhe *de facto*, njohja shprehimisht ose heshtazi, njohja individuale ose kolektive, njohja me kushte, “paranjohjet”, njohjet e ndikuara dhe të tjera.

3.3.1. Njohjet de jure dhe de facto

Njohja *de jure* i jep vulë finale njohjes së shtetit të ri, prandaj edhe pendimi, kthimi dhe revidimi i vendimit bëhet i pamundur. Shtetet, sikurse individët në jetën e përditshme, kur për diçka kanë mëdyshje, konflikte interesash, kalkulime të ndryshme, e japin më me vështirësi këtë lloj të njohjes.

Njohja *de jure* është njohje e përhershme dhe e plotë dhe i përfshin të gjitha marrëdhëniet me shtetin e ri. Ajo ka vlerë retroaktive, sepse vlen nga momenti kur shteti me të vërtetë është krijuar dhe nuk mund të revokohet (të tërhiqet) edhe nëse shteti i pranuar nuk e ka plotësuar detyrimin e marrë me rastin e njohjes. (Gruda, 2013, p. 81)

Secila njohje juridike, është njohje zyrtare apo formale, e shoqëruar me dokumente, faksimile, letra, vula e nënshkrime, të cilat hynë në domenin e formalizmit institucional.

Njohja *de facto* është njohje me mëdyshje, me frikë, me shqetësim, me brengë, me tension, me kufizime, me pasiguri, me vështirësi dhe me vendim të lëkundur, i cili në të ardhmen, varësisht nga krijimi i qartësisë së plotë, ndryshon.

Njohja *de facto* është një njohje jo e plotë, e përkohshme. Shteti, që bën njohjen *de facto*, tregon në këtë mënyrë dëshirën për të hyrë në disa marrëdhënie të kufizuara me shtetin e ri, marrëdhënie jo të plota dhe të paqëndrueshme, duke menduar se shteti i ri nuk është akoma i konsoliduar mirë. (Puto, 2010, p. 177)

Njohja *de facto* prej njohjes *de jure*, dallon edhe nga kohëzgjatja. Njohja e parë nuk është njohje jetëgjatë, nuk është e përhershme apo absolute, ndërsa njohja e dytë, s'le hapësirë për ndryshim e revidim vendimi. Gjersa njohja *de facto* i dedikohet aftësisë së subjektit ndërkombëtar të perceptojë, nuhasë, prekë dhe kuptojë ekzistencën e ndryshimit të ri, duke u mjaftuar vetëm me kaq. Kjo njohje është e përkohshme, është e kufizuar në disa marrëdhënie dhe mund të tërhiqet në çdo moment nëse nuk janë plotësuar shpresat për qëndrueshmërinë e situatës së re.

Njohja *de facto* përfshin një vlerësim hezitues të situatës, një qëndrim të pritjes dhe të shikimit, që do të pasohet nga njohja *de jure* kur dyshimet janë tejkaluar mjaftueshëm për të zgjeruar pranimin formal. (Shaw, 2008, p. 460)

Gjatë viteve 1988-1991, shumica e shteteve i njohën *de facto* dy qeveritë rivale në Liban deri në mbarimin e kryengritjes të udhëhequr nga gjenerali Aoun, dhe më pas qeverisë së Salim Al Husit iu akordua njohja *de jure*. (Abdulahim, n.d.)

Por në të drejtën ndërkombëtare bashkëkohore, pavarësisht se ekzistojnë këto dallime në mes të njohjes formale dhe joformale, njohjes reale dhe juridike, synohet të shkrihen dallueshmëritë e këtij dualiteti.

Në kuadër të kësaj, qeveria britanike ndaloi përdorimin e termit *de facto* në fund të viteve 1940 (edhe pse studiuesit britanezë ende debatojnë çështjen). Rivendosja aktuale thekson, për shkak të konfuzionit (dhe pasojave të mundshme politike), Shtetet e Bashkuara aktualisht nuk i përdorin këto terma. Kur Shtetet e Bashkuara e njohin një shtet apo qeveri, me sa duket tani nënkupton statusin *de jure*. (Glahn & Taulbee, 2017, p. 155)

Veprime të tilla janë ndërmarrë edhe si rezultat i keqpërdorimit të së drejtës nga ana e shteteve njohëse, por edhe si komplikim i situatave në raste të caktuara në të drejtën ndërkombëtare.

Konfuzioni me këto dy lloje njohjesh, nuk presupozon se nuk ndodhin njohje të reja. Sa herë ka pasur krijim shtetesh të reja, kanë ndodhur edhe njohje të reja. Rasti më i fundit, që është me më së paku njohje të reja, ndonëse është realitet i ri faktik e juridik, është paraqitja e Kurdistanit të Irakut, apo zyrtarisht Qeveria Rajonale e Kurdistanit irakian. Atë e ka njohur vetëm Izraeli, por jo edhe shtetet e tjera, madje as miku i ngushtë i Izraelit, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA). Pavarësisht kundërshtimeve, Kurdistan i irakian, faktikisht ka njëfarë autonomie dhe drejtimi të pavarur të territorit që kontrollon.

Përkundër kundërshtimeve, më shumë se 90% e rreth tre milionë kurdëve që votuan, zgjodhën pavarësinë; si përgjigje, një numër vendesh vendosën sanksione ekonomike dhe kërcënuan ndërhyrjen ushtarake. Edhe një nga aleatët më të ngushtë të kurdëve, Shtetet e Bashkuara, tha se rezultatit i mungonte "legjitimiteti" dhe vazhduan të shprehnin mbështetjen për një Irak të bashkuar. (Lee, 2017)

Njohja e Kurdistanit irakian është njohje e gjendjes faktike, pas luftërave të gjata në mes të sekteve, grupeve të ndryshme të armatosura dhe ndërhyrjen e superfuqive rajonale e globale në Irak. Tek e fundit, njohja është edhe deklaram i njëanshëm dhe ajo mund të jetë qoftë për një

Qeveri Autonome si e Kurdistanit të Irakut, për një grup të ri të armatosur apo rebelësh që kontrollon efektivisht një territor etj.

Njohja është deklarim i njëanshëm se një gjendje faktike ose ndonjë kërkesë konsiderohet juridikisht e vlefshme (Andrassy). Njohja është mjaft e shpeshtë në marrëdhënie ndërkombëtare (njohja e shteteve të reja, e qeverive, e kryengritësve si palë ndërluftuese etj.) (Gruda, 2013, p. 285). Kur njohjet nuk vijnë nga shtetet e tjera, natyrisht se gjasat janë edhe për relacione më të relaksuara me Autoritetin Qendror, sikurse ndodh aktualisht edhe me Rajonin Federal të Kurdistanit të Republikës së Irakut.

Qeveria Rajonale e Kurdistanit është autoriteti qeverisës i Rajonit Federal të Kurdistanit të Republikës së Irakut, siç përcaktohet nga Seksioni Pesë i Kushtetutës së Irakut. Që nga rënia e regjimit të mëparshëm, KRG ka promovuar me forcë një Irak të demokracisë, pluralizmit dhe federalizmit, në paqe me veten dhe me fqinjët e saj, duke bërë çdo përpjekje për të mbështetur një shtet të qëndrueshëm dhe paqësor irakian që respekton të drejtat dhe dëshirat e qytetarëve të saj. Kushtetuta e Irakut përcakton qartë të drejtat e guvernatorëve dhe të rajoneve federale dhe KRG mbetet e palëkundur në respektimin e Kushtetutës si autoriteti më i lartë në vend. KRG vazhdon përpjekjet e saj me besim të mirë për të zgjidhur një numër çështjesh të pazgjidhura me qeverinë federale. (Kurdistan Regional Government, n.d.)

Deklarimi se, “me besim të mirë për të zgjidhur një numër çështjesh të pazgjidhura me qeverinë federale”, shpreh qartë edhe relaksim në mes të Qeverisë Rajonale të Kurdistanit dhe Qeverisë së Irakut në Bagdad. Po që se do të kishte njohje të reja nga superfuqitë globale si SHBA, Kina, Rusia etj., gjendja faktike po ashtu do të ndryshonte, por do të ndryshonte edhe raporti në mes të Qeverisë Rajonale të Kurdistanit me Qeverinë Federale në Bagdad. Njohjet po ashtu e ndryshojnë vetë gjendjen faktike, duke i dhënë edhe më shumë “fakticitet” realitetit politik të mëvetësisë së një rajoni, shteti, pale etj.

Njohja është pranim i futjes së shtetit të ri në sistemin ndërkombëtar, me të drejtat dhe detyrimet ndërkombëtare, por edhe futjes në marrëdhënie diplomatike ndërkombëtare, duke e njohur me emër, me pasaporta, me nota diplomatike etj.

Bashkimi Evropian (BE) nuk e njeh Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës dhe shtetet e BE-së veç e veç vendosin për ta njohur shtetin e ri të shpallur më 17 shkurt 2008 (pesë vende

evropiane nuk e njohin ende Kosovën), por Parlamenti Evropian ka marrëdhënie të rregullta me Kosovën. Po ashtu, vetë Bashkimi Evropian në vitin 2015, ka nënshkruar me Kosovën, Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim dhe shumë marrëveshje e kontakte të tjera të nivelit diplomatik. Përfaqësuesja më e lartë e Bashkimit Evropian, Federika Mogerini, ka takime të shpeshta dhe është lehtësuese e dialogut Kosovë-Serbi, duke realizuar dhjetra takime në mes të përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë, për të arritur një Marrëveshje të quajtur Gjithëpërfshirëse, për paqen dhe stabilitetin në rajon. Edhe këto marrëdhënie dhe marrëveshje në mes të BE-së dhe Kosovës, mund të konsiderohen faktikisht njohje, por jo edhe juridikisht.

Asambleja e Kombeve të Bashkuara në nëntor të vitit 2012 votoi me shumicë votash për avancimin e statusit të Palestinës në shtet jo anëtar vëzhgues të OKB-së. Nga shumë palë kjo është konsideruar si njohje *de facto* e Palestinës. Kosovën deri tani *de jure* e kanë njohur 116 shtete, ndërkaq Palestina ka 137 njohje të tilla nga shtetet.

3.3.2. Njohjet shprehimisht dhe heshtazi

Në komunikimet ndërnjerëzore dhe ndërshtetërore, ekziston gjuha verbale dhe joverbale. Njohja përmes heshtjes, është njohje më e zbehtë, por sërish quhet njohje. Sikur në praktikën e komunikimit ndërpersonal, ndërnjerëzor dhe ndërshtetëror, heshtja edhe në praktikën juridike e kushtetuese, njihet si formë e komunikimit, që në shumicën e rasteve, njihet si miratim, pranim, pajtim dhe pohim.

Njohja shprehimisht – E para jepet me një akt të njëanshëm: me letër, me telegram, me deklaratë të shefit të shtetit, me notë diplomatike që i dërgohet shtetit me të cilën njoftohet se pranohet ose me një traktat ndërkombëtar. Kështu, njohja e Republikës Popullore të Kinës *de jure* është bërë më 1 janar 1979 me marrëveshje, me të cilën SHBA dhe RP e Kinës janë pajtuar “të njohin njëra-tjetrën dhe të vendosin marrëdhënie diplomatike.” (Gruda, 2009, pp. 54-55)

Njohja shprehimisht është njohje e manifestuar, e theksuar dhe e pohuar përmes një akti formal, por ajo mund të jetë edhe heshtazi, pavarësisht se hyhet në disa marrëdhënie të tjera. Greqia nuk e njeh Kosovën, as Kina, as Irani etj., por e njohin pasaportën e Kosovës për të hyrë qytetarët e saj në këto shtete. Hyrja përmes pasaportës, pavarësisht se këto shtete nuk e njohin

Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, faktikisht vlerësohet njohje heshtazi, sepse shteti njeh faktin e ri në terren, dokumentin e lëshuar dhe që shihet se është lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës; shihet nga zyrtarët apo policia kufitare kineze, se është dokument i lëshuar nga një shtet i ri, pavarësisht se shteti kinez nuk e njeh Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës dhe e konsideron Kosovën si pjesë të Republikës së Serbisë.

Njohja heshtazi jepet me akt që nuk i përket grupit të parë, por edhe nuk lë dyshim mbi qëllimin që të bëhet njohja, ose që po bëhet pranimi. Kështu, konsiderohet se njohja është dhënë: (1) nëse një shtet lidh marrëveshje me shtetin e ri; (2) nëse pranon dhe dërgon përfaqësues diplomatikë dhe (3) nëse shtetet e treta pranojnë konsujt e shtetit të ri. Pjesëmarrja e delegacionit zyrtar të një shteti në solemnitete me rastin e fitimit të pavarësisë interpretohet si njohje heshtazi. (Gruda, 2013, p. 83)

Pra, njohja mund të manifestohet në dy forma kryesore: ekspresive dhe jo ekspresive. E para është e thënë, ndërsa e dyta njohje e lexuar, e nënkuptuar, por e pashprehur, e pathënë. Propozimi për të vendosur marrëdhënie të rregullta diplomatike me shtetin e ri është padyshim dëshirë për ta njohur atë. Po ashtu, nënshkrimi i një traktati dypalësh midis shtetit që njeh dhe shtetit që njihet, barazohen me aktin e njohjes; pra, është edhe ky një rast i njohjes së tërthortë (Puto, 2010, p. 174). Njohja e shprehur është njohje që përfundimisht largon të gjitha “kuptimet në ambiguitet”, duke mos lejuar më tutje në marrëdhëniet ndërkombëtare, interpretime të reja të realitetit faktik, ndërsa ajo e pashprehur, lejon interpretime të tilla që nocionet të përfshihen në kuptime të dyfishta.

Në disa raste, veprimet e caktuara të shteteve nënkuptojnë njohjen e një shteti tjetër. Megjithatë, për shkak se kjo strukturë e njohjes së tërthortë ose të nënkuptuar është në dispozicion, Shtetet mund të bëjnë një deklaratë të shprehur në atë mënyrë që një veprim i veçantë që përfshin një shtet tjetër në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si përfundim i ndonjë njohjeje. Ky qëndrim u mbajt nga vendet arabe në lidhje me Izraelin, dhe në disa raste të tjera. (Shaw, 2008, p. 462)

Është shprehur mendimi se pjesëmarrja në një traktat shumëpalësh sjell me vete edhe njohjen e tërthortë të shtetit të ri nga shtetet palë të traktatit. Mirëpo, shtete si Britania e Madhe dhe SHBA kanë bërë të ditur në disa raste se, kur nënshkruajnë një traktat shumëpalësh, firma e

tyre nuk ka vlerën e njohjes së ndonjë shteti pjesëtar të traktatit, të cilin ato nuk e kanë njohur më parë (Puto, 2010, p. 174). Kjo ka ndodhur edhe me shtetet arabe në raport me Izraelin.

Në përgjithësi pjesëmarrja në një konferencë shumëpalëshe së bashku me një shtet të panjohur (ose me qeverinë e panjohur të një shteti tanimë ekzistues) nuk do të thotë akt njohjeje të tërthortë, megjithëse është patjetër dëshmi e faktit që entiteti në fjalë ka fituar në një farë mase subjektivitet juridik ndërkombëtar. (Dixon, 2011, p. 186)

Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova filloi edhe përfshirjen dhe anëtarësimin e saj në organizata rajonale dhe ndërkombëtare, anëtare e të cilave ishte edhe Serbia. Anëtarësimi i Kosovës në qershor të vitit 2014 Kosova në SEECP - Procesi i Bashkëpunimit i Evropës Juglindore (KCSS, 2014, pp. 19-20) nuk ka nënkuptuar edhe njohje të heshtur të pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Përkundrazi, Serbia vazhdimisht ka kundërshtuar praninë e Kosovës në nisma dhe organizatat e tilla rajonale. Gjithashtu, në Prishtinë aktualisht janë të hapura zyrat diplomatike të Federatës Ruse, të Republikës Popullore të Kinës, Sllovakisë, Rumanisë dhe Greqisë (MFA, n.d.), por kjo nënkupton se ata kanë njohur heshtazi Republikën e Kosovës.

Edhe pse Izraeli dhe shumë vende arabe janë anëtarë të OKB-së, kjo nuk ndikoi në mosnjohjen arabe të shtetit izraelit (Shaw, 2008, p. 464). Gjithashtu ndryshimi i statusit të Palestinës nga entitet vëzhgues, në shtet jo-anëtar vëzhgues nga OKB-ja nuk nënkupton se Izraeli si anëtar i organizatës heshtazi njeh pavarësinë e Palestinës. Krahasime të tilla vlejné edhe për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, apo kur palët janë të barabarta në nënshkrim të traktateve multilaterale.

3.3.3. Njohjet individuale dhe kolektive

Në botë nuk ekzistojnë vetëm shtetet si subjekte ndërkombëtare, por edhe organizata dhe organizma shtetesh, të cilat kanë një tip të vendimmarrjes më komplekse, me shumë qendra të vendosjes dhe me sovranitete të fuqizuara individuale, ndonëse janë brenda një ombrelle.

Njohja e shteteve të reja mund të bëhet individualisht ose kolektivisht. Në shumicën dërmuese të rasteve, çdo shtet njeh një shtet të lindur rishtazi me një akt të veçantë individual. Duke iu drejtuar qeverisë së shtetit të ri, shteti që akordon njohjen njofton se merr shënim për

lindjen e shtetit të ri, e njeh atë si partner në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe shpreh dëshirën dhe vendimin për të mbajtur me të marrëdhënie të rregullta e të plota. (Puto, 2010, p. 172)

Njohjet mund të jenë edhe nga shtetet veç e veç, por duke u përfshirë në vendimin për njohje të njëkohshme dhe nga një ngjarje e përbashkët historike apo aktuale. Njohja kolektive bëhet në konferenca, kongrese ose në organizata ndërkombëtare, me rezolutë me të cilën organizata ndërkombëtare vendos për krijimin e shtetit të ri, ose me procedurën e pranimit. Kështu janë njohur Rumania, Serbia dhe Mali i Zi në Kongresin e Berlinit; Shqipëria është njohur në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913 etj. (Gruda, 2013, p. 83)

Njohja e dikurshme e Shqipërisë dhe shteteve të tjera ballkanike, merret shpesh si një shembull që ka dalë nga njohjet kolektive në mënyrë të njëkohshme dhe nga një vendngjarje me impakt ndërkombëtar dhe ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare. Njohja e Shqipërisë ishte parashtruar edhe pas Luftës së Parë Botërore. Atëherë, me gjithë qëndrimin negativ të disa shteteve Shqipëria ishte pranuar në Lidhjen e Kombeve (17 dhjetor 1920). (Gruda, 2013, p. 83)

Por në përgjithësi, njohjet ndërkombëtare sot, për dallim para mbi 100 vjetësh, me konferencat e famshme të Fuqive të Mëdha, gjithnjë e më pak po merren kolektivisht, duke ia lënë shteteve, në duart e tyre se, kë dhe kur do ta njohin një subjekt të ri ndërkombëtar, përkatësisht një shtet të ri të sapokrijuar, apo të krijuar disa vjet më parë.

Kështu më 1976 State Department i SHBA-ve shprehej se e drejta ndërkombëtare nuk kërkon nga shtetet që të njohin entitetin tjetër si shtet. Është çështje e vlerësimit të secilit shtet se a e meriton një entitet të njihet si shtet. Në marrjen e vendimit lidhur me këtë, SHBA tradicionalisht shikojnë a ekzistojnë: 1) kontrolli efektiv mbi territorin e definuar qartë dhe popullsinë; 2) administrata e organizuar qeveritare; 3) aftësia për të vepruar efektivisht në drejtimin e marrëdhënieve të jashtme; dhe 4) dëshira për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare. (Gruda, 2013, p. 79)

Në vitin 1991 BE-ja dhe shtetet anëtare të saj miratuan pesë kriteret e mëposhtme për shtetet që kërkojnë njohje: 1. respektimi i dispozitave të Kartës së KB-së dhe dokumentet tjera të Evropës (Konferenca mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë); 2. garancitë për pakicat etnike dhe kombëtare; 3. respektimi i paprekshmërisë së të gjithë kufijve, të cilët mund të ndryshohen vetëm me mjete paqësore dhe me marrëveshje të përbashkët; 4. pranimi i

angazhimeve ndërkombëtare lidhur me çarmatimin dhe mospërhapjen e armëve bërthamore; dhe 5. arbitrazhi ose si zgjidhje e të gjitha mosmarrëveshjeve në lidhje me vazhdimësinë dhe kontestet rajonale. (Slomanson, 2007, p. 85)

Organizatat si Kombet e Bashkuara japin disa mundësi të njohjes kolektive të shteteve. Është argumentuar se pranimi në Ligë dhe Kombet e Bashkuara ka sjellë njohje sipas zbatimit të ligjit nga të gjithë anëtarët e tjerë, pavarësisht nëse kanë votuar kundër pranimi. Pranimi i anëtarësisë është dëshmi *prima facie* e shtetësisë dhe anëtarët që nuk njohin, rrezikojnë objektin e mosnjohjes së tyre nëse i injorojnë të drejtat themelore të ekzistencës së një shteti tjetër. Organet e Kombeve të Bashkuara kanë vepruar vazhdimisht në supozimin se Izraeli është i mbrojtur nga parimet e Kartës për përdorimin e forcës përballë fqinjëve arabë. (Brownlie, 1999, p. 95)

Kjo nënkupton se dy ose më shumë subjekte anëtare të një organizate mund të mos e njohin njëra-tjetrën, edhe pse karta e OKB-së i trajton njëtrajtshëm ato. Një shtet mund të njohë heshtazi ekzistencën e shtetit që anëtarësohet në organizatë edhe në qoftë se nuk e njeh individualisht pavarësinë e tij. Shtetet nuk qenë mjaftueshëm të gatshme që autoritetin e njohjes ta delegojnë plotësisht në organizatat ndërkombëtare. Prandaj, sot më shumë është e aplikueshme njohja individuale e shteteve.

Përveç pranimi të anëtarësimit, Lidhja dhe Kombet e Bashkuara ofrojnë mjete të tjera për të testuar ekzistencën e një shteti. Sipas nenit 17 të Konventës, si dhe nenit 2 (6), 32, 35 (2) dhe 93 (2) të Kartës, organizata ndërkombëtare pretendon të ushtrojë juridiksion mbi shtetet që nuk janë anëtare. Kjo nënkupton se një shtet mund të ekzistojë si i tillë edhe nëse nuk është anëtarë i OKB-së. Ai mund të ketë njohje ndërkombëtare nga shtete anëtare dhe jo anëtare të organizatave ndërkombëtare dhe të jetë një aktorë i përgjegjshëm ndërkombëtar. (Chen, 1951, pp. 222-223)

Kriteret e përcaktuara nga BE-ja për njohjen e shteteve, nuk janë arritur të përdoren në rastin e Kosovës. Arsyeja kryesore ka qenë mungesa e konsensusit të brendshëm për të realizuar njohjen. Për arsye të ndryshme, pesë shtete anëtare të BE-së nuk kanë pranuar të njohin pavarësinë e Kosovës dhe detyruan shtetet tjera të organizatës, të njohin individualisht

pavarësinë e Kosovës. Pavarësia dhe ekzistenca e shtetit të Kosovës dhe e Palestinës nuk është e varur nga njohja kolektive, edhe pse një gjë e tillë do t'i fuqizonte ato.

Njohja ndërkombëtare e shteteve nga shtetet si individë dhe organizatat është çështje e politikave dhe orientimeve gjeostrategjike ndërkombëtare. Arsytet e njohjes ose mosnjohjes kolektive mund të jenë të veçanta për shtete të ndryshme. Në vitin 2012 kur u bë ndryshimi i statusit të Palestinës nga një entitet vëzhgues në një shtet vëzhgues në OKB, nga 193 shtetet anëtare të Asamblesë, 138 votuan në favor të rezolutës, nëntë votuan kundër, dyzet e një abstenuan dhe pesë nuk regjistruan asnjë votim (për shkak të mungesës ose arsye tjera). Kjo nënkuptoi *de facto* se kolektivisht Palestina u njoh si shtet. Mirëpo, pas votimit pati edhe disa reagime si ai i delegacionit të Zelandës së Re, ku theksohet se "*çështja e njohjes së një shteti palestinez ishte një çështje e veçantë.*" (Cerone, 2012)

Trajtimi i statusit të Palestinës si shtet jo-anëtar vëzhgues, nënkupton njohje të shtetësisë së saj. Megjithatë, rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nuk janë detyruese dhe si të tilla nuk obligojnë shtetet tjera që të njohin Palestinën.

3.3.4. Njohja me kushte dhe pa kushte

Njohja e një shteti mund të kushtëzohet dhe të mos kushtëzohet. Vënia e kushteve, do të thotë se njohja është e lidhur me plotësimin e tyre. Nëse kushtet realizohen, gjasat për realizimin e njohjes, janë të mëdha. Njohja me kushte është njohje e afatizuar varësisht nga kohëzgjatja e plotësimit të kushteve nga pala e kushtëzuar, apo edhe heqja dorë nga pala kushtëzuese. Zakonisht më parë pritët të ndodhë plotësimi i kushteve, sesa heqja dorë nga kushti. Kjo ndodh për shkak se shteti që kushtëzon, është palë më me shumë fuqi negociuese se pala e kushtëzuar.

Njohjet bëhen me kusht, sidomos nga ideja e shenjtërimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve, pasi që prishja e një shteti të përbashkët dhe krijimi i një shteti të ri, shkaktonte edhe luftëra të mëdha, gjegjësisht pasoja të paparashikuara në viktima njerëzish, dëme materiale, kaos në rendin ndërkombëtar etj. Për më tepër, sistemi ndërkombëtar i pas-Luftës së Dytë Botërore kishte theksuar shenjtërinë e kufijve ndërkombëtarë dhe u mundua të zbatonte një normë antipushtim. (Fukuyama, 2010, p. 66)

Për njohjet me kusht dhe pa kusht, ka opinione të ndryshme në teoritë ndërkombëtare të njohjeve. Parashtrimi i kushteve me rastin e njohjes së shteteve të reja është çështje rreth së cilës nuk ekziston unitet i mendimeve.

Shumica e autorëve, sidomos përkrahësit e teorisë deklarative, konsiderojnë se parashtrimi i kushteve me rastin e njohjes është gjë e palejueshme. Këtë qëndrim e përmban edhe Projekti Panamez dhe Jugosllav i Deklaratës mbi të Drejtat dhe Detyrat e Shteteve. (Gruda, 2013, pp. 84-85)

Njohja e kushtëzuar, i referohet praktikës së pranimit të njohjes së shtetit me përmbushjen e kushteve të caktuara, për shembull, trajtimin e mirë të pakicave fetare, siç ka ndodhur në rastin e pavarësimit të disa vendeve të Ballkanit në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë. (Shaw, 2008, p. 465)

Njohjet e kushtëzuara më shumë janë të njohura për kontekstin e rendit ndërkombëtar para Luftës së Parë Botërore. Kjo formë e njohjes u aplikua në Kongresin e Berlinit në vitin 1878, ku Fuqitë e Mëdha njohën Bullgarinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Rumaninë (Lauterpacht, 1947, p. 36).

Shtetet e njohura, në këtë mënyrë, marrin përsipër të kryejnë obligime të caktuara e të pranuar në momentin e njohjes. Këto detyrime mund të përfshijnë mbajtjen e një neutraliteti të vazhdueshëm, abstenimin nga tregtia e skllëvërve, miratimin e formave të caktuara të qeverisjes, pajtimin për trajtim të kombit më të favorizuar, ruajtjen e privilegjeve të kapitullimit, mbajtjen e regjimit të tregtisë së lirë, respektimin e pronës private, garancinë për trajtimin specifik të pakicave, dhe ndërmarrjeve të tjera me karakter politik ose komercial. (Chen, 1951, pp. 265-266)

Kosova si vend, e më pas edhe si shtet, ka qenë dhe është një e kushtëzimeve specifike në pothuajse çdo proces ndërkombëtar. Duke filluar nga pavarësia e mbikëqyrur, njohjet e kushtëzuara, kriteret e veçanta për anëtarësim në organizata, kriteret speciale për liberalizim të vizave dhe procese të tjera. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, rëndësi të madhe kishte ardhja e njohjeve dhe jo natyra e tyre. Kështu, Italia njeh pavarësinë e Kosovës "brenda një kuadri të mbikëqyrjes ndërkombëtare"; Për më tepër, Gjermania, Hungaria dhe Suedia pohojnë se "prania e vazhdueshme ndërkombëtare" ka qenë një lloj kushti për njohjen dhe në mënyrë

specifike përmendin themelimin dhe mbështetjen e misionit EURLEX të udhëhequr nga BE-ja për një kohë të pacaktuar. (Almqvist, 2009, p. 9)

Kushte të kësaj dhe natyrave të tjera, Kosova ka pranuar vazhdimisht. Edhe pse jo të mirëseardhura çdo herë, nga shteti i Kosovës ato janë vlerësuar si “rekomandime” të aleatëve ndërkombëtar, dhe gatishmëria për respektim e përmbushje të tyre ka qenë e lartë. Ka pasur edhe raste të veçanta, kur elitat politike në Prishtinë, por edhe opinioni i gjerë publik, janë zemëruar dhe kanë kundërshtuar kushtëzimet e caktuara për procesin e liberalizimit të vizave, e veçmas vlenë të përmendim kushtëzimin për liberalizimin e vizave, me kriterin shtesë të votimit të demarkacionit të kufirit Kosovë-Mali i Zi, dhe ndonëse është përmbushur ky kriter, sërish janë paraqitur pengesa për lëvizje pa viza në Zonën Schengen.

Gjithashtu duhet të theksojmë që Kosova shërben edhe si kusht për progresin e Serbisë për anëtarësim në BE. Normalizimi i marrëdhënieve me Kosovën është një kusht që Serbia të bashkohet me BE, por Brukseli nuk kërkon në mënyrë eksplicite njohjen; qëndrimi i qeverisë së Beogradit është se dy çështjet duhet të mbahen të ndara... megjithatë, duke pasur parasysh se Kosova, gjithashtu shpreson të bashkohet me BE, është e vështirë të imagjinohet se të dy vendet mund të bashkëjetojnë si Shtete Anëtare pa njohje reciproke (Russell, 2019, p. 7). Nga BE-ja Kosova është subjekt i kushtëzuar, por shërben edhe si subjekt i kushtëzimeve, kjo me qëllim të arritjes së paqes dhe stabilitetit në rajon.

Njohjet me kushte e kanë përcjellë edhe Palestinën. Në këtë kontekst, që nga viti 2003, Izraeli ka rënë dakord zyrtarisht dhe ka deklaruar angazhimin e tij për krijimin e një shteti palestinez në kontekstin e zgjidhjes së përhershme dhe përfundimtare të konfliktit izraelito-palestinez. (Hotung, 2011, p. 9)

Kjo gatishmëri e shtetit izraelit natyrshëm është shoqëruar me disa kushte për autoritetet palestineze. Gjatë një ligjrate në Universitetin Bar-Ilan, Kryeministri Izraelit Netanyahu, kishte paraqitur dy kushtet e Izraelit për ekzistencën dhe njohjen e shtetit palestinez: Kushti i parë sipas tij ishte njohja. Palestinezët duhet ta kuptojnë qartë dhe pa dyshim Izraelin si shtet të popullit hebre. Parimi i dytë është demilitarizimi. Territori nën kontrollin palestinez duhet të demilitarizohet me dispozita të sigurisë së hekurt për Izraelin. Pa këto dy kushte, ekziston një

rrezik real që një shtet palestinez i armatosur do të dalë e do të bëhej një bazë tjetër terroriste kundër shtetit hebre, si ai në Gaza. (Israel MFA, 2009)

Kushti i parë nënkupton njohjen e Izraelit si shtet hebre nga palestinezët, gjë që nuk ka një definim të qartë se çfarë nënkupton kjo për palestinezët, apo në çfarë territore mund të ndodhë një gjë e tillë; dhe ofrimi i sigurisë së plotë për shtetin izraelit përmes demilitarizimit të territoreve palestineze si kushti i dytë. Kushti i dytë është i lidhur me atë të parin, dhe pa një përkufizim të qartë të koncepteve njohje dhe demilitarizimin, vështirë se mund të ketë gatishmëri të palëve për arritjen e një marrëveshje që plotëson synimet e izraelitëve dhe palestinezëve. Vendosja e kushteve për njohje varet edhe nga qëllimet politike të shteteve. Ndonjëherë, shtetet me vetëdije vendosin kushte, plotësimi i të cilave është i pamundur në atë moment. Në këtë rast, Palestina dhe Izraeli nuk kanë arritur dakordimin e tyre për plotësimin e këtyre kushteve për njohje të ndërsjellë dhe situata politike në ato territore edhe sot është e paqëndrueshme.

Gjithashtu në rastin e Palestinës kemi edhe shembullin e gatishmërisë së parlamentit italian, i cili paraqet dy kushte për njohjen e Palestinës. Parlamenti italian mbështet njohjen e shtetit të Palestinës, por kjo njohje kushtëzohet me arritjen e një marrëveshjeje midis Fatahut dhe Hamasit, dhe midis izraelitëve dhe palestinezëve. (Stavridis, Gianniou, & Cofelice, 2016, p. 51)

Kushti për arritjen e një marrëveshjeje në mes të palestinezëve ndihmon kauzën e tyre për shtet, ndërkaq marrëveshja në mes të palestinezëve dhe izraelitëve është kusht që Italia të arsyetojë mosgatishmërinë e saj për njohjen e Palestinës. Kjo për faktin se gjasat për arritjen e një marrëveshjeje në mes të palestinezëve dhe izraelitëve janë të ditura se tani për tani janë minimale.

Në rastin e njohjeve me kushte, mund të ndodhë, që në një moment të caktuar, shtetet për arsye nga më të ndryshmet mund të mos vazhdojnë plotësimin e kushteve të marra. Prandaj, dështimi për të përmbushur detyrimet e marra nuk e ndikon njohjen, e cila është një veprim i kryer përtej zhvlerësimit. (Chen, 1951, p. 266)

Shtetet njohëse në momentin e mosplotësimit të kushteve nga shtetet e njohura, nuk mund të tërheqin njohjet. Ato mund të shfrytëzojnë mënyrën e shprehjes së protestës ose mund të ndërpresin përkohësisht, ose tërësisht raportet diplomatike.

3.4. Motivet e njohjes dhe mosnjohjes

Pse një shtet nuk e njeh një shtet tjetër? Çfarë e motivon ta njoh ose mosnjoh? Ka shumë interesa, çështje, barriera, sfida e vështirësi kur një shtet njeh një shtet tjetër. Një raport kushtëzimi të njohjes apo mosnjohjes së shtetit të ri, është edhe raporti i shtetit të cilit i kërkohet njohja me shtetin prej të cilit shkëputet, ndahet apo dekolonizohet shteti i ri.

Motivet e mosnjohjes dhe njohjes janë shumë komplekse. Le të ndalemi tek Izraeli, kur para disa vjetësh gjatë negociatave në mes të SHBA-ve, Izraelit dhe Palestinës, ish-Sekretarja e shtetit, Madeleine Albright, rrëfen trajtesat e negociatave. Në diskutimet në mes palëve, Kryeministri Netanyahu nguli këmbë se terrori ishte i vetmi problem. Izraelitët e dinë se duke mos pasur paqe, mund t'ju duhet të luftojnë. Por ata mendojnë se duhet të luftojnë gjithsesi, dhe më mirë të luftojnë me një autoritet të dobët palestinez sesa me një shtet palestinez më të fortë dhe të njohur ndërkombëtarisht.” (Albright, 2004, p. 347)

Motivi kryesor i qëndrimit të shtetit të Izraelit karshi Palestinës është pasiguria për paqe të qëndrueshme në ato teritore.

E njëjta gjë ndodh edhe në rastin e Serbisë, e cila në raport me Kosovën shfrytëzon një retorikë kundërshtuese. Kjo për faktin se ajo ka pretendime territoriale ndaj Kosovës. Madje, Serbia me kushtetutë akoma e konsideron Kosovën si provincë të saj. (Serbia National Assembly, 2006)

Nëse krahasojmë qasjen zyrtare të Izraelit në raport me Palestinën dhe atë të Serbisë në raport me Kosovën, mund të vërejmë se qasja e Izraelit tingëllon më demokratike në raport me Palestinën, sesa ajo e Serbisë në raport me Kosovën. Është fuqia politike dhe ushtarake që bënë dallimin në të dyja rastet. Sikur fuqia e Serbisë të ishte e përafërt me atë të Izraelit dhe nëse krahasojmë atë me nivelin e nacionalizimit serb, padyshim se rajoni do të ishte në një situatë tjetër. Fakti që Kosova ka orientim gjeostrategjik euroatlantik dhe ka mbështetjen e SHBA-ve, nënkupton se pretendimet e hapura të Serbisë në raport me Kosovën paraqesin një stagnim në vizionin politik të Serbisë. Pra, ambiciet apo pretendimet territoriale, akoma edhe sot, mbeten njëri nga motivet kryesore të shteteve për të mos njohur dhe për të kundërshtuar pavarësinë e shteteve si Kosova. Në këtë kontekst, dallimi në rastin e njohjes së Palestinës nga Izraeli dhe të Kosovës nga Serbia janë të ndryshme dhe të qarta. Izraeli në këmbim të njohjes kërkon siguri dhe

paqe me palestinezët, ndërkaq Serbia në këmbim të paqes me shqiptarët kërkon pjesë të territorit të Kosovës.

Njohja përcaktohet edhe nga rrethanat globale dhe rendi i sistemit ndërkombëtar. Zhvillimet në politikën globale përcaktohen edhe nga raportet e fuqive dhe vlerësimit të interesave gjeopolitike. Ndonjëherë njohja nuk mund të parashikohet, pasi që i nënshtrohet edhe vlerësimit arbitrar të vetë shtetit. Njohja është çështje diskrecionale e shtetit, por jo edhe çështje e vlerësimit arbitrar, sepse në çdo rast ajo duhet të jepet ose refuzohet në pajtim me parimet legale. Nga kjo ka përjashtime që bëhen për arsye të ndryshme. Kështu p.sh., gjatë Luftës së Parë Botërore, Polonia dhe Çekosllovakia kanë qenë të pranuar nga Franca, Anglia, SHBA-të dhe disa shtete të tjera edhe para se të ekzistojnë si shtete të pavarura. (Gruda, 2013, p. 80)

Shumica e shteteve të botës pranojnë ekzistencën e Palestinës si territor, por kontestohet ose nuk pranohet qenësia e saj si shtet funksional dhe i pavarur. Subjektet kryesore të së drejtës ndërkombëtare presin arritjen e një marrëveshjeje në mes të palëve, për të ndërmarrë veprimet që çojnë në njohje.

Njohja e shtetit të ri varet nga sistemi ideologjik i kohës, kërkesat e superfuqive globale dhe rajonale, përcaktimet dhe orientimet vlerore-politike. Perëndimi liberal, i udhëhequr nga SHBA-të në gjysmën e shekullit XX, e sidomos pas shembjes së Murit të Berlinit - ku Perëndimi kapitalist fitoi betejën ideologjike, vlerore dhe ekonomike me ish-Bashkimin Sovjetik komunist e diktatorial - orientimi kah vlerat demokratike, liritë dhe të drejtat e njeriut, të paktën deklarativisht ishte stërkthënë se ka ndikim kushtëzues në njohjen e një shteti a krijese të re në rendin e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Kështu në vitin 1945, SHBA-të kushtëzuan njohjen e Shqipërisë në tre aspekte: së pari, sigurimin se do të mbaheshin zgjedhje të lira, se të gjitha grupet demokratike dhe kandidatët do të mbroheshin plotësisht dhe që korrespondentët e huaj të mund të hyjnë në Shqipëri për të raportuar lirshëm për zgjedhjet; së dyti, qeveria shqiptare duhej të jepte garancitë se të gjitha traktatet dhe marrëveshjet që ishin në fuqi midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, përpara pushtimit nga Italia të ishin të vlefshme; dhe së treti, vendosja e marrëdhënieve diplomatike nuk duhet të interpretohet si paragjykim për shqyrtimin e pyetjeve të tjera të një karakteri ndërkombëtar që përfshin Shqipërinë. (Binaj, 2004)

SHBA-të, Franca, Britania e Madhe, Gjermania dhe shtete të tjera demokratike perëndimore kushtëzojnë njohjen e Palestinës me arritjen e një marrëveshje me Izraelin, ndërkaq në rastin e Kosovës, Rusia, Kina dhe aleatët e tyre njohjen e Kosovës e kushtëzojnë kryesisht me arritjen e një marrëveshje me Serbinë.

Por njohjet mund të jenë të varura edhe nga shkalla e marrëdhënieve të një shteti të sapokrijuar me superfuqitë në rendin global. Rasti më i veçantë mbetet marrëdhënia e veçantë historike në mes të SHBA-së dhe Izraelit. Por ngjashëm ka ndodhur edhe me Kosovën, ku rol vendimtar edhe në shumë njohje të reja ndërkombëtare, janë varur nga vullneti amerikan. SHBA ishte ndër shtetet e para që njohu Kosovën si shtet, sikurse ndodhi njohja e shpejtë edhe e Izraelit, në të njëjtën ditë të shpalljes.

Njohja si akt i lirë politik është e bazuar në interesat e shteteve që e japin atë. Interesat mund të jenë të lidhura direkt me mundësinë e hegjemonisë që shteti njohës mund të ushtrojë në shtetin që njeh, ose edhe në dobësimin e ndikimit të shtetit që njihet me ndonjë shtet tjetër “rival” të shtetit njohës.

Në rastin e Kosovës njohja nga SHBA-të dhe shtetet tjera perëndimore vlerësohet si dobësim i ndikimit të Rusisë në Ballkanin Perëndimor. Rusia ka një miqësi tradicionalisht të ngushtë me Serbinë dhe është e interesuar të ruajë ndikimin e saj politik dhe ekonomik në Ballkan, dhe si anëtare e OKB-së me fuqinë e vetos dhe me interesin e saj historik në Ballkan, Rusia është një lojtar i rëndësishëm mes atyre vendeve që refuzojnë të njohin pavarësinë e Kosovës. (Konrad Adenauer Stiftung, 2018, p. 18)

Njohjet e një shteti të ri kanë motive e interesa të ndryshme, por ato varen edhe nga rrethanat historike të marrëdhënieve ndërkombëtare. Ka mjaft raste kur njohja është bërë e shpejtuar, ndërsa ka edhe raste kur ajo është bërë me vonesë. Më 1778 Franca njohu Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke e arsyetuar këtë me faktin se Britania e Madhe “kishte humbur efektivisht” kolonitë e saj të vjetra, ndërsa SHBA “kishin fituar pavarësinë”. Britania e Madhe e quajti këtë hap të Francës si të parakohshëm dhe i shpalli luftë asaj. (Puto, 2010, p. 170)

Më poshtë, do të paraqesim tabelën e shteteve që e kanë njohur vetëm Palestinën, pastaj listën e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën dhe më pas, listën e shteteve që e kanë njohur vetëm Kosovën. Sikurse do të vërejmë, motivet e njohjes dhe mosnjohjes të të dyja

vendeve janë mjaft të ndërlikuara. Ka pasur publikime lajmesh nga agjencione serbe, por edhe opinione të përforcuara të faqeve të ndryshme me karakter fetar islam, të cilat kanë krijuar përfundime se mosnjohja e Kosovës nga Vatikani – kryeqendra botërore e katolicizmit, vjen për shkak të raporteve të Kishës Katolike me Kishën Ortodokse Ruse. Nga ana tjetër nuk janë ndaluar as interpretimet e tjera se, për shkak të shumicës myslimane të popullsisë shqiptare, kjo është edhe arsyeja e mosnjohjes së Kosovës. Por nëse do të ishte me të vërtetë ky motiv i mosnjohjes së Kosovës nga Vatikani, për shkak të besimit mazhorativ islam të shqiptarëve, atëherë përse në listën e shteteve që e kanë njohur Palestinën, figuron edhe “Holy See”, apo Selia e shenjtë, siç shkruhet në gjuhën shqipe?! Në listën e mëposhtme tabelare, shtetet që e kanë njohur Palestinën, po ashtu janë të njohura për bazën e fortë historike dhe aktuale të religjionit të krishterë-ortodoks, si Federata Ruse, apo vende të njohura për budizëm, si ato të kontinentit aziatik.

Palestinën si vend me shumicë myslimane, e ka njohur India me shumicën hinduse, ndërsa nuk e ka njohur Kosovën. Ka edhe vende tjera në tabelën vijuese, të cilat janë të njohura për shumicën katolike, por që e kanë njohur Palestinën me popullsi shumicë të konfesionit islam. Pra, motivet fetare janë pak të besueshme që diktojnë vendimin final për njohjen e një shteti të ri. Në tabelën e mëposhtme, do të shohim se shumë shtete me shumicë islame e kanë njohur Palestinën islame, por kjo njohje nuk përcaktohet nga motivi i përbashkët fetar, ndonëse efektet e religjionit në disa raste, mund të jenë të dukshme, por jo vendimtare në njohjet ndërkombëtare. Në parim, efektet e religjionit mund të jenë indirekte apo periferike. Ka pasur komentime të ndryshme të motiveve të njohjes dhe mosnjohjes së shtetit të ri, duke e ndërlidhur njohjen me elementin fetar e kulturor.

Rastet e kundërta janë gjithashtu mjaft të shpeshta. P.sh. Anglia i ka njohur SHBA-të 6 vjet pas shpalljes së pavarësisë, Belgjika është njohur nga Holanda disa vjet pas ndarjes, Spanja i ka njohur republikat e Amerikës Latine pas shumë vjetëve, njohja e BRSS-së ka zgjatur deri në vitin 1940 etj. Vatikani e ka njohur Izraelin më 1994, që d.m.th. 45 vjet pas pranimit të tij në OKB dhe vetëm pas marrëveshjes midis Izraelit dhe Organizatës për Çlirimin e Palestinës më 1993. Por, kjo vonesë ka qenë më shumë pasojë e mosbesimit shumë shekullor midis katolikëve dhe Ebrenjëve

[sic] (Gruda, 2013, p. 81). Rastet e tilla, janë të ndërlidhura në një mënyrë apo tjetër, me religjionin, goftë edhe në kontekst tjetër.

Pse Vatikani nuk e ka njohur Kosovën me shumicë myslimane të popullsisë? A ka ndikim religjioni në pengesat për njohjet? Sipas një këndvështrimi, Vatikani nuk e ka njohur Kosovën, për shkak të relacionit të ngushtë me Kishën Ortodokse Ruse dhe përpjekjet për sa më shumë pajtim reciprok. Vatikani nuk e ka njohur Kosovën si shtet për shkak të ndjeshmërisë ndaj Kishës Ortodokse Serbe, siç ka deklaruar kardinali i Kishës Katolike Romake dhe anëtar i Këshillit Papnor, Valter Kasper... (Yvejsi, 2010)

Nëse religjioni i përbashkët në mes të shtetit që njeh një vend të ri dhe shtetit të sapokrijuar, do të ishte vendimtar në njohje, atëherë në tabelat e mëposhtme, të shteteve që e kanë njohur Palestinën, pse figurojnë edhe shtete me shumicë hinduse, edhe shtete me shumicë ortodokse, edhe shtete me shumicë katolike?! Religjioni ndonëse nuk është pa ndikim, efektet e tij janë të vogla dhe me përjashtime.

Nr.	Shteti	Data	Nr.	Shteti	Data
1	Afrika Jugore	15.02.1995	34	Mauritius	17.11.1988
2	Algjeria	15.11.1988	35	Mongolia	15.11.1988
3	Angola	6.12.1988	36	Mozambiku	8.12.1988
4	Argjentina	6.12.2010	37	Namibia	19.11.1988
5	Azerbejxhani	15.04.1992	38	Nepali	19.12.1988
6	Bjellorusia	19.11.1988	39	Nigeria	18.11.1988
7	Bolivia	17.12.2010	40	Nikaragua	16.11.1988
8	Bosnja & Hercegovina	27.05.1992	41	Paraguai	29.1.2011
9	Botswana	19.12.1988	42	Qipro	18.11.1988
10	Brazili	3.12.2011	43	Republika Demokratike e Kongos	18.12.1988
11	Butani	25.12.1988	44	Republika Demokratike Popullore e Laos	2.12.1988
12	Cape Verde	24.11.1988	45	Ruanda	2.1.1989
13	Ekuadori	27.12.2010	46	Rumania	24.11.1988
14	Etiopia	4.02.1989	47	Selia e Shenjtë	26.6.2015
15	Federata Ruse	19.11.1988	48	Serbia	16.11.1988
16	Filipinet	Shtator 1989	49	Seychelles	18.11.1988
17	Gjeorgjia	25.04.1992	50	Shri Lanka	18.11.1988
18	Guatemala	9.04.2013	51	Siria	18.7.2011
19	Guinea Ekuatoriale	Maj 1989	52	Sllovakia	18.11.1988
20	India	18.11.1988	53	St. Vincent dhe Grenadines	29.8.2011
21	Indonezia	15.11.1988	54	Sudani	17.11.1988

22	Iraku	15.11.1988	55	Sudani Jugor	14.7.2011
23	Irani	4.02.1988	56	Taxhikistani	2.4.1994
24	Kamboxha	21.11.1988	57	Tunizia	15.11.1988
25	Kazakistani	6.04.1992	58	Turkmenistani	17.4.1992
26	Kenia	Maj 1989	59	Uganda	3.12.1988
27	Kili	7.01.2011	60	Ukraina	19.11.1988
28	Kina	20.11.1988	61	Uruguai	16.3.2011
29	Kongo	5.12.1988	62	Uzbekistani	25.9.1994
30	Kuba	16.11.1988	63	Venezuela	27.4.2009
31	Kyrgyzستاني	Nëntor 1995	64	Vietnami	19.11.1988
32	Libani	30.11.2008	65	Zambia	16.11.1988
33	Mali	21.11.1988	66	Zimbabëe	29.11.1988

Tabela 1. Lista e shteteve që kanë njohur Palestinën dhe nuk e kanë njohur Kosovën.
Burimi: (UN M. o., n.d.)

Në tabelën e mëposhtme shohim listën e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën dhe i pranojnë ato si realitete të pavarura. Në mesin e këtyre shteteve, mund të gjejmë disa fuqi rajonale të cilat nuk kanë ndonjë peshë të madhe në orientimet e politikave globale si: Turqia, Pakistani, Egjipti, Arabia Saudite dhe shtete të tjera.

Nr.	Shteti	Data		Nr.	Shteti	Data	
		Palestina	Kosova			Palestina	Kosova
1	Afganistani	16.11.1988	18.2.2008	37	Liberi	Korrik 2011	30.5.2008
2	Afrika Qendrore	23.12.1988	22.7.2011	38	Libia	15.11.1988	25.9.2013
3	Antigua dhe Barbuda	22.11.2011	19.5.2015	39	Madagaskari	16.11.1988	24.11.2017
4	Arabia Saudite	16.11.1988	20.4.2009	40	Malajzia	15.11.1988	30.10.2008
5	Bahreini	15.11.1988	19.5.2009	41	Malawi	23.10.1998	14.12.2009
6	Bangladeshi	16.11.1988	27.2.2017	42	Maldivë	28.11.1988	19.2.2009
7	Belize	9.9.2011	07.8.2008	43	Mali i Zi	24.7.2006	09.10.2008
8	Benini	Maj 1989	18.8.2011	44	Malta	16.11.1988	22.8.2008
9	Brunei Darussalam	17.11.1988	25.4.2012	45	Maroko	15.11.1988	19.3.2008
10	Bullgaria	25.11.1988	20.3.2008	46	Mauritania	15.11.1988	14.9.2010
11	Burkina Faso	21.11.1988	23.4.2008	47	Nigeri	24.11.1988	15.8.2011
12	Burundi	22.12.1988	16.10.2012	48	Omani	13.12.1988	04.2.2011
13	Çadi	1.12.1988	01.6.2012	49	Pakistani	16.11.1988	25.12.2012
14	Republika Çeke	18.11.1988	21.5.2008	50	Papua Guinea e re	13.1.1995	03.10.2012
15	Cote d'Ivoire	1.12.2008	16.9.2011	51	Peruja	24.1.2011	22.2.2008
16	Dominika	19.9.2011	11.12.2012	52	Polonia	14.12.1988	26.2.2008
17	Egjipti	18.11.1988	26.6.2013	53	Republika Domenikane	15.7.2009	10.7.2009
18	El Salvador	25.8.2011	29.6.2013	54	Republika e Koresë	24.11.1988	28.3.2008
19	Emiratet e Bashkuara Arabe	16.11.1988	14.10.2008	55	Saint Lucia	14.9.2015	19.8.2011
20	Gaboni	12.12.1988	15.9.2011	56	São Tomé dhe Príncipe	10.12.1988	13.3.2012
21	Gambia	18.11.1988	07.4.2009	57	Senegali	22.11.1988	19.2.2008
22	Gana	29.11.1988	23.1.2012	58	Shqipëria	17.11.1988	18.2.2008
23	Grenada	25.9.2011	25.9.2013	59	Sierra Leone	3.12.1988	11.6.2008
24	Guinea	21.11.1988	12.8.2011	60	Somalia	15.11.1988	19.5.2010

25	Guinea-Bissau	21.11.1988	10.1.2011	61	Suedia	30.10.2014	04.3.2008
26	Guyanas	13.1.2011	16.3.2013	62	Suriname	26.1.2011	08.7.2016
27	Haiti	27.9.2013	10.2.2012	63	Swazilenda	Korrik 1991	12.4.2010
28	Hondurasi	26.8.2011	03.9.2010	64	Tajlanda	18.1.2012	24.9.2013
29	Hungaria	23.11.1988	19.3.2008	65	Tanzania	24.11.1988	29.5.2013
30	Islanda	15.12.2011	05.3.2008	66	Timori Lindor	1.3.2004	20.9.2012
31	Jemeni	15.11.1988	11.6.2013	67	Togo	29.11.1988	02.7.2014
32	Jordania	16.11.1988	17.7.2009	68	Turqia	15.11.1988	18.2.2008
33	Katari	16.11.1988	07.1.2011	69	Unioni i Comorosit	21.11.1988	14.5.2009
34	Kosta Rika	5.2.2008	17.2.2008	70	Vanuatu	21.8.1989	28.4.2010
35	Kuvajti	15.11.1988	11.10.2011	71	Xhibuti	17.11.1988	08.5.2010
36	Lesoto	3.5.2011	11.2.2014				

Tabela 2. *Lista e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën.*

Burimi: (UN M. o., n.d.); (MPJK, n.d.)

Më poshtë, do të gjeni listën e shteteve që e kanë njohur vetëm Kosovën, ku për dallim prej Palestinës, atë e kanë njohur kryesisht shtetet e Perëndimit liberal, e veçanërisht superfuqia globale, SHBA. Por dy superfuqi të tjera globale si Rusia dhe Kina, e kanë njohur Palestinën, kurse nuk e kanë njohur Kosovën. Po ashtu, Kosovën nuk e kanë njohur kryesisht shtetet e Amerikës Latine, shtetet që besohet se janë në mospajtime edhe me SHBA-në dhe Kosovën e konsiderojnë edhe projekt “amerikan”, prandaj “anti-amerikanizmi” i Amerikës Latine shpjegohet nganjëherë si një nga motivet për mosnjohje të Kosovës nga këto shtete.

Në këtë kontekst, shumë shtete amerikano-latine, për shkak se Palestinën e konsiderojnë si shtet që SHBA akoma nuk e ka njohur atë – e kanë njohur pikërisht Palestinën si shtet, si kundërshtim ndaj politikës së jashtme amerikane, apo si reagim ndaj politikave amerikane për Lindjen e Mesme dhe globin në tërësi.

Por edhe ky mund të jetë korrelacion iluziv, kur dy karakteristika që në dukje të parë janë të ngjashme, ngatërrohen e nuk merren parasysh të shoqëruara me shumë motive të tjera të gjeopolitikës, raporteve të veçanta të secilit shtet me shtetin amë prej nga shkëputet apo krijohet një shtet i ri etj.

Natyrisht, njohja e shtetit të ri me vonesë mund të jetë shkas i problemeve me këtë shtet të posakrijuar, për arsye se kjo gjë është njëfarë indikator i sigurt që shtetet që s’e kanë njohur kanë rezerva ose qëndrim armiqësor ndaj tij (Gruda, 2013, p. 81). Në rastin e Kosovës, disa shtete që hezituan të njohin menjëherë pavarësinë e Kosovës, ndryshuan qëndrim në momentin e

publikimit të mendimit këshillëdhënës të GJND-së, e cila theksoi se miratimi i deklaratës nuk ka shkelur asnjë rregull të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare. (ICJ, 2010, p. 14)

Pas dy tabelave të mësipërme, le të paraqesim edhe tabelën e shteteve që e kanë njohur vetëm Kosovën dhe më pas të bëjmë edhe ndonjë komparacion të disa motiveve të njohjes dhe mosnjohjes së një shteti të ri.

Nr.	Shteti	Data	Nr.	Shteti	Data
1	Australia	9.2.2008	24	Republika e Kiribatit	29.10.2010
2	Barbados	15.2.2018	25	Republika e Kolumbisë	04.8.2008
3	Duka i Madh i Luksemburgut	21.2.2008	26	Republika e Kroacisë	19.3.2008
4	Holanda	04.3.2008	27	Republika e Latvisë	20.2.2008
5	Ishujt Kuk	18.5.2015	28	Republika e Lituanisë	06.5.2008
6	Ishujt Marshall	17.4.2008	29	Republika e Maqedonisë	09.10.2008
7	Ishujt Solomon	05.8.2014	30	Republika e Naurus	23.4.2008
8	Japonia	18.3.2008	31	Republika e Palaus	06.3.2009
9	Kanada	18.3.2008	32	Republika e Panamas	16.1.2009
10	Konfederata Zvicerane	27.2.2008	33	Republika e San Marinos	12.5.2008
11	Mbretëria e Bashkuar	18.2.2008	34	Republika e Singaporit	01.12.2016
12	Mbretëria e Belgjikës	24.2.2008	35	Republika e Sllovenisë	05.3.2008
13	Mbretëria e Danimarkës	21.2.2008	36	Republika Federale e Gjermanisë	20.2.2008
14	Mbretëria e Norvegjisë	28.3.2008	37	Republika Franceze	18.2.2008
15	Mbretëria e Tongos	15.5.2014	38	Republika Italiane	21.2.2008
16	Niue	23.6.2015	39	Republika Portugeze	07.10.2008
17	Principata e Andorrës	08.6.2011	40	Saint Kitts dhe Nevis	28.10.2012
18	Principata e Litenshtajnit	25.3.2008	41	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	18.2.2008
19	Republika e Austrisë	28.2.2008	42	Shtetet Federative të Mikronezisë	05.12.2008
20	Republika e Estonisë	21.2.2008	43	Shteti i Pavarur i Samoas	15.9.2008
21	Republika e Finlandës	07.3.2008	44	Tuvalu	18.11.2010
22	Republika e Fihit	19.11.2012	45	Zelanda e Re	09.11.2009
23	Republika e Irlandës	29.2.2008			

Tabela 3. *Lista e shteteve që kanë njohur Kosovën dhe nuk e kanë njohur Palestinën.*
Burimi: (MPJK, n.d.)

Një numër i konsiderueshëm i shteteve që e kanë njohur Kosovën, nuk e kanë njohur Palestinën. Motivet mund të jenë nga më të ndryshmet dhe ndonjëherë edhe të paqartësuara sa duhet, pasi duhet të analizohet jo vetëm raporti i shteteve që e njohin shtetin e ri, por edhe raportet e shtetit me shtetin që ka kontest, apo konflikt ndërkombëtar me shtetin fqinj; me shtetin e dikurshëm e të përbashkët apo shtetin prej nga shteti i ri shkëputet apo krijohet si subjekt i ri ndërkombëtar.

SHBA-të nuk e kanë njohur Palestinën, për shkak të politikës së afërt me Izraelin, ndërsa Kosovën e kanë njohur. Por le të marrim një shembull tjetër, prej të cilit mund t'i kuptojmë rrethanat specifike të mosnjohjes së një shteti të ri, e që nuk mund të gjeneralizohet për situata të tjera po ashtu specifike në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe historike. Pse Gjermania nuk e njeh Palestinën? Gjatë një konference për media në Berlin, Kancelarja Angela Merkel, rreth njohjes së Palestinës pohoi se, Gjermania ishte kundër njohjes së njëanshme të një shteti palestinez, duke kërkuar rivendosjen e bisedimeve të paqes midis izraelitëve dhe palestinezëve. Merkel tha... se Berlioni mbështet një zgjidhje dyshtetëshe dhe "e shohim sa e vështirë është kjo, kështu që ne gjithashtu besojmë se njohja e njëanshme e shtetit palestinez nuk do të na çojë përpara drejt këtij qëllimi". (The Times of Israel, 2018)

Gjermania për shkak të gjenocidit nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka ndjerë përgjegjësinë e veçantë ndaj hebrenjve, duke mos u rreshtuar në pozicionin pro-Palestinë. Autori izraelit Daniel Barenboim, lidhur me këtë, thotë: ...natyrisht, Gjermania dhe Izraeli kanë pasur gjithmonë një marrëdhënie veçanërisht të qëndrueshme; Gjermania gjithmonë ka ndjerë me të drejtë veçanërisht detyrimin ndaj Izraelit. Por unë duhet të shkoj një hap më tej: Gjermania gjithashtu ka një detyrim të veçantë ndaj palestinezëve. Pa Holokaustin kurrë nuk do të kishte qenë një ndarje e Palestinës, nuk do të kishte qenë asnjë luftë el-Nakba, dhe okupimi në vitin 1967. Kjo nuk është vetëm për përgjegjësinë gjermane për palestinezët, por për atë të të gjithë evropianëve: Antisemitizmi ishte një fenomen panevropian dhe palestinezët vazhdojnë të vuajnë nga pasojat e tyre të drejtpërdrejta, edhe pse vetë ata nuk janë në asnjë mënyrë përgjegjës për të. (Barenboim, 2017)

Pra, motivet e njohjes dhe mosnjohjes në rastet e Gjermanisë dhe Palestinës, janë të lidhura direkt me raportin e Gjermanisë me shtetin që ka pasur marrëdhënie të ndjeshme në të kaluarën, prandaj nuk mund të shmanget tragjedia njerëzore e Holokaustit nga nazistët, për të treguar motivet e mosnjohjes së Palestinës nga Gjermania e sotme. Për mosnjohjen e Palestinës nga Gjermania kanë ndikuar edhe orientimet gjeopolitike. Gjermania, sikurse shumica e shteteve perëndimore është njëri nga aleatët kryesorë dhe më të fuqishëm të SHBA-ve dhe që të dyja bashkë janë pjesë e Traktatit Veri-Atlantik të NATO-s. Të njëjtat motive në rastin e Kosovës kanë

pasur ndikim tjetër. Gjermania ka njohur dhe mbështetur fuqishëm pavarësinë dhe zhvillimin e Kosovës.

Gjermania e ka njohur Kosovën, sepse ndaj Serbisë, nuk e ka pasur dhe as nuk e ka përgjegjësinë sikur e ka ndaj Izraelit dhe antisemitizmit të dikurshëm. Në anën tjetër, Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore po ashtu e ka pushtuar Serbinë, por nuk ka ndikuar kjo që të mos e njoh sot shtetin e Kosovës, shtet të cilin e konteston edhe sot, Republika e Serbisë. Por pushtimi i Gjermanisë naziste ndaj Beogradit të Serbisë dhe pjesëve të tjera në vitin 1941, nuk barazohet me vrasjen e miliona hebrenjve. Prandaj, e kaluara historike, mund të ndikojë motivet e njohjes ndërkombëtare të një shteti, por vetëm një e kaluar me gjurmë më të thella e tragjike si Holokausti ndaj hebrenjve.

Megjithatë, Gjermania është treguar e kujdesshme edhe në çështjen palestineze, por pa i zemëruar izraelitët. Lidhur me vendimin e Presidentit aktual të SHBA-së, Donald Trump, se njeh Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit, Gjermania ishte renditur në anën e shumicës së shteteve që kundërshtojnë këtë vendim të njëanshëm, pasi që situata në Lindjen e Mesme, pas këtij vendimi unilateral amerikan të Trumpit, do të përkeqësohej. Ministri i Jashtëm i Gjermanisë Sigmar Gabriel paralajmëroi... kundër një njohjeje të njëanshme amerikane të Jerusalemit, si kryeqytetin izraelit... (Landau N. , 2017)

Një analogji e motiveve të mosnjohjes ndërkombëtare të Kosovës si shtet i pavarur, në krahasim me njohjen e Palestinës, është edhe Federata Ruse. Kjo e fundit, për shkak të miqësisë dhe lidhjes speciale historike me Serbinë, nuk e ka njohur Kosovën. Po ashtu, njohja nuk ka ardhur edhe për shkak të konsiderimit dhe vlerësimit të Kosovës, si “projekt unilateral të Perëndimit liberal dhe SHBA-së”. Kosova e radhitur në zonat e interesit gjeopolitik perëndimor, gjithashtu shihet si situatë e pafavorshme për interesat ruse në Ballkanin Perëndimor. Raporti special në mes të Rusisë dhe Serbisë mund të përafrohet me raportin special të SHBA-së me Izraelin. Rusia nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur, për shkak të lidhjes speciale me Serbinë, ngjashëm sikurse SHBA nuk e njeh Palestinën si shtet të pavarur, për shkak të lidhjes speciale me Izraelin. Por përtej këtyre motiveve, fshihen edhe motive të tjera, të cilat nuk janë të parëndësishme. Për shembull, Rusia duke mos e njohur Kosovën dhe duke e mbështetur Serbinë, përpiqet dhe synon të kufizojë ndikimin e Bashkimit Evropian dhe interesit amerikan në Ballkanin Perëndimor. Rusia duke mos

e njohur Kosovën, përpiket të arsyetojë ose të kërkojë njohjen e territoreve të shkëputura me forcë nga Gjeorgjia dhe Ukraina, si Osetinë Jugore, Abkhazinë dhe Krimenë. Rusia duke mos e njohur Kosovën, përpiket të paraqitet në arenën ndërkombëtare dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) si ruajtëse e të drejtës ndërkombëtare, dhe duke e akuzuar SHBA-në si shkelëse të kësaj të drejteje. Pra, motivet për mosnjohjen e një shteti nga një shtet janë të ndërlidhura me shumë interesa, pavarësisht se në shikim të parë, dominon vetëm një interes.

Një faktor tjetër me rëndësi në njohjen apo mosnjohjen e një shteti të ri, luajnë edhe grupet lobuese, diaspora e një shteti etj. Rast tipik është roli i veçantë që ka luajtur diaspora hebraike në forcimin e marrëdhënieve të veçanta mbështetëse të SHBA-së ndaj Izraelit. Madje, lobim afërsisht të ngjashëm për Kosovën, intervenimin ushtarak, lidhjen dhe përkrahjen e vazhdueshme amerikane ndaj Kosovës, disa e kanë shpjeguar dhe ndërlidhur edhe me rolin e mërgatës shqiptaro-amerikane në SHBA.

Konflikti arabo-izraelit ka marrë shumë forma. Më e dukshme ka qenë përplasja ushtarake, ndonëse konflikti ka pasur edhe përmasë politike e ekonomike. Shtetet arabe refuzuan t'i jepnin Izraelit njohje diplomatike. Me anë të Lidhjes së Shteteve Arabe (të themeluar në vitin 1945) vendet arabe organizuan një bojkot të kompanive ndërkombëtare që kishin marrëdhënie tregtare me Izraelin. Anasjellas, diplomatët izraelitë dhe lobistët proizraelitë u orvatën të bindnin politikëbërësit amerikanë të mos u jepnin armë e ndihmë ekonomike shteteve arabe që Shtetet e Bashkuara i konsideronin miqësore gjatë Luftës së Ftohtë. (Fawcett, 2005)

Lobet shqiptare gjatë kohës kishin zhvilluar veprimtarinë e tyre për realizimin e idealeve kombëtare. Për këtë qëllim, në vitin 1990, Lidhja Qytetare krijoi Komitetin Shqiptar të Punëve Publike Shqiptare (AAPAC), për të mbështetur kongresmenët që pranuan të mbështesin rezolutat lidhur me shqiptarët si dhe një Fondacion Shqiptaro-Amerikan. Ngritja e fondeve ishte një pjesë e madhe e punës, mbledhja dhe përhapja e informacionit ishte një punë tjetër. Nën administratën e Clintonit, këto përpjekje u lehtësuan nga pranimi në Kongres i disa mbështetësve të njohur të çështjes shqiptare. (Ragaru & Dymi, 2014, p. 15)

Motivet e njohjes dhe mosnjohjes janë të kushtëzuara nga faktorë të jashtëm e të brendshëm, në radhë të parë, nga interesa politike dhe ekonomike, për të vazhduar më tej, edhe

me rrethana historike. Kosovën nuk e njohin pesë shtete të Bashkimit Evropian: Spanja, Greqia, Qipro, Rumania dhe Sllovakia.

Greqia pranon dokumentet e Kosovës, që në fakt pranon realitetin, por *de jure* nuk e njeh Kosovën. Po cilat janë motivet e Sllovakisë për të mos e njohur Kosovën? Margarete Hurn thekson se hezitimi për njohje të Kosovës buron në frikën për separatizëm të brendshëm. Sipas Hurn, rrënjët e saj nuk mund të gjenden vetëm në një histori të lëvizur të shekullit të 20-të [...], por edhe në një ndjenjë të përgjakshme të publikut të gjerë [...] se pakica hungareze që jeton në jug është një kërcënim për interesat më të rëndësishme të shtetit tonë dhe se ata ende planifikojnë të shkëputen dhe të bëhen pjesë e Hungarisë... Sot pakicat hungareze përbëjnë të paktën 10% të popullsisë së përgjithshme të Sllovakisë, me disa zona në jug të Sllovakisë që kanë më shumë se 40% të popullsisë së tyre, të cilat janë me përkatësi etnike hungareze. (Hurn, 2008)

Të njëjtin mendim apo pikëpamje, mbi problemet e brendshme të aspiratave etnike për shkëputje, e jep edhe autori japonez Yuko Kambara. Ai pohon se Republika Sllovake ka një problem etnik me pakicën e saj hungareze, sepse Sllovakia ishte pjesë e Mbretërisë Hungareze dhe pastaj Monarkisë Austro-Hungareze, për 900 vjet. Sllovakët së pari fituan pavarësinë së bashku me çekët, si Çekosllovakia në vitin 1918, dhe më vonë u ndanë nga Çekosllovakia në vitin 1993. Fundi i Monarkisë Austro-Hungareze la shumë pak minoritete etnike hungareze brenda vendeve fqinje, përfshirë Sllovinë. Popullsia e Sllovakisë është rreth 5.4 milionë, nga të cilat shumica sllovake përbëjnë 80% .Tri pakicat e tjera janë romë, rusë dhe hungarezë, ku të fundit përbëjnë pakicën më të madhe në Sllovinë jugore, duke numëruar rreth 458,000 njerëz dhe përbëjnë 8.5 % të popullsisë sllovake. (Kambara, 2008)

Në përgjithësi, frika nga përparësia në rast të ndarjes së njëanshme është njëri prej argumenteve të politikanëve dhe diplomatëve sllovakë, kur qëndrimi i Sllovakisë për mosnjohje qëndron mbi tryezë në rastet zyrtare dhe jozyrtare. (Slavikova, 2011)

Edhe pse Sllovakia nuk e ka njohur e Kosovën, është treguar e moderuar sa i përket kontakteve liberale. Ajo ka zyrën ndërlidhëse në Prishtinë. (Syla, 2013, p. 5)

Po pse Spanja nuk e njeh Kosovën? Ngjashmëria e motiveve të mosnjohjes së Kosovës nga Spanja, është pothuajse e njëjtë me motivin e supozuar të mosnjohjes nga Sllovakia. Edhe Spanja, edhe Sllovakia, kanë ndjenja separatiste të popullatës pakicë në territoret e tyre. Madje,

kundërshtimi i ashpër i Spanjës për të mos e njohur Kosovën, tregon edhe për vlerësimin e rrezikut edhe më të lartë të kontestit separatist në Spanjë, sesa në Sllovaki. Spanja po ballafaqohet me katalonasët dhe baskët në shtetin e tyre. Njohja e Kosovës, do të lexohej edhe njëfarë detyrimi i brendshëm politik dhe etik, ndaj Katalonisë dhe Rajonit Bask.

Nacionalistët katalanas kanë kohë që ankohen se rajoni i tyre dërgon shumë para në pjesë të varfra të Spanjës, pasi taksat kontrollohen nga Madridi. Ata gjithashtu thonë se ndryshimet e Spanjës në statusin e tyre autonom në vitin 2010 minuan identitetin katalanas. Në një referendum më 1 tetor 2017, i shpallur i paligjshëm nga Gjykata Kushtetuese e Spanjës, rreth 90% e votuesve katalanas mbështetën pavarësinë. Por pjesëmarrja ishte vetëm 43%... Separatistët në pushtet, në parlamentin katalanas shpallën pavarësinë më 27 tetor. I zemëruar nga kjo, Madridi imponoi sundimin e drejtpërdrejtë duke u thirrur në nenin 155 të kushtetutës - i pari për Spanjën. Qeveria spanjolle shkarkoi udhëheqësit katalanas, shpërndau parlamentin dhe thirri zgjedhjet e parakohshme rajonale më 21 dhjetor 2017, të cilat i fituan partitë nacionaliste. Carles Puigdemont, ish-Presidenti katalanas, u arratis, por kërkohet në Spanjë i akuzuar për rebelim, siç janë katër që ikën me të. Dy nga ish-ministrat e tij janë në burg në Spanjë. Në qershor të vitit 2018, nacionalistët katalanas rifituan kontrollin e rajonit nga sundimi i drejtpërdrejtë i Madridit, pasi u betua një qeveri e re. Quim Torra, një aleat i ngushtë i z. Puigdemont, do të udhëheqë qeverinë rajonale. (BBC, 2018)

Si në rastin e Sllovakisë, si në rastin e Spanjës për mosnjohje të Kosovës, kemi rrethanat e brendshme separatiste, apo potencialisht me aspirata për ndarje etnike e territoriale, e të cilat nga Qeveria vendase sllovaqe e spanjolle, konsiderohen si motive për mosnjohje të një shteti të ri si Kosova, sepse kjo do të thoshte edhe legjitimitet për shtete të reja nga ndarjet e tyre të brendshme. Por sërish situata e njohjes ndërkombëtare është e komplikuar. Të marrim sërish Sllovakinë, që po konsiderohet me aspirata separatiste të grupit etnik hungarez brenda territorit të tyre dhe njohjen e Palestinës. Pse atëherë e njohu Palestinën? Më 18 nëntor 1988, Sllovakia bashkë me Çekinë e njohën shtetin e Palestinës. Edhe atëbotë kishte pakicë të madhe hungareze në Sllovaki. Po ashtu, Spanja, që ka problemin katalonas dhe bask brenda shtetit, ka dhënë mbështetje për Palestinën.

Spanja ishte një nga ato vende, që në vitin 2014 miratoi një mocion jo detyrues duke i bërë thirrje qeverisë të njohë një shtet palestinez në koordinim me çdo lëvizje të ngjashme nga Bashkimi Evropian... Kryetari i Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas, i kërkoi Spanjës të njohë “shtetin e Palestinës” në përputhje me rekomandimin e parlamentit vendas. (Benari, 2018)

Edhe Ministri i Punëve të Jashtme, është cituar nga mediet e ndryshme botërore, për gatishmërinë e Spanjës për ta njohur Palestinën: Nëse “BE nuk është në gjendje të arrijë një vendim unanim,” opsiioni i njohjes individuale të Palestinës është “në tryezë”, shtoi ai. (Benari, 2018)

Por çështja bëhet edhe më e komplikuar, pasi që sërish del në pah “karta e kërcënimit” për mosnjohje të Palestinës, nga “çështja katalonase”: Në një takim të kohëve të fundit midis udhëheqësit të partisë së majtë spanjolle Podemos, Pablo Iglesias dhe kryeministrit spanjoll Pedro Sánchez, Iglesias i kërkoi Sanchezit të konsideronte që Spanja të ishte vendi i parë i madh i BE-së që të njohë shtetin e Palestinës... Parlamenti spanjoll ka miratuar në të vërtetë një mocion që i bën thirrje qeverisë të njohë Palestinën në vitin 2014, por kjo nuk ishte e detyrueshme dhe më së shumti ishte simbolike... Ángel Más, president i ACOM-it - një shoqatë e dedikuar për përmirësimin e marrëdhënieve midis Spanjës dhe Izraelit dhe luftimin e BDS-së – publikoi në ABC të Spanjës, argumente kundër kësaj lëvizjeje. Argumenti i tij kryesor ishte: Nëse Spanja e njeh Palestinën, Izraeli mund të hakmerret duke njohur shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Katalonjës në tetor 2017 dhe kjo do të kishte rezultate katastrofike. (Levy, 2018)

Duhet të kuptojmë se motivet për njohje të Palestinës nga Sllovakia dhe Spanja janë edhe të natyrës juridike. Këto shtete mund ta vlerësojnë Palestinën si rast të dekolonizimit, ndërkaq Kosovën si rast të shkëputjes. Ky fakt edhe mund të bëjë diferencën në trajtimin e të dy rasteve.

Edhe Rumania, sikurse Spanja e Sllovakia, kanë probleme të brendshme të minoriteteve etnike, me sfond dhe vullnet për shkëputje. Përleshjet e para etnike në Evropën Juglindore postkomuniste u zhvilluan në Rajonin e Transilvanisë të Rumanisë, në të cilin pjesa më e madhe e vendit është pakica më e madhe hungareze, e përqendruar me 1.4 milionë banorë. Menjëherë pas dhjetorit 1989, kur rumunët dhe hungarezët u bashkuan me forcat e tyre për të përmbysur regjimin e Çausheskut dhe tensionet mes dy grupeve etnike filluan të përshkallëzohen. Tre muaj më vonë, ato shpërthyen në tensionet më të dhunshme dhe e të dukshme në qytetin e Targu-

Mures, ku konfrontimet e përgjakshme të rrugëve rezultuan në disa të vdekur dhe qindra të plagosur... (Vasile, 2016)

Hezitimi i Rumanisë për njohjen e Kosovës pos raporteve të dëshirueshme me Serbinë, ka edhe faktorin kryesor të mosnjohjes që është integriteti territorial i vetë Rumanisë. Shteti rumun beson se hungarezët do ta shfrytëzojnë shembullin e Kosovës për të kërkuar autonomi për tërë Transilvaninë... ku ata përbëjnë shumicën dërmuese etnike. Pakica hungareze vazhdimisht ka bërë kërkesa për autonomi, që sillen prej kërkesave më të moderuara për kompetenca më të mëdha administrative dhe më shumë kushte për shkollim në gjuhën e tyre amtare etj., e deri te kërkesat radikale për njohje të së drejtës për vetëvendosje. (Papasceu, 2011, p. 62)

Rumania e njeh Palestinën që nga viti 1988, ndërkaq raportet e tyre u përkeqësuan së fundmi kur Kryeministrja rumune Viorica Dăncilă ka njoftuar se, Bukureshti do të lëvizë ambasadën e saj në Izrael nga Tel Avivi në Jerusalem. Dăncilă bëri njoftimin në Uashington më 24 mars në konferencën vjetore politike të grupit lobues pro-Izrael në Shtetet e Bashkuara - Komiteti Amerikan i Izraelit për Çështjet Publike (AIPAC). (RFE/RL, 2019)

Këto informacione çuan edhe në anulimin e vizitës së Mbretit Abdullah II të Jordanisë në Rumani... kjo ishte anuluar “në solidaritet me Jerusalemin, pasi vuri re se Kryeministrja rumune Viorica Dăncilă ka shprehur qëllimin për të lëvizur ambasadën e vendit të saj në Jerusalem”. (Memo, 2019)

Qipro është shteti që nuk e ka njohur Kosovën dhe që pas përplasjeve historike ndërmjet Turqisë dhe Greqisë, u krijuan dy shtete me emërtimin Qipro: Qipro turke dhe Qipro greke. Ndërsa Greqia, përveç kontestit të emrit për shumë vjet ndaj Maqedonisë - e që është arritur tashmë marrëveshja historike, duke u emërtuar Maqedonia e Veriut - pretendon kontest për Vorio-Epirin në Jug të Republikës së Shqipërisë. Në pesë prej këtyre shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, ka probleme ose vlerësohen si të tilla nga qeveritë vendase, për rajonet e tyre të brendshme.

Rasti i Qipros tregon se sa të pazbërthyera lehtësisht janë motivet e njohjes dhe mosnjohjes së një shteti të ri. Sikurse Kurdistan i Irakut që nuk arriti të merrte njohje ndërkombëtare, ashtu edhe Qipro turke, arriti të njëhej vetëm nga Turqia. Pak a shumë e ngjashme edhe me referendumin në vitin 1991 në Kosovë, kur u shpall Pavarësia e Kosovës, e cila

u njoh në atë kohë, vetëm nga Republika e Shqipërisë - si shtet amë i shumicës etnike shqiptare. Kështu, në maj të vitit 1983, Denktash ndërpreu të gjitha bisedimet ndërkomunale, dhe në nëntor ai shpalli Republikën Turke të Qipros Veriore (TRNC); pavarësia e republikës u njoh vetëm nga Turqia. Këshilli i Sigurimit i OKB-së e dënoi masën e ndërmarrë dhe përsëriti kërkesën e saj të parë të bërë në vitin 1974, që të gjitha trupat e huaja të tërhiqen nga Republika e Qipros. Përpjekjet e rinovuara për paqe të OKB-së në vitet 1984 dhe 1985, nuk ishin të suksesshme, dhe në maj të vitit 1985 një kushtetutë për TRNC u miratua me referendum. (Britannica, 2018)

Qipro pavarësisht ndarjes në dysh dhe pretendimeve greko-turke për ishullin, nuk ka ngurruar ta njoh Palestinën si shtet. Edhe në vitet e fundit, sërish ka përpjekje të qipriotëve për bisedime dypalëshe. Ndarjet brendaqipriote dhe impaktet e dy shteteve të fuqishme rajonale si Turqia dhe Greqia, kanë pasur ndikim në raportin dhe marrëdhëniet e Qipros me Bashkimin Evropian, Palestinën, Izraelin etj.

Rezervat e gazit natyror, zbuluar fillimisht në det të hapur në vitin 2011, u bënë një çështje gjithnjë e më e diskutueshme mes të dy palëve... Vetëm disa ditë pasi bisedimet me TRNC u shpërndanë në vitin 2017, Qiproja filloi të lejojë Total Group të stërvitej për gazin natyror. Kur vendi lejoi që Eni të fillonte shpimet në shkurt të vitit 2018, ndërhyenin anijet luftarake turke, duke kthyer anijet e korporatës. Exxon Mobil Corporation filloi të shpurojë atë vit, pavarësisht kundërshtimeve turke. Në janar 2019, për shkak se grekët qipriotë nuk arritën të siguronin një marrëveshje të drejtë me turqit qipriotë, Turqia njoftoi se do të fillonte shpime pranë Qipros. (Britannica, 2018)

Edhe para pak vjetësh, udhëheqësia qipriote ka pasur deklarime sa i përket njohjes së kufijve të Palestinës, përkatësisht të vitit 1967. Presidenti i Qipros ka njoftuar se vendi i tij njeh një shtet palestinez brenda kufijve të vitit 1967, pasi disa shtete të Amerikës së Jugut bënë veprime të ngjashme... Ai gjithashtu shprehu shpresën se një shtet palestinez do të formohet me Lindjen e Al-Quds (Jerusalem) si kryeqytetin e saj. Pas deklaratave të ngjashme që vijnë kryesisht nga shtetet e Amerikës së Jugut, përkatësisht Brazili, Argjentina, Ekuadori, Bolivia, Uruguai, Kili dhe Peru, Qipro njohu një shtetësi palestineze brenda kufijve që ekzistonin përpara se Izraeli të pushtonte Bregun Perëndimor në Luftën Gjashtëditore të vitit 1967. (The authentic voice of Palestine, 2011)

Por ajo që mbetet interesante në këtë raport, është bashkëpunimi i ngushtë në mes të Qipros dhe Izraelit, qoftë në ekonomi, turizëm etj. Gjatë 70 vjetëve të fundit, marrëdhëniet e Qipros dhe Palestinës ishin ato të miqësisë së ngushtë dhe aleancës politike. Të dy ishin ish-koloni britanike dhe të dy pësuan nga manipulimet britanike, duke lënë prapa dy vendbanime të ndara. (Saath, 2016)

Në rastin e Kosovës Qipro nuk ka as marrëdhënie zyrtare as jozyrtare me Republikën e Kosovës. Është njëri prej pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e njeh Kosovën, por është shteti i vetëm anëtar i Unionit që nuk kontribuon në forcën e EULEX-it në Kosovë, në misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë (Syla, 2013, p. 3). Qëndrimi i Qipros zyrtare padyshim bazohet në implikimet e brendshme të saj. Në këtë situatë, turqit e Qipros do të vazhdojnë ta mbështesin kauzën e Kosovës, ndërsa grekët e Qipros kauzën e Serbisë... lidhur me grekët e Qipros, duhet të merret parasysh edhe një faktor tjetër. Tërthorazi, qëndrimi i tyre për Kosovën lidhet jo pak me situatën politike në Qipro. Shpallja e pavarësisë së "TRNC-së" më 1983 i ka bërë grekët e Qipros më të ndjeshëm ndaj çështjeve të sovranitetit nacional, integritetit territorial dhe pavarësisë nacionale (Kentas, 2011, p. 136). Duhet të theksojmë që raportet e Kosovës me Qipron greke pas shumë përpjekjesh kanë shënuar progres simbolik. Personat me pasaporta qipriote mund të hynë në Kosovë pa viza, ndërsa personat me pasaporta të Kosovës që kanë vizë Shengen që vlenë për disa hyrje mund të hynë në territorin qipriot. Ndërsa republika e vetëshpallur Turke e Qipros së Veriut i lejon personat me pasaporta të Kosovës që të hynë në territorin e tyre pa viza (Fazliu, 2016). Njohja e një shteti ka specifikacione të panumërta në raportet bilaterale dhe diplomatike. Njohja kushtëzohet nga një sërë faktorësh, të cilët në një shtet ndikojnë, në një shtet tjetër jo, qofshin faktorë krejtësisht të ngjashëm.

Akti i njëanshëm i shpalljes së pavarësisë si arsye për mosnjohje është përdorur nga shumë shtete. Në veçanti, nga shtetet që nuk dëshirojnë të kenë pasoja juridike apo politike ndërkombëtare. Kjo për faktin se njohjet ndërkombëtare problematizohen shumë edhe nën këtë arsyetim. Shpalljet e njëanshme apo unilaterale, pa pajtimin e Bashkësisë Ndërkombëtare, pa pajtimin e shtetit prej nga shkëputet, dekolonizohet apo krijohet shteti i ri, vlerësohen si pengesa për njohjen më të shpejtë dhe më të lehtë të një shteti të sapokrijuar në rendin ndërkombëtar. Edhe Kosova, edhe Palestina, janë në kontekste të ngjashme, pasi që vendet më të fuqishme

politike dhe ekonomike në botë, nuk janë njëzëri. Nëse për Palestinën nuk pajtohet SHBA, për Kosovën, nuk pajtohet Rusia dhe Kina.

Shpalljet e njëanshme të pavarësisë së shteteve nuk janë aq të njëanshme sa mund të përkufizohen si të tilla në gjuhën diplomatike e juridike. Ato janë akte të njëanshme, edhe kur gjysma e botës e njeh një shtet të ri; edhe atëherë kur mbi gjysma e shteteve anëtare të OKB-së e njohin një shtet të ri, siç ka ndodhur qoftë me Kosovën, qoftë me Palestinën. Ato janë të njëanshme për shkak se nuk mund të arrihet konsensusi absolut, i plotë dhe i të gjithë akterëve në skenën ndërkombëtare e globale.

Si aktet e njëanshme juridike, si njohjet ndërkombëtare, bëhen të rëndësishme për t'i studiuar, analizuar dhe reaguar, pasi që shkaktojnë pasoja dhe ndikime të pakontestueshme në rendin ndërkombëtar. Pasojat juridike të njohjes janë: shteti, i cili e ka bërë njohjen, nuk mund të mohojë (kontestojë) më vonë faktin, gjendjen ose kërkesën e pranuar ose të konfirmojë se ato janë të kundërligjshme. Rëndësia e njohjes qëndron sidomos në faktin se ajo e zëvendëson parashkrimin. Njohja e gjendjes së krijuar nga subjekti për të drejtat e të cilit akoma fjala mund t'i largojë diferencat dhe të pajtojë gjendjen faktike me gjendjen juridike. (Gruda, 2013, p. 285)

Aktet e njëanshme juridike janë të njohura në të drejtën ndërkombëtare, në gjuhën diplomatike e të marrëdhënieve ndërkombëtare, dhe si të tilla kanë efekte të mëdha në politikat e një shteti ndaj një shteti tjetër. Ato gjithmonë shkaktojnë debat dhe janë edhe si rezultat i vështirësive të mëdha të harmonizimit dhe dialogimit të interesave kundërthënëse ndërmjet dy e më tepër subjekteve ndërkombëtare. Sfidat janë të pranishme gjithmonë në marrjen e pëlqimit absolut të secilit shtet, për të krijuar një situatë të caktuar juridike. Shtetet sikurse individët e grupet më të vogla, gjatë ndërveprimit dhe marrëdhënieve të tyre reciproke, kanë jo vetëm pika të përbashkëta, interesa të përputhshme, por edhe konflikte, mospajtime dhe synime për të përfituar sa më shumë njëra apo tjetra palë. Prandaj, janë të paevitueshme aktet e njëanshme juridike, por ato mund të kalojnë me pasoja më pozitive në rendin ndërkombëtar, nëse ka bashkëpunim, vullnet dhe kurajo për të vazhduar dialogun e negociatat.

3.5. Marrëdhëniet e Izraelit me Rusinë dhe SHBA-të

3.5.1. Marrëdhëniet e Izraelit me Rusinë

Krahasimi i Palestinës dhe Kosovës qoftë në kontekstin e anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, qoftë në njohjet ndërkombëtare, duhet të bëhet edhe duke krahasuar marrëdhëniet e Izraelit me SHBA-në dhe Rusinë, ngjashëm siç duhet të bëhet edhe krahasimi i marrëdhënieve të Serbisë me Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për krijimin e shtetit të Izraelit kontribut të çmuar dha edhe BRSS-ja, e cila kishte përkrahur atë në shumë mënyra. Mirëpo, në mes të BRSS-së apo Ruisë së sotme, historia e marrëdhënieve është me ndryshime të njëpasnjëshme që nga lindja e shtetit të Izraelit. Kryesisht marrëdhëniet në mes të Izraelit dhe Ruisë vlerësohen si raporte interesi dhe jo miqësie. Disa çështje kryesore që i bashkojnë, por edhe i ndajnë në të njëjtën kohë të dyja vendet janë: shitja e armëve nga Rusia për shtetet arabe, aleanca me Iranin si një nga vendet e konsideruara më armiqësore për Izraelin, si dhe së fundi, lufta në Siri.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë botërore, BRSS-ja ofroi përkrahje për kauzën sioniste. Kremlin mbështeti themelimin e një shteti të pavarur hebre dhe krijoi rrjete për të ndihmuar hebrenjtë e rinj të Evropës Lindore që të emigronin në Palestinë nëpërmjet Iranit. Në vitin 1947, ajo votoi për Rezolutën 181, duke vendosur planin për ndarjen e Palestinës. (Razoux, 2008, p. 2)

Pas krijimit të Izraelit, BRSS-ja ishte ndër vendet e para që njohu atë. Por raportet e Izraelit me BRSS-në sërish u prishen gjatë kohës së Bashkimit Sovjetik dhe luftës arabo-izraelite. Këto marrëdhënie përkeqësimi bilateral, pothuajse mbetën të tilla mbi dy dekada.

Pas luftës në qershor 1967, Bashkimi Sovjetik riarmatosi vendet arabe dhe ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Izraelin. Kremlin më pas tërhoqi një numër të "vijave të kuqe" në Lindjen e Mesme që Izraeli kurrë nuk i kaloi: madje as gjatë Luftës së Sfillitjes (1969-1970), ose luftës Yom Kippur (tetor 1973), ose Luftës Libaneze (qershor 1982). (Razoux, 2008, p. 2)

Marrëdhëniet sovjetike-izraelite u rivendosën në fund të epokës së Gorbaçovit në tetor të vitit 1991 dhe u përmirësuan nën Jelcinin në vitet 1990, gjatë kulmit të emigrimit hebre nga ish-Bashkimi Sovjetik në Izrael. Por, nën drejtimin e ekspertit të jashtëm sovjetik të Lindjes së Mesme, Yevgeni Primakov (i cili shërbeu si ministër i jashtëm dhe pastaj kryeministër gjatë

presidencës së Jelcinit), Moska ishte më e fokusuar në përmirësimin e marrëdhënieve me regjimet antiamerikane në Iran dhe Irak, dhe u bë më kritik ndaj Izraelit. (Katz, 2018, p. 104)

Pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, tensioneve në mes të Rusisë dhe separatistëve çeçenë, emëruesi i përbashkët për Rusinë dhe Izraelin, ishte deklarimi i dyja vendeve për “luftë ndaj terrorizmit islamik”. Pasi Putini erdhi në pushtet në fund të vitit 1999, kryeministri izraelit Ariel Sharon filloi ta takonte atë në fillim të viteve 2000. Ndërsa shumica e liderëve perëndimorë ose kritikuan ose heshtën për ndërhyrjen e Putinit në Çeçeni, Sharon e vlerësoi atë. Argumenti i tij se Rusia dhe Izraeli kërcënoheshin nga terroristët myslimanë (qofshin çeçenë apo palestinezë), me sa duket rezononin me Putinin, sidomos kur bashkëpunimi ruso-izraelit i inteligjencës u thellua në prag të incidentit të Beslanit në vitin 2004. Kur Putini bëri vizitën e tij të parë në Izrael në vitin 2005 (një udhëtim që përfshinte edhe Egjiptin, por jo Sirinë), presidenti rus shprehu mbështetjen e tij të fortë për sigurinë e shtetit hebraik. (Katz, 2018, p. 104)

Në këtë periudhë kohore Izraeli po ballafaqohej me Intifadën e Dytë, ndërkaq Rusia me kryengritjen çeçene. Më 28 prill 2005, në vizitën e parë të një udhëheqësi të Kremlinit në Izrael, Presidenti Vladimir V. Putin i Rusisë, u përpoq të zbuste frikën se siguria e Izraelit u kërcënua nga asistenca bërthamore e Rusisë ndaj Iranit dhe shitjet e raketave në Siri. (Myre, 2005)

Por pas terrorizmit dhe armiqësisë me Iranin, Izraeli dhe Rusia bëhen bashkë dhe forcojnë marrëdhëniet e tyre diplomatike, edhe me synimet për bashkëpunim ekonomik, përkatësisht atë të gazit. Deri në vitin 2009, Izraeli po zhvillonte negociata të avancuara për të blerë gaz natyror nga Rusia. Pas zbulimit të fushave të gazit jashtë brigjeve të Izraelit, janë mbajtur bisedime interesante dhe të rëndësishme për mundësinë e hyrjes së kompanive ruse të energjisë në tregun e Izraelit, këtë herë si partnerë strategjikë. (Livne, 2013, p. 62)

Në fushën ushtarako-industriale, tregtia e mbrojtjes aktualisht është e parëndësishme në vëllim dhe në cilësi. Në vitin 2009, kishte dy marrëveshje për blerjen ruse të UAV-ve izraelite nga Industria e Hapësirës së Izraelit, duke arritur vlerën në 100 milionë dollarë. Kjo blerje u pasua nga një marrëveshje e dytë, në vlerë prej 400 milionë dollarë, në të cilën UAV të disa llojeve të ndryshëm u grumbulluan në Rusi nga 2010-2012... Me blerjen e avionëve të ngjashëm, Rusia shpresonte të mbyllte boshllëkun teknologjik të zbuluar në konflikt. Raporte të tjera përmendën

marrëveshjen si një *quid pro quo* për tolerancën ruse për shitjet e avancuara të armëve në Iran dhe Siri. (Krasna, 2018, p. 15)

Lufta e përgjakshme në Siri, dominimi i Sirisë nga forcat iraniane, turke e ruse, e rritën interesimin për bashkëpunim dhe marrëveshje më të gjerë e më të qartë, në mes të Izraelit dhe Rusisë... Në shtator 2015, Netanyahu takon Putinin në Moskë. Qeveria izraelite thotë se të dy vendet kanë rënë dakord për një mekanizëm për të koordinuar veprimin e tyre ushtarak në Sirinë e shkatërruar nga lufta, në mënyrë që të shmangin "keqkuptimet" midis forcave të tyre. Më 30 shtator, forca ajrore ruse nisi një fushatë të sulmeve ajrore në mbështetje të presidentit sirian Bashar al-Assad, forcat e të cilit po luftojnë kundër rebelëve. Në tetor, Rusia thotë se një linjë telefonike është ngritur me Izraelin për të siguruar që nuk do të ketë përleshje midis forcave të tyre ajrore. (AFP, 2018)

Izraeli ka sulmuar shumë caqe në Siri, duke i pasur në objektiva zonat ku ndodheshin forcat e Hezbollahut nga Libani dhe ato të Iranit. Linja e kuqe e Rusisë u vu në provë në shtator të vitit 2018, kur mbrojtja ajrore siriane e rrëzoi një avion zbulimi rus Il-20 jashtë bregut sirian gjatë një sulmi izraelit, duke vrarë 15 anëtarë të ekuipazhit. Moska fajësoi Izraelin për shkaktimin e incidentit dhe njoftoi se do të hakmerret duke dhuruar raketa S-300 në Siri. Deri atëherë, Rusia kishte kërcënuar në mënyrë të përsëritur për të ofruar sistemin e fuqishëm të mbrojtjes ajrore në Siri, por gjithnjë u pengua që ta bënte këtë në përgjigje të presionit dhe joshjes izraelite (Lund, 2019, p. 30). Në shkurt të vitit 2019, në Moskë u realizua një takim në mes të Presidentit rus Vladimir Putin, dhe Kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu. Në takimin e parë pas incidentit me aeroplanin rus është diskutuar për sistemet anti-raketore S-300 të Rusisë në Siri, pasi ato bateri raketore u transferuan në Siri pas incidentit në aeroplan. (Keinon, 2019)

Sikurse e pamë, raporti i Izraelit me Rusinë, është raport i kushtëzuar nga fuqia e ndikimit rus në Iran, Siri dhe vendet arabe, si dhe interesat reciproke ekonomike. Duke qenë se SHBA është aleati kryesor dhe mbështetësi më i fuqishëm në politikën globale, vendet arabe që promovojnë më shumë “çështjen palestineze”, përpiqen që të shohin te Rusia, një superfuqi tjetër botërore, që i kundërvihet aleatit amerikan të Izraelit.

Rusia merr një rol aktiv në luftën në Siri, duke e mbrojtur hapur presidentin e mbijetuar Bashar Al-Asad. Po ashtu, Rusia bashkë me Iranin dhe Turqinë, janë fuqizuar sidomos me rolin e

zvogëluar të SHBA-së në Siri, dhe aktualisht janë treshja mjaft vendimmarrëse e së ardhmes së Sirisë. Izraeli duke e parë rolin e Rusisë në Siri, Iran e gjetiu në vendet arabe, përpiqet që të ketë bashkëpunim të ngushtë në fushat e sigurisë rajonale, dhe të mos ketë konfrontime me të. Izraelin e shqetëson lidhja dhe mbështetja e Rusisë ndaj Iranit e Sirisë, prandaj raportet e Izraelit dhe Rusisë tashmë së fundi, janë të përcaktuara dhe të kushtëzuara direkt në rolin e Rusisë në Lindjen e Mesme dhe forcat trepalëshe të negociatave për rindërtimin e Sirisë pas luftës së gjatë.

3.5.2. Marrëdhëniet e Izraelit me SHBA-të

Ekziston një perceptim gjeneral se raportet e Izraelit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë raporte përtej çdo vëllazërie dhe besëlidhjeje të përjetshme. Ato përshkruhen përtej diplomacisë së zakonshme bilaterale dhe bëhen sinonim i gati lidhjes “siameze”. Ndonëse mbështetja amerikane për Izraelin është me të vërtetë e pa kontestuar, duke përfshirë miliarda dollarë në ndihmë dhe mbështetjen e besueshme diplomatike... Disa mundësi përfshijnë mbështetje të thellë për Izraelin midis publikut amerikan, ndikimin e lobit pro-izraelit dhe afinitetit amerikan ideologjik me demokracinë më të qëndrueshme të Lindjes së Mesme. (Beauchamp, 2018)

Nëse do të bënim një “vizitë historike” të raporteve Izrael-SHBA që pas Luftës së Dytë Botërore, në raste të caktuara, më të mira do t’i shohim raportet e Izraelit me Rusinë sesa me SHBA-të. Raportet e tyre nuk ishin aq të mira, sikurse mund të paragjykohej pozitivisht aleanca e tyre. Marrëdhëniet Izrael-SHBA kanë qenë jo gjithmonë të njëjta dhe jo gjithmonë në të njëjtat frekuenca diplomatike.

Vendet nuk ishin pothuajse aq afër në dekadat e para të Izraelit. Presioni për koncesionet territoriale u shkallëzua nën pasardhësin e Trumanit, Dwight D. Eisenhower, i cili i vuri veton shitjes së armëve në Izrael. Sekretari i tij i shtetit, John Foster Dulles, e hodhi poshtë Izraelin si “gurin e mullirit rreth qafës sonë” dhe e kërcënoi atë me sanksione gjatë Krizës së Suezit të vitit 1956 (Oren, 2008). Në kontekstin e “Luftës së Ftohtë” në mes të ish-Bashkimit Sovjetik dhe SHBA-së, Izraeli nga kjo e fundit konsiderohej si një mënyrë për ndaljen e zgjerimit të ndikimit sovjetik në Lindjen e Mesme. Interesi i SHBA-së më shumë se prej “gjakut të përbashkët vëllazëror”, sikur mund të paragjykohej shpesh, ishte interes kryesisht gjeopolitik dhe gjeostrategjik. Në vitin 1967,

në një kohë kur marrëdhëniet SHBA-Izrael ishin ende mjaft të kufizuara, izraelitët shkuan vetëm në luftë pasi presidenti Lyndon Johnson i njoftoi ata se ai nuk do të ishte në gjendje të përmbushë angazhimin e mëparshëm të SHBA-ve për të hapur rrethet Tiran, që Egjipti i kishte mbyllur për transportin izraelit. (Freilich, 2017, p. 138)

Shtetet e Bashkuara treguan mbështetjen e parë strategjike të prekshme për Izraelin, kur i ofruan aeroplan të nevojshëm në luftën Yom Kippur të vitit 1973, sepse donte t'i bënte një goditje Egjiptit dhe Bashkimit Sovjetik. Në ditët e para, Shtetet e Bashkuara furnizuan Izraelin me mbi 1,000 tonë pajisje ushtarake dhe tejkaluan sasinë që Bashkimi Sovjetik i kishte dhënë Sirisë dhe Egjiptit bashkë. Këta aeroplanë ndryshuan rrjedhën e luftës dhe çuan në një fitore izraelite, e cila i dha një goditje të madhe forcave egjiptiane të mbështetura nga sovjetikët. (Waxer, 2013, p. 9)

Gjatë viteve të '70-ta të shekullit XX, Izraeli mori përkrahjen e SHBA-së, por nuk e kishte atë mbështetje në luftën me Egjiptin, në vitet e '50-ta të po këtij shekulli. Historia e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy shteteve, por edhe SHBA-Izrael, nuk është histori statike, por dinamike. Ajo i subordinohet rrethanave të gjeopolitikave globale dhe rajonale.

Deri në fund të viteve 1970-ta, një aleancë e pashembullt amerikane-izraelite ishte shfaqur, e vulosur nga ekzistenca e një lobi të fuqishëm pro-izraelit në Washington dhe rritja e ndihmës amerikane për Izraelin me miliarda dollarë. (Oren, 2008, p. 124)

Në librin e tyre "Lobi izraelit dhe Politika e Jashtme e SHBA-ve", autorët John Mearsheimer dhe Stephen Walt argumentojnë se, mbështetja e pakushtëzuar që Shtetet e Bashkuara i japin Izraelit është një arsye qendrore prapa anti amerikanizmit në botë dhe një nga motivet kryesore pas sulmeve terroriste kundër Shteteve të Bashkuara. (Waxer, 2013, p. 43)

Ka pasur edhe një interpretim me rëndësi mbi aleancën speciale në mes të SHBA-së dhe Izraelit, ngjashëm sikurse është thënë edhe për rolin e lobit shqiptaro-amerikan, në nxitjen e Perëndimit, SHBA-së dhe vendeve evropiane, për të intervenuar në shpëtimin e popullatës civile shqiptare nga ish-regjimi jugosllav, duke e bombarduar këtë të fundit edhe ushtarakisht. Ngjashëm thuhet edhe për rolin e lobit hebraik në SHBA: për të qenë të sigurt, shumica e hebrenjve amerikanë ende ndjejnë një lidhje të veçantë me Izraelin dhe grupet lobuese më të mëdha pro-izraelite, siç është Komiteti Amerikano-Izraelit i Punëve të Jashtme (AIPAC), tregojnë

mbështetje të pafundme për politikat e qeverisë aktuale izraelite dhe ka ndikim të konsiderueshëm në Kongres. Por bashkësia hebraike amerikane ndahet gjithnjë e më shumë dhe mbështetja për Izraelin nuk përkthehet automatikisht në mbështetje të politikës së qeverisë izraelite. (Blackwill & Gordon, 2016, p. 19)

Ndarja e grupeve të lobimit nënkupton edhe humbje graduale të ndikimit. Në fund të fundit, pavarësisht këtyre ecejakeve dhe lëkundshmërive të raporteve historike-diplomatike Izrael-SHBA, lidhja e tyre ka qenë dhe mbetet ndër më të veçantat në historinë e marrëdhënieve bilaterale në mes të dy vendeve. Pavarësisht nga arsyet e “marrëdhënieve të veçanta”, mbështetja amerikane për Izraelin është mjaft e gjerë. Ndihma e përgjithshme amerikane për Izraelin, që nga themelimi i tij në vitin 1949 deri në vitin 2016, arrin në rreth 125 miliardë dollarë, një shumë e madhe, duke e bërë Izraelin përfituesin më të madh të ndihmës amerikane në epokën e Luftës së Dytë Botërore. Deri në fund të paketës dhjetëvjeçare të ndihmës ushtarake të rënë dakord, kohët e fundit për vitet 2019-2028, shifra e përgjithshme do të jetë rreth 170 miliardë dollarë. (Freilich, 2017, p. 135)

Përveç parasë, vetoja amerikane në OKB, për të mbrojtur Izraelin edhe atëherë kur shumica e shteteve e kritikojnë atë për “kolonitë hebraike” në Palestinë dhe “përdorimin e tepruar” të forcës ndaj Hamasit dhe popullsisë civile, llogaritet ndër interesat më të rëndësishme të Izraelit nga SHBA. Kjo i jep asaj siguri në shumë pika të terrenit dhe që shumë rezoluta dhe dokumente të OKB-së, të mos e kenë fuqinë e ndryshimit të forcës izraelite në territoret palestineze. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka edhe përplasje në mes të krerëve të SHBA-së dhe Izraelit.

Gjatë Presidencës së Barack Obamas, mospajtimet në mes të palëve ishin evidente. Gjatë vitit 2010 tensionet u përshkallëzuan mes dy aleatëve, me mosmarrëveshje të mprehtë rreth politikës së Obamës mbi Iranin dhe ndërtimet e Izraelit. Shumë izraelitë dhe mbështetës amerikanë të Izraelit fajësuan Presidentin Obama për përçarje, duke argumentuar se ai kërkoi të rindërtonte lidhjet me botën myslimane me shpenzimet e Izraelit... Kështu, në pranverën e vitit 2010, partneriteti amerikan-izraelit u përball me krizën më të keqe në gati 20 vjet. (Malka, 2011, pp. 15-16)

Sikur me Rusinë, sikur me SHBA-në, pika më konfliktuoze diplomatike për Izraelin, është raporti i shteteve të tjera me Iranin. Duke e konsideruar shtetin me shumicë shiite si kërcënim për sigurinë e Izraelit, kjo e bën si temën më të "nxehtë" në përplasjet diplomatike. Nën drejtimin e Presidentit të SHBA-ve Donald Trump, shteti ndërmori veprime. Vendimi i SHBA-së, i shpallur në dhjetor 2017, për të njohur Jerusalemin si kryeqytetin e Izraelit dhe për të lëvizur atje ambasadën e SHBA-ve, ka ushqyer tensionet në mes të SHBA-ve dhe palestinezëve. Përgjithësisht, udhëheqësit izraelitë festuan për ndryshimin, por Kryetari i Organizatës për Çlirimin e Palestinës (PLO) dhe Presidenti i Autoritetit Palestinez (PA) Mahmoud Abbas, kundërshtoi me forcë. (Zanotti, 2019, pp. 8-9)

Pas këtij vendimi, situata në Lindjen e Mesme ka eskaluar në dhunë dhe përleshje të mëdha në mes të forcave izraelite dhe palestinezëve. Shumë shtete evropiane dhe të tjera, po ashtu nuk e kanë mirëpritur vendimin e Trumpit, për të qenë Jerusalemi si kryeqytet i Izraelit, pasi që ky qytet ka domethënie të gjerë simbolike, historike dhe hyjnore, për tri nga religjionet më të mëdha botërore si: hebraizmi, krishterimi dhe islami. Kjo do të thotë se, Jerusalemi është territor që konsiderohet i shenjtë për palestinezët dhe kjo ka çuar në valë të reja të dhunës në mes të izraelitëve dhe palestinezëve, por edhe e ka vështirësuar edhe më tej zgjidhjen e problemit në mes të Izraelit dhe Palestinës, e sidomos e ka bërë edhe më të ndërlikuar, zgjidhjen e kënaqshme të konsideruar prej shumicës së shteteve të botës dhe ato evropiane, si zgjidhje me dy shtete: edhe për izraelitët, edhe për palestinezët.

Por në marrëdhëniet diplomatike Izrael-SHBA, është shënuar progres i paparë, e sidomos pas fërkimeve tensionuese në mes të Kryeministrit izraelit dhe ish-Presidentit amerikan, Barak Obama. Ky i fundit, bashkë me disa shtete evropiane, kishin arritur një marrëveshje historike për armët bërthamore me Iranin. Kjo marrëveshje e kishte zemëruar Izraelin dhe kishte nxitur kritika ndaj Obamës. Mirëpo, Donald Trump, Presidenti aktual amerikan, më 8 maj të vitit 2018 njoftoi së fundmi se Shtetet e Bashkuara po tërhiqen nga Plani i Përbashkët Gjithëpërfshirës i Veprimit (JCPOA) lidhur me programin bërthamor të Iranit, i cili shpesh quhet "Marrëveshja bërthamore e Iranit". Në njoftimin e tërheqjes së 8 majit 2018 dhe memorandumit presidencial të lëshuar të njëjtën ditë, Presidenti i udhëzoi agjencitë federale të fillonin të ndërmarrin hapa për të ri-imponuar sanksionet e vendosura sipas ligjeve të SHBA-së, të cilat u hoqën ose nuk u morën

parasysh me qëllim që Shtetet e Bashkuara të përmbushnin angazhimet në JCPOA. (Mulligan, 2018, p. 1)

Trump është tërhequr nga marrëveshja disapalëshe me Iranin, duke e gëzuar tejmasë Izraelin, por duke e plasaritur raportin diplomatik të SHBA-së me disa shtete të fuqishme evropiane si Gjermania, Franca etj. Trump ka ringjallur një aleancë të SHBA-së me Izraelin, me tri vendime të tij: me njohjen e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit më 6 dhjetor të vitit 2018 (The White House, 2018), me prishjen e marrëveshjes për armët nukleare me Iranin, si dhe me njohjen e sovranitetit të Izraelit mbi rrafshnaltën e Golanit në mars të vitit 2019. (The White House, 2019)

3.6. Marrëdhëniet e Serbisë me SHBA-të dhe Rusinë

3.6.1. Marrëdhëniet e Serbisë me SHBA-të

SHBA-të dhe Serbia kanë krijuar, zhvilluar dhe kultivuar raportet e tyre diplomatike nëpër kohë të ndryshme në disa sfera. Ato kanë zhvilluar aktivitetin diplomatik edhe kur qëndrimet i kanë pasur të kundërta. Sidoqoftë, pas viteve të '90-ta të shekullit të kaluar, Kosova është futur në mes të dy shteteve si pikë mospajtuese. SHBA-të mbështesin fuqishëm shtetin e Kosovës, i cili u shkëput nga Serbia në vitin 1999, ndërkaq në vitin 2008 shpalli pavarësinë nga Serbia.

Në mes të SHBA-ve dhe Serbisë asnjëherë nuk kanë ekzistuar aleanca strategjike, edhe pse ato kanë mbajtur të njëjtën anë në Luftën e Dytë Botërore. Pas Luftës së Dytë Botërore u krijua Jugosllavia e re Socialiste. Edhe pse SHBA-të nuk kanë zhvilluar marrëdhënie politike dhe kanë shkatërruar bashkëpunimin tregtar me shtetet komuniste, marrëdhëniet midis Jugosllavisë Socialiste dhe SHBA-ve ishin të mira, posaçërisht pas vitit 1948, pas prishjes së marrëdhënieve të Jugosllavisë me vendet e Bllokut Lindor. Jugosllavia Socialiste ishte vendi i vetëm socialist që kishte marrë ndihmë ekonomike nga SHBA-të në formën e financimit të Fondit Marshall. Gjithashtu Jugosllavia dhe Polonia ishin të vetmet vende socialiste që kishin trajtim MFN në marrëdhëniet tregtare me SHBA-të. Baza ligjore për këto marrëdhënie tregtare ishte marrëveshja tregtare të cilën Serbia e përfundoi me SHBA në 1882 dhe që është ndryshuar pak në vitin 1946. (Bjelic, 2007, p. 8)

Politika jostabile e Jugosllavisë ka reflektuar edhe në marrëdhëniet e saj me SHBA-të. Ato u përkeqësuan pas Konferencës së Beogradit të vendeve të painkuadruara në shtator të vitit 1961, kur Tito nuk e kritikoi shkeljen sovjetike të moratoriumit mbi testimet nukleare. Në këtë atmosferë, Kongresi vendosi të tërheqë trajtimin tarifor të kombit më të favorizuar (MFN) nga Jugosllavia. (Vucetic, 2008, p. 277)

Sidoqoftë, në prill të vitit 1963, Tito u përpoq të siguronte ambasadorin e SHBA-së George F. Kennan që Jugosllavia kishte politikë të pavarur midis Lindjes dhe Perëndimit. Në të njëjtin muaj, Tito i shkroi një letër Presidentit Kennedy. Pas përgjigjes së Kenned-it, Sekretari Dean Rusk erdhi në një vizitë të shkurtër në Jugosllavi në maj të vitit 1963, duke pohuar deklaratën e të dyja palëve që ata kishin nevojë për të forcuar marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shteteve të Bashkuara, gjë që rezultoi me vizitën e Titos te Kennedy në tetor 1963. (Vucetic, 2008, p. 277)

Përmirësimi i raporteve politike në mes të Jugosllavisë dhe SHBA-ve solli zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike. Bashkëpunimi tregtar ishte shumë i zhvilluar sidomos në periudhën e viteve 1980, kur tregtia e mallrave në mes të Jugosllavisë dhe SHBA-së kaloi nivelin prej 1 miliardë dollarësh. (Bjelic, 2007, pp. 8-9)

Marrëdhëniet diplomatike në mes të SHBA-ve dhe RSFJ-së u cenuan në vitin 1992. Më 21 maj 1992, SHBA-të njoftuan se nuk do ta njohin Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ) - si një shtet pasardhës i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). RFJ-ja ishte e përbërë nga Republikat e Serbisë dhe Malit të Zi. Ambasadori amerikan Warren Zimmerman u tërhoq nga Beogradi, por misioni vazhdoi me një staf nën autoritetin e një të Ngarkuari me Punë të Përkohshme. Qeveria e Shteteve të Bashkuara mori qëndrimin se regjimi qeverisës i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë së vitit 1946, pushoi së ekzistuari dhe se asnjë shtet nuk përfaqësonte vazhdimin e vetëm të RSFJ-së. (United States Department of State, n.d.)

Tregtia me SHBA-të ishte e prishur gjatë viteve 1990 për shkak të sanksioneve kundër regjimit të Millosheviçit - si pjesë e luftës në Bosnje dhe Hercegovinë (e hequr në vitin 1996), dhe sanksionet të cilat u ri-imponuan si pjesë e aksionit të drejtuar nga NATO kundër Serbisë në vitin 1999. (Hartwell & Sidlo, 2017, p. 27)

Në vitin 1999, Shtetet e Bashkuara ndërprejnë marrëdhëniet me Beogradin kur Serbia zhvilloi një fushatë spastrimi etnik dhe deportimit të popullatës së saj etnike shqiptare, kryesisht

në Krahinën e Kosovës. Si përgjigje, NATO zhvilloi një fushatë bombardimi kundër Serbisë që zgjati 78 ditë dhe përfundoi me krijimin e UNMIK-ut dhe KFOR-it për të stabilizuar rajonin dhe për të mundësuar kthimin e personave të zhvendosur. (Morelli & Garding, 2018, p. 14)

Amerika ka kohë që është e angazhuar për zhvillimin ekonomik dhe demokratik në Serbi dhe rajonin më të gjerë të Ballkanit. Në vitet 2001 - 2015, Shtetet e Bashkuara investuan më shumë se 728 milionë dollarë për të nxitur rritjen ekonomike, për të forcuar sistemin e drejtësisë dhe për të promovuar qeverisjen e mirë në Serbi. Gjithashtu që nga viti 2001, bizneset e SHBA-së kanë investuar rreth 3.8 miliardë dollarë në Serbi, duke krijuar ose ruajtur mbi 16,000 vende pune serbe. (The White House, 2016)

Që nga tranzicioni i Serbisë në vitin 2000, Shtetet e Bashkuara kanë vlerësuar se një Serbi e qëndrueshme dhe demokratike do të ishte thelbësore për stabilitet në rajonin e Ballkanit. Lidhjet SHBA-Serbi ishin të tensionuara kur Shtetet e Bashkuara e njohën pavarësinë e Kosovës në vitin 2008 dhe mbetën një nga mbështetësit më të fuqishëm të Kosovës. Megjithatë Shtetet e Bashkuara kanë ofruar mundësinë “të bien dakord që të mos pajtohen” me Serbinë mbi Kosovën, çështja mund të vazhdojë të ndikojë marrëdhëniet, veçanërisht pasi Shtetet e Bashkuara në përgjithësi mbeten mbështetësit më me influencë ndërkombëtare për Kosovën. (Morelli & Garding, 2018, p. 14)

Shtetet e Bashkuara vlerësojnë kontributin e Serbisë në përpjekjet globale të ruajtjes së paqes. Sipas programit të Financimit të Ushtrisë së Huaj (FMF), i cili ka siguruar më shumë se 8.6 milionë dollarë ndihmë sigurie për modernizimin e mbrojtjes dhe trajnimeve për Serbinë që nga viti 2011, Shtetet e Bashkuara kanë shpërndarë në total 40 makina “Humvees” për të mbështetur pjesëmarrjen e Serbisë në operacionet e OKB-së anembanë botës. (Bureau of European and Euroasian Affairs , 2018)

Në qershor të vitit 2017, Presidenti Vuçiç vizitoi Washingtonin dhe u takua me Zëvendëspresidentin Mike Pence. Disa anëtarë të Kongresit shprehën shqetësimin lidhur me takimin për shkak të marrëdhënieve të Serbisë me Rusinë, por Zëvendëspresidenti Pence në takim me Vuçiçin thuhet se ngriti çështjen e Rusisë dhe të Qendrës “Humanitare” të Rusisë në Nish. Marrëdhëniet përsëri u goditën nga një pengesë e lehtë në tetor të vitit 2017, kur ambasadori i SHBA-ve në Beograd u akuzua, kryesisht nga shtypi proqeveritar, për ndërhyrje në

punët e brendshme të Serbisë, pasi ai kritikoi Ministrin e Mbrojtjes Aleksandar Vulin, për shprehje të mbështetjes për kriminelët e dënuar të luftës, duke sugjeruar se komentet e tilla mund të dëmtojnë përpjekjet për të përmirësuar imazhin e Serbisë në Shtetet e Bashkuara. (Morelli & Garding, 2018, p. 14)

Pas rëndësisë që ka raporti i Serbisë me SHBA-në, padyshim se raport tjetër shumë relevant mbetet ai në mes të Serbisë dhe Rusisë.

3.6.2. Marrëdhëniet e Serbisë me Rusinë

Rusia është aleati dhe mbështetësi kryesor historik i Serbisë. Bashkëpunimi i të dy vendeve daton herët, ndërkaq, Rusia është faktor që ndikon po ashtu në rrugën evropiane të Serbisë. Sidoqoftë, gjatë historisë Serbia dhe Rusia kanë pasur luhatjet e tyre në marrëdhëniet ndërshtetërore, veçanërisht në periudhën e ish RSFJ-së. Interesat strategjike lidhen me vendndodhjen gjeopolitike të vendeve të Ballkanit, në veçanti Serbisë.

Rusia ndjehet si mbrojtëse e natyrshme e vendeve të Ballkanit që ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane në shekullin XIX. Me një fjalë, përfshirja e Rusisë në Ballkan është reflektuar në statusin e saj të një fuqie të madhe botërore dhe në tendencën e saj për të lavdëruar epërsinë e saj kombëtare, kulturore dhe etnike. (Stojanova, 2016, p. 81)

Dashuria e Rusisë dhe Serbisë mori një goditje gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur çetnikët mbretërorë përfundimisht u bashkuan me Gjermaninë naziste dhe partizanët e Titos fituan mbështetjen e Aleatëve (Globalsecurity, n.d.). Në fund të Luftës së Dytë Botërore, më saktësisht në fund të vitit 1944, Ushtria e Kuqe kishte kontribuar shumë në fitoren e partizanëve jugosllavë kundër forcave fashiste. Marrëdhëniet diplomatike midis BRSS-së dhe Serbisë u krijuan më 24 qershor 1940 (Aghayev, 2017, pp. 5-6). Kur Tito prishi raportet me Kominformin/Stalinin në vitin 1948, simpatizantët e Kominformit, kryesisht serbë, i burgosi në burgun famëkeq të Goli Otokut në Detin Adriatik. (Globalsecurity, n.d.)

Pas vdekjes së Stalinit ndodhi një pajtim sovjetiko-jugosllav, por ishte i shkurtër pasi që filluan mosmarrëveshjet e reja në vitin 1958, pasi zyrtarët sovjetikë përsëri u përpoqën të ndërhynin në vendimet e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Përveç kësaj, çdo përpjekje për të

reformuar Jugosllavinë nga BRSS-ja u shoqërua nga një pikëpamje negative, në kuptimin që ata shkaktuan ankth dhe dyshim në dobinë e tyre. Në veçanti, ata e gjykuan ashpër reformën ekonomike në vitin 1965. Sovjetikët ishin kundër të gjitha reformave në Jugosllavi, sepse mendonin se çdo reformë si dhe demokratizim, çonin Jugosllavinë “në liberalizëm dhe Perëndim”, prandaj duhej parandaluar. (Aghayev, 2017, p. 6)

Udhëheqësi komunist i Jugosllavisë me veprimet e tij vazhdoi goditjen e raporteve me BRSS-në. Pastrimi i parë i Titos në rrethin e tij të brendshëm partizan ishte ministri serb i Brendshëm Aleksandar Ranković - i akuzuar për stalinizëm në vitin 1966.

Serbët e perceptojnë aktin e ardhshëm të anti-serbizmit të Titos në projektin e kushtetutës së vitit 1974, i cili i dha statusin e provincës autonome Vojvodinës dhe Kosovës. (Globalsecurity, n.d.)

Një histori e gjatë e transferimeve të armëve gjatë Luftës së Ftohtë u ndërpre nga prishja e marrëdhënieve të Titos me Moskën, dhe Jugosllavia pa vetëm dy marrëveshje të mëdha të përfunduara gjatë viteve 1970 dhe 1980. Ishte urdhër i madh në vitin 1974 që solli raketat anti-tank dhe një tjetër relativisht më i vogël në vitin 1980, për raketa portative sipërfaqësore në ajër (SAM)... (Hartwell & Sidlo, 2017, p. 40)

Pas rreth 50 vjetësh raporte të turbullta, palët kishin gatishmërinë e lartë për bashkëpunim, por mundësitë nuk ekzistonin. Marrëdhënia e Rosisë me Serbinë u forcua në vitet 1990, kur Moska përkrahu herë pas here Slobodan Millosheviçin gjatë luftërave të shpërbërjes jugosllave (Morelli & Garding, 2018, p. 12). Humbja e linjës së ashpër sovjetike dhe pavarësia pasuese e Rosisë hapën një periudhë të influencës së dobët ruse në rajon.

Susan Woodward dhe të tjerë kanë shpjeguar veprimet e Rosisë gjatë kësaj periudhe, duke reflektuar nevojën e vendit për të hyrë në forume kyçe ekonomike si G-7 dhe për të fituar ndihma financiare shumë të nevojshme. Të dobët dhe të varur nga Perëndimi për ndihmë dhe vullnet të mirë, Rusia mbështeti rezolutat e Këshillit të Sigurimit që kufizonin rrjedhën e armëve në rajon, si dhe ata që njohën pavarësinë e Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës. (Konitzer, 2010, p. 10)

Lidhjet politike dhe ekonomike midis Moskës dhe Beogradit u forcuan pas shpërbërjes së Jugosllavisë, veçanërisht gjatë fushatës së NATO-s të vitit 1999 kundër veprimeve të Serbisë në Kosovë, të cilat Moska i kundërshtoi. (Morelli & Garding, 2018, p. 12)

Serbia ka zënë një vend të posaçëm në politikën ruse. Duke ndikuar në Beograd, Moska synon të sigurojë vetë mjetet e kontrollit të situatës në rajon. Njëkohësisht, Moska ka zhvilluar kontakte me pakicat serbe në mënyrë që të ndikojë drejtpërdrejtë në zhvillimet në Bosnjë e Hercegovinë, Mal të Zi dhe Kosovë, kryesisht duke ushqyer ambiciet separatiste. Intensifikimi i veprimeve të Rusisë ndaj rajonit daton që nga viti 2008. Ishte koha kur Prishtina shpalli pavarësinë dhe Rusia, e cila mbështeti Serbinë dhe nuk njohu shkëputjen e Kosovës, mori kontrollin mbi kompaninë serbe të karburantit, NIS. (Szpala, 2014, p. 2)

Një tjetër raport është edhe rasti me ndikimin ushtarak rus në Ballkan, duke përfshirë Serbinë, e cili në vitin 2011 themeloi një Qendër Humanitare Rajonale në Nish, së bashku me Rusinë. Kjo qendër u krijua me synimin për të lejuar një reagim të shpejtë në rast të një fatkeqësie natyrore ose të ndonjë emergjence tjetër humanitare. Të dy qeveritë kanë hedhur poshtë akuzat se objekti ka për qëllim të hapë rrugën për krijimin e një baze ushtarake. (Stojanova, 2016, p. 84)

Instrumentet ekonomike të presionit të aplikuar nga Moska drejt Serbisë përfshijnë dominimin rus në sektorin e karburantit dhe gazit. Në vitin 2008 Gazprom Rus bleu kompaninë serbe NIS, duke fituar kështu kontroll të plotë mbi sektorin e përpunimit të naftës (rafineritë e Pançevës dhe Novi Sadit) dhe një pozicion të fortë në rrjetin e shpërndarjes (në vitin 2012 kompania kishte një pjesëmarrje prej 82% në tregun e karburanteve dhe 38% në tregun e shitjes me pakicë). (Szpala, 2014, p. 2)

Në vitin 2016, Rusia ishte investitori i 9-të më i madh në Serbi, me 81.2 milionë euro investime, një rënie e madhe nga viti 2010, kur Rusia ishte investitori më i madh në vend (në 216 milionë euro). Ndërsa rezultatet nga gjysma e parë e vitit 2017 janë paksa inkurajuese (Banka Kombëtare e Serbisë vlerëson hyrjet në 46.9 milionë euro, një ritëm më të shpejtë se 2016 dhe mjaftueshëm për të vendosur Rusinë në numrin 6 të të gjithë investitorëve). (Hartwell & Sidlo, 2017, p. 34)

Të dy vendet aktivitetin e tyre politik e zhvillojnë në mënyrë të rregullt. Më 24 maj 2013, në Soçi, Presidentët Vladimir Putin dhe Tomislav Nikoliç, nënshkruan deklaratën mbi

partneritetin strategjik ndërmjet Rusisë dhe Serbisë. Për momentin, midis dy shteteve ekziston një regjim pa viza... Të dy vendet kanë kryer ushtrime të përbashkëta ushtarake. Në vitin 2016, Rusia transferoi në Serbi si dhuratë tridhjetë tanke T-72C dhe tridhjetë BRDM-2 me të gjitha armët. (Aghayev, 2017, p. 7)

Moska thuhet se ofron mbështetje financiare dhe politike për disa parti serbe. Në vitin 2016, Partia Demokratike e Serbisë, Lëvizja Dveri dhe Partia Popullore Serbe nënshkruan një deklaratë me partinë e Rusisë, Rusia e Bashkuar, e cila shpreh mbështetjen për një zonë ushtarake neutrale në Ballkan. (Morelli & Garding, 2018, p. 12)

Në fillim të vitit 2017, Presidenti rus Putin dhe Kryeministri i atëhershëm serb Vuçiç, ranë dakord për transferimin e gjashtë avionëve luftarakë MiG-29, 30 tanke dhe 30 automjete të blinduara në Serbi... Përveç kësaj, raportet e medias sugjeruan se Serbia ishte e interesuar në blerjen e një sistemi mbrojtës ajror rus dhe krijimin e një objekti për riparimin e helikopterëve rusë MIL, të cilën disa analistë e krahasuan me “hapjen e një baze ushtarake ruse në territorin e Serbisë”. Blerjet e armëve të Serbisë kanë potencial për të përkeqësuar tensionet me fqinjët si Kosova dhe Kroacia. (Morelli & Garding, 2018, p. 13)

Duhet të theksojmë se këto dy shtete viteve të kaluara kanë patur edhe tensione në mes vete, por lidhja e tyre është aq e fuqishme dhe e thellë sa që ato nuk arriti t’i përçajë asnjë çështje, madje as përshpejtimi i bisedimeve të pranimit në BE, as kriza në rritje në Ukrainë (duke përfshirë Krimenë) apo dështimi i tubacionit të propozuar të Rrjedhës së Jugut, nuk ka arritur të prishë marrëdhëniet midis Serbisë dhe Rusisë. (Hartwell & Sidlo, 2017, p. 6)

Një raport i rëndësishëm për të shtjelluar në këtë studim të aspektit komparativ Kosovë-Palestinë, është edhe qasja e ndryshme që kanë shtetet e Amerikës Jugore ndaj Kosovës dhe Palestinës.

3.7. Qasja e shteteve të Amerikës Latine ndaj Kosovës dhe Palestinës

Numri i shteteve të Amerikës Latine apo Jugore që nuk e kanë njohur Kosovën është shumë më i madh në krahasim me numrin e atyre që nuk e kanë njohur Palestinën. Shtetet kryesore të Amerikës Latine që nuk e kanë njohur Kosovën janë: Argjentina, Brazili, Kili, Kolumbia, Kuba, Meksiko, Paraguaji, Uruguaji dhe Venezuela. Ndërkaq, disa nga shtetet e Amerikës Latine që nuk e kanë njohur Palestinën janë: Kolumbia, Meksiko dhe të tjera.

Amerika Latine ka qenë më e hapur ndaj Palestinës dhe më e mbyllur ndaj Kosovës. Në parim, duket se raportet e shteteve të Amerikës Latine me SHBA-në, e kanë përcaktuar edhe raportin me Kosovën apo Palestinën. SHBA-të janë konsideruar si “sponzoruesi” kryesor i pavarësisë së Kosovës dhe ky vlerësim është lobuar si i tillë edhe nga Serbia në vendet e Amerikës Latine. Sidoqoftë, disa arsye kanë ndikuar në njohjen e pavarësisë së Kosovës nga disa shtete të Amerikës Latine. Një nga to është aleanca me Shtetet e Bashkuara, e cila u demonstrua nga fakti se Peruja (22 Shkurt 2008) dhe Kolumbia (4 gusht 2008), e cila negocioi nënshkrimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë me Shtetet e Bashkuara, ka marrë ndihmë të konsiderueshme nga SHBA-të në luftën kundër drogës, prandaj, pranuan pavarësinë e Kosovës në vitin 2008. (Kos-Stanišić & Luša, 2018)

Amerika Latine shpesh është përshkruar edhe si grumbull shtetesh autoritariste, të cilat janë në aleancë më të fortë me Rusinë, sesa me SHBA-në, si promovuese e demokracisë dhe sistemeve ekonomike kapitaliste. Shumica e shteteve të Amerikës Latine kanë njohur Palestinën, për dallim nga numri më i vogël i njohjeve për Kosovën, duke u shpjeguar shpesh me raportet që kanë këto shtete latine me SHBA-në. Gjersa SHBA-të janë vlerësuar më shumë si pro Izraelite dhe kundër Palestinës, atëherë pozicionimi i shteteve të Amerikës Latine ndaj Palestinës, do të lexohej edhe si kundërshtim ndaj politikës së jashtme amerikane në çështjet globale dhe ato të Lindjes së Mesme.

Argjentina, Brazili dhe Uruguai kur njohën Palestinën, zhgënjyen dhe habitën SHBA-të dhe Izraelin. Së pari, Amerika Latine vazhdon të lehtësohet nga sfera e ndikimit të Washingtonit, me Bolivinë dhe Venezuelën, duke ndjekur një marrëdhënie në rritje me Iranin; së dyti, drejtimi i politikave të njohjes së Amerikës Latine nuk është për t’u befasuar, pasi Amerika Latine ka një

rritje në marrëdhëniet tregtare dhe politike me botën myslimane, prandaj njohja e Palestinës sa është gjest politik po aq është një masë ekonomike që synon t'i kënaqë liderët islamikë, në mënyrë që të forcohen marrëdhëniet tregtare. (COHA, 2010)

Impakti ekonomik është një faktor tjetër i rëndësishëm, por jo kryesor që ka motivuar këto shtete të njohin Palestinën.

Në një artikull të gushtit të vitit 2010, Rrjeti Global Arab citon Ministrin Egjiptian të Tregtisë dhe Industrisë, Rasheed Mohamed Rasheed, duke pohuar se Kajro dëshiron të forcojë lidhjet e saj me Argjentinën, veçanërisht në fushën e mjekësisë, tekstilit dhe IT-së. Artikulli shpjegon se “vëllimi i këmbimit tregtar mes Egjiptit dhe Argjentinës u rrit nga 616 milionë dollarë në 2007 në 1.2 miliardë dollarë në 2008, por u zvogëluar në 643 milionë dollarë në 2009 për shkak të krizës financiare”. Argjentina është partneri i dytë më i madh tregtar i Egjiptit në Amerikën Latine. (COHA, 2010)

Në mosnjohjen e Kosovës nga shtetet kryesore të Amerikës Latine, si nga Argjentina, Brazili, Meksika dhe shtetet tjera ka disa arsye. Në rastin e Argjentinës, theksohet se parimi i vetëvendosjes dhe shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës pa një marrëveshje me Serbinë hap një precedent të rrezikshëm. Gazeta e përditshme argjentinase Clarin argumenton se qeveria ka marrë një vendim për të mos e njohur Kosovën me frikën se mund të rrezikojë negociatat me Mbretërinë e Bashkuar dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi Ishujt Falkland (Kos-Stanišić & Luša, 2018). Nëse krahasojmë interesat e Argjentinës në raport me aleatët e Kosovës siç janë SHBA-të dhe vendet e Evropës Perëndimore, ndoshta do të kishte interesa më të mëdha sesa ato me shtetet arabe në rastin e njohjes së Palestinës. Çështjet e orientimeve dhe politikave ndërkombëtare të shtetit dhe problemi i ishujve përcaktojnë edhe qëndrimin momental për mosnjohjen e Kosovës.

Në një intervistë të realizuar nga Demokraci Plus (D+), për Gazetën Online Insajderi të publikuar në vitin 2017, me Athur Nogueiras, i cili është diplomat në ambasadën e Brazilit në Hanoi të Vietnamit dhe autor i librit ‘Kôssovo: Província ou País?’ (Kosova: Provincë apo Shtet?), Nogueiras, pohon se vendimi i mosnjohjes së Deklaratës së Njëanshme të Pavarësisë së Kosovës nuk është marrë me synim që të shkojë kundër askujt. Ky është një vendim i bazuar në normat e Ligjit Ndërkombëtar të Publikut [sic], mbi rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, në vetë

Kartën e OKB-së dhe në fund edhe në traditat dhe vlerat e politikës së jashtme të Brazilit. Mosnjohja e shpalljes së pavarësisë është vendimi ynë sovran dhe i njëanshëm: asnjë shtet nuk ka kërkuar nga Brazili që të deklarojë këtë apo atë qëndrim dhe vendimi i Brazilit mori në konsideratë vetëm parametrat e përmendura. (Gorczeski, 2017)

Frika se ngjarjet në Ballkanin e largët mund të hapnin “Kutinë e Pandorës” dhe se separatistët e Amerikës Latine mund të kërkojnë “rastin e Kosovës” dhe, me mbështetjen e SHBA, të arrinin ndarjen, u vërtetuan në rastin e Bolivisë. Për shkak të kundërshtimit ndaj politikës amerikane, lidhja me valën e majtë rozë, si dhe gjendja e brendshme politike në lidhje me përpjekjet për t'u shkëputur nga katër provincat e Medio Luna, Bolivia, udhëhequr nga Presidenti Evo Morales, nuk e njohën pavarësinë e Kosovës. (Kos-Stanišić & Luša, 2018)

Pos SHBA-ve në rastin e Kosovës rëndësi jo të vogël ka edhe mosnjohja nga Spanja. Spanja si ish-vend kolonizator dhe i afërt kulturalisht ka ndikuar në pengimin e njohjes së Kosovës nga vendet e Amerikës Latine. Në fillim të tetorit 2008, disa medie serbe (si ditorja Dnevnik e Novi Sadit, agjencia zyrtare e lajmeve Tanjug dhe stacioni liberal televiziv B92) zbuluan se diplomatët spanjollë kishin marrë udhëzime me një listë argumentesh, në mënyrë që t'i bindnin partnerët në Afrikë, në Amerikën Latine dhe në botën arabe që të mos e njohnin Kosovën. Misioni i Spanjës në KB ishte posaçërisht aktiv dhe po ashtu ushtronte trysni të drejtpërdrejtë në qeveritë mike (dhe relativisht të varura), duke përfshirë Andorrën dhe disa republika të Amerikës Qendrore. (Fanés, 2011, p. 18)

Nga frika e problemeve të brendshme me Katalonjën dhe baskët, Spanja rastin e Kosovës e avokon si shkelje të së drejtës ndërkombëtare në vendet ku ka impakt, duke përfshirë edhe shtetet e Amerikës Latine.

Në tërë këtë proces Serbia si trashëgimtare e rrjetit diplomatik të ish-Jugosllavisë nuk ka ndaluar përpjekjet për të penguar njohjen e Kosovës nga shtetet e Amerikës Latine. Serbia ka bërë sidomos lobim në Kubë, si një shtet të rëndësishëm për të ushtruar ndikimin dhe autoritetin në shtetet e tjera të Amerikës Latine, për ta kundërshtuar njohjen e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. Ka pasur edhe deklarime mediatike të zyrtarëve qeveritarë serbë pas takimeve me zyrtarë të Kubës, ku i janë falënderuar këtij shteti, që nuk po e njohin Kosovën dhe po ashtu u kanë bërë thirrje që të bëjnë lobim kundër Kosovës edhe në shtetet e tjera të Amerikës Latine

dhe Karaibe. *"Ne e vlerësojmë shumë politikën parimore të Kubës në drejtim të pavarësisë së shpallur në mënyrë të njëanshme të të ashtuquajturës 'Kosovë', si dhe përpjekjet diplomatike të atij vendi që synon njohjen nga vendet e tjera të Amerikës Latine dhe Karaibeve e të cilat po i rezistojnë presionit për të njohur 'Kosovën' si një shtet i pavarur"*, theksoi Aleksandar Vulin, Ministër i Mbrojtës së Serbisë. (B92, 2018)

Element me rëndësi për njohje të shteteve të reja nuk mund të mohohet se është edhe ai kulturor, për të cilin ndikim do të shpjegojmë shkurtimisht më poshtë.

3.8. Efekti i kulturës dhe zhvillimeve globale në njohje të shteteve

Pavarësisht se ka interpretime të lidhura edhe me karakter religjioz në raportet diplomatike, në praktikën ndërkombëtare dhe globale, efektet e religjionit janë anësore, sesa direkte. Rrethanat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk ishin të llojit të veçantë me ngjarjet që ndodhën në vitet e '90-ta në fund të shekullit XX, sidomos në Jugosllavi.

Lufta në vendet ballkanike, kur shtetet si Serbia arsyetonin dhunën ndaj pakicave etnike, merrte edhe komente me natyrë religjioze, por kjo ishte vetëm shpërfaqje retorike, sesa në realitetin politik e faktik. Ndërhyrja e armatosur nga Perëndimi liberal, nën udhëheqjen amerikane, u vlerësua si ndërhyrje humanitare për ndaljen e regjimit të Millosheviçit. Efektet e luftës në Jugosllavi u ndjenë në tërë zonën ballkanike, veçanërisht në Kosovë, që në vitin 1999 u mbrojt nëpërmjet një veprimi ushtarak të NATO-s. Perspektivën e një paqeje më të qëndrueshme e hapi rënia e regjimit të Millosheviçit në Beograd, që u mund nga kandidati Koshtunica në zgjedhjet e vitit 2000; element i rëndësishëm që ndikoi në këtë paqe ishte edhe dorëzimi i Milosheviçit në Gjykatën e Hagës me akuzën e krimeve kundër njerëzimit. (Grimberg, 2005, p. 259)

Sionistë ekstremë fetarë në Izrael gjithnjë e më shumë e shohin veten si kujdestarë dhe përcaktues të mënyrës se si duhet të jetë shteti hebre dhe janë shumë të rreptë kur bëhet fjalë për ndonjë lëshim për arabët. Nga ana tjetër, grupet islamike në Palestinë dhe gjetkë në botën islamike përkrahin domosdoshmërinë e çlirimit të territoreve dhe vendeve "të shenjta" për arsye fetare dhe predikojnë dhunë dhe urrejtje kundër Izraelit dhe popullit hebre. (Mostafa, 2018)

Këto teori dhe veprime transmetohen nëpër aleatë dhe pavarësisht impaktit dhe interesave mund të ndajnë qëndrimet e shteteve për qasjen e zgjidhjes së konfliktit dhe të njohjes ndërkombëtare.

Ndikimi i religjionit apo “civilizimit sllav” kundrejt një civilizimi tjetër, mund të shihej vetëm si retorikë politike e diplomatike, e jo gjetje e shkaqeve të vërteta të konflikteve dhe luftërave që çuan në vdekjen e aq shumë civilëve. Edhe në raport me Kosovën si “djep i Serbisë hyjnore”, edhe me Palestinën si “djep hyjnor i tri civilizimeve”, ekzistojnë forca reale gjeopolitike dhe rajonale, por për shumicën e opinionit të gjerë publik, roli i religjionit sërish bëhet me rëndësi. Prandaj, në këtë kontekst, elementi kulturor apo “civilizimi” ka efekte edhe në interpretimet mbi refuzimin e njohjes apo mosnjohjes ndërkombëtare të një shteti, pavarësisht se kemi aq shumë raste të cilat e dëshmojnë për rolin krejt periferik të religjionit në njohjen apo mosnjohjen e një shteti.

Njohjet në arenën ndërkombëtare u bënë shpesh, edhe si mjete diplomatike për të treguar raportin e forcave rivale e globale. Njohjet ndërkombëtare dhe refuzimet kategorike të njohjeve nuk mund të shkëputen nga rrethanat e menjëhershme të pas - Luftës së Dytë Botërore, por edhe një momenti kthese historike: rënia e ish-Bashkimit Sovjetik dhe më vonë, edhe sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA.

Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, roli i SHBA-së dhe NATO-s ishte shumë i madh në rrjedhat globale. Por nuk zgjati shumë, pasi që po ndryshonte sërish raporti i forcave globale dhe po hynim në një botë që shpesh është quajtur edhe “botë pasamerikane”. Dhjetëvjeçari i fundit i mijëvjeçarit të dytë ishte problematik pasi të dy këta aktorë i matën forcat në disa sprova që dhanë rezultate jo fort të kënaqshme.

Në Ballkan iu vu fre destabilizimit të zonës, duke i dhënë NATO-s një rol strategjik, ndërsa Bashkimit Evropian një rol politik. Në konfliktin izraelo-palestinez u luajt karta e ndërmjetësimit ndikues të SHBA-ve, që të mund të hapej një mundësi për paqe dhe siguri, por rezultatet qenë të pakta. (Grimberg, 2005, p. 260)

Pas Luftës së Dytë Botërore (1945), pas shembjes së Murit të Berlinit (1989), momenti më vendimtar për refuzimet kategorike apo njohjet e reja ndërkombëtare të shteteve të sapokrijuara – ndonëse më rrallë, ishte sulmi terrorist në Kullat Binjake të Nju Jorkut në SHBA. Duke qenë se

terrorizmi ndërkombëtar po përfaqësohej nga grupe shtetërore dhe më shumë jashtështetërore, me simbolika, mesazhe e retorikë edhe në emër të islamit dhe librit të shenjtë të myslimanëve, Kuranit, elementi fetar shpesh përzihej në analizat gjeopolitike, duke u ripërtërirë sërish doktrina e Samuel Hantingtonit mbi “përplasjen e qytetërimeve”.

Tensioni ndërkombëtar arriti nivele të larta: terrorizmi po merrte një përmasë globale, i ushqyer nga ideologjia e fundamentalizmit islamik, ku ekzistonin grupe dhe përbërës të ndryshëm. Siç ka argumentuar Robert Pape në vitin 2005, terrorizmi i ushtruar nëpërmjet sulmeve vetëvrasëse ka ardhur në rritje sepse grupe të ndryshme kanë vërejtur se ai ka dhënë rezultate nga pikëpamja gjeopolitike dhe strategjike, duke rezultuar me një ndër taktikat më pak të kushtueshme të përdorura ndonjëherë nga grupet terroriste dhe ose guerile. Gjatë më shumë se dy dekadave të fundit edhe grupet nacionaliste palestineze – si ato me natyrë laike ashtu dhe ato me natyrë fetare – e kanë përdorur vetëvrasjen si instrument strategjik në përpjekje për t’iu kundërvënë dhunës shtetërore të Izraelit, që është përshkallëzuar sidomos gjatë dhe pas viteve 2000. (Hide, 2014, p. 108)

Përgjegjësia në raport me grupet terroriste si “grupe jashtëinstitucionale” bëri që sovraniteti dhe integriteti territorial i shteteve të vihet në diskutim. Këto grupe pavarësisht se nuk ishin nën kontrollin direkt të një shteti, ato vepronin në një shtet të pranuar ndërkombëtarisht, të njohur nga shtetet dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara etj. SHBA-të dhe aleatët e saj sulmuan shtetet që strehonin terroristët, kështu duke e cenuar sovranitetin dhe integritetin territorial të tyre. Ndërhyrjet u legjitimuan nën siglën e “sigurisë globale” dhe “luftës kundër terrorizmit”.

Njohjet dhe mosnjohjet në kontekst të zhvillimeve të reja globale u bënë përplasje e superfuqive globale dhe rajonale për të treguar rolin e tyre në botë. Rusia në një anë kundërshtonte në mënyrë aktive pavarësinë e Kosovës, duke marrë pozicione se nuk do ta njihte kurrë Kosovën, ndërsa SHBA po ashtu kritikonte për ekspansionin rus drejt Ukrainës dhe Gjeorgjisë. Refuzimet kategorike të njohjeve për Kosovën, u bënë nga Rusia, Kina etj., edhe si dy shtete në marrëdhënie rivale globale, pasi që Kosova renditet në anën e influencave të SHBA-së. Por kritikën amerikane ndaj Rusisë mbi aneksimin e Krimesë, luftën me Ukrainën dhe Gjeorgjinë, u shpeshtuan po ashtu, bashkë me aleatët e tjerë të Perëndimit.

Kina e Rusia në kundërshtimin e Pavarësisë së Kosovës thirreshin edhe në të drejtën ndërkombëtare dhe dënimin e aktit të njëanshëm të Kosovës. Zyrtarët shtetërorë Kinez pohojnë se akti i njëanshëm i Kosovës mund të prodhojë një sërë rezultatesh që do të çojnë në një ndikim serioz negativ për paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit dhe në realizimin e ndërtimit të një shoqërie shumetnike në Kosovë, për të cilën Kina është shumë e shqetësuar (Chinadaily, 2008). Të gjitha këto zhvillime kanë ndikuar që Kosova të mos marrë një njohje dhe pranueshmëri të gjerë shtetërore ndërkombëtare, ndërkaq, edhe pse rastet janë të ndryshme, palët kanë pozicione të kundërta edhe në rastin e Palestinës.

Së këtejmi, mund të konkludojmë se elementi kulturor mund të bëhet si katalizator apo pengues i njohjes apo mosnjohjes së një shteti të ri, apo edhe ndaljes e përshpejtimit të këtij procesi, por efektet e tij nuk janë vendimtare. Ndonjëherë elementi kulturor dhe ai fetar, mund të shfrytëzohet vetëm si arsyetim dhe interpretim për njohje apo mosnjohje të një shteti. Njohja apo mosnjohja e shtetit të ri është proces i ndërlikuar, me shumë ndryshore dhe interesa të ndërthurura të një shteti njohës.

Njohja ndërkombëtare si akt dhe proces për shtetet e reja është në përpjekjet e tyre për sa më shumë forcim të subjektivitetit ndërkombëtar.

IV. SUBJEKTIVITETI NDËRKOMBËTAR

4.1. Legjitimiteti ndërkombëtar i pavarësisë së Kosovës dhe Palestinës

Kosova në arenën ndërkombëtare është bërë objekt diskutimi në dy raste kryesore: e para mbi legjitimitetin e ndërhyrjes humanitare në vitin 1999, dhe e dyta pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Në të dy rastet legjitimiteti i veprimeve është debatuar, ndërkaq në rastin e dytë çështja ka shkuar edhe më tej, pasi Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GNJD) trajtoi aspektin legal të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës – një proces i nxitur nga Serbia në asamblenë e përgjithshme të OKB-së, e cila më pas dërgoi çështjen në GJND.

Pas çlirimit të Kosovës në vitin 1999, u instalua Misioni i OKB-së UNMIK, i cili me udhëheqësit e popullit të Kosovës do të ndërtonin administratën e re në territorin e çliruar. Sidoqoftë, me Rezolutën 1244 ishte paraparë që misionet ndërkombëtare të ishin të përkohshme dhe se Kosova duhej të kishte statusin e saj final politik dhe institucional. Askush nuk priste kthim të Kosovës nën Serbi. Sidoqoftë, në një raport të paraqitur në Këshillin e Sigurimit në vitin 2005, Kai Eide, i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm, shqyrtoi situatën politike në Kosovë dhe rekomandoi që të fillojë procesi i statusit final të parashikuar në Rezolutën 1244. Këshilli i Sigurimit ra dakord, por udhëzoi Sekretarin e Përgjithshëm të "ndjekë në mënyrë aktive çështjen". Një grup i shteteve të njohur si Grupi i Kontaktit, ranë dakord për një sërë parimesh për të administruar procesin e statusit përfundimtar, i cili përfshinte përmbajtjen nga hapat e njëanshëm dhe kërkoi që statusi përfundimtar i Kosovës të miratohej nga Këshilli i Sigurimit. (Meller, 2012, p. 837)

Në nëntor të vitit 2005, ish-Presidenti finlandez Marti Ahtisaari, u emërua si "I dërguari i posaçëm për procesin e statusit të ardhshëm për Kosovën" nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Misioni i Ahtisarit ishte të lehtësonte një zgjidhje politike që do të përcaktonte statusin e ardhshëm të Kosovës. Për të arritur një zgjidhje të tillë politike, Ahtisaari dhe ekipi i tij zhvilluan negociata gjithëpërfshirëse me udhëheqjen e Serbisë dhe Kosovës... në Korrik të vitit 2006, në

Vjenë u zhvilluan bisedimet e para të drejtpërdrejta midis liderëve serbë dhe shqiptarë për statusin e ardhshëm të Kosovës. (Crickemans, 2007, p. 9)

Viti 2007 vuri në dukje përpjekjet intensive për të zgjidhur çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Megjithatë, diplomacia ndërkombëtare nuk pati sukses në tejkalimin e dallimeve politike dhe pozicioneve diametralisht të kundërta ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, ndërsa Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë vazhdoi të transferonte përgjegjësitë e mbetura në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) së Kosovës. (Geci, 2008, p. 7)

Negociatat nuk po sillnin rezultate, ndërkaj statusi i Kosovës duhej të kishte të paktën një alternativë. Pas raundeve të tjera të negociatave, Ahtisaari paraqiti paketën e tij përfundimtare të propozimit për statusin e Kosovës. Baza kryesore e dokumentit ishte: "*Rekomandim: statusi i Kosovës duhet të jetë pavarësia, e mbikëqyrur nga bashkësia ndërkombëtare*". Kjo provokoi një sërë përgjigjesh. Beogradi e hodhi poshtë planin, Parlamenti Evropian e miratoi atë, Rusia bëri thirrje për raunde të reja të negociatave të udhëhequra nga një diplomat tjetër dhe Shtetet e Bashkuara dhanë mbështetjen e tyre të plotë. (Broek, 2010, pp. 29-30)

Debati i Këshillit të Sigurimit të OKB-së i mbajtur më 19 dhjetor 2007 u mbyll pa ndonjë hap konkret. "...Këshilli i Sigurimit i KB-së dështoi të lidhë ndarjet e thella mbi të ardhmen e Kosovës dhe vendet perëndimore thanë se do të merrnin udhëheqjen për drejtim të krahinës për pavarësinë nga Serbia". (Geci, 2008, p. 59)

Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia, duke ndezur kremtimin midis shqiptarëve etnikë, të cilët përbëjnë 92% të popullsisë së vendit. Serbia dhe pakica serbe e Kosovës kundërshtuan ashpër deklaratën dhe refuzuan ta njohin atë. Serbia vazhdon ta shikojë Kosovën si një provincë të saj. (Woehrel, 2011, p. 1)

Në njohjen e shpalljes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia në vitin 2008, shtete të shumta, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, e karakterizuan pavarësinë e Kosovës si rezultat *sui generis* i një grupi rrethanash unike, në veçanti abuzimeve të të drejtave të njeriut nga Serbia në Kosovë gjatë viteve 1990 dhe ndërhyrja dhe administrimi i mëvonshëm i komunitetit ndërkombëtar në krahinë (Connolly, 2013, pp. 71-72). Disa mendonin se momenti nuk ishte i volitshëm pasi ai qe ose i parakohshëm ose i vonshëm, të tjerët e konsideronin këtë veprim nul dhe të pavlefshëm.

OKB-ja miratonte një qëndrim më të mesëm, BE-ja nuk gjente dot një përgjigje të përbashkët, ndërsa NATO-ja nuk ndihej e përfshirë (Pernet, 2014, p. 247). Serbia arriti një fitore të mrekullueshme diplomatike kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara votoi më 8 tetor 2008, për të parashtuar çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND). (Woehrel, 2011, p. 3)

Pas kërkesës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ), duke kërkuar që ajo të japë një mendim këshillëdhënës në çështjen e përputhjes me të drejtën ndërkombëtare të shpalljes së njëanshme të pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës (shih Njoftimin për Shtyp 2008/34 të 10 tetorit 2008), Gjykata ka bërë një Urdhër që organizon procedimet. Në Urdhrin e saj të datës 17 tetor 2008, Gjykata vendosi që Kombet e Bashkuara dhe Shtetet Anëtare të saj, konsiderohen se mund të jenë në gjendje të japin informacion mbi pyetjen e paraqitur në Gjykatë për një mendim këshillëdhënës. Ajo ka caktuar 17 prillin 2009, si afat brenda të cilit deklaratat me shkrim mbi pyetjen mund t'i paraqiten Gjykatës, dhe 17 korrik 2009, si afat kohor brenda së cilës shtetet dhe organizatat që kanë paraqitur deklarata me shkrim mund të paraqesin me shkrim komentet mbi deklaratat e tjera. (ICJ, 2008)

Marrja me GJND-në nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 8 tetor 2008, ka qenë e shpejtë falë dinamizmit të Vuk Jeremiçit, por përpunimi i mendimit të Gjykatës ka marrë gati dy vjet (22 korrik 2010). Në të vërtetë, procedura konsultative është shumë komplete. Çdo shtet ka mundur të japë një kontribut të shkruar lidhur me çështjen e shtruar. Duke numëruar Republikën bolivariene të Venezuelës, e cila është anuluar për shkak të shkeljes së afatit, 36 shtete kanë dërguar nga një memorie. Më në fund, 46 ekspertë përfaqësues të 29 vendeve kanë ndërhyrë gjatë audiençave. (Pernet, 2014, p. 249)

Në verdiktin e saj GJND-ja tregon se pyetja në të cilën është kërkuar mendimi këshillëdhënës është parashtuar në Rezolutën 63/3, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme Asambleja e Përgjithshme) më 8 tetor 2008. Më tej, ajo rikujton se kjo pyetje thotë: "A është deklarata e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës në pajtim me të drejtën ndërkombëtare?". (ICJ, 2010, p. 1)

Më 22 korrik 2010, Gjykata rikujton konkluzionet e saj të arritura më parë, që "miratimi i shpalljes së pavarësisë së 17 shkurtit 2008 nuk shkeli të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999) ose Kornizën Kushtetuese". Së fundmi, ajo konkludon se "rrjedhimisht miratimi i kësaj deklarate nuk ka shkelur ndonjë rregull të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare". (ICJ, 2010, p. 14)

Nuk ka lajm që ka rritur më shumë subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës sesa verdikti gjyqësor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me përputhjen e Deklaratës së Pavarësisë me të drejtën ndërkombëtare. Serbia duke dërguar Kosovën në GJND kishte krijuar një moment të ri në sjelljen ndërkombëtare të Kosovës, pasi që përgjigjja pozitive do të jetë argument i fuqishëm në lobimin për njohje dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Mbi të gjitha verdikti i Gjykatës mund të përdoret edhe sot nga autoritetet kosovare, si mjet për të luftuar kontestimin e shtetit në arenën ndërkombëtare.

Në krahasim me Kosovën, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së nuk ka patur një kërkesë të tillë për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë për të shqyrtuar deklaratën e pavarësisë së Territoreve të Okupuara Palestineze (TOP) apo Palestinës. Në nëntor të vitit 1988, në përgjigje të Intifadës, OÇP-ja shpalli TOP-in shtet sovran dhe të pavarur (i quajtur 'Palestina'). Asambleja e Përgjithshme nuk e njohu ekzistencën e shtetit. Ajo vetëm pohoi "nevojën që populli palestinez të ushtrojë sovranitet mbi territorin e tyre ..." dhe riemërtoi delegacionin vëzhgues të OÇP-së në OKB si "Palestinë"... Megjithatë, vitet e 1990-ta sollën fillimin e vetëqeverisjes në TOP përmes krijimit të AP-së. AP-ja ishte një nga produktet e një numri të negociatave midis Izraelit dhe OÇP-së. Procesi filloi me një shkëmbim të ndërsjellë të njohjes, Izraeli duke u njohur si shtet dhe OÇP-ja si "përfaqësuesi legjitim i popullit palestinez". (Sherman, 2005, pp. 18-19)

Palestina ka kërkuar të ketë njohje zyrtare ndërkombëtare si një shtet, më shumë se një herë. Në vitin 1989, OÇP-ja aplikoi për anëtarësim në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (WHO). Megjithatë, ndikimi politik dhe financiar i Shteteve të Bashkuara e ndaloi këtë përpjekje. Më pas, WHO-ja i kërkoi OÇP-së të tërheqë kërkesën e Palestinës. Pak javë pas tërheqjes së kërkesës së Palestinës, OÇP-ja paraqiti një dokument ratifikimi në 'Konventat e Gjenevës të vitit 1949' në Zvicër, por qeveria u përgjigj: "Për shkak të paqartësive brenda bashkësisë

ndërkombëtare për ekzistencën ose mosekzistencën e shtetit të Palestinës” nuk është në gjendje të përcaktojë nëse Palestina është një shtet apo jo. (Hajaj, 2012, pp. 25-26)

Sot, katër Konventat e Gjenevës janë ratifikuar universalisht. Rregullat e tyre dhe ato të Protokolleve shtesë të vitit 1977 konsiderohen në masë të madhe si një ligj zakonor ndërkombëtar, i detyrueshëm për të gjitha shtetet dhe të gjitha palët në konflikte. (FDFA, 2017)

Autoriteti Palestinez (AP) në këto përpjekje nuk arriti qëllimin e synuar dhe kjo nënkuptonte se statusi ligjor i pavarësisë së Palestinës vazhdonte të ishte i kontestuar, përderisa shqyrtohej nga organe të ndryshme. Në vitin 2004 në një opinion këshillëdhënës të kërkuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në lidhje me pasojat juridike të ndërtimit të një muri në territorin e pushtuar palestinez nga Izraeli, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) vendosi se *konstruksioni i murit që po ndërtohet nga Izraeli, fuqia okupuese, në Territorin e Okupuar Palestinez, duke përfshirë Jerusalemin Lindor dhe rajonin e lidhur me të, janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, duke detyruar Izraelin të ndërpresë shkeljet e së drejtës ndërkombëtare* (ICJ, 2004, p. 69). Gjykata në këtë vendim ndau subjektet. Palestinën e njeh si territor të pushtuar dhe Izraelin si pushtuesin e tij. Ky vendim i GJND-së ndikoi në rritjen e sovranitetit të jashtëm të Palestinës.

Duke iu drejtuar kundërshtimeve amerikane dhe izraelite ndaj juridiksionit të Gjykatës, GJND-ja vuri në dukje “përgjegjësinë e saj të përhershme” ndaj Palestinës për shkak të statusit të veçantë të vëzhguesit që sistemi i KB-së i ka dhuruar asaj. Bazuar në një përfshirje të tillë të mëhershme, AP-ja nuk kufizohet që të kërkojë nga Asambleja e Përgjithshme njohjen e shtetit palestinez brenda kufijve të vitit 1967. AP-ja gjithashtu mund të kërkojë nga Asambleja e Përgjithshme që të paraqesë një kërkesë për një mendim këshillimor në GJND. Gjuha mund të jetë e ngjashme me atë të paraqitur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës: a janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare përpjekjet e popullit palestinez për të deklaruar një shtet brenda kufijve të pranuar ndërkombëtarisht të vitit 1967? (Yoffie, 2011, pp. 506-507)

Veprime të tilla të palestinezëve shihen si mundësi për të rritur legjitimitetin e pavarësisë së tyre në raport me kontestin që i bëhet. Sidoqoftë, shembulli që kanë tërhequr në raport me Kosovën nënkupton se Kosova ka një përparësi në raport me Palestinën, sa i përket legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë së saj. Kosova ka tashmë në dorë një dokument me anë të të cilit

arsyeton legjitimitetin e pavarësisë së saj. Natyrisht, mendimi i GJND-së është vetëm një nga arsyet që ndikojnë në forcim të legjitimitetit të shtetit, ndërkaq ai varet shumë edhe nga sovraniteti i brendshëm i tij.

Duhet të theksojmë se në procesin e gjyimit të rastit të ballafaqimit me pasojat juridike të ndërtimit të murit në territorin e pushtuar palestinez nga Izraeli, GJND-ja gjithashtu lejoi Palestinën të paraqesë një deklaratë me shkrim dhe të marrë pjesë në argumentet gojore, pavarësisht se statuti i Gjykatës kufizon pjesëmarrjen e tillë të shteteve palë ose organizatave ndërqeveritare. Gjykata e arsyetoi vendimin duke “marrë parasysh faktin se Asambleja e Përgjithshme i kishte dhënë Palestinës një status të veçantë të vëzhguesit dhe se Palestina ishte bashkë-sponsoruese e projekt-rezolutës që kërkonte mendimin këshillëdhënës” (Yoffie, 2011, p. 508). Ky veprim dhe veprime të tilla konsiderohen si avancim i statusit ligjor në të drejtën ndërkombëtare.

Gjithashtu, në vitin 2011, Gjykata Ndërkombëtare Penale (GJNP) hodhi poshtë deklaratën e Palestinës për të pranuar juridiksionin e gjykatës sipas nenit 12(3) të Statutit të Romës, i cili lejon shtetet që nuk janë palë në statut të pranojnë juridiksionin e Gjykatës mbi krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës. Deklarata e Palestinës ishte në lidhje me krimet e kryera nga ushtria izraelite në Gaza gjatë ‘Operation Cast Lead’ të dhjetorit 2008. Prokurori i Përgjithshëm i GJNP-së tha se: “Palestina duhet të njihet nga KB-ja si shtet para se të pranojë kërkesën e saj për të hetuar krimet brenda territoreve të saj”. (Hajaj, 2012, p. 26)

Në dy rastet Palestina ka patur të kontestuar shpalljen e pavarësisë dhe njohjen e saj, ndërkaq edhe pse në rastin e parë është trajtuar, ajo ka rrjedhur si rezultat i njohjes së statusit të shtetit vëzhgues që Palestina e fitoi në vitin 2012 në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Për Palestinën statusi i shtetit vëzhgues në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së është njëra nga arritjet më të mëdha të njohjes dhe forcimit të legjitimitetit dhe subjektivitetit ndërkombëtar të saj.

Krimet e Ushtrisë Jugosllave bënë që të ndërmerren veprime ushtarake nga bashkësia ndërkombëtare të udhëhequra nga SHBA-të dhe aleatët e saj, për të ndihmuar në çlirimin e shqiptarëve të Kosovës nga Serbia. Veprimet u ndërmorën sidomos nën doktrinën e “ndërhyrjes humanitare”, kthimin e mbi 1 milion refugjatëve kosovarë, vrasjen e mbi 10 mijë civilëve

shqiptarë, djegien e shtëpive dhe granatimin ushtarak ndaj zonave me popullsi civile, si dhe me përshpejtimin ndërhyrës ushtarak, nga prania e një zyrtari amerikan të OSBE-së në luginën e masakrës së Reçakut. Arsyetimet e Perëndimit mbi legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë ishin: “ndërhyrja humanitare”; stabiliteti rajonal, shkelja e të drejtave të shqiptarëve nga ish regjimi jugosllav, numri i viktimave nga ky regjim, humbja e të drejtës për t’i qeverisur shqiptarët, pas shtypjes dhe konfliktit të armatosur; koston e intervenimit ushtarak që kishte detyruar Perëndimin për ta sulmuar ish-Jugosllavinë dhe shpërbërjen e kësaj federate, krijimin e shumë shteteve të reja pas shuarjes së saj, si dhe shumë arsye të tjera të njohura dhe të panjohura.

Në anën tjetër, Serbia arsyetonte veprimet e veta, se po “luftonte separatistët shqiptarë” dhe “guerilen terroriste”, si dhe thirrej në “të drejtën ndërkombëtare” mbi sovranitetin e saj territorial, në “të drejtën historike” mbi sundimin mesjetar të Kosovës dhe në “të drejtën hyjnore e mitologjike” mbi “Kosovën si Jerusalemi i Serbisë”.

Edhe Izraeli pretendonte për “të drejtën historike e biblike” mbi tokat në Palestinë, të drejtën religjioze mbi rrëfimet e mbretit David” etj. Zonat e shenjta për hebrenjtë në Jerusalem dhe pjesët e tjera të vendit, po ashtu janë bërë thirrje për t’u legjitimuar shteti i Izraelit. Në anën tjetër, Bashkësia Ndërkombëtare, veçanërisht vendet evropiane dhe SHBA-të, legjitimitetin izraelit, e shohin edhe me të drejtën izraelite për një shtet, e sidomos pas gjenocidit të paparë në histori ndaj hebrenjve.

Por edhe palestinezët, njësoj si izraelitët, thirren në të drejtën e tyre historike, religjioze dhe juridike mbi pronësinë e territorit të tyre në Lindjen e Mesme. Shenjtërimi i vendeve islame, xhamia Al-Aksa etj., janë ndër pjesët më të ndjeshme, në të cilat palestinezët kërkojnë legjitimitetin e mëvetësisë. Po ashtu, legjitimiteti kërkohet sidomos edhe në kufijtë e vitit 1967 dhe luftën që detyroi të iknin qindra e mijëra palestinezë jashtë vendit. Palestinezët kërkojnë legjitimitetin e tyre edhe në mbi 70 përqind të njohjeve që vijnë vetëm nga shtetet anëtare të OKB-së, me mbi 130 njohje ndërkombëtare, në dhjetra rezoluta nga OKB, në anëtarësimin në organizata ndërkombëtare etj.

Kosova për dallim nga Palestina, ka përforcuar edhe argumentin e vendimit dhe opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), se Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.

Thënë përmbledhtas, legjitimiteti ndërkombëtar i Kosovës dhe Palestinës, forcon subjektivitetin ndërkombëtar të tyre, si dhe shton numrin e njohjeve ndërkombëtare, dhe anasjelltas, çdo njohje e re forcon subjektivitetin ndërkombëtar të dyja shteteve.

4.2. Subjektiviteti i Kosovës dhe Palestinës

Subjektiviteti i një shteti është aftësia e tij vepruese në përputhje me interesat e veta. Pra, është aftësia e ndikimit të shtetit në shtetet e tjera, i aftë dhe me fuqi për të ndikuar dhe për t'u pranuar si subjekt i pavarur në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Përkufizimi i përgjithshëm i subjektit të së drejtës ndërkombëtare mund të formulohet pak a shumë kështu: subjekti i së drejtës ndërkombëtare është ai person ndërkombëtar, i cili ka të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare dhe nga burime të tjera të së drejtës ndërkombëtare. (Puto, 2010, p. 89)

Aftësitë kryesore të një subjekti ndërkombëtar janë: së pari, aftësia për të ngritur padi në gjykatat ndërkombëtare (dhe të një vendi) për të kërkuar të drejtat e tij të dhëna nga e drejta ndërkombëtare; së dyti, për t'iu nënshtruar një pjese ose të gjitha detyrimeve që burojnë nga e drejta ndërkombëtare; së treti, për të pasur të drejtën të lidhë marrëveshje ndërkombëtare (traktate) të vlefshme, të cilat kanë natyrë detyruese në të drejtën ndërkombëtare; së katërti për të gëzuar disa ose të gjitha imunitetet nga juridiksioni ndërkombëtar, i cili nuk i nënshtrohet sistemit ligjor të shteteve të tjera. (Dixon, 2011, p. 169)

Bazuar nga këto aftësi mund të vërejmë se subjektet ndërkombëtare në rrethana dhe kohë të caktuar mund të kenë dhe ushtrojnë aftësi të caktuara.

Pasi trajtesa jonë ka të bëjë me shtetin si subjekt i së drejtës ndërkombëtare, mund të theksojmë se Kosova dhe Palestina gjithashtu kanë aftësi të ndryshme në rrethana të caktuara. Në veçanti duhet të kemi parasysh këto aftësi kur kemi kontestim të shtetit. Pra, duhet të theksojmë se ka shumë definime të shtetit, por, më i rëndësishmi është i paraqitur përmbajtësisht nga Konventa e Montevideos mbi të drejtat dhe obligimet e shteteve, në bazë të së cilës ndërtohet koncepti mbi shtetin si bashkësi e territorit të caktuar, e popullsisë në këtë territor, e pushtetit sovran dhe efektiv mbi popullsinë në këtë territor dhe e aftësisë që të vendosë marrëdhëniet me shtetet tjera. (Petriç, 2012, p. 215)

Subjektet e së drejtës që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën si shtete, i njohin edhe si subjekte të së drejtës ndërkombëtare dhe gjithashtu njohin të gjitha aftësitë e tyre vepruese sipas asaj të drejte.

Kosova në raport me Serbinë, në krahasim me Palestinën në raport me Izraelin, ka subjektivitet të ndryshëm ndërkombëtar. Kosova duke qenë e përkrahur nga SHBA-të, ka arritur të ketë subjektivitet ndërkombëtar falë lobimit amerikan në vendet që nuk e kanë njohur ende subjektivitetin e Kosovës. Falë aleancës së veçantë SHBA-Izrael, subjektiviteti ndërkombëtar i Palestinës bëhet më i cenueshëm, por Palestina ka arritur të marrë mbështetjen për subjektivitet ndërkombëtar nga superfuqitë e tjera globale si: Rusia, Kina, vendet e Bashkimit Evropian, Amerika Latine.

Palestina për dallim nga Kosova, ka njohjen nga fqinjët dhe konsiderohet me vlera kulturore e historike të përbashkëta, ndërsa Kosova ndonëse ka marrë njohjen e fqinjëve si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shqipëria, nga pikëpamja kulturore shihet e ndryshme nga ta, përveç me Shqipërinë, apo vazhdimësitë territoriale me pakicat etnike shqiptare në vendet fqinje maqedonase, serbe dhe malazeze. Nga vendet afër saj, Kosovën nuk e kanë njohur Greqia, fqiu i Shqipërisë dhe Rumania. Në pikëpamjen më të afërt fqinjësore, këto janë dy shtetet që e kontestojnë subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës. Për dallim nga Kosova, Palestina ka subjektivitetin e pranuar nga fqinjët sirianë, arabo-sauditë, libanezë, irakianë dhe egjiptianë.

Fqinjët arabë të Palestinës - Siria, Arabia Saudite, Libani, Iraku dhe Egjipti - u bashkuan me palestinezët dhe shpallën luftë kundër Izraelit. Lufta nuk përfundoi në mënyrë të favorshme për arabët. Me mbështetjen dhe ndihmën nga Britania dhe Shtetet e Bashkuara, shteti hebre i Izraelit mundi ushtritë arabe sulmuese dhe mori kontrollin e një pjese më të madhe të tokës, duke përfshirë disa nga tokat e përcaktuara nga OKB si pjesë e gjysmës arabe. (Saylor Academy, 2018)

Më 15 dhjetor 1988, Kombet e Bashkuara me Rezolutën 43/177, pranojnë shpalljen e shtetit të Palestinës dhe sovranitetin mbi territorin e tyre, ndër tjerash, në rezolutë, theksohen këto pika: pranon shpalljen e shtetit të Palestinës nga Këshilli Kombëtar i Palestinës më 15 nëntor 1988; dhe, konfirmon nevojën për t'i mundësuar popullit palestinez të ushtrojë të drejtat e tyre të sovranitetit mbi territorin e tyre të pushtuar që nga viti 1967. (UNGA, 1988)

Rezoluta 43/177 e OKB-së tregon rastin kur njihet sovraniteti i një populli, territoret e të cilit faktikisht janë të pushtuara dhe ai nuk ka kontroll efektiv mbi ato territore. Bazuar në këtë mund të theksojmë se subjektiviteti ndërkombëtar në këtë rast nuk është burim i plotësimit të plotë të kriterëve të Montevideos mbi shtetin, por si rezultat i vullnetit të politikave ndërkombëtare përballë një situatë të caktuar. Shembull për këtë e kemi edhe Vatikanin. Selia e Shenjtë është një person juridik dhe palë në një numër konventash shumëpalëshe dhe marrëveshjeve dypalëshe në cilësinë e saj si Selia e Shenjtë dhe jo si entiteti territorial i Vatikanit. Ajo zhvillon marrëdhëniet e saj me shtetet si një entitet i barabartë, jo si një shtet ose një entitet territorial, por një entitet i panënshtuar ndaj ndonjë autoriteti më të lartë. (Sherman, 2005, p. 34)

Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Kosovën, përkundrazi, nuk njeh Pavarësinë e Kosovës (UN, 1999). Madje, në Kosovë ende figuron Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) dhe kritikant ndaj ekzistencës së këtij misioni, vijnë edhe nga vetë drejtuesit e shtetit të Kosovës. Përndryshe, rasti i Kosovës ka histori të kundërshtimit, prej Këshillit të Sigurimit, për të mos lejuar intervenimin ushtarak në ish-Jugosllavi dhe veprimin të konsideruar unilateral jashtë Këshillit të Sigurimit. Rol të veçantë me vetot e tyre, kishin Rusia dhe Kina, si dy aleatë të Serbisë, prej të cilës është shkëputur Kosova.

Handikap kryesor në cenimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës aktualisht mbetet Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, shfuqizimin e së cilës e pengojnë Rusia dhe Kina me vetot e tyre. Kjo rezolutë shfrytëzohet nga Serbia dhe aleatët e saj, si dhe nga kundërshtarët e SHBA-ve, si pretekst për të mos njohur dhe për të penguar anëtarësimin e Kosovës në Organizatat Ndërkombëtare. Veprime të tilla rrjedhimisht pengojnë rritjen dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës.

Autoritetet drejtuese të palestinezëve, Organizata për Çlirimin e Palestinës dhe Autoriteti Palestinez kanë shtrirë deri në një masë subjektivitetin e Palestinës në nivele të ndryshme ndërkombëtare. Organizata për Çlirimin e Palestinës ka ndërtuar dhe zhvilluar marrëdhënie me organizata dhe shtete të ndryshme që ndikojnë në rritjen dhe forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Palestinës. Ajo ka statusin e vëzhguesit të përhershëm në OKB, që do të thotë se mund të vëzhgojë dhe të flasë në seancat e Asamblesë së Përgjithshme (por nuk mund të

votojë) dhe gjithashtu ka një fuqi të veçantë për të bashkëfinancuar projekt-rezolutat lidhur me çështjet në Lindjen e Mesme. OÇP-ja ka qenë gjithashtu palë e shumë marrëveshjeve të detyrueshme, duke përfshirë Marrëveshjen e Përkohshme dhe marrëveshjet e refugjatëve me Jordanin dhe Libanin dhe vazhdon të negociojë marrëveshje për të mirën e Autoritetit Palestinez, duke përfshirë një marrëveshje të lirë të asociimit me BE-në. (Sherman, 2005, pp. 36-37)

Kosova për dallim nga Palestina, nuk arriti të anëtarësohet në një prej organizatave më të specializuara dhe më të rëndësishme të OKB-së, në fushën e kulturës, arsimit dhe shkencës, UNESCO. (Irish, 2015)

Por Palestina arriti të pranohet si anëtare e saj, ndonëse me kundërshtimin e madh të SHBA-së dhe Izraelit, të cilat edhe ndalën financimin dhe më pas, duke u larguar SHBA edhe nga UNESCO, si një nga sponzoruesit më të mëdhenj të saj. Votimi në selinë qendrore të UNESCO-së, ndjek një përpjekje të palestinezëve për të kërkuar njohjen si një shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara. Ajo sinjalizoi se palestinezët kanë për qëllim të ndjekin anëtarësimin në një numër të agjencive të specializuara të Kombeve të Bashkuara, të cilat kanë rregullat e tyre për anëtarësim dhe ku Shtetet e Bashkuara nuk kanë fuqi të vetos. (Lynch, 2011)

Autoriteti Palestinez, i cili ushtron juridiksionin e vet mbi Zonën Autonome të Palestinës, ka në një masë të madhe subjektivitet ndërkombëtar dhe mund të lidhë traktate e marrëveshje me shtete tjera (si dhe me OKB-në) duke shkëmbyer përfaqësues diplomatik... megjithatë ai ende nuk është pranuar nga të gjithë si qeveri e një shteti të pavarur, pavarësisht se është i lidhur me një territor të përcaktuar qartë dhe kështu duket, së paku aktualisht, si një subjekt ndërkombëtar *sui generis*. (Dixon, 2011, p. 180)

Nëse krahasojmë me Kosovën, vërejmë që anëtarësimi në OKB nuk është kushti i fundit për plotësim, në mënyrë që të mos ketë kontestim të shtetësisë së Kosovës. Anëtarësimi qoftë si vëzhgues apo anëtar i plotë në OKB, nuk garanton njohjen apo anëtarësimin në subjekte të tjera të së drejtës ndërkombëtare, dhe gjithashtu nuk garantohet as përfshirja në traktate apo pakte të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare.

Kosova ka nënshkruar marrëveshje të shumta bilaterale dhe multilaterale me shtete dhe organizata ndërkombëtare (MFA, n.d.), ndërkaq vlen të përmendet që si shtet, Kosova ka

nënshkruar edhe Marrëveshjen për Stabilizim Asociim si marrëveshje kontraktuale me BE-në. (EU, 2015)

Duhet të theksojmë që Kosova ka arritur të jetë pjesë e disa organizatave të rëndësishme ndërkombëtare, si: Banka Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve dhe Njësia Ndërkombëtare e Transportit Rrugor. (Marleku, 2012, p. 90).

Gjithashtu, Kosova në vitin 2012 është anëtarësuar edhe në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD, 2012). Kosova është pjesë edhe e një numri të konsiderueshëm të organizatave ndërkombëtare dhe atyre joqeveritare ndërkombëtare. Të gjitha marrëveshjet, anëtarësimet dhe pjesëmarrjet ndërkombëtare forcojnë sovranitetin e jashtëm të Kosovës.

Kosova ballafaqohet me lobimin aktiv nga Serbia në vendet që nuk e kanë njohur atë, ngjashëm sikurse Izraeli lobon kundër Palestinës në Kombet e Bashkuara dhe vendet e tjera veç e veç, për ta penguar subjektivitetin e saj ndërkombëtar. Në krahasim me numrin e njohjeve, anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare, Palestina duket se është më e fuqishme në shtrirje të sovranitetit të jashtëm. Kosova qëndron më e dobët në raport me OKB-në, krahasuar me Palestinën e cila ka mbështetje më të madhe dhe njihet nga më shumë shtete të OKB-së, si anëtare të saj.

Dobësimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës shkaktohet edhe nga kundërshtimi i pesë vendeve të Bashkimit Evropian, që deklarojnë aktivisht se nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, por si përparësi në raport me Palestinën, është fakti i mbështetjes nga vendi më i fuqishëm në botë, SHBA-të.

Kosova në raport me Palestinën ka përparësi të dallueshme në sovranitetin e saj të brendshëm, ndërsa Palestina në krahasim me Kosovën ka përparësi të vogël në sovranitetin e jashtëm. Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës dhe Palestinës përfundimisht më shumë është i varur nga qëndrimet me bazë gjeopolitike të superfuqive, sesa në parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Pjesë e rëndësishme e subjektivitetit ndërkombëtar është edhe aftësia e shtetit për të ruajtur integritetin territorial.

4.3. Integriteti territorial i Kosovës dhe i Palestinës

Nëse nisemi nga kriteret e Montevideos për ekzistimin e shteteve, popullsia dhe territori janë dy nga katër kriteret kryesore.

Popullsia e shtetit është bashkësi e personave mbi të cilët ai e zbaton pushtetin e vet kulmor, si nëse jetojnë në territorin e tyre (juridiksioni territorial), si në rast se janë shtetas të tij (juridiksioni personal). (Petriç, 2012, p. 219)

Në rastin e Kosovës, gjithashtu edhe në atë të Palestinës, kriteri mbi popullsinë e qëndrueshme nuk është i kontestuar. Megjithëse refugjatët në rastin e Palestinës janë çështje e diskutueshme në mes të palëve.

Një shtet duhet të ketë një shtrirje të caktuar fizike, e cila e dallon qartazi nga fqinjët e vet. Kjo nuk do të thotë që duhet të ekzistojë një siguri e plotë lidhur me shtrirjen e tij territoriale. (Dixon, 2011, p. 173)

Kosova qeverisë më pak se njëmbëdhjetë mijë kilometra katrorë. Territori i tanishëm kufitar i Kosovës është vendosur me Kushtetutën e Republikës Federale të Jugosllavisë në vitin 1946, si pjesë e një përpjekjeje për një ndarje administrative nga Republika Socialiste e Serbisë ... këta kufij konsiderohen të caktuar dhe të pranuar nga bashkësia ndërkombëtare. Brenda kufijve të përcaktuar banon një popullatë e përhershme e cila qeveriset nga autoriteti i Kosovës. Sipas Kushtetutës jugosllave, Kosovës iu dha statusi autonom dhe praktikisht asaj iu njohën të drejtat e njëjta si gjashtë republikat e tjera jugosllave, të cilat përbënin territorin e saj. (Panganiban, 2015, pp. 56-57)

Në Kushtetutën e Kosovës thuhet se, Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm, se nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj. (Kuvendi i Kosovës, 2008)

Çështja e tokës është jetike në marrëdhëniet ndërmjet Palestinës dhe Izraelit. Në autobiografinë “Zonja Sekretare”, Madeleine Albright, duke shqyrtuar momentet delikate gjatë

bisedave mes udhëheqësit të palestinezëve Arafatit dhe atij të izraelitëve Netanjahut, tregon edhe këtë gjë, rreth rëndësisë së çdo pëllëmbë të tokës ndërmjet tyre:

Palestinezët donin tokë, izraelitët siguri. Çështja ishte sa tokë do të kthehej dhe çfarë garancish do të jepnin palestinezët për sigurinë... Sasia e tokës që do të transferohej nuk qe përcaktuar dhe kjo ishte burim mosmarrëveshesh të mëdha. Palestinezët besonin se u kishin premtuar se, përpara se të fillonin bisedimet për statusin përfundimtar, do t'u jepnin gjithë Bregun Perëndimor dhe Gazën, me përjashtim të Jerusalemit, si dhe vendbanime e postblloqe të sigurisë. Izraelitët kundërshtonin me vendosmëri, duke thënë se çështja varej krejtësisht nga gjykimi i tyre... Shimon Peres, ia kishte mbushur mendjen Arafatit të pranonte një pakt që nuk përcaktonte ndonjë përqindje të saktë. (Albright, 2004, pp. 342-343)

Territoret palestineze janë më të kontestuara nga Izraeli sesa ato të Kosovës nga Serbia. Territori i Kosovës nga Serbia cenohet kryesisht nëpërmjet kontrollit politik mbi komunitet e banuara me shumicë serbe, veçanërisht katër komunave në veri të vendit, si dhe përmes shfrytëzimit të të ashtuquajturave “zona të mbrojtura”, që përfshijnë hapësira të pronave të trashëgimisë kulturore shumica prej tyre fetare, dhe kryesisht, të shfrytëzuara nga Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë.

Pavarësisht se deklarativisht dhe në Kushtetutën e Serbisë, Kosova si tërësi territoriale është pjesë e integritetit territorial të Republikës së Serbisë, efektivisht (Serbia National Assembly, 2006), përveç kontrollit *de facto* të katër komunave të Veriut si: Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, Kosova nuk konsideron se nuk e ka kontrollin në pjesët e tjera të vendit. Në këto pjesë të territorit të Kosovës, integriteti territorial i Kosovës është konfirmuar në mënyrë të përsëritur dhe herë pas here e zbatuar nga forcat ndërkombëtare të vendosura në këtë zonë nën mandatin e OKB-së. Për më tepër, me përfundimin e Marrëveshjes së Brukselit në prill 2013, hapat bashkëpunues që përfshijnë gjithashtu Serbinë duhet të ndërmerren për të siguruar që çdo formë e qeverisë autonome të bëhet brenda rendit juridik të Kosovës. Kjo përfshin integrimin e forcave lokale të policisë në policinë e Kosovës. (Global Kosovo, n.d.)

Integriteti territorial i Kosovës në pjesën veriore është rikonfirmuar edhe nga aksione të ndryshme policore për rend dhe ligj nga Policia e Kosovës në vitin 2011, dhe viteve të tjera, që

kulmoi me arrestimin dhe dëbimin e Shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Marko Gjuriq, në vitin 2018, i cili nuk përfilli urdhërin e autoriteteve të Kosovës për të mos hyrë në Kosovë. (Shehu, 2018)

Bazuar në decentralizimin etnik sipas Pakos së Ahtisaarit, si dokumenti më relevant deri më tash për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës dhe zotimet e Kosovës para Bashkësisë Ndërkombëtare mbi pakicat, komunat me shumicë serbe janë vetëqeverisëse në shumicën e fushave. Kontestimi i integritetit dhe shtetit nga shumica e komunave serbe bëhet, duke refuzuar simbolin dhe flamurin e shtetit të Kosovës në institucionet zyrtare publike, të ndikuara nga Serbia etj. Mirëpo, *de facto*, Kosova ka më të konsoliduar integritetin territorial të saj, sesa Palestina, pasi që kjo e fundit, historikisht ka pasur sfida në përcaktimin e plotë të territoreve, pasi janë kontestuar edhe nga Izraeli, por edhe nga shtetet e tjera. Ndërkaq, njohjet e Kosovës nga subjektet e së drejtës ndërkombëtare përkojnë me gjendjen faktike territoriale.

Edhe pse shumica prej tyre janë të kontestuara nga Izraeli, Palestina ka vendosur kufijtë e saj, dhe një shumicë dërmuese e bashkësisë ndërkombëtare, përfshirë OKB-në dhe BE-në, i njeh “Linjat e Gjelbërta” si ndarjen legjitime midis territorit palestinez dhe izraelit, duke përfshirë Bregun Perëndimor, Rripin e Gazës dhe Jerusalemin Lindor. Që nga Marrëveshjet e Oslos, bashkësia ndërkombëtare është pajtuar sa i përket çështjes së kufirit, Palestina dhe Izraeli duhet të përdorin kufijtë para vitit 1967 si pikënisje për diskutime të mëtejshme. (Pitta, 2018, p. 15)

Një shtet mund të njihet si një person juridik edhe pse është i përfshirë në një mosmarrëveshje me fqinjët në lidhje me përcaktimin e saktë të kufijve të tij, përderisa ekziston padyshim një brez i qëndrueshëm territori i cili kontrollohet nga qeveria e shtetit të supozuar. Për këtë arsye, së paku, “Shteti i Palestinës” i deklaruar në nëntor të vitit 1988 në një konferencë në Algjeris, nuk mund të konsiderohet si një shtet i vlefshëm. Organizatat palestineze nuk kanë kontrolluar ndonjë pjesë të territorit që ata pretendojnë (Shaw, 2008, p. 199), edhe pse Asambleja e Përgjithshme e OKB-së përmes rezolutës 43/177 konfirmon nevojën për t'i mundësuar popullit palestinez të ushtrojë sovranitetin e tyre mbi territorin e pushtuar që nga viti 1967. (United Nation, 1988)

Izraeli edhe sot kontrollon pjesën më të madhe të territorit, edhe të atyre pjesëve që nga palestinezët, konsiderohen se i takojnë Palestinës. Palestina përveç Gazës dhe Bregut

Perëndimor, dhe një pjese të rrafshnaltës së Golanit - si vazhdimësi territoriale siriane që Izraeli e ka pasur njëfarë kontrolli edhe më të madh, sidomos pas luftës në Siri, nuk ka kontroll të plotë të territorit të pretenduar. Izraeli vazhdimisht ka deklaruar se kontrolli i territoreve palestineze, me raste, bëhet edhe për shkak të sigurisë së Izraelit nga sulmet e Hamasit. Për shkak të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit, Izraeli dërgon trupat e tyre edhe në territoret e vlerësuara si palestineze. Për këto dhe arsye të tjera autori Malcolm N. Shaw Palestinën e konsideron “shtet jo të vlefshëm”. (Shaw, 2008, p. 199)

Në rastin e Palestinës, është e qartë – dhe ky është qëndrim unik i bashkësisë ndërkombëtare - se kemi të bëjmë me territorin përtej kufijve të vitit 1997, për okupimin ushtarak ndërkombëtar juridik të Izraelit. Është e padyshimtë se Izraeli nuk ka sovranitet në territoret përtej kufijve të vitit 1997, ndonëse shteti palestinez në të ashtuquajturën Bregun Perëndimor të Gazës është vetëm në krijesë [sic], këto hapësira që janë nën okupimin e Izraelit janë territor të shtetit të ardhshëm palestinez që është duke u krijuar. Por, është hapur një sërë çështjesh konkrete të kufizimit të tij, para së gjithash problemi i Jerusalemit lindor që e ka aneksuar Izraeli dhe e mban si pjesë të territorit që i takon sovranitetit të tij. (Petriç, 2012, p. 225)

Izraeli ka kundërshtuar gjithmonë t’u vërë një cak maksimal pretendimeve të tij territoriale në “Palestinë” dhe mund të mendohet që kjo pothuaj e ka bërë të mos ketë një territor të përcaktuar qartë. Por në praktikë është jashtë dyshimit që Izraeli është shtet, pasi ekziston një bërthamë territoriale, e cila quhet pa mëdyshje “Izrael”. (Dixon, 2011, p. 173)

Ekzistenca e një shteti me bazë territoriale nuk llogaritet e rrezikuar nëse nuk ka territor të definuar plotësisht apo nuk ka kontroll absolut mbi atë territor; gjithashtu në rastin kur shteti nuk ka territor të definuar për shkak të pretendimeve territoriale ndaj vendeve të tjera nuk rrezikon subjektivitetin juridik të shtetit pretendues. Kjo nënkupton se Palestina paraqet një entitet që nuk është mjaft efektiv, por jo sa për t’u mos rrezikuar qenësia e ekzistencës.

Në territorin që Izraeli pranon se i përket Palestinës, Izraeli vazhdon të përdorë ushtrinë e vet për të kontrolluar kufijtë duke hequr aftësinë e Palestinës për të kontrolluar efektivisht territorin e saj, që përfshinë edhe mundësinë e pranimit të ndihmave ndërkombëtare përmes kufijve tokësorë dhe ujorë gjatë kohëve të konfliktit me Izraelin. (Panganiban, 2015, pp. 63-64)

Pamundësia e ushtrimit të sovranitetit dhe “varësia” nga Izraeli paraqitet edhe në një tekst të medias së njohur britanike, BBC NEWS, ku jepen disa nga të dhënat rreth profilit të Palestinës: Palestinezët janë përpjekur për vetëvendosje, por kanë arritur vetëm kontroll të kufizuar mbi çështjet e tyre. Marrëdhëniet me autoritetet izraelite janë shënuar nga konflikti i dhunshëm. Ekonomia është e fragmentuar dhe i nënshtrohet kufizimeve izraelite. (BBC, 2017)

Një nga territoret më të kontestuara është edhe qyteti i Jerusalemit, i konsideruar si vend i shenjtë për dyja palët: edhe izraelitët, edhe palestinezët. Dyja palët konsiderojnë se kanë “të drejtën e tyre historike” mbi këtë qytet. Edhe më shumë kontestimi i këtij territori, do të jetë më problematik, pas vendimit zyrtar të Presidentit aktual Donald Trump, për njohjen e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit dhe hapjen e Ambasadës së SHBA-ve në të.

Jerusalemi deri në kohën e ardhjes së Trumpir në Shtëpinë e Bardhë, ishte vënë si pikë për t’u negociuar. Shumë shtete kanë kundërshtuar veprimin amerikan dhe nuk iu kanë bashkuar thirrjes së Izraelit dhe SHBA-së, për të hapur ambasadat e tyre në Jerusalemin si kryeqytet izraelit, e jo kryeqytet të të dyja palëve, apo me status të veçantë e protektorat ndërkombëtar.

Territoret palestineze vazhdimisht janë të kontestuara, por edhe Izraeli kontestohet nga forcat politike palestineze. Okupimi izraelit i Bregut Perëndimor, me ndërtimin e vazhdueshëm të vendbanimeve, pikat e kontrollit ushtarak dhe sulmet palestineze, kanë ngadalësuar përparimin drejt një marrëveshjeje përfundimtare dhe ka bërë që shumë nga të dyja palët të kontestojnë vlerën e marrëveshjeve. Izraeli mban kontroll të plotë mbi rrugët anashkaluese, vendbanimet dhe Luginën e Jordanit dhe bën sulme në zona urbane kundër grupeve të armatosura. Në vitin 2005, Izraeli përfundoi tërheqjen e të gjithë trupave dhe kolonëve të saj nga Rripi i Gazës por mban kontrollin e hapësirës ajrore, bregdetin... - duke përfshirë furnizimet e ushqimit dhe mallrave të tjera - përveç kalimit me Egjiptin... (BBC, 2017)

Kosova e ka më të qartë integritetin territorial sesa Palestina. Përzierja e të drejtës historike me të drejtën juridike, dhe e të drejtës hyjnore me të drejtën ndërkombëtare, është edhe më e ndërlikuar për integritetin territorial të Palestinës, sesa të Kosovës. Ndonëse edhe elementi sakral bëhet pjesë e retorikës të udhëheqësve serbë. Madje në analogji me Palestinën, është edhe vetë konsiderimi i Kosovës sidomos nga Kisha Ortodokse Serbe dhe krerët e Serbisë,

si “Jerusalemi i Serbisë”. Kjo e bën edhe më të ndërlikuar integritetin territorial të Kosovës, kur e drejta juridike vihet përballë të drejtës hyjnore-historike e mesjetare serbe.

Jashtë Veriut të Kosovës, integriteti territorial më së shumti kontestohet nga komunitetet vetëqeverisëse me shumicë serbe pas decentralizimit etnik dhe nga organizimi ekstraterritorial i kishave dhe manastireve ortodokse, të cilësuar se i takojnë vetëm serbëve. Madje, ajo quhet si Kisha Ortodokse Serbe dhe janë nën autoritetin dhe kontrollin e plotë, me shumë zona speciale, nga Kisha Ortodokse Serbe e Serbisë dhe asaj në Kosovë.

Kosovarëve iu kërkua mbrojtja e mjediseve rrethuese përmes përcaktimit të zonave mbrojtëse (buffer zone) të rreth 47 pronave të trashëgimisë kulturore (shumica prej tyre kisha dhe manastire të besimit ortodoks që shfrytëzohen nga Kisha Ortodokse Serbe). Ky detyrim, i paraparë në Planin e Ahtisaarit, gjatë procesit të zbatimit nga ICO, përmes ndryshimeve joparimore dhe një ligji të veçantë, u transformua në vija të kuqe të ndarjes territoriale. Zonat rrethuese (buffer zone) rreth pronave të trashëgimisë kulturore u transformuan në Zona të Veçanta të Mbrojtura, duke i ofruar eksterritorialitet Kishës Ortodokse Serbe dhe Serbisë brenda territorit të Kosovës. (Ec Ma Ndryshe, 2013)

Pengesë për pretendimet e Serbisë mbi territorin e Kosovës është edhe synimi i tyre për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). BE i ka vënë kusht Serbisë që të njohë realitetin gjeografik dhe politik për të realizuar këtë synim. Në nenin 38 të Kornizës Negociuese të Kapitullit 35 të negociatave, për Kosovën thuhet:

...Si pjesë e përpjekjeve të saj për t'u harmonizuar me *acquis* të BE-së, Serbia në veçanti do të sigurojë që legjislacioni i miratuar, përfshirë shtrirjen e saj gjeografike, nuk do të biejë në ndesh me normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Kosovën (EU, 2014, p. 16). Bazuar në këtë kusht, Serbia duhet të rrugëtojë drejt BE-së me Kosovën si subjekte juridike ndërkombëtare të ndara.

Dallimi në rastin e Kosovës dhe Palestinës është substancial. Territoret palestineze vazhdimisht cenohen nga Izraeli, i cili ndërmerr aksione të ndryshme edhe ushtarake, ndërkaq, në territorin e Kosovës autoritetin e vetëm mbi sigurinë dhe kontrollin e tij e ushtrojnë trupat e KFOR-it, ushtrisë dhe Policisë së Kosovës.

4.4. Sovraniteti i Palestinës dhe paralelizmi me Kosovën

Sovraniteti është aftësia e qeverisë për të ushtruar autoritetin e saj në territorin e shtetit. Me sovranitet duhet të kuptohet, se pushteti që zbaton “qeveria” e këtij shteti, është pushteti më i lartë, në aspektin formal-juridik i panënshtuar ndaj askujt dhe i pavarur prej cilitdo pushtet tjetër; pra është pushteti kulmor brenda dhe i pavarur jashtë. (Petriç, 2012, p. 235)

Ushtrimi i sovranitetit nga Autoriteti Kombëtar i Palestinës (AKP) në territoret e saj është një sfidë e madhe dhe mjaft komplekse. Disa analistë argumentojnë se AKP-ja, e cila u krijua nën DEP, është një qeveri me fuqi të kufizuar sovrane dhe se AKP-ja kishte vetëm kontroll efektiv mbi popullsinë, jo mbi territorin e saj. Në mbështetje të këtij argumenti, Tal Backer thotë se edhe nëse DEP i dha disa kompetenca administrative AKP-së, fuqitë kryesore të shtetit nuk do të ushtrohen nga AKP-ja, por nga vetë Izraeli; të tilla si siguria e jashtme dhe marrëdhëniet diplomatike. (Hajjaj, 2012, p. 30)

Kjo bëri që AKP-ja në një ose mënyrën tjetër të jetë e varur nga Izraeli. Sipas Marrëveshjes Oslo I, zyrtarisht e quajtur Deklarata e Parimeve mbi Marrëveshjet e Përkohshme Vetëqeverisëse në mes Izraelit dhe Palestinës, ose Deklarata e Parimeve – DEP, gjithashtu e bën të qartë se ka disa kompetenca që Palestina nuk posedon. Palestina mund të krijojë një forcë të brendshme të sigurisë, por jo një ushtri; Izraeli do të vazhdojë të mbrojë zonën nga kërcënimet e jashtme. (Giridhar, 2006, p. 5)

Deklarata e Parimeve (DEP) nuk i ka siguruar Palestinës sovranitet mbi territoret e saj, për më tepër, Autoriteti Kombëtar i Palestinës faktikisht nuk është autoritet i pavarur, dhe nuk ushtron kontroll efektiv të plotë mbi territoret e Palestinës. Është ende e diskutueshme nëse qeveria palestineze ushtron autoritet të mjaftueshëm mbi territoret e saj. Ajo ka kontroll të plotë vetëm mbi një pjesë të tyre, ndërsa në të tjerat, veçanërisht në Bregun Perëndimor, ka kontroll të pjesshëm, pasi Izraeli zotëron pothuajse 60% të territorit. (Pitta, 2018, p. 19)

Kosova para shpalljes së pavarësisë ka ndërtuar institucione funksionale, të cilat dolën nga zgjedhjet e lira dhe demokratike si në nivelin lokal ashtu edhe në atë qendror. Nga viti 2008, Kosova udhëhiqet nga një institucion ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, me një president që shërben si kreu i shtetit dhe një kryeministër, i cili shërben si kreu i qeverisë – i cili ushtron

pushtetin ekzekutiv. Pushteti legjislativ i Kosovës i është dhënë Kuvendit të Kosovës dhe kompetencat gjyqësore përbëhen nga një Gjykatë Supreme me gjykatat tjera nën të (Panganiban, 2015, p. 57). Ndërsa, shtrirja e autoritetit të qeverisë qendrore sfidohet vetëm në veri të vendit, i cili është i banuar me shumicë serbe. Autori Besnik Pula në një artikull mbi sovranitetin e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë, thekson se sovranitetin do ta thjeshtëzoja këtu vetëm në dy aspekte themelore: (1) kontrollin e brendshëm të territorit (ushtrimin efektiv të pushtetit), përfshirë dhe monopolin mbi përdorimin legjitim të mjeteve të dhunës (funksionimi i forcave të armatosura si ushtria dhe policia), dhe (2) legjitimiteti ndërkombëtar mbi territorin. Në qershor 1999, Serbia efektivisht e ka humbur formën e parë të sovranitetit mbi Kosovën. Me njohjen ndërkombëtare pas 17 shkurtit, Serbia e humb edhe formën e dytë të sovranitetit mbi Kosovën (Besnik Pula, 2008). Serbia nuk mund të ushtrojë kontroll mbi territorin e Kosovës, përveç cenimit të sovranitetit që mund ta zhvillojë përmes strukturave ilegale dhe komunave me shumicë serbe, të dala nga decentralizimi etnik.

Vështirësitë në anën e palestinezëve për konsolidim të sovranitetit të brendshëm vazhduan edhe gjatë viteve të '90-ta. Marrëveshja e vitit 1994 e Rripit të Gazës dhe Jerikos bën thirrje për krijimin e një komiteti të përbashkët të quajtur Komisioni për Çështjet Civile dhe Bashkëpunim për të trajtuar çështjet civile në rajon... duke përfshirë infrastrukturën, licencimin, shëndetësinë, transportin dhe çështje të tjera të tilla... Izraeli gjithashtu deklaroi se ka autoritet mbi vendbanimet, Zonën Ushtarake... sigurinë e jashtme, sigurinë e brendshme dhe rendin publik... (Giridhar, 2006, p. 5)

Nga kjo marrëveshje mund të duket sikur Izraeli po konsolidon sovranitetin e tij mbi territoret palestineze, sesa anasjelltas. Në anën tjetër, Kosova vazhdon shtrirjen e sovranitetit të brendshëm, edhe pse nga shumë autorë është e diskutueshme nëse Kosova me të vërtetë ka një qeveri të tillë, sepse "Rezoluta 1244 mbetet në fuqi edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës - ende ekziston një administratë territoriale ndërkombëtare". (Hajaj, 2012, p. 15) Zhvillimi i sovranitetit të Kosovës nuk mbeti peng i Rezolutës 1244, e cila edhe pse ngeli akoma në fuqi, nuk e pasqyron gjendjen faktike në terren. Sot, rreth 4,000 trupa nga KFOR-i, të udhëhequra nga NATO-ja, të siguruar nga 28 vende vazhdojnë të punojnë drejt ruajtjes së një mjedisi të qetë, të sigurtë dhe lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët dhe komunitetet në Kosovë. (NATO, n.d.)

Sovraniteti i Kosovës u forcua edhe me përfundimin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, i cili kishte kompetenca ekzekutive në drejtësi, ndërkaq nga qershori i vitit 2018, ai ka mandat monitorues dhe këshillëdhënës deri në vitin 2020 (EULEX, 2018). Kosova tani ka të gjitha kompetencat në drejtësi dhe autoritetet vendore do të gjykojnë të gjitha rastet. Në fund të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës gjithashtu votoi formimin e ushtrisë së Kosovës. Në ligjin për forcat ushtarake të Kosovës thuhet se Forca e Sigurisë së Kosovës mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës. (Kuvendi i Kosovës, 2019)

Veprime progresive sikur rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve në drejtësi, siguri dhe mbrojtje për Kosovën nënkuptojnë forcim dhe avancim të mekanizmave për ushtrim të sovranitetit në tërë territorin e vendit.

Rëndësi të veçantë në konsolidimin e sovranitetit të brendshëm ka edhe konsensusi politik në raport me çështjet e rëndësishme kombëtare. Si shembull, mund të merret viti 2006, kur Hamasi fitoi zgjedhjet në Palestinë dhe forcat e tjera politike palestineze u përplasën me të.

Pas intensifikimit të përleshjeve mes dy fraksioneve në fillim të vitit 2007, në Mekë u nënshkrua një marrëveshje që solli formimin e një qeverie të unitetit kombëtar. Për fat të keq, ajo u shpërbë nga një shpërthim tjetër i dhunës përmes së cilës Hamasi mori kontrollin e Rripit të Gazës, ndërsa Fatah e konsolidoi kontrollin e saj mbi Bregun Perëndimor, duke hapur rrugën për dy qeveri të veçanta palestineze (Pitta, 2018, p. 18). Ndarjet ndërmjet organizatave palestineze, do të dobësonin edhe më tutje sovranitetin e synuar të tyre. Me fjalë të tjera, kjo ishte vetëcopëtim i integritetit dhe sovranitetit territorial. Lufta me Izraelin për sovranitet, u shndërrua në luftë në mes të vetë palestinezëve për pushtet e territore.

Në nëntor të vitit 1974, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara pasi njohu Organizatën për Çlirimin e Palestinës, përmes Rezolutës 3237, i dha asaj statusin e vëzhguesit në asamble (United Nations, 1974). Ky status i OÇP-së në vitin 2012 u avancua nga vëzhguesi jo-anëtar, në shtet vëzhgues jo-anëtar (United Nations, 2012). Trajtimi i rastit të Palestinës në Kombet e Bashkuara si subjekt shtetëror vëzhgues përmison dukshëm sovranitetin e jashtëm të saj. Përderisa Kosova nuk është anëtare as e BE-së, e as e OKB-së, Palestina të paktën njihet dhe është pranuar si shtet jo-anëtar vëzhgues në OKB. Në krahasim me Kosovën, në sovranitetin e

jashtëm Palestina ka disa përparësi në raport me OKB-në. Megjithatë, anëtarësimi i plotë në OKB, i Kosovës dhe Palestinës mbetet peng i gjeopolitikave ndërkombëtare.

Pasi u arrit një marrëveshje në mes të partive politike Fatah dhe Hamas, në qershorin e vitit 2014, u formua një qeveri e re nën Presidencën e Mahmoud Abbas. Kjo marrëveshje njihet si qeveria e bashkimit palestinez të vitit 2014. Uniteti i kësaj qeverie të re mori njohje nga Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara, Kina dhe Shtetet e Bashkuara. (Panganiban, 2015, p. 68)

Bashkimi i grupeve dhe rrymave të përfaqësuesve palestinezë, dhe njohja e tyre brenda dhe jashtë vendit padyshim që ndikon në avancimin dhe shtrirjen e sovranitetit të brendshëm dhe të jashtëm të Palestinës.

Autori Ian Brownlie argumenton se nuk mjafton vetëm që të ketë një qeveri të themeluar, por një qeveri duhet të ketë kontroll efektiv mbi qytetarët dhe territorin e saj. Ai thotë: “Ekzistenca e qeverisë efektive, me organe të centralizuara administrative dhe legjislative, është dëshmia më e mirë e një komuniteti politik të qëndrueshëm”. Që nga bashkimi i të dyja partive politike, Hamas dhe Fatah, nën një qeveri, tani mund të argumentohet se qeveria e Palestinës ka kontroll efektiv mbi qytetarët e saj edhe me territorin që aktualisht është kontestuar me Izraelin. (Panganiban, 2015, p. 68)

Mungesa e sovranitetit të mjaftueshëm të autoriteteve drejtuese palestineze mbi territoret e tyre, bëri që të jepen interpretime të ndryshme mbi kuptueshmërinë e kriterëve të Montevideos mbi shtetin. Mbështetësit e shtetësisë palestineze argumentojnë se, në Konventën e Montevideos fjala “qeveri” nuk është e kualifikuar nga mbiemri “efektiv”. Në vend të kësaj ai tregon për një praktikë të re shtetërore ku njësitë territoriale mund të njihen si shtete edhe nëse nuk ushtrojnë autoritet të plotë në kohën kur kjo njohje jepet. Ky është rasti me Republikën Demokratike të Kongos, Bosnje dhe Hercegovinën, Timorin Lindor, Kosovën dhe Guinea Bissau. (Stettner, 2012, p. 2)

Me sfida të tilla edhe pse në masë më të vogël është ballafaquar edhe Kosova, pengesa kryesore e kontrollit territorial me të cilën ballafaqohet qeveria e Kosovës është Veriu i Saj, ku shumica serbe jeton dhe refuzon pavarësinë e Kosovës. Shkurtimisht, “vështirësitë për të ushtruar autoritetin qeveritar në Veri të Kosovës, nuk përjashtojnë përfundimin se Kosova ka struktura qeveritare që përfaqësojnë popullin e Kosovës”. Në fakt, krijimi i shteteve të pavarura

kroate dhe Bosnje-Hercegovinës ishte i mundur pavarësisht se qeveria e tyre nuk ushtronte kontroll mbi territoret e tyre. (Hajjaj, 2012, p. 16)

Kosova dhe Serbia përmes negociatave të ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian kanë arritur disa marrëveshje, siç është Marrëveshja për Përfaqësim dhe Bashkëpunim Rajonal, Marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (Deda & Qosaj-Mustafa, 2013), Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve dhe të tjera.

Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve e vitit 2013, bëri integrimin e strukturave serbe, (duke përfshirë edhe ato të komunave veriore të Kosovës) të politikës, drejtësisë dhe sigurisë në kuadër të kornizës ligjore të shtetit të Kosovës. Me këtë marrëveshje në mes tjerash palët pajtohen të mos pengojnë njëra-tjetrën në rrugëtimin e tyre për anëtarësim në BE dhe angazhohen për respektimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura më parë. (Kuvendi i Kosovës, 2013)

Edhe pse Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, me marrëveshjet e arritura ajo lë të nënkuptohet se njeh legjitimitetin e Qeverisë së Kosovës.

Kriteri i qeverisë efektive ka të bëjë me shfaqjen e autoritetit shtetëror në lidhje me territorin dhe popullatën. Kjo përfshin aktet administrative rutinë, si mbledhja e taksave dhe ofrimi i shërbimeve publike, lëshimi i licencave për eksplorimin dhe shfrytëzimin e pasurisë natyrore të një territori etj. Natyrisht, Kosova kryen të gjitha këto funksione. (Global Kosovo, n.d.)

Duhet të përmendim se, Palestina udhëhiqet nga një demokraci parlamentare, e bazuar në tri degë të veçanta të pushtetit; ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor. Kreu i Ekzekutivit është Presidenti i cili zgjidhet direkt nga vota popullore e qytetarëve palestinezë çdo katër vjet (Panganiban, 2015, p. 67). Me këtë organizim funksional vërejmë që në territoret Palestineze, Izraeli mbledh të hyrat tatimore që përbëjnë dy të tretat e buxhetit të AKP-së; ekonomia palestineze është shumë e varur nga tregu izraelit i punësimit; AKP-ja nuk ka infrastrukturën e vet dhe merr energjinë dhe karburantin e saj nga Izraeli; dhe Izraeli kontrollon të gjitha hyrjet dhe daljet në AKP (Hajjaj, 2012, p. 31). Për dallim nga Qeveria palestineze, ajo e Kosovës brenda territorit të shtetit ushtron autoritet efektiv, me sistem juridik, institucional, ekonomik, tregtar etj., të pavarur.

Jerusalemi dhe vendet e cilësuar të shenjta në këto territore, janë pikat e tjera më kontestuese dhe më problematike për një zgjidhje të përhershme të konfliktit.

Në të kaluarën, ndonëse Izraeli kishte aneksuar Jerusalemin Lindor në vitin 1967, ai kishte qenë zyrtarisht i heshtur mbi çështjen e sovranitetit mbi Vendet e Shenjta Islamike; praktikisht, dy xhamitë kontrolloheshin nga Vakfi mysliman... Por Arafat e mohoi kategorikisht çdo zgjidhje që nuk do t'i jepte shtetit të ri të Palestinës sovranitet të plotë mbi Jerusalemin Lindor, përfshirë Haram al-Sharif. (Blaku, 2000)

Edhe në mijëvjeçarin e ri, sovraniteti izraelit mbi vendet e përkufizuara të shenjta në aspektin islam nga palestinezët, shkakton reagimet më të zëshme, duke eskaluar edhe në dhunë.

Rasti tipik ishte vizita e Ariel Sharonit në Malin e Tempullit: Më 28 shtator 2000... Sharoni i vuri shkrepësen fuçisë së barutit. Vizita e tij bëri që të shpërthejnë trazirat dhe rebelimi në Haram al-Sharif i cili u shtri në zona të tjera të Jerusalemit Lindor dhe në qytete të tjera. Brenda një kohe të shkurtër rebelimet degraduan në një revoltë totale – të quajtur Intifada e Al-Aqsas (Fawcett, 2005, p. 254). Këto dhe raste të tjera më vonë tregojnë mbi kompleksitetin e synimeve për sovranitetin e pretenduar të autoriteteve palestineze mbi territoret e tyre.

Ngjashmëri në këtë kontekst me elemente “hyjnore-historike”, ka edhe Kosova, sidomos në festat e Betejës së Humbur të Kosovës, festën e ashtuquajtur “Vidovdan” më 28 qershor, parullat nacionaliste, miti se “Kosova është Jerusalemi serb” etj. Por e drejta hyjnore dhe historike mbi vendet e shenjta, është shumëfish më e sforcuar në kujtesën palestineze dhe të myslimanëve, sidomos edhe për shkak të aktualitetit të vazhdueshëm si burim literature, nga Kurani i shenjtë për myslimanët, ku përmenden tokat në Lindjen e Mesme.

Sovraniteti i jashtëm i Palestinës është më i zhvilluar dhe më pak i kontestuar sesa sovraniteti i jashtëm i Kosovës. Kjo për faktin se akoma është aktive Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kundërshtimi nga Serbia me mbështetje të Rusisë dhe Kinës si dy superfuqi; gjithashtu ndikimi i pesë vendeve të BE-së që nuk e kanë njohur ende Kosovën etj., janë barriera për konsolidim të sovranitetit të jashtëm të Kosovës.

Ndërkaq, sovranitetin e brendshëm Kosova e ka të konsoliduar dhe ka dallime të mëdha nga Palestina. Integriteti territorial dhe sovraniteti i Kosovës është i shtrirë në shumicën e

territorit të Kosovës dhe në të nuk ka ndërhyrje të asnjë subjekti tjetër shtetëror, për dallim nga Palestina së cilës vazhdimisht i cenohet sovraniteti nga Izraeli.

4.5. Palestina dhe Kosova në marrëdhëniet ndërkombëtare

Zotësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet është një tregues i rëndësishëm që i është bashkangjitur njohjes nga vendet tjera. Është një kapacitet jo i kufizuar për kombet sovrane, pasi organizatat ndërkombëtare, shtetet e pavarura dhe organet e tjera mund të hynë në marrëdhënie juridike me subjekte të tjera sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare. (Shaw, 2008, p. 202)

Autori Dixon aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me subjektet tjera të së drejtës ndërkombëtare e vlerëson si “pavarësi juridike”, por jo si “vetëqeverisje praktike”. Sipas tij, një shtet ekziston, atëherë kur territori i tij nuk ndodhet nën autoritetin ligjor e sovran të një shteti tjetër... në këtë kuptim shtetet me pavarësi juridike kanë aftësinë juridike të hyjnë në marrëdhënie me shtetet e tjera në emër të vetvetes. Çështja nëse ato kanë mundësinë ta ushtrojnë praktikisht këtë aftësi juridike nuk ka të bëjë me përcaktimin parimor nëse ato janë apo jo shtete. (Dixon, 2011, p. 174)

Në rastin e Palestinës situata është e komplikuar, në njërin anë palestinezët kanë nënshkruar një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërkaq në anën tjetër përmendet argumenti se Marrëveshja Oslo I, e njohur si Deklarata e Parimeve (DEP) në mes të Palestinës dhe Izraelit e përjashton një mundësi të tillë.

Aftësia e Palestinës për të hyrë në marrëdhëniet e jashtme është e kufizuar rëndë nga Marrëveshja e Përkohshme e vitit 1995... "... nuk do të ketë kompetenca dhe përgjegjësi në sferën e marrëdhënieve të jashtme, sferë e cila përfshin themelimin e ambasadave jashtë vendit, konsullatave ose llojeve tjera të misionëve dhe funksioneve të jashtme ose lejin e themelimit të tyre në Bregun Perëndimor ose në Rripin e Gazës, caktimin ose pranimin e personelit diplomatik konsullor dhe ushtrimin e marrëdhënieve diplomatike. (Giridhar, 2006, p. 6)

Sidoqoftë, ka edhe trajtesa të tjera që rastin e Palestinës e vlerësojnë si subjekt me të drejta dhe përgjegjësi ndërkombëtare. Kjo për faktin se marrëveshja e arritur në Oslo I, i trajton

vetëm kompetencat e Autoritetit të themeluar Palestinez (AP)dhe jo Organizatës për Çlirimin e Palestinës (OÇP).

Aftësia e Kosovës për të qenë pjesë e marrëveshjeve ndërkombëtare, po ashtu kontestohet. Argument për këtë disa autorë përmendin prezencën ndërkombëtare në Kosovë dhe statusin aktiv të Rezolutës 1244 të KS-së së OKB-së. Mbështetja në prezencën e konsiderueshme ndërkombëtare e vë në pikëpyetje aftësinë e Kosovës për të përmbushur kriterin e katërt, kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera. Ky kriter ka kaluar shqyrtime të kujdesshme, pasi shumë akademikë e konsiderojnë këtë më shumë si një pasojë sesa një kusht të shtetësisë... (Taillefer, 2011). Argumentet e përdorura në rastin e Kosovës sigurisht që mund të jenë legjitime, por mund të mos jenë të sakta. Kjo për faktin se tashmë Kosova funksionon e pavarur, e ndarë nga çdo autoritet tjetër dhe përmes kushtetutës dhe akteve të tjera juridike rregullon marrëdhëniet me shtetet tjera.

Aftësia për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera, i referohet kapacitetit ligjor të një subjekti për të marrë pjesë në marrëdhëniet publike ndërkombëtare, duke përfshirë kompetencën ligjore për të përmbushur detyrimet e saj... Ideja është që nëse një njësi plotëson tre kriteret e para (një territor, një popullsi dhe një qeveri) mund të konsiderohet një shtet dhe për këtë arsye ka aftësinë të hyjë në marrëdhënie me shtetet e tjera dhe jo anasjelltas. (Pitta, 2018, p. 4)

Kështu, pavarësia është e lidhur ngushtë me këtë kriter. Një shtet ende mund të jetë nën presion nga një fqinj më i fortë, duke dëmtuar aftësinë e tij për të hyrë në marrëdhënie “siç e sheh të arsyeshme” dhe prandaj do të ishte joreale të kërkohej pavarësi e plotë në mënyrë që një njësi të kualifikohet si shtet. (Persson, 2016, p. 21)

Megjithatë, në praktikë, OÇP u pranua të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me shtetet ose organizatat ndërkombëtare “në dobi të AP-së”. Mund të pohojmë se AP-ja ka aftësinë për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare, edhe pse kjo shpesh ushtrohet nëpërmjet OÇP-së. Për më tepër, nuk ka dallim strikt midis OÇP-së dhe AP-së. Kur ndërveprojnë me qeverinë palestineze, shtetet dhe organizatat ndërkombëtare ndonjëherë i referohen si AP disa të tjerë edhe si OÇP. Konkretisht, të dyja mbajnë një rrjet funksional të

marrëdhënieve diplomatike, përveç pjesëmarrjes në organizata të ndryshme ndërkombëtare me status të ndryshëm (nga vëzhguesi në asociim ose filial). (Pitta, 2018, pp. 19-20)

Autoritetet drejtuese të Palestinës kanë nënshkruar një numër të konsiderueshëm të traktateve shumëpalëshe. Sipas të dhënave që prezanton ueb faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Palestinës, deri në vitin 2018 ajo ka nënshkruar mbi 87 traktate ndërkombëtare, duke përfshirë kategorinë e të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare humanitare, të çarmatimit, çështjeve penale, mjedisit, ligjit të detit, marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore, arbitrazhit tregtar, ligjet e traktateve, atë për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, të UNESCO-s, për zhvillim, transport dhe të tjera. (MFA - Palestine, 2018)

Palestina ka nënshkruar gjithashtu një numër të marrëveshjeve dypalëshe me Turqinë, Egjiptin, Jordanin, SHBA-të, Bashkimin Evropian, Kanadanë, Rusinë, Izraelin, EFTA (Zvicërr, Norvegji, Island dhe Lihtenshtajn), Ligën Arabe, Parlamentin Evropian, Protokollet e Parisit dhe të tjera. (Chamber of Commerce and Industry of Hebron)

Shumica e shteteve që njohin pavarësinë e Palestinës kanë të instaluar misionet e tyre diplomatike, qoftë përmes ambasadave, konsulatave, apo të deleguarve të tjerë diplomatikë. Gjithashtu misionet diplomatike në Palestinë i kanë të vendosura edhe shtetet dhe organizatat që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Palestinës sikurse Komisioni Evropian, Kombet e Bashkuara, SHBA-të, Britania e Madhe, Spanja, Holanda, Japonia, Italia, Gjermania, Franca dhe subjekte të tjera ndërkombëtare. Palestina ka misionet e veta diplomatike në të gjitha shtetet që e njohin, gjithashtu edhe në shtetet dhe organizatat që nuk e njohin pavarësinë e saj. (PASSIA)

Bazuar nga këto të dhëna, mund të konstatojmë që Palestina ka kapacitet për të hyrë në marrëveshje ndërkombëtare, edhe pse është i diskutueshëm statusi shtetëror i saj. Sidoqoftë, më shumë se gjysma e shteteve të botës e njohin pavarësinë e Palestinës, ndërkaq disa prej tyre kanë arritur edhe marrëveshje bilaterale me të.

Kuptimi aktual i kriterit për të pasur “aftësinë për të hyrë në marrëdhëniet ndërkombëtare” është kontestues. Disa argumentojnë se subjekti duhet të ketë vetëm aftësinë teknike për të kryer marrëdhënie të jashtme (d.m.th., të ketë një Ministri të Jashtme). Në ekstremin tjetër, pohohet se ky kriter kërkon që shtetet tjera duhet ta kenë pranuar ofertën për

të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare me entitetin. Kjo, në fakt, do ta bëjë kërkesën e njohjes një element konstituiv të shtetësisë - një pikëpamje që nuk qëndron plotësisht. (Global Kosovo, n.d.)

Kosova ka Ministrinë e Punëve të Jashtme e cila zhvillon aktivitetin e saj të bazuar në dokumentet strategjike të hartuara për të përmirësuar pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Nëse ekzistenca e Ministrisë së Punëve të Jashtme do të ishte argument për plotësimin e këtij kriteri, Kosova e plotëson atë që nga shpallja e pavarësisë.

Në këtë rast, nuk ka dyshim që Kosova, në kushtetutën e saj, i ka dhënë vetes kompetenca të plota mbi çështjet e jashtme dhe administron këto kompetenca nëpërmjet një Ministrie të dedikuar të Punëve të Jashtme. Kosova nuk përfaqësohet më ndërkombëtarisht nga UNMIK-u, ose në bashkëpunim me UNMIK-un. Në vend të kësaj, Kosova ka fituar anëtarësim në institucione të rëndësishme ndërkombëtare, të rezervuara për shtetet, si Banka Botërore, FMN dhe BERZH. (Global Kosovo, n.d.)

Shteti i Kosovës në vitin e 11- të të ekzistimit të tij ka arritur 116 njohje ndërkombëtare prej shteteve nga mbarë bota (MFA, n.d.), ndërkaq disa nga ato shtete kanë përfaqësitë e tyre diplomatike në Kosovë, si SHBA-të, Gjermania, Franca, Britania e Madhe, Italia, Austria, Turqia dhe shtetet tjera.

Duhet të përmendim që prezente në Prishtinë janë edhe misionet e disa prej shteteve që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, si Federata Ruse, Republika Popullore e Kinës, Sllovakia, Rumania, Greqia dhe shtete të tjera (MFA, n.d.). Në Kosovë përmes misionëve të tyre diplomatike janë prezente edhe një numër i organizatave, si OKB-ja, BE-ja, NATO-ja, Këshilli i Evropës dhe organizatat e tjera ndërshtetërore dhe joqeveritare ndërkombëtare. Shteti i Kosovës me mundësitë që ka, ka hapur një numër të ambasadave dhe misionëve të tjera diplomatike në botë, duke vendosur marrëdhënie diplomatike me mbi 88 vende, përfshirë ambasadën e Kosovës në SHBA, Francë, Gjermani, Britani të Madhe, Itali, Kanada, Australi, Japoni, Turqi, Egjipt, në vendet fqinje dhe vende tjera. (MFA, 2018)

Nëse shohim listën e njohjeve të shteteve nga kapitulli i mësipërm, vërejmë se shumica e shteteve demokratike dhe liberale e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Nga krahasimi me

Palestinën vërejmë disa dallime të qarta, të orientimeve gjeostrategjike në politikat ndërkombëtare.

Kosova si shtet ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm të traktateve bilaterale dhe multilaterale. Kosova është anëtare e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe ka nënshkruar Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) me Shqipërinë, Maqedoninë, Kroacinë, Bosnje-Hercegovinën dhe Turqinë. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me qëllim të liberalizimit të tregtisë me BE, hyri në fuqi në prill të vitit 2016. Përveç kësaj, Kosova ka nënshkruar traktate të taksimit të dyfishtë me Shqipërinë, Maqedoninë, Slloveninë, Austrinë, Turqinë, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Mbretërinë e Bashkuar. (Export.gov, 2019)

Gjatë dhjetë vjetëve të fundit, Kosova është bashkuar me mbi 50 organizata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, një dëshmi për njohjen dhe pranimin e gjerë ndërkombëtar të Kosovës në botën multilaterale, duke përfshirë: Marrëdhëniet kontraktuale me BE-në në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit, Konventa Apostille, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës dhe Komisioni i Venecias, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore, Migracionit, Azilit, Iniciativës Rajonale të Refugjatëve dhe të tjera. (GlobalKosovo, n.d.)

Një prej marrëveshjeve më të rëndësishme në nivel ndërkombëtar për Kosovën, është Marrëveshja për Stabilizim-Asociim. Pavarësisht se BE-ja nuk e njeh Kosovën *de jure*, me këtë marrëveshje, *de facto*, BE e njeh Kosovën si palë. MSA është marrëveshje ndërkombëtare e lidhur ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian qëllimi i së cilës është themelimi i marrëdhënieve formale dhe kontraktuale ndërmjet dy palëve me qëllim të anëtarësimit të Kosovës në BE. Përmes MSA themelohet një Asociacion mes Kosovës dhe BE-së i cili ka për qëllim që vendit tonë t'i ofrohet: - Përkrahje për përforcimin të demokracisë dhe sundimit të ligjit. - Përkrahje për stabilitetin politik, ekonomik dhe institucional, si dhe stabilizimin e rajonit... (MIE, 2018)

MSA është një prej marrëveshjeve që ndikon në subjektivitetin tregtar ndërkombëtar, por edhe e përforcon Kosovën si akter në skenën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Në këtë marrëveshje, UE-ja ofron hapje të tregjeve dhe ndihmë të konsiderueshme financiare dhe politike për shtetet përkatëse dhe si kompensim kërkon hapa seriozë drejt reformave politike dhe ekonomike sipas kritereve të Kopenhagës... (Ibrahimi, 2009)

MSA ndikon edhe në marrëveshjet bilaterale të Kosovës me vendet fqinje në Ballkanin Perëndimor dhe mundëson raporte më të relaksuara tregtare. Përmes MSA-së, ndikohen edhe fusha të tjera të drejtësisë, ekonomisë, politikës dhe raporteve ndërfqinjësore. MSA-ja ndikon edhe në forcimin dhe inkorporimin e ligjeve evropiane të tregtisë së lirë, si dhe jep hapësirë për promovimin direkt dhe indirekt të produkteve të Kosovës në vendet evropiane dhe anasjelltas.

Përmes ekonomisë e tregtisë së lirë, në realitet, njihet edhe më shumë subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës. Kosova njihet nga institucionet e BE-së dhe përfaqësuesit e saj, por edhe nga publiku i gjerë, konsumatorët evropianë, bizneset evropiane etj.

Edhe Palestina ka marrëveshje tregtare me vendet fqinje, duke e pasur edhe një marrëveshje për tregti të lirë në zonën arabe, por edhe Kosova ka raporte të mira tregtare me fqinjët e saj, përjashtimisht vitit 2019, kur marrëdhëniet e saj tregtare janë përkeqësuar me Serbinë dhe Bosnje-Hercegovinën. Shumica prej marrëveshjeve bilaterale të Kosovës, janë firmosur me Shqipërinë, si një nga vendet më të afërta fqinje, por edhe për shkak të përbashkësisë kombëtare e kulturore, ngjashëm si Palestina, me elementin e përbashkësisë kulturore-fetare me arabët fqinj.

Sikur Palestina, aftësia e Kosovës për të hyrë në marrëveshje ndërkombëtare është evidente dhe e pamohueshme. Edhe pse statusi aktiv i Rezolutës 1244, mosnjohja nga pesë vendet e BE-së, kundërshtimi madhor i Serbisë, pozicioni kundërshtues i Rusisë dhe Kinës, padyshim që janë një pengesë për intensifikimin e marrëdhënieve ndërkombëtare nga ana e institucioneve të Kosovës.

Kosova gjithnjë e më shumë po maturohet ndërkombëtarisht dhe po konsolidon aftësinë për të hyrë në marrëveshje ndërkombëtare.

4.6. Suksedimi në rastin e Kosovës dhe Palestinës

Suksedimi më së shumti ka rëndësi në fushën e përgjegjësisë dhe të drejtës. Në Konventën e Vjenës për Suksedimin e Shteteve në Lidhje me Traktatet, më 23 gusht 1978, kemi disa nga këto përkufizime konceptesh mbi suksedimin, shtetet paraardhëse e pasardhëse etj. Në këtë studim do të ndajmë vetëm disa nga këto nocione që kanë të bëjnë direkt me nomenklaturën e suksedimit:

(b) "Suksedimi i shteteve" nënkupton zëvendësimin e një shteti nga një tjetër në përgjegjësi për marrëdhëniet ndërkombëtare të territorit;

(c) "Shteti paraardhës" (ang. predecessor state) nënkupton shtetin i cili është zëvendësuar nga një shtet tjetër në shfaqjen e suksedimit të shteteve;

(d) "Shtet pasardhës" nënkupton shtetin që ka zëvendësuar një shtet tjetër me rastin e shfaqjes së një pasardhësi... (Difesa, n.d.)

Në po të njëjtën Konventë, përcaktohet edhe lloji i shteteve që merren në konsideratë për suksedim.

Kjo Konventë zbatohet vetëm për efektet e një vargu të shteteve që ndodhin në konformitet me të drejtën ndërkombëtare dhe, në veçanti, me parimet e së drejtës ndërkombëtare të mishëruar në Kartën e Kombeve të Bashkuara. (Difesa, n.d.)

Suksedimi merr disa elemente të rëndësishme që kanë të bëjnë me trashëgiminë e përgjegjësiwe direkte dhe indirekte. Bartja e përgjegjësisë në shtetin e ri dhe shuarja e një shteti paraardhës, është ndër problematikat kryesore që kanë nxitur nevojën për konventat ndërkombëtare, të tipit të Vjenës. Shuarja apo krijimi i një shteti të ri, shkakton efekte dhe pasoja në shumë fusha në rendin ndërkombëtar, marrëdhëniet ndërkombëtare, Organizatat Ndërkombëtare, në Të Drejtën Ndërkombëtare Publike, në diskutimet mbi Të Drejtën e Intervenimeve Humanitare etj.

Suksedimi ndodh kur një shtet pushon së ekzistuari ose humbet kontrollin mbi një pjesë të territorit të tij, dhe një shtet tjetër vjen në ekzistencë ose merr kontrollin mbi territorin e humbur nga shteti i parë. Një shqetësim kryesor në këtë rast është nëse detyrimet ndërkombëtare të shtetit të mëparshëm janë marrë nga shteti pasues.

Ndryshimet në formën e qeverisë së një shteti, të tilla si zëvendësimi i një monarkie nga një formë demokratike e qeverisjes, nuk modifikojnë ose përfundojnë detyrimet e bëra nga qeveria e mëparshme. Kur shteti pushon së ekzistuari, megjithatë, traktatet e përfunduara në përgjithësi ndërpriten dhe ato të shtetit pasues zbatohen për territorin. (West's Encyclopedia of American Law, n.d.)

Pasi Kosova ishte pjesë e Jugosllavisë dhe me Kushtetutën e vitit 1974 ishte njësi apo krahinë autonome, Kushtetuta Jugosllave e vitit 1974 nuk siguronte qartë as të drejtën e shkëputjes të republikave anëtare. Megjithatë, preambula e kësaj të fundit deklaronte se Kombet e Jugosllavisë, pjesëmarrës të së drejtës për vetëvendosje që u takonte popujve, përfshinte të drejtën për ndarje, pasi që ata ishin bashkuar në mënyrë që të formonin një Republikë Federative të kombeve dhe kombësive të lira dhe të barabarta... (Zeka, 2012, p. 25)

Pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pavarësisht të ish-republikave të saj, ato arritën suksedimin. Mirëpo, Kosova nuk ishte pjesë e marrëveshjes për suksedimin e republikave të Jugosllavisë, e cila u nënshkrua në prill të vitit 2001 nga Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Sllovenisë dhe Republika Federale e Jugosllavisë si shtete të barabarta (Dipublico, 2010). Prandaj, Republika e Kosovës duke shqyrtuar të drejtat e saj mbi kontributet brenda ish RSFJ-së, duhet të ndërmarrë nisma për të zhvilluar procesin e suksedimit.

Sa i përket suksedimit të traktateve, Kosova me kushtetutë ka marrë përsipër respektimin e të gjitha traktateve ndërkombëtare që derivojnë nga ish RSFJ-ja dhe mandati i UNMIK-ut. Në Deklaratën e pavarësisë thuhet: *Marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë Konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore.* (Kuvendi i Kosovës, 2008)

Kosova ka miratuar platformën për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, në të cilën është përfshirë edhe çështja e suksesionit në traktatet ndërkombëtare, në të cilën thuhet: *Ashtu si shtetet tjera përbërëse të*

ish-Jugosllavisë, çështja e suksesionit të Kosovës ndaj detyrimeve të traktateve ndërkombëtare duhet të zgjidhet sipas parimeve të vendosura të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve dhe Konventën e Vjenës për Suksesionin e Shteteve lidhur me Traktatet (Kuvendi i Kosovës, 2019). Kështu, Kosova ka paraqitur qëndrimin e saj për trajtesën edhe të kësaj çështjeje në negociatat përfundimtare.

Në kuadër të suksedimit të traktateve ndërkombëtare, deri në vitin 2019, Kosova ka arritur të zhvillojë këtë proces me disa shtete si: Austria, Belgjika, Britania e Madhe, Çekia, Finlanda, Gjermania dhe shtete të tjera. Në kuadër të këtij procesi është bërë suksedimi i dhjetëra traktateve ndërmjet Kosovës dhe shteteve të përmendura. (MFA, 2016)

Një nismë të tillë, Kosova duhet ta përdorë pos me traktate, konventa shumëpalëshe dhe në rrugën për anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare.

... Një mundësi e mirë është që Kosova të argumentoj anëtarësimet me maksimën se marrëveshjet në vend se të jenë vendosje e obligimeve të reja, janë vazhdimësi e obligimeve ligjore të mëhershme... Një shembull ilustrues i kësaj është se shteti i Malit të Zi është anëtarësuar në UNESCO dhe KE përmes të njëjtit instrument, si secesion i shtetit Serbia dhe Mali i Zi . (Berisha, 2018, p. 11)

Palestina trajtohet si rast i dekolonizimit dhe jo si rast i shkëputjes. Prandaj, autori Hersch citon parimin e trashëgimisë së shteteve në mandatet e “A”, siç përshkruhet nga Traktati i Lozanës. Gjithashtu, traktatet relevante pas luftës gjerësisht pajtohen se, Palestina ishte në të vërtetë një shtet i sapokrijuar. Përveç kësaj, Gjykata e Përhershme e Drejtësisë Ndërkombëtare e njohu shtetin e Palestinës gjatë gjyqimit të saj lidhur me koncesionet e ofruara nga autoritetet osmane. Në këtë drejtim, vlen të përmendet se gjykatat e Britanisë dhe Palestinës arritën në një vendim që qeveria e Palestinës ishte shteti pasardhës dhe prandaj duhej t'u akordoheshin pronat e listuara në listën civile osmane. (Law Student, 2013)

Gjithashtu autori Quigley, argumenton se deklarata e shtetësisë në vitin 1988 nga Këshilli Kombëtar i Palestinës, është një vazhdimësi e jo fillim i shtetësisë. Ky pretendim kërkon të forcojë kërkesën e Palestinës për shtetësinë e saj. Ky supozim është i vërtetë, sidomos duke pasur parasysh faktin se Palestina gëzonte sovranitetin e shtetit që nga kohërat e lashta. (Law Student, 2013).

Për rastin e Palestinës dhe shembujt e tillë si çështje e dekolonizimit, autori Dixon, thekson se në rast se territori që shpallë pavarësinë faktike ka aftësinë të pretendojë për të drejtën e vetëvendosjes, atëherë duket se ai e ka mundësinë e të fituarit të pavarësisë juridike (nëse përmbush edhe kritere të tjera) dhe të “të qenit shtet”. Një territor i dikurshëm kolonial ka të drejtën të realizojë pavarësinë e vet falë këtij parimi dhe duket se nuk ka rëndësi nëse ky akt kryhet në mënyrë të vullnetshme duke pasur pëlqimin e fuqisë së dikurshme koloniale apo në kundërshtim me vullnetin e saj. Dixon pohon gjithashtu se njerëzit e territorit të pushtuar palestinez kanë të drejtë për vetëvendosje dhe çdo veprim që mund t’i kundërvihet kësaj të drejte përbën në vetvete një shkelje të së drejtës ndërkombëtare. (Dixon, 2011, p. 175)

Palestina gjithashtu ka shfrytëzuar të drejtën e aderimit në traktate dhe konventa ndërkombëtare duke aplikuar dhe duke u bërë pjesë e tyre. Palestina në vitin 2014 në bllok ka paraqitur aplikimin për 15 konventa shumëpalëshe. (Berisha, 2018, p. 11)

Në vitin 2017, si shenjë proteste kundër njohjes amerikane të Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit, Autoriteti Palestinez do të dorëzonte dokumentet e kërkuara për nënshkrimin e 22 konventave dhe traktateve ndërkombëtare. (Landau N. , 2017)

Anëtarësimin në traktate dhe konventa ndërkombëtare, palestinezët e kanë shfrytëzuar për njohje dhe rritje të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit.

V. PROCESI I ANTARËSIMIT NË ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

5.1. Pjesëmarrja dhe anëtarësimi i Kosovës dhe Palestinës në nismat rajonale

Shtetet që vazhdimisht kanë konteste të njohjes ndërkombëtare, që nuk marrin mbështetjen e plotë nga superfuqitë më me ndikim, kanë edhe sfida për pjesëmarrje në nismat rajonale e globale. Këtu mund të përmendim edhe Kosovën, edhe Palestinën. Si njëra, si tjetra, kanë pengesa nga më të ndryshmet rreth pjesëmarrjes në forumet dhe nismat rajonale. Pengohen edhe për t'u anëtarësuar në organizata rajonale, të cilat mund të jenë me karakter ekonomik, tregtar, politik, kulturor, por mund të jenë edhe në fushën e sigurisë si: bashkëpunimi kundër trafikimit të drogës, qenieve njerëzore, krimit të organizuar etj.

Kosova dhe Palestina po ashtu pengohen nga shtetet që i kontestojnë ato, por edhe nga shtetet që janë pjesë e këtyre nismave dhe nuk duan të dobësojnë marrëdhëniet me shtetet që i kontestojnë Kosovën dhe Palestinën.

Kosova menjëherë pas përfundimit të luftës, drejtohej nga UNMIK-u. Në fushën e ekonomisë, një nga ngjarjet më të rëndësishme, e që ndërlidhej ngushtë me bashkëpunimin rajonal, ishte Marrëveshja për Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore, e njohur si CEFTA. UNMIK-u nënshkroi marrëveshjen e CEFTA-s në emër të Kosovës më 19 dhjetor 2006. Më 26 korrik 2007 Kosova u bë anëtare fuqiplotë në CEFTA. Para anëtarësimit në CEFTA, Kosova kishte nënshkruar marrëveshje bilaterale të tregtisë së lirë, me Shqipërinë (2003), Maqedoninë (2005), Kroacinë (2006) dhe Bosnjën (2006). Këto marrëveshje u avancuan dhe u unifikuan në kuadër të CEFTA-s, pasi të gjitha këto vende u bënë anëtare të kësaj marrëveshjeje multilaterale. (GAP, 2011)

CEFTA ishte një marrëveshje më e gjerë sesa veç me vendet fqinje. Ajo përfshinte bashkëpunimin e shumë shteteve, e jo krejt fqinjësisht veç me Kosovën. CEFTA (Central European Free Trade Agreement) është një marrëveshje e tregtisë së lirë në të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia. (PSHRK, n.d.)

Një shtet që nuk e njeh ende Kosovën, si Rumania, do të bëhej po ashtu bllokuese për disa nisma rajonale të Kosovës. Sidoqoftë, pasi shtetet si Rumania dhe disa të tjera u anëtarësuan në Bashkimin Evropian, braktisën CEFTA-n... Nëpërmjet CEFTA-s, këto vende pjesëmarrëse u mobilizuan për t'iu qasur institucioneve politike, ligjore dhe ekonomike të Bashkimit Evropian, duke forcuar në këtë mënyrë demokracinë dhe ekonominë e tyre të tregut... (PSHRK, n.d.)

Kosova para shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë, përfaqësohej vetëm nga UNMIK-u, por roli i tij u bë i paqartë pas saj. Situata të tilla konfrontuese, do të lindnin edhe në takime dhe forume të tjera në nismat rajonale. Por me marrëveshjet e fundit me Serbinë, siç do të shohim më vonë, Kosova është më e përfshirë në nismat rajonale, më pak ka ngatërime përfaqësimesh me UNMIK-un dhe më pak ka pengesa siç kishte dikur, e veçanërisht pas “Marrëveshjes për fusnotën”.

... UNMIK-u nënshkroi një numër marrëveshesh ndërkombëtare në emër të Kosovës, të tilla si Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrëveshja e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit, Observuesi i Transportit i Evropës Juglindore, CEFTA, dhe, më e rëndësishmja, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal. (KIPRED, 2014)

Kundërshtimi më i madh i Serbisë për Kosovën, në nismat rajonale, ishte menjëherë pas pavarësimit. Po ashtu, rol bllokues kishin edhe shtetet në afërsi si Bosnja dhe Hercegovina, Rumania, Greqia dhe Qipro, por edhe Spanja e Sllovakia, si pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin ende Kosovën.

Sfidat që hasi Kosova për pjesëmarrje dhe anëtarësim në nisma dhe organizata rajonale bëri që të zhvillojë negociata me Serbinë për të arritur një marrëveshje, e cila do të zbuste apo eliminonte këto kundërshtime të Serbisë.

Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Serbisë për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal u arrit më 24 shkurt 2012. Në marrëveshje palët u morën vesh që Kosova në nisma dhe organizata rajonale të paraqitet me deniminimin Kosova* dhe me fusnotën shoqëruese si në vijim: *“Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës”*. (Qeveria e Kosovës, 2012)

Nga vetë marrëveshja e mësipërme, nuk përjashtohet prania e UNMIK-ut në takime, por Kosova fusnotën e shihte si mjet zhblokues për pjesëmarrje në nismat rajonale. Ngjashëm për të hequr dorë nga bllokimet në integrimet evropiane, anëtarësimin në NATO, edhe Maqedonia pranoi të ndryshonte emrin e saj, për të arritur marrëveshje historike me Greqinë, mbi mospajtimet rreth emërimit të shtetit maqedonas dhe dakordimit që të quhet “Maqedonia e Veriut”.

Në anën tjetër, marrëveshja me Serbinë, ia solli Kosovës disa përfitime, siç është anëtarësimi i saj në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (KBR). Kosova u pranua në këtë organizatë të rëndësishme në shkurt të vitit 2013, ku bordi i RCC-së ndryshoi statutin e organizatës për t’i mundësuar Kosovës pjesëmarrjen (RCC, 2013). Organizata ka 46 anëtarë, ka sekretariatin e saj me seli në Sarajevë dhe një zyrë ndërlidhëse në Bruksel... me qëllim promovimin dhe avancimin e integritit evropian dhe euroatlantik të rajonit. (RCC, n.d.)

Aktualisht ekzistojnë rreth 40 nisma rajonale të cilat përfshijnë një varg të çështjeve të sigurisë, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me bashkëpunimin e policisë, gjyqësorin, ushtrinë, dhe emergjencat – disa prej të cilave janë pjesë e KBR-së. Deri në shtator të vitit 2014, Kosova ka arritur të bëhet anëtare vetëm e dy prej këtyre nismave (SEECF dhe ILECU), ndërsa vazhdon të ngecë në anëtarësimin e saj në nismat e tjera, ku Kosova kryesisht ose vazhdon të pres përgjigje ose i kthehen refuzime të qarta. (KCSS, 2014, p. 14)

Objektivat kryesorë të SEECF janë: rritja e bashkëpunimit politik dhe të sigurisë; nxitjen e bashkëpunimit ekonomik; zgjerimi i bashkëpunimit në fushat e dimensionit njerëzor, demokracisë, drejtësisë dhe luftimit të aktiviteteve ilegale. (RCC, n.d.)

ILECU synon përmirësimin e qëndrueshëm të bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar dhe rajonal në luftën kundër krimit të organizuar transnacional, i cili kontribuon në forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë në Evropën Juglindore. (LBI, n.d.)

Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për krijimin e kësaj të fundit, e cila do të funksionojë si pjesë e Policisë së Kosovës. Në këto njësi do të përfshihen: Zyrat e INTERPOL, EUROPOL, EUROJUST dhe FRONTEX. (Curri & Loshi, 2013, p. 76)

Kosova gjithashtu është pjesë e Nismës Rajonale për Migracion, Refugjatët dhe Azilin (MARRI). MARRI ka mandat që të promovojë bashkëpunim më të afërt rajonal dhe qasje të

përbashkët, gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar në fushat e azilit, kontrollit kufitar, regjimit të vizave, integritit dhe kthimit të refugjatëve me synimin për të arritur standardet ndërkombëtare dhe evropiane në këto fusha. (MARRI, n.d.)

Kosova nuk është anëtare në RACVIAC/ Qendra për Bashkëpunim në Fushën e Sigurisë në Evropën Juglindore, mirëpo në takimin MAG më 10 tetor 2014, Kosova u ftua të merrte pjesë në mënyrë të përhershme, në të gjitha nivelet dhe në kushte të barabarta në të gjitha aktivitetet dhe takimet e RACVIAC & MAG. (RACVIAC, n.d.)

Bashkëpunimi rajonal nuk është me rëndësi vetëm në fushën diplomatike dhe ekonomike, por edhe në atë që konsiderohet motivi bazik i qenieve njerëzore, por edhe i shteteve: siguria. Në të kundërtën, pasojat janë në mekanizmat më të dobët në reagimet ndaj kërcënimeve të sigurisë, ndaj të cilave duhet të përballesh si shtet i vetëm.

Për fat të keq, nga tri iniciativat rajonale të synuara në zhvillimin social, Kosova nuk është anëtare e Rrjetit Shëndetësor të SEE ose Qendrës për Shërbimet Publike të Punësimit të Evropës Juglindore. (Curri & Loshi, 2013, p. 76)

Bashkëpunimi rajonal i paraprin atij evropian. Bashkëpunimi më i ngushtë rajonal është një parakusht për vendet që synojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian. Nxitja e marrëdhënieve më të ngushta midis vendeve të Ballkanit dhe Evropës Juglindore do të thotë intensifikimin e tregtisë, nxitjen e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe ideve, dhe bashkëpunimin drejt ndjekjes së përgjithshme të objektivave të përbashkëta. (MFA, 2016)

Kosova është pjesë e disa projekteve, forumeve, konferencave dhe iniciativave rajonale si: “Kapitulli i mbyllur në Ballkan”, “Një Arkitekturë e Ardhshme e Sigurisë për Evropën Juglindore”: “Krijimi i Çështjeve”, Konferenca “Chevening” për Lidërsipin Rajonal, Konferenca “Fuqizimi i Ballkanit”, Konferenca Rajonale “Formimi i Ardhmërisë së Vendeve të Evropës Juglindore”, Projekti “Përmirësimi i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes rajonale të Kosovës”, Forumi i Miqësisë së Kosovës - Malit të Zi “Radovan Zogoviq”, Seminari Rajonal: Bashkëpunimi Rajonal në Ballkanin Perëndimor, Konferenca Ndërkombëtare mbi Diplomacinë Publike në shërbim të bashkëpunimit ndërkufitar etj. (MFA, n.d.)

Në shumë organizata rajonale të sigurisë, Kosova është bërë anëtare si në ILEXU, SEECP etj., por jo në PCC SEE, SELEC etj. Ka pasur edhe pengesa të tjera në nismat rajonale të Kosovës, si ajo për përfitime të programeve të PSTOC-it, A-5 etj.

Një proces që ka qenë mjaft entuziast për nxitjen e bashkëpunimit rajonal ishte edhe “Procesi i Berlinit”. Procesi i Berlinit ishte iniciuar në vitin 2014 nga Kancelarja gjermane Angela Merkel, në të cilin përfshihen dymbëdhjetë shtete, gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor të cilat janë në faza të ndryshme të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian dhe gjashtë shtete anëtare të BE-së. (Veseli, 2016)

Edhe në ditët e sotme, përmendet “Procesi i Berlinit”, por në mënyrë mjaft të zbehtë.

Në vitin 2019, u bë i njohur edhe “Samiti i Berlinit” për Ballkanin Perëndimor, poashtu nën drejtimin e Merkelit dhe Presidentit të Francës Emmanuel Macron, i cili nuk solli ndonjë rezultat konkret. (Shehu, 2019)

Kosova akoma ka pengesa në pjesëmarrjen dhe fuqizimin rajonal, nga arsye të llojllojshme si: mënyra se si prezantohet në këto forume, kundërshtimet e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, lobimi i Serbisë kundër pjesëmarrjes së Kosovës etj.

Në vitin 2018, Kosova kishte hequr dorë nga pjesëmarrja në një forum në Shkup të Maqedonisë së Veriut për shkak të fusnotës. Iu referuan Kosovës me fusnotë dhe rezolutën 1244, e kjo bëri që Koordinatorin Nacional për mbrojtje nga Dhuna në Familje... të anulojë pjesëmarrjen në Forumin Rajonal “Promovimi dhe Implementimi i Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”. (FaktePlus, 2018)

Edhe Palestina vazhdon të ketë vështirësi në bashkëpunimet, nismat dhe anëtarësimet rajonale. Një përkrahje të madhe e ka që rrethohet me shumë shtete që ndajnë afërsinë e përbashkët kulturore, duke iu lehtësuar rruga e bashkëpunimit dhe anëtarësimit. Le të shërbehemi me rastin e Ligës Arabe, me 22 shtete me shumicë islame, ku Palestina pranohet si anëtare e saj, që në fillim të formimit si organizatë e fuqishme rajonale. (BBC, 2017)

Qëllimet e Lidhjes janë për të punuar “drejt së mirës së përbashkët të të gjitha vendeve arabe, përmirësimi i statusit të tyre, e ardhmja e sigurtë dhe realizimi i aspiratave dhe shpresave të tyre” që të sigurojnë përfitime ekonomike, sociale dhe politike. Ndërsa përparime të konsiderueshme pati në çështjet ekonomike dhe sociale, dhe megjithëse Pakti i vitit 1945

mishëroi një garanci për të mbrojtur [pavarësinë dhe sovranitetin] e çdo anëtar, përparim i vogël politik është arritur ndonjëherë (Kechichlan, 1994). Sidoqoftë, për Palestinën është përparësi e madhe anëtarësimi në këtë organizatë pasi promovon idenë saj për vetëqeverisje dhe pavarësi edhe në mekanizmat tjerë ndërkombëtarë.

Në Lindje të Mesme ekzistojnë disa organizata, traktate, konventa dhe marrëveshje ndërmjet shteteve. Përpos Lidhjes Arabe të tjerat janë të natyrave të ndryshme dhe funksionojnë kryesisht bazuar në lidhjet gjeografike të shteteve. Palestina nuk është anëtare në Këshillin e Bashkëpunimit të vendeve të Gjirit (GCC), organizatë politike, ekonomike dhe e sigurisë. (International Peace Institute, 2013)

Palestina është pjesë e Këshillit të Unitetit Ekonomik Arab (EECU), nismë tjetër e rëndësishme regjionale e cila ka për qëllim nxitjen e tregtisë midis vendeve arabe; të punoj për të arritur unitetin e plotë ekonomik mes vendeve anëtare; të sigurojë të drejta të barabarta për shtetet anëtare dhe qytetarët e tyre... (UIA, 2014)

Palestina është bërë pjesë edhe e disa nismave dhe marrëveshjeve që kanë për qëllim zhvillimin ekonomik dhe tregtar. Marrëveshja e Agadirit është një marrëveshje e tregtisë së lirë midis Egjiptit, Jordanisë, Marokut dhe Tunizisë. E quajtur sipas qytetit të Agadirit në Marok - ku procesi i krijimit të paktit u lansua në maj të vitit 2001, u nënshkrua në Rabat në shkurt 2004 dhe hyri në fuqi në mars të vitit 2007. Në vitin 2016, pas gjashtë vjetësh pasiviteti, marrëveshja u ringjall. Në prill, Libani dhe Palestina iu bashkuan paktit të tregtisë. Janë nënshkruar gjithashtu pesë protokolle dhe dy memorandume. (Bilaterals, 2017)

Rol në bashkëpunimin rajonal kanë luajtur jo vetëm vendet fqinje arabe, por edhe vendet aziatike me ekonomi të fuqishme, si Japonia. Në korrik të vitit 2006, Qeveria e Japonisë propozoi “Korridorin për Paqe dhe Prosperitet” si një nismë afatmesme dhe afatgjatë ndaj bashkëjetesës dhe bashkëprosperitetit midis Izraelit dhe Palestinës... Për të arritur konceptin e Korridorit për Paqe dhe Prosperitet, JICA po kryen bashkëpunim teknik për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm, si dhe bashkëpunimin teknik dhe ndihmën financiare për infrastrukturën për ndërtimin e Parkut Agro-Industrial “Jericho”. (JICA, n.d.)

Po ashtu, një ndihmë lehtësuese po e japin iniciativat e shoqërisë civile dhe qendrat e ndryshme për dialogun e bashkëpunimin izraelito-palestinez. Qendra për Hulumtim dhe

Informim Izrael-Palestinë (IPCRI) u themelua në Jerusalem në vitin 1988 për të nxitur dialogun në mes të shoqërisë civile izraelite dhe palestineze. Në atë kohë dhe për më shumë se një dekadë, ishte i vetmi institut i përbashkët izraelito-palestinez në botë. Në vitin 2013, qendra u quajt “Izraeli-Palestina: Iniciativa Rajonale Kreative”, sepse fokusi i saj është zhvendosur nga programet e orientuara drejt hulumtimit në një punë më të mirë në terren dhe publik. (Peaceinsight, 2017)

Për dallim nga Kosova, Palestina e ka qasjen më të lehtë në nisma dhe organizata rajonale, kjo për faktin që shumica e shteteve të rajonit të Lindjes së Mesme kanë shumë karakteristika të përbashkëta etnike, gjuhësore dhe fetare.

Ka edhe nisma të tjera në fushat sociale, gjinore e rinore. Një nga to është edhe Iniciativa Rajonale Arabe e njohur si “ActionAid”, e cila është një lëvizje e organizatave dhe individëve që punojnë në të gjithë Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, të motivuara nga avancimi i të drejtave sociale, ekonomike dhe qytetare të grave dhe të rinjve... (ActionAid, n.d.)

Kjo iniciativë ka disa qendra në rajonin e Lindjes së Mesme, duke përfshirë edhe Palestinën. ActionAid - Iniciativa Rajonale Arabe aktualisht operon nga selia e saj rajonale në Aman, me veprimtari programore në Jordani, Liban, Marok dhe Tunizi me një program partneriteti shtesë në Palestinë. (ActionAid, n.d.)

Edhe nismat tjera të bashkëpunimit rajonal, kanë në fokus direkt Palestinën, sikurse është Misioni i UFM-së (Union for the Mediterranean). Misioni i UFM-së është të rrisë bashkëpunimin rajonal, dialogun dhe zbatimin e projekteve dhe iniciativave me ndikim... me theks të veçantë tek të rinjtë dhe gratë, në mënyrë që të adresohen tre objektivat strategjike të rajonit: stabiliteti, zhvillimi njerëzor dhe integrimi. (UFM, n.d.)

UFM është organizata ndërqeveritare euro-mesdhetare e cila bashkon të gjitha 28 vendet e Bashkimit Evropian dhe 15 vendet e Mesdheut Jugor dhe Lindor. (UFM, n.d.)

Palestina merr pjesë edhe në forumet rajonale të temave të tjera, si ato që kanë të bëjnë me burimet ujore, ekologjike etj. Një nga bashkëpunimet më të rëndësishme është edhe partneriteti me Bashkimin për Mesdheun.

Pas marrëveshjes së paqes të vitit 1994 ndërmjet Jordanisë dhe Izraelit, iniciativat e bashkëpunimit rajonal lulëzuan, megjithëse frytet e përpjekjeve të tilla mbeten të pazgjidhura. Disa nga shembujt përfshijnë: Grupi Punues për Zhvillimin Ekonomik Rajonal (REDWG) - i cili

vepron nën drejtimin e Bashkimit Evropian (BE), u formua për të nxitur bashkëpunimin ekonomik midis katër palëve kryesore në paqe - Egjipti, Izraeli, Jordania dhe Autoriteti Kombëtar Palestinez (AKP). (Al-Khouri, 2000)

Edhe në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, sa herë iu kanë referuar me rezoluta zgjidhjes së konfliktit izraelito-palestinez, por edhe çështjes së kthimit të refugjatëve palestinezë nga vendet si Libani, Siria, Jordania etj., e kanë përmendur bashkëpunimin rajonal, në të mirë të sigurisë, stabilitetit dhe mirëkuptimit:

Jo vetëm për bashkëpunim rajonal, por ekspertët e ekonomisë thërrasin edhe në bashkëpunimin e Palestinës me Bashkimin Evropian, si interes afatgjatë ekonomik. Provat tregojnë se në periudhën afatgjatë, eurozona do të bëhet partneri më i rëndësishëm tregtar i Palestinës dhe eurot janë monedha të qëndrueshme dhe të përshtatshme ankoruese. (Cobham & Kanafani, 2004)

Komisioni Evropian është donatori më i madh i ndihmës së jashtme ndaj palestinezëve. Mbështetja e saj bazohet në një partneritet të përbashkët, të themeluar në bazë të Marrëveshjes së Përkohshme të Asocimit mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin. U nënshkrua në vitin 1997 midis Komunitetit Evropian dhe OÇP-së në emër të Autoritetit Palestinez. Plani i veprimit BE-Palestinë u miratua në maj të vitit 2013, duke përcaktuar agjendën për bashkëpunim ekonomik dhe politik me BE-në dhe mbetet në fuqi deri në vitin 2020. (EC, n.d.)

Së bashku me Izraelin dhe Jordanin, Palestina merr pjesë në Iniciativën Evropiane të Ndërtimit të Paqes (ish-Programi i Partneritetit për Paqe)... Por e përbashkëta e Kosovës dhe Palestinës për shkak të barrierave në njohjen ndërkombëtare, është fusnota e përbashkët.

Në faqen e saj zyrtare për Palestinën, Komisioni Evropian, kur iu referohet me asteriks apo fusnotë Palestinës, sqaron: *"*Ky përcaktim nuk do të interpretohet si njohje e një shteti të Palestinës dhe nuk paragjykon pozicionet individuale të Shteteve Anëtare për këtë çështje"*. (EC, n.d.)

Nga kjo që paraqitëm deri më tash, mund të përmbledhim qëndrimin se, si Kosova, si Palestina, në rrugëtimet e tyre për shtetndërtim dhe njohje ndërkombëtare, ndonëse me heqjen dhe reduktimin e aq shumë pengesave në anëtarësimet në organizatat rajonale e ndërkombëtare, akoma hasin në shumë vështirësi të pranimit, pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit

rajonat. Për dallim nga Kosova dhe vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, që janë nxitur për kohë të gjatë edhe nën deklaratimet diplomatike për bashkëpunim rajonal dhe me synimet për integritet e gjera evropiane, anëtarësimin në BE dhe NATO, në Lindjen e Mesme ndryshon panorama e fqinjësisë së mirë.

Palestina e rrethuar me dhjetëra shtete me shumicë myslimane, vështrohet me afërsi më të mëdha kulturore dhe diplomatike me shtetet fqinje, me përjashtim të vetëm, me shtetin që e konteston atë: Izraelin. Ndërsa për dallim nga Palestina, Kosova me përjashtim të afërsisë kombëtare me Shqipërinë dhe afërsinë kulturore e gjeografike me pakicat etnike shqiptare në Luginën e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, kulturalisht është shumë më e ndryshme me shtetet fqinje, duke e përfshirë edhe Serbinë.

Kosova ka njohje ndërkombëtare më pak se Palestina, ka po ashtu pengesa rajonale si Palestina, ka përfshirje të pjesshme në rajon, sikurse Palestina në rajonin e Lindjes së Mesme. Palestina e përballur me konflikte të herëpashershme, me fuqinë politike e ushtarake të Izraelit në botë, me përkrahjen edhe të shteteve të superfuqishme për të, ka akoma vështirësi të mëdha në integritet rajonale. Por edhe Kosova, me mosnjohjen nga Greqia, Bosnja dhe Hercegovina, Rumania dhe Qipro, por edhe nga Sllovakia e Spanja, dhe lobimin aktiv e sistematik të Serbisë për të bllokuar Kosovën, vazhdon të ketë jo pak sfida në bashkëpunimin, përfaqësimin dhe anëtarësimin në organizatat rajonale.

5.2. Bashkimi Evropian dhe Kosova

Sikurse çdo organizatë tjetër botërore, edhe Bashkimi Evropian (BE), njërën ndër kriteret e para të përgjithshme për pranimin e anëtarëve të rinj, e ka detyrimin e anëtarit të ri t'i përshtatet standardeve të saj.

BE vepron me procedura gjithëpërfshirëse të miratimit... përkatësisht: në përputhje me të gjitha standardet dhe rregullat e BE-së, duke pasur pëlqimin e institucioneve të BE-së dhe të shteteve anëtare të BE-së, me pëlqimin e qytetarëve të tyre - siç është shprehur përmes miratimit në parlamentin e tyre kombëtar ose me referendum. (EU, 2016)

Nëse në OKB kërkohet që në radhë të parë, shteti që aplikon të jetë shtet paqedashës, në BE, para së gjithash, kërkohet të respektojë vlerat demokratike. Më pas, rol të rëndësishëm në përcaktimin e kriterëve të përgjithshme për anëtarësim, merren “Kriteret e Kopenhagenit”.

Traktati mbi Bashkimin Evropian thotë se çdo vend evropian mund të aplikojë për anëtarësim nëse respekton vlerat demokratike të BE-së dhe është e përkushtuar t'i promovojë ato. Vendet që dëshirojnë të bashkohen duhet të kenë: institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e pakicave; një ekonomi funksionale të tregut dhe kapacitetin për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut në BE; dhe aftësia për të marrë dhe zbatuar në mënyrë efektive detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë respektimin e qëllimeve të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar. (EU, 2016)

Kosova ballafaqohet me papunësi të lartë, varfëri, pasiguri në vendin e punës, shkallë asimetrike në raportin eksport-import, duke mbizotëruar importi mbi 90 përqind krahasuar me eksportin. Fuqia e Kosovës për t'i përballuar konkurrencës dhe forcave të tregut në BE është e dobët, por problemi kryesorë i saj qëndron te papunësia në shkallë të lartë.

Në fakt, shkalla e papunësisë vlerësohet në rreth 34.6% (shkalla më e lartë në Evropën Juglindore) dhe Kosova është ndër vendet më të varfëra në Evropë, me gati një të tretën e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë. Për më tepër, vendi vuan edhe nga nivelet e larta të krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe mungesës së transparencës. (SA, 2018)

BE-ja po ashtu ka kushtëzuar vendet e Ballkanit Perëndimor edhe me shumë kritere të tjera shtesë. Madje për Kosovën, edhe për liberalizim vizash, ka vënë kushte që nuk i ka vënë asnjë shteti tjetër gjatë procedurave për liberalizim, siç ishte miratimi i demarkacionit të kufirit Kosovë-Mali i Zi. Kriteret shtesë për vendet e Ballkanit Perëndimor, u vendosën sidomos në nxitjen e raporteve të mira ndërfqinjësore dhe distancimin nga e kaluara e trazuar nga luftërat ndëretnike etj.

BE-ja gjithashtu duhet të jetë në gjendje të integrojë anëtarët e rinj. Në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor kushtet shtesë për anëtarësim u përcaktuan në të ashtuquajturin “Procesi i Stabilizim-Asociimit”, kryesisht lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e

fqinjësisë së mirë... Këto rregulla ndahen në 35 fusha të ndryshme të politikave (kapituj), siç janë transporti, energjia, mjedisi etj. Secila prej të cilave negociohet veçmas. (EU, 2016)

Institucionet e BE-së po ashtu mbikëqyrin sistematikisht përparimin dhe progresin e këtyre vendeve ballkanike, duke përfshirë edhe Kosovën. Në rastin e Kosovës, ka pasur raporte të rregullta të ashtuquajtura “Raporte të Progresit”, ku tregohen dobësitë institucionale të Kosovës, përparimet dhe ngecjet në shumicën e fushave. Gjatë gjithë negociatave, Komisioni vëzhgon përparimin e kandidatit në zbatimin e legjislacionit të BE-së dhe përmbushjen e angazhimeve të tjera, duke përfshirë çdo kërkesë referimi. (EU, 2016)

Në rrugën e saj integruese, pos tjerash Kosova duhet të zhvillojë dialogun me Serbinë. Në raportin e zgjerimit të Komisioni Evropian të vitit 2018 për Ballkanin Perëndimor, thuhet se: “Një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe ligjërishme e detyrueshme për normalizimin është urgjente dhe vendimtare në mënyrë që Serbia dhe Kosova të përparojnë në rrugët e tyre evropiane.” (European Commission, 2018, p. 8)

Prandaj, Kosova duhet të bëjë çmos që të vazhdojë dialogun në mënyrë që të arrijë objektivat për avancim të statusit të saj në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Sfida e marrëveshjes me Serbinë nuk është e vetmja në rrugën e anëtarësimit të Kosovës në BE.

Në një studim të punuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politika, konkludohet se janë të tejkalueshme pengesat ligjore me të cilat ballafaqohen aspiratat e Kosovës për statusin e kandidatit.

“Neni 49, i cili *prima facie* duket se imponon një kusht që Kosova nuk është në gjendje të përmbushë, domethënë të jesh të kualifikuar si një ‘shtet’ - nuk do të përfshinte njohjen e shtetit nga Bashkimi Evropian, duke parë se një kompetenca [sic] e tillë nuk është përcaktuar në Traktat. Si rezultat, termi “shtet evropian” nuk nënkupton shtetësinë, njohje nga BE, e cila nuk ka kompetenca për ta bërë këtë, apo shtetet anëtare, të cilat kanë të drejtë të pavarur për të njohur këdo që dëshirojnë”... (Tuhina & Palokaj, 2018)

Sidoqoftë, raportet e Kosovës me BE-në nuk duhet të vazhdojnë me këtë ritëm, ato duhet të dinamizohen, kryesisht si rezultat i rritjes së efikasitetit në punë të institucioneve të Kosovës

në përmbushjen dhe zbatimin e marrëveshjes së Agjendës Evropiane të Reformave (ERA) dhe Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim (MSA).

Edhe Serbia si kundërshtar e Kosovës, synon anëtarësimin e saj në BE dhe shumë çështje, e veçmas kapitulli i 35-të i BE-së, ndërlidhet me Kosovën dhe kjo është parë si një kushtëzim shtesë që i kërkohet Serbisë për zgjidhjen e çështjeve të hapura me Kosovën. Aktualisht gjasat për anëtarësim të Kosovës në BE janë shumë të vogla dhe nuk pritet para një dekade, në minimum, e veçmas, kur dihen vonesat edhe në vetë liberalizimin e vizave, ku Kosova është i vetmi vend, qytetarët e të cilit nuk kanë të drejtë të lëvizin pa viza as edhe në vitin 2019.

Në raportin e zgjerimit të Komisionit Evropian të vitit 2018 për Ballkanin Perëndimor, theksohet edhe çështja se, Bashkimi Evropian duhet të jetë më i fortë para se të jetë më i madh: *“Vetë BE-ja duhet të sigurojë që ajo të jetë gati institucionalisht për të mirëpritur shtetet e reja anëtare pasi të kenë përmbushur kushtet e vendosura. Bashkimi duhet të jetë më i fortë dhe më solid, para se të jetë më i madh”* (European Commission, 2018, p. 16). Serbia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Kosova, ndonëse synojnë anëtarësimin në BE, ai nuk do të varet vetëm nga plotësimi i kriterëve, por edhe nga gatishmëria e organizatës për të pranuar anëtarë të rinj. Sfidat më të mëdha për anëtarësim në BE aktualisht pritet të jenë për Bosnje-Hercegovinën dhe veçanërisht për Kosovën.

5.3. Anëtarësimi dhe qëndrimi i NATO-së në rastin e Kosovës dhe Palestinës

Kosova konsideron se NATO ka qenë forca shumëkombëshe e çlirimit të saj nga ushtria dhe policia jugosllave, ndërsa Serbia, e konsideron atë si “agresore të integritetit territorial të Jugosllavisë, përkatësisht të Serbisë”, pas sulmeve ajrore në vitin 1999.

Shtatëdhjetë e tetë ditë fushatë bombarduese kundër Serbisë në pranverë dhe vera e hershme e vitit 1999 ishte konflikti i fundit i madh ndërkombëtar në shekullin më të përgjakshëm të të gjithë shekujve. Ishte gjithashtu i pari në disa aspekte - herën e parë në pesëdhjetë vite të ekzistencës që Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior shkoi në luftë, hera e parë që një koalicion i vendeve sulmoi një regjim për t'i dhënë fund brutalizimit të një pakice kombëtare, herën e parë që vetëm fuqia ajrore ishte e mjaftueshme për të siguruar fitore, dhe herën e parë

që forcat e armatosura të SHBA-së kryen një operacion të qëndrueshëm ushtarak pa vuajtur një fatkeqësi të vetme luftarake. (Norris, 2005)

Për të analizuar më tej qëndrimet e NATO-së ndaj Kosovës dhe Palestinës dhe anëtarësimin në këtë organizatë të fuqishme të sigurisë evropiane e botërore, duhet para së gjithash të shkëpusim një nga qëllimet e kësaj organizate ushtarake.

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) është një aleancë ushtarake e themeluar në vitin 1949. Aktualisht, NATO ka 29 anëtarë. Në vitin 1949, kishte 12 anëtarë themelues të Aleancës: Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Vendet e tjera anëtare janë: Greqia dhe Turqia (1952), Gjermania (1955), Spanja (1982), Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia (1999), Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia (2004), Shqipëria dhe Kroacia (2009), dhe Mali i Zi (2017) (NATO, 2019). Mali i Zi është anëtar i më i ri i organizatës, ndërsa shumë shpejt, edhe Maqedonia e Veriut do të bëhet anëtare e saj, ku do të rritet sërish numri i shteteve anëtare të NATO-s.

Nga këto shtete anëtare pavarësinë e Kosovës akoma nuk e kanë njohur katër shtete, duke përfshirë: Spanjën, Greqinë, Rumaninë dhe Sllovakinë. Këto shtete bëjnë pjesë edhe në pesëshen e shteteve anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën. Tri nga katër shtetet, Greqia, Rumania dhe Sllovakia kanë njohur pasaportën e Kosovës, ndërkaq Spanja mbetet akoma shteti me kundërshtinë më të madhe ndaj pavarësisë së Kosovës. Kështu që një ndryshim eventual i statusit të tyre karshi pavarësisë së Kosovës do të ketë efekte në dy organizata të rëndësishme ndërkombëtare.

Nëse krahasojmë njohjet e shteteve anëtare të NATO-së për Kosovën dhe Palestinën, atëherë gjejmë një dallim të madh. Pavarësia e Palestinës nuk njihet nga 18 shtete anëtare në mesin e të cilave janë: Belgjika, Kanada, Danimarka, Franca, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Greqia, Gjermania, Spanja, Estonia, Letonia, Lituania dhe Kroacia.

Kosova ka shprehur hapur orientimin Euro-Atlantik të saj dhe njëri nga synimet kryesore në politikën e jashtme është edhe anëtarësimi në NATO. Kosova nuk ka mundur që të aplikojë për anëtarësim në NATO deri në fund të vitit 2018, kur edhe u themelua ushtria e Kosovës.

Ndërkaq, kontribut të çmuar në ndërtimin e kapaciteteve për ushtrinë e Kosovës kanë dhënë shumica e vendeve anëtare të NATO-së. Prandaj, Kosova ka shpresë se me konsolidimin e ushtrisë në bashkëpunim me NATO-në do të vjen edhe anëtarësimi në këtë organizatë. Në krahasim me Kosovën, Palestina do të ketë më sfida rrugën e bashkëpunimit me NATO-n, kjo për faktin e raporteve speciale të SHBA-ve me Izraelin dhe se më shumë se gjysma e shteteve anëtare, nuk e njohin atë si shtet.

NATO me trupat e saj shumëkombëshe është prezente në Kosovë që nga viti 1999, ndonëse operon me Rezolutën 1244, ndërsa në Lindjen e Mesme, po ashtu ka interesim aktiv. Për NATO-n, Dialogu Mesdhetar, ka qenë ndër nismat më të rëndësishme për stabilitetin dhe dialogun në Lindjen e Mesme. Dialogu Mesdhetar u themelua në vitin 1994 dhe që nga fillimi, Izraeli ka qenë një nga pjesëmarrësit më dinamik. Kjo iniciativë mbledhi Izraelin dhe partnerët e saj arabë rreth të njëjtës tryezë, duke i angazhuar ata në një dialog politik dhe të sigurisë dhe duke prekur bashkëpunimin ushtarak... (Rasmussen, 2011). Roli dhe veprimtaria e organizatës nuk është vetëm ushtarak dhe nuk kufizohet vetëm në Botën Perëndimore.

NATO-ja ushtron veprimtarinë e saj në Kosovë përmes misionit të KFOR-it. KFOR-i vazhdon të kontribuojë në ruajtjen e një mjedisi të sigurt, të qetë dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë në Kosovë.

Po çfarë raporte ka aktualisht NATO me Kosovën? Pas shndërrimit të Forcave të Sigurisë së Kosovës në ushtri përmes legjislacionit Kosovar, kreu i NATO-s kishte kritikuar Kosovën për këtë veprim.

Shefi i Aleancës Veri-Atlantike, Jens Stoltenberg, ka thënë se Kosova do të ketë pasojë nëse vazhdon me planet e saj. *“Kemi biseduar për planet e Kosovës për ta transformuar Forcën e Sigurisë në ushtri. Një hap i tillë ndodh në kohën e gabuar dhe është kundër këshillave që Kosovës ia kanë dhënë shumë aleatë të NATO-s dhe mund të ketë pasojë serioze për integritetin euro-atlantik të Kosovës.”* (Sulaj, 2018)

Diskutimet më të rrepta që bëhen pas krijimit të ushtrisë së Kosovës, është se a ka të drejtë Kosova të angazhojë FSK-në pa lejen e NATO-s, në rast se kërkohet ushtria për ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit territorial, punën e së cilës para krijimit të saj, e bënte KFOR-i dhe Njësia Speciale e Kosovës “NJSO” apo e njohur si “ROSU”?!

Neni 4 i Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës parasheh:

Ushtria e Kosovës ka për detyrë kryesore mbrojtjen e sovranitetit, integritetit territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës. (Kuvendi i Kosovës, 2019)

Në Kosovë nuk mund të paramendohet një intervenim ushtarak për ruajtjen e integritetit territorial, pa koordinim dhe harmonizim të qëndrimeve në mes Ushtrisë së Kosovës dhe aleatëve të NATO-s, veçanërisht SHBA-ve.

Si Kosova, si Serbia, si Palestina dhe si Izraeli, asnjëri prej këtyre shteteve nuk është anëtar i NATO-s. Ndërsa raportet me Palestinën, janë të varura edhe nga raportet e NATO-s me Izraelin. Me këtë të fundit, janë raporte të mira, pasi që shumica e shteteve anëtare të NATO-s, e kanë njohur Izraelin.

...marrëdhëniet izraelite me NATO-në duhet të jenë më të mira. Themeluar vetëm një vit pas Izraelit, NATO përbëhej nga shtete të krishtera, me një përjashtim që nga viti 1952, Turqia. Asnjë anëtar i NATO-s nuk kishte një grindje themelore me ekzistencën e shtetit hebre, dhe shumica kishin votuar në favor të krijimit të tij. (Creveld, 2005)

Me kalimin e kohës, edhe raportet dhe perceptimet e izraelitëve për NATO-në, do të ndryshonin përgjithmonë. Një nga ngjarjet po ashtu interesante për ta shkëputur këtu, është ndryshimi i perceptimit mbi NATO-në, pas sulmeve ajrore kundër Jugosllavisë në vitin 1999.

Në masën që NATO ende kishte një mision, shumë izraelitë e konsideronin atë me skepticizëm. Ky fakt ishte i dukshëm në pranverën e vitit 1999 kur Aleanca nisi një fushatë ajrore kundër Beogradit për shkak të goditjes së këtij të fundit në Kosovë... Si rezultat, larg mbështetjes së ndërhyrjes së NATO-s, shumë izraelitë simpatizuan serbët. Kur kryengritja e dytë palestineze filloi në vjeshtën e vitit 2000 dhe çoi në shumë viktima, disa u larguan më tej... A nuk mund të përpiqet NATO-ja t'u bëjë atyre atë që po i bënte Serbisë? (Creveld, 2005)

Pra, për dallim nga Kosova, që nuk është anëtare e NATO-s, por vetë NATO është me trupat e saj në Kosovë, në Palestinë, rrallëkush e imagjnon se një ditë do të jetë aty për të siguruar paqen në Lindjen e Mesme, e sidomos edhe për shkak të relacioneve të afërta me Izraelin, sikurse e shkoqitëm më lart.

NATO-ja nuk ka shprehur gatishmërinë të jetë me trupat e saj për ta ruajtur paqen dhe sigurinë në Palestinë, ndonëse ka pasur zëra dhe kërkesa për një gjë të tillë, duke marrë edhe shembullin nga misioni paqeruajtës në Kosovë.

NATO nuk “do të përfshihet në procesin e paqes në Lindjen e Mesme dhe nuk është duke kërkuar një rol në të,” - tha Rasmussen në një konferencë vjetore të sigurisë në qytetin izraelit Herzliya... Shefi i Autoritetit Palestinez në detyrë Mahmoud Abbas thotë se do të pajtohet që trupat e NATO-s të vendosen në Palestinë për një periudhë të kufizuar kohore... (PC, 2011)

Kërkesat për NATO-në kanë qenë temë në mediet perëndimore, duke u cituar edhe kërkesa e kreut të Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas. “Për një kohë të gjatë dhe kudo që duan, jo vetëm në kufijtë lindorë, por edhe në kufijtë perëndimorë, kudo”, tha Abbas për misionin e imagjinuar të NATO-s. “Pala e tretë mund të qëndrojë. Ata mund të qëndrojnë për të siguruar izraelitët dhe për të na mbrojtur. Ne do të demilitarizohemi,” - shtoi ai. “A mendoni se ne kemi ndonjë iluzion që ne mund të kemi ndonjë siguri nëse izraelitët nuk e ndjejnë se kanë siguri?” (Rudoren, 2014)

Duke tërhequr paralele në mes të Kosovës dhe Palestinës, në raportet me NATO-në, ka dallime të konsiderueshme. Gjersa në Kosovë NATO ndërhyri edhe ushtarakisht për ta larguar regjimin e Millosheviçit, nuk ka ndonjë provë bindëse se e njëjta gjë do të mund të ndodhë në Palestinë, për ta bindur shtetin izraelit për dy shtete dhe për marrëveshje paqësore rreth statusit të Jerusalemit, i pretenduar si qytet nga dyja palët, edhe për shkak të rëndësisë historike e religjioze, për tri fetë e mëdha botërore.

Një dallim tjetër me rëndësi në këtë analogji është edhe raporti i Serbisë me NATO-në, duke e parë forcën shumëkombëshe si “agresore e jashtme”, ndërsa Izraeli, nga frika se mund të bëhet një intervenim i ngjashëm edhe në konfliktin izraelito-palestinez, shteti hebraik vetëm se ka përforcuar marrëdhëniet e mira me NATO-në. Pra, afërsia e Kosovës me NATO-n është dukshëm më e madhe, sepse vetë NATO është prezente ushtarakisht në Kosovë, ndërsa jo vetëm që nuk është me mision paqeruajtës në Palestinë, por NATO ka raporte shumë të mira me shtetin izraelit.

Rol ndërmjetësues pa dyshim për këtë marrëdhënie të mirë NATO-Izrael, e ka edhe SHBA-ja, si një nga sponzorueset më të mëdha të kësaj force të sigurisë evropiane e globale.

Për anëtarësimin e Kosovës në NATO, ka disa sfida. Pos njohjes nga katër vendet anëtare, duhet të plotësohen edhe disa kriterë të cilat janë të parapara me Traktatin e Themelimit të Organizatës.

Sipas një studimi të bërë në vitin 1995 janë përcaktuar disa kriterë për vendet aspirante, të cilat anëtarësimin mund ta bëjnë: duke inkurajuar dhe mbështetur reformat demokratike, duke përfshirë krijimin e kontrollit civil dhe demokratik mbi forcat ushtarake; nxitjen e modeleve dhe zakoneve të bashkëpunimit, konsultimit dhe ndërtimit të konsensusit si karakteristikë e marrëdhënieve midis anëtarëve të Aleancës; dhe promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore... (NATO, 2019)

Ndonëse NATO-ja është e përfshirë në Kosovë prej 15 vitesh dhe përkundër faktit që të gjitha vendet fqinje të Kosovës i janë bashkuar programit Partneriteti për Paqe (PpP) të NATO-s, Kosova është vendi i vetëm që ka mbetur jashtë procesit të zgjerimit të NATO-s. Kosova nuk ka vendosur ndonjë marrëdhënie zyrtare, dypalëshe apo kontraktuale me NATO-n dhe, për më shumë, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që nuk ka asnjë bashkëpunim me KVA-në e NATO-s. (KCSS, 2015)

Në vitin 2014, Kosova arriti të bëhet shtet vëzhgues në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, i cili ishte hapi i parë i rëndësishëm për rritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit. Që nga viti 2016, Kosova ka përmirësuar marrëdhëniet e saj me NATO-n në disa mënyra, duke përfshirë intensifikimin e bashkëpunimit dypalësh me udhëheqjen politike dhe ushtarake të NATO-s. Kosova gjithashtu ka marrë pjesë si vëzhgues në takimet e Kartës së Adriatikut (A5), që konsiderohet si një forum i rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve në mes të NATO-s dhe Ballkanit Perëndimor. (Visoka, 2018, p. 25)

Në nëntor të vitit 2015, Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg për vendosjen e marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe NATO-s... në letrën dërguar Kryeministrit të Kosovës në dhjetor të vitit 2016, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ka konstatuar se Këshilli Veri-Atlantik (NAC) i NATO-s ka gjetur pajtim për një formë të re bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe NATO-s përmes “ndërveprimit” që do të nis në vitin 2017. Edhe pse paraqet hapin e parë drejt bashkëpunimit fillestar të Kosovës

me NATO-n, megjithatë ky ndërveprim nuk nënkupton që Kosova është vend partner i NATO-s nëse krahasohet me vendet partnere të NATO-s. (QKSS, 2017, pp. 5-6)

Në kontekstin e nisjes së bashkëpunimit me institucionet e Kosovës, NATO-ja do të ofrojë aktivitete shtesë për Kosovën për pjesëmarrje në programet përkatëse të partneritetit të NATO-s, ndonëse në fusha të kufizuara të këtyre programeve. Në përputhje me këtë, Kosova mund të përfshihet që të marrë pjesë në programet e NATO-s, përfshirë mbrojtjen nga sulmet kibernetike, edukimin, trajnimin dhe logjistikën. (QKSS, 2017, pp. 6-7)

Anëtarësimi i Kosovës në NATO do të forconte subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës edhe në fushën e sigurisë, dhe do të kontribuonte për paqe të qëndrueshme në rajon.

5.4. Organizata e Bashkëpunimit Islamik, Kosova dhe Palestina

Për vendet arabe, qoftë në aspektin politik, diplomatik e të sigurisë, qoftë në atë kulturor, emërues i përbashkët është edhe religjioni islam. Shumica e vendeve arabe me shumicë islame janë bashkuar edhe në organizatat e tyre, duke qenë bashkëpunuese edhe nën ndikimin kulturor-islam.

Organizata e Bashkëpunimit Islamik (OIC) është organizata e dytë më e madhe ndërqeveritare pas Kombeve të Bashkuara me një anëtarësi prej 57 shtetesh të shpërndara në katër kontinente. Organizata është zëri kolektiv i botës myslimane. Ajo përpiqet të mbrojë interesat e botës myslimane në frymën e nxitjes së paqes dhe harmonisë ndërkombëtare mes njerëzve të ndryshëm të botës. Organizata u krijua me një vendim të samitit historik, i cili u zhvillua në Rabat, Mbretëria e Marokut... 25 shtator 1969, pas zjarrvënies penale të Xhamisë Al-Aqsa në Jerusalemin e pushtuar. (OIC, n.d.)

Kosova është njohur nga disa shtete të kësaj organizate. Afërsia më e madhe diplomatike me të vjen nga anëtarësia e Turqisë dhe Shqipërisë në OIC. Shteti i Palestinës është shtet anëtar i OIC-ut që nga viti 1969. (OIC, n.d.)

Në raport me Kosovën, qoftë për shkak të afërsisë gjeografike e ndërfqinjësore, qoftë për shkak të vlerësimit të Xhamisë Al-Aksa si vend i shenjtë në Palestinë, qoftë për shkak lidhjes më

të fortë, por edhe për shkak të politikave të përbashkëta arabe kundër Izraelit, Palestina ka marrëdhëniet shumë të mira me këtë organizatë, krahasuar me Kosovën.

Nga 57 anëtarë të OIC-ut, 21 prej tyre nuk e njohin pavarësinë e shtetit të Kosovës. Këto janë: Republika Demokratike e Algjerisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Kamerunit, Republika e Indonezisë, Republika Islamike e Iranit, Republika e Irakut, Republika e Kazakistanit, Republika e Kirgizisë, Republika e Lebanonit, Republika e Malit, Maroko, Republika e Mozambikut, Republika Federale e Nigerisë, Shteti i Palestinës, Republika e Sudanit, Republika Arabe e Sirisë, Republika e Taxhikistanit, Republika e Tunizisë, Republika e Turkmenistanit, Republika e Ugandës dhe Republika e Uzbekistanit. Ndërkaq, pavarësinë e Palestinës nuk e njeh vetëm Republika e Kamerunit. Nuk ka dyshim që njohja e Kosovës edhe nga anëtarët tjerë të OIC-ut do të ishte përparësi edhe për anëtarësim në këtë dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

OIC-u ka qëndrimin për dy shtete si zgjidhje të konfliktit izraelito-palestinez, por nuk pajtohet me qëndrimin e Presidentit të SHBA-së, Donald Trump, për Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit. Në një nga deklaratat e fundit të OIC-ut, është thënë: *Ne theksojmë se kurrë nuk do të jetë e mundur të heqim dorë nga aspiratat për një shtet sovran dhe të pavarur të Palestinës në bazë të kufijve të vitit 1967 dhe me Jerusalemin Lindor si kryeqytet të saj; që ne e konsiderojmë si parakusht për paqen dhe sigurinë në rajon...* (Extraordinary Islamic Summit Conference, 2017)

Kosova ka shënuar raporte të mira diplomatike me OIC-un. Ka pasur disa takime në mes të Sekretarit Gjeneral të kësaj organizate dhe zyrtarëve të lartë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, në vitin 2013, Sekretari Gjeneral kishte bërë një udhëtim zyrtar për herë të parë në Kosovë. Edhe pas 22 korrikut 2010, Sekretari i Përgjithshëm i OIC-ut, Ekmeleddin Ihsanoglu, kishte përshëndetur Opinionin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (ICJ) se, shpallja e pavarësisë nga Kosova është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Sekretari i Përgjithshëm i OIC-ut ishte një nga të parët që pranoi shpalljen e pavarësisë nga Kosova në vitin 2008... (OIC, 2010)

Raporti i Kosovës me vendet arabe dhe islame është kompleks. E para, Kosova si vend me shumicë myslimane të popullsisë së saj; e dyta, Kosova vlerësohet nga disa shtete islame si projekt amerikan dhe nuk pajtohen me politikat e jashtme botërore të SHBA-së, si dhe; e treta, Serbia si një trashëgimtare më e njohur e ish-Jugosllavisë, ende ruan raportet e mira me shumë

shtete islame. Ndërsa, Serbia, për shumë dekada, në sytë e perëndimit e ka propaganduar së mbrapshti idenë se Kosova është “çerdhe e fundamentalizimit islamik”.

Raportet e mira të shtetit të Kosovës me shumicën e anëtarëve të OIC-ut nuk kanë reflektuar edhe me anëtarësim e Kosovës në atë organizatë. Kosova aplikoi për statusin e vëzhguesit tek në vitin 2018. (Gazeta Express, 2018)

Kosova më herët hezitoi të aplikojë për anëtarësim në OIC për shkak të frikës se do të dëmtonte rrugën e saj për integrim në organizatat euroatlantike. Në fillim të vitit 2019, OIC-u miratoi një rezolutë përmes së cilës i bëri thirrje vendeve anëtare, që të njohin pavarësinë dhe të përkrahin Kosovën në rrugën e saj për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. (OIC-CFM, 2019, pp. 68-70)

Për t’u bërë anëtarë në këtë organizatë Karta e OIC-ut në pikën dy të Nenit 3 thekson: “Çdo shtet, anëtar i Kombeve të Bashkuara, që ka shumicë myslimane dhe respekton Kartën, që paraqet një kërkesë për anëtarësim, mund të bashkohet me Organizatën, nëse miratohet me konsensus vetëm nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm në bazë të kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm”. (OIC, 2017)

Për Kosovën, pos shteteve që nuk kanë njohur pavarësinë, pengesa e dytë është se ky nen kërkon që Kosova të jetë anëtar i Kombeve të Bashkuara. Mirëpo, në OIC ka anëtarë që nuk janë pjesë e Kombeve të Bashkuara dhe janë pjesë e organizatës, sikurse që është rasti i Palestinës.

Sidoqoftë, për statusin e anëtarit vëzhgues, pika 1 e Nenit 4 të Kartës së OIC-ut thotë: “Vendimi për dhënien e Statusit të Vëzhguesit një shteti, anëtar i Kombeve të Bashkuara, do të merret nga Këshilli i Ministrave të Jashtëm, vetëm me konsensus...” (OIC, 2017). Anëtarësia në OKB mbetet kriter bazë edhe në këtë nen, i cili nuk dallon nga kriteri bazik i anëtarit të plotë të organizatës.

Anëtarësimi i Kosovës në OIC do të ishte përparësi për Kosovën. Së pari, pasi pranimi në OIC do të thotë njohje potenciale edhe nga pjesa e mbetur e shteteve që nuk e kanë njohur pavarësinë, Kosova do të rriste subjektivitetin e saj ndërkombëtar dhe do t’i hapeshin rrugët për anëtarësim në organizata dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Pos anëtarësimit në OIC, Kosova duhet të zhvillojë raportet bilaterale me vendet anëtare, përmes të cilave mund të ndikonte në shtetet tjera në botë që të njohin apo zbusin qëndrimet e

tyre karshi pavarësisë së Kosovës. Kosova mund të shfrytëzojë ndikim e OIC-ut në shtetet që kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, veçanërisht në shtetet e Afrikës dhe Amerikës Latine, në mënyrë që të shqyrtojnë mundësitë për ndryshim të qëndrimeve.

Në vitin 2014, OIC i bëri thirrje Rusisë të "rishqyrtojë qëndrimin e saj ndaj pavarësisë së Kosovës dhe të mos jetë pengesë përpara së drejtës së popullit të Kosovës për vetëvendosje". (Newman & Visoka, 2016, p. 23)

Përveç relacionit të Kosovës dhe Palestinës me Bashkimin Evropian, NATO-në, OIC-un, me rëndësi të posaçme është edhe krahasimi i raporteve të Kosovës dhe Palestinës me organizata e institucione të tjera me ndikim në Evropë dhe në botë. Një nga to është edhe qasja që ka Këshilli i Evropës ndaj Kosovës dhe Palestinës, për të cilin do të bëjmë fjalë në vazhdim.

5.5. Këshilli i Evropës, Kosova dhe Palestina

Para se të shqyrtojmë raportin e Këshillit të Evropës me shtetet si Kosova dhe Palestina, duhet të paraqesim shkurtimisht misionin dhe qëllimet e KE-së.

Këshilli i Evropës mbron lirinë e shprehjes dhe të medias, lirinë e tubimit, barazinë dhe mbrojtjen e pakicave... Këshilli i Evropës ndihmon shtetet anëtare të luftojnë korrupsionin dhe terrorizmin dhe të ndër marrin reformat e nevojshme gjyqësore. Grupi i tij i ekspertëve kushtetues, i njohur si Komisioni i Venecias, ofron këshilla ligjore për vendet në mbarë botën. (COE, n.d.)

KE-ja është i njohur veçmas për avokimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, e sidomos i njohur për avokimin për moszbatimin e dënimit me vdekje, nga shtetet e saj anëtare. Shtetet anëtare të KE-së janë: Shqipëria, Andora, Armenia, Austria, Azerbejxhani, Belgjika, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Irlanda, Italia, Latvia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Monako, Mali i Zi, Holanda, Maqedonia Veriore, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, San Marino, Serbia, Republika e Sllovakisë, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra, Turqia, Ukraina dhe Mbretëria e Bashkuar. KE-ja ka edhe shtete në rolin observues apo vëzhguese si: Kanada, Selia e Shenjtë, Izraeli, Japonia, Meksika dhe Shtetet e Bashkuara. (COE, n.d.)

Nga lista e shteteve anëtare, pavarësinë e Kosovës nuk e njohin 13 shtete: Armenia, Azerbajxhani, Bosnja-Hercegovina, Qipro, Gjeorgjia, Greqia, Republika e Moldavisë, Serbia, Republika e Sllovakisë, Rumania, Federata Ruse, Spanja dhe Ukraina. Ndërkaq pavarësinë e Palestinës, nga tërësia prej 47 shteteve anëtare, 27 prej tyre nuk e njohin atë, si: Andora, Armenia, Austria, Belgjika, Kroacia, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, , Latvia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Monako, Holanda, Maqedonia Veriore, Norvegjia, Portugalia, Republika e Moldavisë, San Marino, Zvicra, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar.

Në kontekstin e pranimi të pavarësisë së shteteve, Kosova ka një përparësi në raport me Palestinën, marrë parasysh se vendi ndodhet gjeografikisht në Evropë, ndërkaq ky disbalanc numrash tregon edhe për orientimin gjeopolitik të Kosovës dhe Palestinës. Sigurisht, nëse krahasojmë shtetet anëtare të OIC-ut që kanë njohur Kosovën dhe Palestinën, mund të veçojmë përparësinë e Palestinës në raport me Kosovën.

Numri i madh i shteteve që nuk e njohin, nuk është parë si problem për Palestinën. Ajo në krahasim me Kosovën ka fituar një përparësi në Këshillin e Evropës. Me kërkesën e saj në vitin 2011, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i dha Këshillit Kombëtar Palestinez statusin “Partner për Demokraci”. (UNSPIAL, 2011)

Statusi synon të forcojë lidhjet e Evropës me vendet fqinje dhe lejon “partnerët” të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë Evropiane, pa të drejtë vote. Për Palestinën kjo ishte një e arritur e madhe, e cila do të afronte mundësinë e anëtarësisë së plotë dhe do të ndikonte në rritjen e subjektivitetit juridik të saj. (Dailystar, 2011)

Kosova akoma nuk ka provuar që të anëtarësohet në Këshillin e Evropës edhe pse udhëheqësit e saj e kanë proklamuar atë si mundësi.

Në maj të vitit 2019, Ministri i Jashtëm i Kosovës Behxhet Pacolli, ka pohuar se ka qenë një strategji për të mos aplikuar... (Vllahiu & Sopi, 2019)

E veçanta e raportit KE-Palestinë, duhet të shikohet edhe nga prizmi i raportit KE-Izrael, ndërsa në raport me Kosovën, duhet të shikohet në kontekstin e raporteve të shteteve anëtare të KE-së veç e veç me Kosovën, e sidomos refuzimi kategorik i Rusisë për ta njohur Kosovën, por

edhe të qenët anëtare në KE, e vetë Serbisë, si kundërshtuesja kryesore e pavarësisë së Kosovës ndikon në pengimin e Kosovës për t'u afruar me KE-në.

Roli kundërshtues në raport me KE-në dhe anëtarësimin e Kosovës, luajnë edhe një sërë faktorësh të tjerë, por në mesin e shteteve që kundërshtojnë anëtarësinë, mund të jenë edhe ato që nuk e njohin Kosovën, si pesëshja evropiane (Spanja, Sllovakia, Greqia, Qipro dhe Rumania), e të cilat po ashtu janë anëtare të KE-së.

Prania si shtet-observues e Izraelit në Asamblenë Parlamentare të KE-së, i ka ndihmuar këtij shteti që të shtyjë përpara politikat e veta në Palestinë. Në vitin 2018, KE iu drejtua Autoritetit Palestinez: Për herë të parë në historinë e saj, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i bëri thirrje Autoritetit Palestinez që të ndalë pagesat e veta ndaj terroristëve të burgosur dhe familjeve të tyre. Izraeli e shtyu Këshillin të përfshijë një denoncim të pagesave terroriste si pjesë e kalimit të një rezolute të përgjithshme mbi konfliktin izraelito-palestinez. (Lazaroff, 2018)

KE-ja nuk qëndron duarkryq rreth konflikteve në Lindjen e Mesme. Asambleja Parlamentare e KE-së ka pasur disa rezoluta mbi zgjidhjen e konfliktit izraelito-palestinez.

Në janar të vitit 2018, Asambleja Parlamentare përkujton Rezolutën e saj 1940 (2013) mbi situatën në Lindjen e Mesme, ku “përsërit mbështetjen e saj për një zgjidhje dy-shtetërore të konfliktit izraelito-palestinez, në bazë të kufijve të vitit 1967, të cilat realitete të reja në terren, mund të shoqërohen nga shkëmbimi i kufizuar i tokës, siç është pranuar kohët e fundit nga vendet arabe”. Ai shton se Jerusalemi mund të bëhet kryeqyteti i shtetit të Izraelit dhe shtetit të ardhshëm palestinez, si rezultat i negociatave të drejtpërdrejta midis izraelitëve dhe palestinezëve. Asambleja shpreh keqardhje për deklaratën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të 6 dhjetorit 2017... (COU-PA, 2018)

Nga citimi i mësipërm kuptojmë se KE-ja është për zgjidhje dy-shtetërore, me negociatat si mjeti i vetëm dhe se është kundër vendimit të Tumpit për të Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit.

Po në paragrafët e tjerë, KE... gjithashtu, i bën thirrje të gjitha forcave palestineze të përfundojnë, pa vonesa të mëtejshme dhe në mënyrë transparente, pajtimin, tashmë të shpallur disa herë, midis Fatahut dhe Hamasit, bazuar në parimet e Kuartetit, duke rritur gjithashtu besueshmërinë e Palestinës. (COU-PA, 2018)

Mosnjohja e pavarësisë së Palestinës nga Këshilli i Evropës dhe shumica e shteteve anëtare, nuk afektojnë qëndrimin korrekt të kësaj organizate për të njohur të drejtën e popullit palestinez për shtetësi. Padyshim, të gjitha këto ndërmarrje të Këshillit të Evropës përkojnë me misionin dhe vlerat e saj në raport me të drejtat e njeriut.

KE, sidomos për shkak të Serbisë dhe Rusisë, ka rezerva më të mëdha ndaj Kosovës. Mosanëtarësimi i Kosovës në KE, e pengon atë edhe në anëtarësimin e saj në organizata tjera rajonale dhe ndërkombëtare.

Duke e pasur parasysh që Kosova nuk është pjesë e Këshillit të Evropës nënkuptohet se ajo nuk mund ta nënshkruajë cilëndo prej konventave evropiane që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e drejtësisë (Ligji nr. 04/L për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, 2011). Si rezultat, Kosova e ka materializuar bashkëpunimin në gjyqësor vetëm në baza bilaterale me shtetet e rajonit, të cilat e kanë njohur Kosovën. EULEX shërben si ndërmjetësues mes Kosovës dhe shteteve të rajonit që nuk e kanë njohur Kosovën. (QKSS, 2014)

Sidoqoftë, Kosova de fakto ka raporte të rregullta komunikimi formal me Këshillin e Evropës. Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë filloi aktivitetet e saj të bashkëpunimit në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë në vitin 1999... (Servoz-Gallucci, n.d.)

KE-ja nuk e njeh Kosovën dhe Kosova nuk është anëtare e saj, as e plotë, as në rolin observues, as në rolin observues në Asamblenë Parlamentare me përfaqësuesit e saj sikurse është Izraeli.

Këshilli i Evropës e trajton Kosovën në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Anëtarësimi në KE do të kishte ndikim pozitiv dhe do të forconte pretendimin e Kosovës për të qenë një shtet sovran evropian. Edhe pse, ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe ka përfunduar pavarësinë e mbikëqyrur në shtator 2012, Kosova ende nuk është ftuar për t'u bërë anëtare e Këshillit të Evropës. Duke ditur se 31 shtete anëtare të Komitetit të Ministrave kanë njohur Kosovën, votat për të siguruar ftesën për anëtarësim janë të mjaftueshme. (PIPS, 2014, p. 4)

Përfitimet e anëtarësimit në KE janë më shumë politike, sesa që janë ekonomike, ligjore apo sociale. Anëtarësimi i Kosovës në KE rrit mundësinë që Kosova të mbrojë qytetarët e saj që

kanë probleme të natyrës së ndryshme në vende jashtë Kosovës dhe që janë anëtare të KE-së... Gjithashtu pjesëmarrja e përfaqësuesve kosovarë në kuadër të KE-së do të rriste prestigjin ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe mund të ndikojë që opinionet e Asamblesë Parlamentare dhe Këshillit të Ministrave të KE-së të jenë më favorizuese për Kosovën. (GAP Institute, 2008, p. 4)

Një çështje tjetër me rëndësi për ta adresuar në raportin KE-Kosovë është edhe miratimi në Kuvend të Kosovës, i Gjykatës Speciale për Drejtësi, me bazë në Holandë, me nismën e një anëtari të Asamblesë Parlamentare të KE-së.

Gjithçka filloi në dhjetor 2010 me raportin e përgatitur për Këshillin e Evropës, për “trajtimet çnjerëzore dhe trafikimin me organe” në Kosovë, të quajtur Raporti i Dick Marty-t. Mbas miratimit të raportit, EULEX krijoi një Forcë Speciale për hetimet (SIFT). Kosova nënshkroi më pas me BE-në një marrëveshje ku zotohej për zbatimin e shtetit ligjor. Marrëveshja u kthye në ligj pas miratimit nga Parlamenti i Kosovës në gusht 2015. Kështu u hap rruga për të krijuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Oranews, 2018). Edhe pse është vlerësuar si i padrejtë dhe i panevojshëm, themelimi i Gjykatës Speciale nga ana e shtetit të Kosovës tregon për gatishmërinë shtetërore dhe institucionale për bashkëpunim me instancat e drejtësisë ndërkombëtare, për të zbardhur të gjitha dyshimet e ngritura nga raporti i Marty-it.

Përmbledhtas mund të shtohet se, raportet e Kosovës dhe Palestinës me KE-në nuk janë me fuqi sikurse janë të Serbisë, si kontestuese kryesore e Pavarësisë së Kosovës, dhe Izraelit si kontestuese kryesore e Pavarësisë së Palestinës. Gjersa Serbia është anëtare e plotë e KE-së, Izraeli është po ashtu shtet me status observues, me tre përfaqësues të saj në Asamblenë Parlamentare të KE-së. Po ashtu, Kosova, për shkak se nuk e njohin ndërkombëtarisht disa shtete të KE-së, duke përfshirë këtu edhe Serbinë e Rusinë, ka raportet edhe më të pafavorshme me KE-në, e sidomos me Rusinë si anëtare e saj, si superfuqia globale që kundërshton pavarësinë e Kosovës dhe mbron aleatin e saj tradicional – Serbinë.

5.6. Anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB)

Duhet të theksojmë që anëtarësimi në një organizatë ndërkombëtare nuk i jep definim final ekzistencës së një shteti. Anëtarësimi në OKB nuk do të jetë përfundimi i punës për moskontestimin e shteteve apo anasjelltas. Në këtë kontekst mund të përmendim shembullin e Zvicrës, e cila si shtet ka ekzistuar edhe para anëtarësimit të saj në OKB në vitin 2002. (UNGA, 2002)

Nuk mund të kontestohet qenësia e një shteti nëse ai nuk mund të bëhet pjesë e një organizate si rezultat i ndikimeve të shteteve që e kontestojnë atë. Kosovës i mohohet anëtarësimi në OKB si rezultat i përdorimit të vetos nga Rusia dhe Kina në KS, ose në rastin e Palestinës përdorimi i vetos nga SHBA-ja. Sigurisht anëtarësimi në OKB do të ishte vula finale e funksionimit normal të një subjekti shtetërorë të së drejtës ndërkombëtare.

Për këtë arsye, anëtarësimi në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) është ndër objektivat më të lartë të shteteve të sapokrijuara apo shteteve të reja apo të kontestuara nga shtete të fuqishme, duke përfshirë këtu edhe Kosovën e Palestinën. Kosova ndonëse konsideron veten shtet paqedashës, duke e projektuar Kushtetutën e vet në përputhje të plotë me Kartën e Kombeve të Bashkuara, ka sfida të shumta në procedurën e anëtarësimit në OKB, sidomos për shkak të qëndrimit kundër nga disa shtete – anëtare të përhershme të KS të OKB-së. Njësoj pa sfida, nuk është as Palestina. Nëse shkruajmë për procedurat e anëtarësimit në OKB, Në paragrafët e saj informues mbi këto theksohet:

Anëtarësia në Organizatë, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, “është i hapur për të gjitha shtetet paqedashëse që pranojnë detyrimet e përmbajtura në Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe që në gjykimin e Organizatës janë në gjendje t'i kryejnë këto obligime”. Shtetet pranohen në anëtarësim në Kombet e Bashkuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me rekomandim të Këshillit të Sigurimit. (UN, n.d.)

Pavarësisht natyrës së anëtarësimit të një shteti të ri në OKB, kjo organizatë, nuk njeh shtetet, pasi që shtetet në mënyrë individuale, vendosin për njohjen e një shteti të ri, apo qeverie të re. Njohja e shtetit ose qeverisë së re është një akt që vetëm shtetet dhe qeveritë e tjera mund

të japin ose të refuzojnë. Kjo në përgjithësi nënkupton gatishmërinë për të hyrë në marrëdhënie diplomatike.

Kombet e Bashkuara nuk janë as shtet as një qeveri dhe prandaj nuk posedojnë asnjë autoritet për të njohur asnjë shtet apo një qeveri. Si një organizatë e shteteve të pavarura, ajo mund të pranojë një shtet të ri për anëtarësimin e vet ose të pranojë kredencialet e përfaqësuesve të një qeverie të re. (UN, n.d.)

Në rastin e Palestinës, OKB-ja ka nxjerrë disa rezoluta përmes të cilave ka pranuar sovranitetin e shtetit të saj. Përmes rezolutës 43/177 të dhjetorit të vitit 1988, OKB-ja në pikën 1 të rezolutës pranon shpalljen e shtetit të Palestinës nga Këshilli Kombëtar i Palestinës më 15 nëntor 1988; dhe në pikën dy, konfirmon nevojën për t'i mundësuar popullit palestinez të ushtrojë sovranitetin e tyre mbi territorin e tyre të pushtuar që nga viti 1967. (United Nation, 1988)

Varet nga interpretimi, mirëpo në momentin kur KB-ja ka pranuar shpalljen e shtetit të Palestinës, nënkuptohet se ai shtet ekziston. Palestina nga Izraeli dhe shtetet tjera që nuk e njohin pavarësinë e saj, kontestohet pikërisht në plotësimin e kriterëve të shtetësisë, të cilat megjithatë janë të diskutueshme.

Por si do të duhej të aplikonin Kosova dhe Palestina për anëtarësim në OKB? Sa janë gjasat e pranimin në OKB? Cilat janë pengesat kryesore? Cili është faktori më vendimmarrës që një shtet i ri të anëtarësohet në OKB?

Në mënyrë që të bëhet anëtar një shtet duhet t'i paraqes një kërkesë Sekretarit të Përgjithshëm dhe një letër që deklaron zyrtarisht se i pranon detyrimet sipas Kartës. Këshilli i Sigurimit e shqyrton aplikimin. Çdo rekomandim për pranim duhet të marrë votat afirmative të 9 nga 15 anëtarët e Këshillit, me kusht që asnjë nga pesë anëtarët e saj të përhershëm - Kina, Franca, Federata Ruse, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës – nuk kanë votuar kundër aplikimit. Nëse Këshilli rekomandon pranimin, rekomandimi i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme për shqyrtim. Një shumicë votash me dy të tretat është e nevojshme në Asamble për pranimin e një shteti të ri. Anëtarësia hyn në fuqi ditën kur miratohet rezoluta për pranim. (UN, n.d.)

Dhjetë shtete anëtare jo të përhershme me mandat të përkohshëm, ndryshohen vazhdimisht. Këshilli i Sigurimit është i përbërë nga 15 anëtarë, ku 5 prej tyre janë të përhershëm. Sipas procedurës së mësipërme, Kosova apo Palestina do të duhej t'i merrnin në fillim votat afirmative, nëntë (9) prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve të Këshillit. Nëse do t'i merrnin votat afirmative, p. sh., nga Belgjika, Bregu i Fildishtë, Republika Dominikane, Guinea Ekuatoriale, Gjermania, Indonezia, Kuvajti, Polonia, Perua, Afrika e Jugut, do të duhej që të paktën të mos kishin votat kundër nga pesë shtetet anëtare të përhershme dhe me të drejtë vetoje të OKB-së. Nga përbërja aktuale e Këshillit të Sigurimit dhjetë shtete njohin pavarësinë e Kosovës, ndërkaq qëndrim prerazi kundër, kanë Federata Ruse dhe Kina, ndërsa për Palestinën, qëndrimi kategorik kundër, vjen nga SHBA-të. Prandaj, pa pëlqimin e pesë shteteve anëtare të përhershme, gjasat për anëtarësim të plotë të Palestinës dhe Kosovës në OKB, nuk janë të mundshme.

Edhe në një raport të publikuar në vitin 2013 nga KIPRED – Qendra për Arsim, me titullin: “Procesi i anëtarimit në OKB: Dallimet dhe ngjashmëritë e Kosovës dhe Palestinës”, kur reflektohet dhe projektohen gjasat për anëtarësim të Kosovës dhe Palestinës në OKB, përfundimi del pesimist, apo edhe realist, pikërisht bazuar në procedurat e aplikimit në OKB dhe fuqinë e pesë shteteve anëtare të përhershme:

“Përfundimisht Kosova dhe Palestina do kenë vështirësi të mëdha për të arritur statusin e anëtarit me të drejta të plota, jo se u mungojnë shtetësia apo qëllimet paqësore, por për shkak të fuqisë shumë të madhe që gëzojnë shtetet e përhershme të OKB-së nëpërmjet të drejtës së vetos [sic].” (Retkoceri, 2013)

Bazuar në atë çfarë diskutuam më lart, mund të konstatojmë që anëtarësimi në OKB nuk është çdoherë një çështje ligjore, për më tepër në rastin e Kosovës dhe Palestinës, mbetet një çështje e qartë politike, apo më mirë të themi gjeopolitike.

Institucionet e Kosovës nuk duhet të presin ndryshim të kompetencave të Këshillit të Sigurimit në mënyrë që të aplikojnë për anëtarësim. Në këtë situatë duhet të mendohet aplikimi për anëtarësim si shtet vëzhgues në OKB. Në këtë procedurë, nuk do të kishte pengesa nga përdorimi i vetos nga Rusia apo Kina në KS të OKB-së. Ndërkaq kriteret për të fituar këtë status nuk janë të parapara në Kartën e OKB-së, megjithëse është instaluar një praktikë për mënyrën e fitimit të këtij statusi.

Shtetet jo-anëtare të Kombeve të Bashkuara, të cilat janë anëtare të një ose më shumë agjencive të specializuara, mund të aplikojnë për statusin e Vëzhguesit të Përhershëm. Statusi i një Vëzhguesi të Përhershëm bazohet thjesht në praktikë dhe nuk ka dispozita në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Praktika daton nga viti 1946, kur Sekretari i Përgjithshëm pranoi përcaktimin e Qeverisë Zvicerane si Vëzhgues i Përhershëm në Kombet e Bashkuara. Vëzhguesit u paraqitën më pas nga disa shtete që më vonë u bënë anëtarë të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Austrinë, Finlandën, Italinë dhe Japoninë... Vëzhguesit e Përhershëm kanë qasje të lirë në shumicën e takimeve dhe dokumentacionit përkatës. (UN, n.d.)

Shtetet jo-anëtare që kanë marrë një ftesë të përhershme për të marrë pjesë si vëzhgues në seancat dhe punën e Asamblesë së Përgjithshme dhe mbajtjen e misionëve të përhershme vëzhguese në Zyrat Qendrore janë Vatikani dhe Palestina (2012). (UN, n.d.)

Statusi i vëzhguesit jo-shtetëror në OKB Palestinën e ka bërë palë dhe si e tillë komunikon pa ndërmjetësues me OKB-në; është anëtare në mekanizma të specializuar si UNESCO, ndërsa Kosova nuk është pranuar as në UNESCO dhe ka më pak shtete anëtare të OKB-së që e kanë pranuar atë. Aktualisht, Palestinën e njohin 137 anëtarë të OKB-së, ndërsa Kosovën 116.

Palestina, e veçanërisht Kosova, duhet të zhvillojnë strategji për njohje të reja në mënyrë që të rritet numri i shteteve anëtare të OKB-së që njohin pavarësinë e tyre dhe gjithashtu duhet të intensifikojnë përpjekjet e tyre për t'u anëtarësuar në mekanizma të specializuar të OKB-së dhe organizatave të tjera të natyrave të ndryshme.

Nëse suksesi i anëtarësimit në këto organizata varet nga anëtarësimi në OKB, atëherë njohjet e reja nuk varen nga ajo. Palestina dhe Kosova duhet të vazhdojnë dialogun me Izraelin, përkatësisht me Serbinë në terma realë dhe të kërkojnë një zgjidhje konkrete, të qëndrueshme dhe përfundimtare. Duhet të ritheksojmë që Kosova dhe Palestina janë raste tërësisht të kundërta, me qëllime të njëjta për anëtarësim në OKB. Sidoqoftë, Kosova ka sovranitetin e brendshëm që i garanton shtrirje graduale të sovranitetit të jashtëm, përderisa Palestina është në një situatë krejtësisht tjetër, asaj i kontestohet sovraniteti i brendshëm dhe i jashtëm.

Zyrtarët e shtetit të Kosovës, për shkak të procedurave dhe vendimmarrjes fuqiptotë nga shtetet si Rusia e Kina, në negociatat që priten të zhvillohen në raportin Kosovë-Serbi në vitin

2019, për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse, deklarojnë se, po që se do të arrijmë pajtim reciprok me Serbinë, atëherë as Rusia, as Kina, nuk do ta përdorin veton kundër Kosovës në OKB.

Prandaj, një mënyrë për të marrë pëlqimin në OKB nga Rusia dhe Kina, është arritja e një “marrëveshjeje historike”, e pranueshme nga dyja palët (Kosova dhe Serbia) dhe më pas, edhe Kina, edhe Rusia, do të pajtoheshin që Kosova të jetë anëtare e OKB-së. Anëtarësimi në OKB, për Kosovën, vlerësohet si përfundim i kontestimit si shtet i pavarur, sovran dhe i pranuar botërisht.

5.7. Anëtarësimi në organizatat e tjera ndërkombëtare

Kosova për dallim nga Palestina, nuk është pranuar si anëtare në UNESCO - një nga organizatat më të njohura në botë dhe në kuadër të OKB-së, në fushën e kulturës, shkencës dhe arsimit. Ndërsa Palestina, është pranuar si anëtare e plotë në UNESCO.

Kosova nuk arriti të bëhej anëtare e UNESCO-së në vitin 2015, duke dështuar anëtarësimi i saj vetëm për tri vota (Irish, 2015). Në mënyrë indirekte anëtarësimi i Palestinës në UNESCO e ka dëmtuar synimin e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë.

Pas pranimi të Palestinës nga organizata, u larguan SHBA-të (Rosenberg & Morello, 2017), si aleati dhe mbështetësi kryesor i Kosovës në këtë rrugëtim. Për Kosovën do të jetë handicap i madh largimi i SHBA-ve, ndërkaj në rrethanat e reja tentimi për t’u anëtarësuar në këtë organizatë aktualisht nuk do të ishte ideja më e mirë! Për Palestinën do të jetë përparësi e madhe çështja e anëtarësimit në UNESCO. Ajo pos përfitimeve në fushën e kulturës, shkencës dhe arsimit do të përdorë anëtarësimin edhe në realizimin e interesave të saj në forcimin e sovranitetit të jashtëm.

Në fushën e sigurisë, Palestina po ashtu është në pozitë më të favorshme, pasi në vitin 2017 ajo u bë anëtare e plotë në INTERPOL (Interpol, 2017). Izraeli bashkë me SHBA-të e kishin kundërshtuar pranimin e Palestinës në INTERPOL, por nuk kishin arritur t’i bindnin shtetet shumicë që të mos e votonin, dhe në vitin 2017, Palestina u bë anëtare e plotë e kësaj organizateje me 194 shtete anëtare deri më sot. (Ahren, 2017)

Në përpjekjen e saj të tretë, Kosova në fund të vitit 2018 nuk arriti të bëhet anëtare e Interpolit. (Evropa e Lirë, 2018)

Dështimi i pranimit të Kosovës në Interpol, i atribuohet kushteve të anëtarësimit, ku kërkohen 2/3 e votave për anëtarësim; numri jo i mjaftueshëm i njohjeve që ka shteti i Kosovës; gjithashtu në votim, ka ndikuar edhe fushata e egër e Serbisë kundër anëtarësimit të Kosovës, si dhe; sigurisht lobimi jo adekuat dhe jo i vazhdueshëm i përfaqësuesve të Republikës së Kosovës.

Ky dështim solli reagimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila me vendim nr.01/76 të datës 21 nëntor 2018, vendosi masën (taksë) prej 100% për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina... Qeveria e Kosovës iu dërgoi shteteve të Kuintit përfshirë zyrën e BE-së, një dokument të quajtur Memorandum... duke u përmendur fushata agresive e Serbisë në arenën e jashtme, ndërhyrjet në integritetin territorial dhe kushtetues, kërcënimet për luftë nga ana e Serbisë, moszbatimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel mes palëve, si dhe aspekte tjera. (Krasniqi, Cakolli, & Haxholli, 2019)

Palestina u bë anëtare e Organizatës Botërore të Doganave (WCO) në vitin 2015 (NAP, 2015), ndërsa Kosova u anëtarësua në vitin 2017 (Dogana e Kosovës, 2017). WCO ofron udhëheqje, udhëzime dhe mbështetje për administratat doganore për të siguruar dhe lehtësuar tregtinë e ligjshme, për të realizuar të ardhura, për të mbrojtur shoqërinë dhe për të ndërtuar kapacitete. (WCO, n.d.)

Aktualisht organizata ka 183 anëtarë gjithsej. Për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë, menjëherë ka reaguar Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë, duke tentuar të demantojë anëtarësimin, të cilin e quajti të jashtëligjshëm. Përmes një komunikate, MPJ e Serbisë... ka pohuar se anëtarësimi i Kosovës në WCO është pezulluar përkohësisht (MFA - Serbia, 2017). Në vitin 2019, në listën e shteteve anëtare të WCO-së figuron shteti i Kosovës dhe i Palestinës, ndërsa pretendimet e Serbisë nuk përkojnë me realitetin faktik.

Në vitin 2016 Palestina dhe Kosova u bënë anëtare të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit. Palestina në mënyrë efektive është anëtare nga data 19 dhjetor 2015, ndërsa Kosova nga data 5 janar 2016. (Zyberi, 2016)

E themeluar në vitin 1899 për të lehtësuar arbitrazhin dhe format e tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis shteteve, PCA është zhvilluar në një institucion arbitrar modern dhe shumë të gjerë, i vendosur në mënyrë të përkryer për të përmbushur nevojat e evoluimit të mosmarrëveshjeve të bashkësisë ndërkombëtare. (PCA, n.d.)

Anëtarësimet në këtë organizatë, sigurisht se janë të rëndësishme dhe për të penguar anëtarësimin e Kosovës, pos Serbisë, është involvuar edhe Rusia, e cila dënoi anëtarësimin e Kosovës në PCA, duke e quajtur të paligjshëm. (Sputnik, 2016)

Për anëtarësimin në Bankën Botërore, ka disa kushte paraprake. Për t'u bërë një anëtar i Bankës, sipas Neneve të Marrëveshjes së IBRD, një vend duhet së pari të bashkohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Anëtarësimi në IDA, IFC dhe MIGA është i kushtëzuar me anëtarësimin në IBRD. Në bashkëpunim me FMN dhe në konsultim me stafin tjetër të Grupit të Bankës Botërore, Zëvendës Presidenca e Sekretariatit të Korporatës koordinon procesin e anëtarësimit të ri dhe mban informacionin në lidhje me statusin e anëtarësimit që përfshinë listat e anëtarësimit. (The World Bank, 2019)

Kosova është bërë anëtare e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, ndërsa Palestina jo; Kosova në Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim, por jo Palestina; Kosova në Korporatën Financiare Ndërkombëtare, por Palestina nuk është ende anëtare; Kosova në Agjencinë për Garantimin e Investimeve Multilaterale (MIGA), por jo edhe Palestina si anëtare. (The World Bank, 2019)

Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID) e përbërë nga 154 vende anëtare, po ashtu si anëtare ka Izraelin, i cili është anëtarësuar në vitin 1983, dhe Kosovën, e cila u anëtarësua në vitin 2009, por jo edhe Palestinën. (ICSID, 2019)

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) është një organizatë e 189 vendeve, që punojnë për të nxitur bashkëpunimin monetar global, për të siguruar stabilitetin financiar, për të lehtësuar tregtinë ndërkombëtare, për të nxitur punësim të lartë dhe për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe për të zvogëluar varfërinë në mbarë botën. (IMF, n.d.)

Kosova është pranuar në FMN, sikurse është shtet anëtar edhe Izraeli, por jo edhe Palestina. Palestina i është bashkuar një iniciative të FMN-së për të shpërndarë statistikën për publikun. Palestina u bë anëtare e Standardit për Shpërndarjen e të Dhënave Speciale, ose SDDS, më 19 prill, duke u bërë shteti i pestë arab për t'u bashkuar pas Egjiptit, Marokut, Tunizisë dhe Jordanisë. SDDS është një standard nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për të udhëzuar vendet në përhapjen e statistikave kombëtare për publikun. (MA'AN, 2012)

Në rast se do të përmblihdhim krahasimin Kosovë-Palestinë në raport me organizatat botërore dhe ndërkombëtare, në fushën bankare e financiare, Kosova qëndron në raport shumë më të mirë të subjektivitetit ndërkombëtar, krahasuar me Palestinën, e cila ende nuk figuron në listën e shteteve anëtare të Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve, Agjencinë për Garantimin e Investimeve Multilaterale etj.

Palestina dhe Kosova, janë pranuar nga Federata e Futbollit Botëror FIFA. Palestina u pranua në FIFA më 1998 dhe ende nuk është kualifikuar për Kupën e Botës. (FIFA, 2019)

Kosova është anëtarësuar në FIFA, 18 vjet më vonë se Palestina, përkatësisht në vitin 2016. Kosova është anëtarja e 210-të e FIFA-s (FFK, 2016). Kësisoj, Federata e Futbollit e Kosovës pas anëtarësimit në UEFA më 3 maj 2016 në Budapest, e ka përmbyllur me sukses edhe misionin tjetër për anëtarësim në shtëpinë e futbollit botëror. (UEFA, 2018)

Kosova dhe Palestina janë pjesë edhe të shumë organizatave të tjera ndërkombëtare, ndërqeveritare, në fusha të ndryshme politike, ekonomike, kulturore, sportive etj., por në këtë trajtesë është e pamundur të përfshihen të gjitha.

Duhet të theksojmë se përparësia e vogël por e dallueshme e Palestinës në raport me Kosovën, sa i përket subjektivitetit ndërkombëtar dhe anëtarësimeve në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, lidhet edhe me faktin kohorë se veprimtaria e Palestinës për njohje dhe pranueshmëri ndërkombëtare, zhvillohet që nga viti 1988 apo edhe më herët, ndërkaj ajo e Kosovës fillon 30 vjet më vonë.

5.8. Politika e Jashtme e Kosovës dhe Palestinës

Kosova për t'u pranuar në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, meritat dhe suksesin ia ka atribuar zakonisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Francës, Italisë, dhe në disa raste, edhe shtetit të Turqisë, por edhe Shqipërisë.

Kosova në raport me Organizatat Ndërkombëtare, duke varur shpresat vetëm në shtetet mike, pavarësisht dhjetëra ambasadave të saj nëpër shtete të botës, deri tani ka pasur një rol më pasiv, ndonëse nuk kanë munguar disa dokumente, strategji dhe lobime.

Shtetet e vogla sikur Kosova dhe Palestina, nuk kanë forcë të mjaftueshme për të ndryshuar opinionet dhe qëndrimet e shteteve në arenën ndërkombëtare. Në veçanti kur ato kontestohen nga afërsisht gjysma e shteteve të botës. Prandaj, varësia e këtyre shteteve nga shtete më të fuqishme, sikur Kosova nga SHBA-të, nuk është diçka e jashtëzakonshme.

Aktualisht Kosova ka një program qeveritar të miratuar, i cila përfshinë politikën e jashtme dhe të integriteteve. Fokusi i këtij programi është forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës si objektiv parësor, me mision të posaçëm në arritjen e njohjeve të reja, anëtarësimin e plotë në organizatat ndërkombëtare e rajonale dhe sjelljen e investimeve të huaja direkte në Kosovë. (MIN, 2017)

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Emigrantëve e Palestinës, ka miratuar një grup parimesh dhe qasjesh për politikën e jashtme, të cilat përfshijnë:

- Qëndrimet e detajuara dhe specifike të autoriteteve karshi paraqitjes së qëndrimit palestinez për konfliktin palestinez-izraelit;
- Sqarimi dhe promovimi i objektivave paqësore kombëtare palestineze, si të drejta të garantuara nga e drejta ndërkombëtare;
- Thellimi i marrëdhënieve me vendet arabe duke forcuar Lidhjen Arabe dhe rolin e saj;
- Forcimi i marrëdhënieve me vendet tjera islamike dhe Konferencën Islamike dhe vendet e organizatës së të painkuadruarve;
- Thellimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe miqësore me Vendet Perëndimore dhe Lindore Evropiane;
- Përmirësimi i marrëdhënieve me shtetet që ende nuk kanë marrë qëndrim për të mbështetur qëndrimin kombëtar palestinez;
- Për të dhënë kontribut në bisedime me Izraelin;
- Ruajtja e qëndrimeve në Kombet e Bashkuara;
- Përfaqësimi në organizata dhe nisma ndërkombëtare dhe rajonale;
- Pjesëmarrje në ngjarje dhe përpjekje ndërkombëtare të ndryshme në interes të kombit palestinez;
- Rritje të njohjes ndërkombëtare të Palestinës për të mundësuar anëtarësimin e plotë në OKB. (MFA - Palestine)

Politika e Jashtme Palestineze pësoi goditje të rëndë në vitin 2017, kur Presidenti i SHBA-ve Donald Trump, vendosi të njohë Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit.

Pas njoftimit të Trump, Abbas dhe zyrtarët e lartë të AP-së refuzuan SHBA-të si sponzore të procesit politik dhe filluan përpjekjet për të formuluar një strategji të re politike. Ndërsa e refuzoi SHBA-në si ndërmjetësues në procesin e paqes, AP-ja ka kërkuar alternativa të negociatave me Izraelin duke rritur luftën e saj diplomatike.

Parimet kryesore të strategjisë së re janë:

- Duke zëvendësuar negociatat e sponsorizuara nga Shtetet e Bashkuara me një kornizë ndërkombëtare që do të përpiket të detyrojë pajtimin izraelit me KB-në;
- Rezoluta, duke vepruar për t'u anëtarësuar në trupa ndërkombëtarë;
- Duke kërkuar njohje të Jerusalemit si kryeqytet i Palestinës;
- Duke i bërë thirrje më shumë vendeve të njohin Palestinën, ose duke deklaruar territoret e vitit 1967;
- Përpjekjet për t'u bashkuar me organet ndërkombëtare;
- "Rivlerësimin" e Marrëveshjeve të Oslos;
- Përqendrimi në rezistencën e paarmatosur popullore dhe të tjera. (Jacob, 2018)

Politika palestineze sado që mund të jetë më e konsoliduar, pasojat nga tërheqja e bashkëpunimit me SHBA-të mund të ketë dështime edhe më të rënda.

Përkritazi me Kosovën, pas dështimit të anëtarësimit në UNESCO, INTERPOL, dhe zvarritjes së liberalizimit të vizave, zhvillimet e brendshme politike kanë marrë kahje tjetër. Taksa 100% ndaj mallrave me origjinë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë ndikuar rrjedhën normale të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare të Kosovës. Një raport jo i zakonshëm u pa në mes të Kosovës dhe përfaqësuesve të shteteve aleate, të cilët i kërkuan Kosovës që të largojë apo pezullojë taksën 100%.

Presioni për tërheqjen e taksës u ndërlidh me faktin se Serbia kushtëzoi dialogun Kosovë-Serbi me këtë taksë, ndërsa pala kosovare deklaroi se pa njohjen e Serbisë, taksa nuk do të tërhiqet. Në muajt në vazhdim, presioni ndaj Qeverisë së Kosovës vazhdoi nga zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian... si dhe përmes letrave të qarta të dërguara nga SHBA-të... (Krasniqi, Cakolli, & Haxholli, 2019)

Kjo rezultoi me një ç'akordancë të qëndrimeve nga liderët e vendit, Presidenti kërkoi largimin e taksës, Kryetari i Kuvendit kërkoi pezullimin e saj, kurse Kryeministri nuk ndërroi qëndrim. Veprimet e pakoordinuara institucionale brenda vendit prodhuan efekte negative në Politikën e Jashtme të shtetit. Deri në gjysmën e parë të vitit 2019, nuk ka ndryshuar statusi i pesë shteteve anëtare të BE-së që nuk e njohin Kosovës dhe kjo nënkupton se edhe katër vendet anëtare të NATO-s që nuk e kanë njohur Kosovën, nuk kanë ndryshuar qëndrim për të.

Në vitin 2018, Kosova ka arritur të sigurojë vetëm një njohje të re (nga Barbados), ndërsa trendi i njohjes diplomatike ka rënë ndjeshëm në vitet e fundit. Kosova për herë të parë është përballur me sfidën e tërheqjes së njohjes nga një numër i vogël i shteteve postkoloniale, të njohura për tregtinë me njohjen e shteteve të tjera të njohura pjesërisht. (Visoka, 2018, p. 3)

Në vitin 2018, kërkesat për anëtarësim në organizata të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare u ndalën për shkak të mungesës së koordnimit politik dhe humbjes së mbështetjes së jashtme. Kosova nuk ka aplikuar prapë për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) dhe INTERPOL në vitin 2018. Ngjashëm, pavarësisht punës përgatitore të ndërmarrë për të aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës (KE), në vitin 2018 nuk ka pasur zhvillime të rëndësishme. (Visoka, 2018, p. 7)

Themelimi i ushtrisë së Kosovës në dhjetor të vitit 2018, do të jetë me efekte të rëndësishme në plotësimin e mozaikut të shtetit të Kosovës si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. Kosova tashmë mund të nisë rrugën për realizimin e aspiratave për anëtarësim në NATO. Sidoqoftë, ajo duhet të zhvillojë reformë të brendshme, për të forcuar sistemin shtetëror në mënyrë që të ndërtohen aftësitë për të zhvilluar programe dhe strategji afatgjate dhe të pavarura në Politikën e Jashtme, dhe veçanërisht në rritjen e njohjeve dhe të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Për dallim nga Kosova, e varur direkt dhe shumë nga ndihma e diplomacisë amerikane dhe evropiane, Palestina është mbështetur më shumë në mundësitë e veta për diplomacinë e forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar, por edhe në aleatët fqinj arabë dhe me shumicë islame. Ajo ka varur shpresat edhe në rreth 60 shtete anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Islamik. Raportet e Kosovës me SHBA-në, janë shumëfish më të fuqishme se të Palestinës me Rusinë apo me SHBA-në, prandaj kjo varësi e një shteti në ndërtim e sipër prej një superfuqie globale si SHBA,

e ka bërë Kosovën shumë më pak me vullnet, kreativitet dhe vetiniciativë për politika më aktive të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

5.8.1. Orientimi gjeostrategjik i Kosovës dhe Palestinës

Kosova ka orientim zyrtar, shtetëror e gjeostrategjik Euroatlantik. Varësisht se si janë rreshtuar SHBA-të apo shtetet evropiane në zhvillimet globale, ashtu janë vënë pas edhe autoritetet zyrtare të Kosovës.

Palestina për shkak të rrethimit ndërfqinjësor me dhjetëra shtete arabe e me shumicë myslimane, ka orientim tjetër gjeostrategjik, që ndërlidhet me kontekstin gjeografik, historik, politik e kulturor të Lindjes së Mesme.

Një nga deklaratimet e shpeshta që është thënë për Izraelin është se ky vend, është ndër shtetet e rralla me përfaqësim demokratik të tipit perëndimor (Freedomhouse, 2018), krahasuar me të gjitha shtetet e tjera arabe e islame, të cilat e kanë të vështirë të dalin nga organizimi i jetës shtetërore përmes religjionit, formave monarkike të udhëheqjes, teokracisë, autoritarizmit të klerikëve etj. Shumë shtete arabe e islame, duke përfshirë Palestinën, e konsiderojnë edhe sistemin politik e demokratik, si “sajesë kulturore dhe ideologjike” të “Perëndimit kristian”.

Gjersa orientimi gjeostrategjik i Kosovës është orientim pro-perëndimor, proamerikan, proevropian, Palestina nuk e ka këtë orientim gjeostrategjik. Palestina duke e vlerësuar Perëndimin si mbështetës të Izraelit, e veçmas SHBA-në, e ka edhe një politikë të zemërimit ndaj mbështetjes amerikane për Izraelin, e veçmas me vendimin e fundit të Presidentit Amerikan rreth Jerusalemit dhe Golanit. Jo vetëm, por edhe për shkak të aleancës së ngushtë SHBA-Izrael, Palestina ka një orientim tjetër gjeostrategjik, krahasuar me Kosovën, e cila ndonëse nuk njihet nga Izraeli, asnjëherë nuk acaron raportet diplomatike me të, pikërisht edhe për shkak të aleancës properëndimore dhe proamerikane.

Orientimi gjeostrategjik i Kosovës është edhe në aspektin vleror e kulturor, i drejtuar në demokracitë evropiane dhe perëndimore, ndërsa Palestina vazhdon të mbetet një nga identifikueset me religjionin islam, ndonëse një pakicë e konsiderueshme janë edhe të feve të tjera. Edhe në vetë forcat politike palestineze, ka divergjenca të mëdha rreth ndikimit të fesë në

peizashin shtetëror palestinez. Madje, ka ndarje të thellë në mes të dy forcave rivale politike brenda popullatës palestineze. Hamasi, një grup politik radikal e islamik, me forcë kapi kontrollin e Gazës nga rivali Fatah, një grup thelbësisht laik palestinez.

Ndërkohë, Bregu Perëndimor mbetet pak a shumë nën kontrollin e Fatahut, i cili dominon Autoritetin Kombëtar Palestinez në atë rajon. Prandaj, për herë të parë, dy territoret e dallueshme palestineze - Rripi i Gazës dhe Bregu Perëndimor - nuk janë më nën një autoritet të vetëm palestinez. Hamasi ka rritur ndjeshëm ndikimin e tij në mesin e palestinezëve për vite me radhë, dhe ai mori një nxitje të madhe duke fituar zgjedhjet më të fundit. Tani ai ka kërkuar kontroll ekskluziv mbi Gazën, bazën e tij historike dhe bazën e pushtetit. Nuk është e qartë nëse Hamasi do të përpiqet të marrë kontrollin e Bregut Perëndimor gjithashtu, apo nëse do të kishte sukses nëse do të bënte një lojë të tillë. Bregu Perëndimor është një rajon tjetër me një dinamikë shumë të ndryshme. (Friedman, 2007)

Paqartësia gjeostrategjike e orientimit palestinez është mjaft e dallueshme nga orientimi i qartë gjeostrategjik i Kosovës, ku edhe forcat politike, pozitë e opozitë, të majtë e të djathtë, nacionalistë e socialistë, janë properëndimore, proamerikane, proevropiane dhe kanë thuajse konsensus të gjerë politik, nacional e qytetar mbi orientimin e qartë euroatlantik të Kosovës.

Në grupin e parimeve dhe qasjeve në Politikën e Jashtme të Qeverisë Palestineze, askund nuk përmenden SHBA-të, Bashkimi Evropian apo NATO-ja. Ndërkaq në pikën e pestë me radhë për nga rëndësia, thuhet se duhet të bëhet “thellimi i marrëdhënieve bilaterale, miqësore dhe të bashkëpunimit me vendet perëndimore dhe lindore evropiane dhe me vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim.” (MFA - Palestine)

Pas njoftimit të Presidentit Trump për njohje të Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit në vitin 2017, pos kundërshtimit të tij, Qeveria Palestineze, ndërmori një sërë veprimesh. Ata njoftuan se SHBA-të kanë përjashtuar veten nga procesi i paqes dhe vazhduan orientimin e tyre drejt Rusisë dhe Kinës. Këshilltari i Presidentit të Palestinës Abas, Nabil Sha'th u takua me zyrtarë në Rusi për të diskutuar krijimin e një forumi ndërkombëtar për mbikëqyrjen e procesit të paqes dhe më 23 dhjetor, ai vizitoi Kinën në krye të një delegacioni palestinez për takimet me zyrtarët kinezë. (Jacob, 2018)

Orientimi gjeostrategjik i Palestinës dallon dhe është në kundërshtim me orientimin e Kosovës. Orientimi i Kosovës paraqitet në secilin dokument të hartuar shtetëror ku tregohet se prioriteti kryesor është thellimi bashkëpunimit me SHBA-të, BE-në dhe NATO-n.

Në programin e Qeverisë së Kosovës 2017-2021, në kuadër të Politikës së Jashtme, SHBA-të janë subjekti i parë juridik ndërkombëtar që përmendet. Programi pohon se “Qeveria e Kosovës do të investojë në fuqizimin dhe thellimin e partneritetit special me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si partneri më i rëndësishëm i Kosovës dhe popullit të saj”. (MIN, 2017, p. 7)

Kosova marrëdhëniet me SHBA-të i ka vendosur edhe para atyre me Shqipërinë si vend amë, me të cilin është etnikisht i njëjtë, ka historinë, kulturën dhe gjuhën e përbashkët.

Orientimi Euroatlantik i Kosovës është i shprehur edhe në Strategjinë e Kuvendit të Kosovës për bashkëpunim ndërinstitucional në fushën e Politikës së Jashtme, ku në fillim të saj thuhet: se “Njohjet ndërkombëtare mbeten prioritet i institucioneve të Republikës së Kosovës. Veprimet shtetërore të Republikës së Kosovës, për realizimin e këtij prioriteti, janë zhvilluar në partneritet të ngushtë me SHBA-të, Britaninë e Madhe, Gjermaninë dhe Francën, aleatët e tjerë euroatlantik, si dhe aleatët rajonalë strategjik si Shqipëria”. (Kuvendi i Kosovës, 2019, p. 2)

Politika e Jashtme dhe orientimi gjeostrategjik i Kosovës dhe Palestinës, dallojnë në përmbajtje dhe veprime. Përderisa Kosova sovranitetin e brendshëm e përdorë si argument për shtrirje të atij të jashtëm, Palestina tenton përmes sovranitetit të jashtëm të ndikon në përcaktimin e atij të brendshëm.

Sfidat për orientim të qartë janë si për Palestinën, si për Kosovën, por për këtë të fundit, bazuar në dëshirën dërmuese të shqiptarëve për integrimin evropian dhe orientimin janë objektiva më të qarta dhe më të qëndrueshme. Palestina duke pasur shumë rrëfime historike, religjioze etj., mbi të kaluarën dhe shenjtërimin e tokës bazuar në tekstet e shenjta, krahasuar me Kosovën, e ka më të vështirë të arrijë kompromiset, por edhe nga konteksti i shumicës arabe e islame në rajonin e Lindjes së Mesme.

Rajoni i Lindjes së Mesme, krahasuar me Rajonin e Ballkanit, është më kompleks, sidomos për shkak të ndërfutjes së elementit religjioz në interpretimet historike, pavarësisht se doza justifikimesh politike dhe me karakteristika fetare-historike, gjinden edhe në këto anë.

Kosova nuk ka objektiv të qartë në qasjen ndaj shteteve të botës Islame. Për shumë vite Kosova ka shmangur anëtarësimin në OIC duke pasur frikë se lidhja me botën islamike do të minonte rrugën e saj të integritetit evropian, si dhe shmangte çdo lidhje indirekte me ekstremizmin dhe terrorizmin e dhunshëm fetar. (Visoka, 2018, p. 25)

Ndërsa Palestina, për shkak të shumë problemeve të grumbulluara nga e kaluara dhe interpretimi i ndërlikuar mbi të sotmen dhe të ardhmen, nuk ka objektiva të qëndrueshme.

Në analogjinë studimore Kosovë-Palestinë, Kosova e ka edhe orientimin gjeostrategjik, edhe objektivat më të qarta, për dallim nga Palestina, e cila për shkak të rrethanave historike, politike dhe të kontekstit rajonal e shumë përmasorë, e ka më të paqartë si orientimin gjeostrategjik, si vetë objektivat. Synimet e Kosovës dhe Palestinës në zhvillim të raporteve ndërkombëtare, të subjektivitetit ndërkombëtar, varen edhe nga ndihma prej shteteve e superfuqive të caktuara.

5.8.2. Roli i Shqipërisë për Kosovën dhe vendeve arabe për Palestinën

Gjersa për Kosovën, Shqipëria llogaritet “shtet amë”, Palestina e konsideron veten e saj si qendër gravituese kulturore, fetare e shpirtërore të shumicës së myslimanëve në botë, menjëherë pas statusit më të lartë që ka Qabja në Mekën e Arabisë Saudite. Shqipëria ka luajtur rol të rëndësishëm për Kosovën, sidomos gjatë ushtrimeve guerile në territorin e saj gjatë viteve 1998-1999, mbështetjes edhe logjistike, vendstrehimit të qindra e mijëra refugjatëve në këtë vend etj.

Por historia nuk është krejt e ndryshme edhe me Palestinën, duke qenë se me qindra e mijëra palestinezë, edhe sot e kësaj dite, nga luftërat sporadike me Izraelin, dëbimet, zgjerimi i kolonive dhe vendbanimeve të reja izraelite etj., kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë jetë refugjatësh në kampet dhe lagjet e vendeve arabe, si: Libani, Siria, Libia, Egjipti etj.

Shqipërinë e bën të lidhur me Kosovën, rrëfimi mbi të kaluarën e përbashkët etnike e kombëtare, nacionalizmi panshqiptar, kurse Palestinën me vendet arabe, e përforcon rrëfimi fetar mbi identitetin e përbashkët islam, por edhe me identitetin panarab.

Shqipëria përballë vendeve të pasura arabe dhe fqinje me Palestinën, është më e dobët. Prandaj, në këtë kontekst, Palestina është më e fortë. Palestina rrethohet me shtete arabe dhe me shumicë myslimane, të cilat e konsiderojnë si shtet të papërshtatshëm Izraelin, që në raportin e forcave me njëri-tjetrin, arabët dalin të jenë shumicë bashkë me palestinezët, ndërsa izraelitët pakicë e vetme në këtë rajon - ndonëse kanë marrëdhënie të mira diplomatike me shumicën e këtyre shteteve, me përjashtim të përkeqësimit diplomatik me Iranin, pasi që nuk ka kompaktësi brenda shteteve islame, sikurse mund të mendohet shpesh.

Shqipëria edhe sot, në aspektin diplomatik, është lobuese aktive për Kosovën, ndonëse në arenën ndërkombëtare, ajo vazhdon të jetë e dobët dhe me ndikim mjaft të kufizuar. Shqipëria në të gjitha format dhe me të gjitha mënyrat diplomatike ka mbështetur njohjen nga shtetet dhe anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Në shtator të vitit 2018 gjatë fjalimit të tij në sesionin e 73-të të Asamblenë së Përgjithshme të OKB-së, Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta, në mes tjerash përmendi edhe çështjen e Kosovës: “Ne u bëjmë thirrje dhe mirëpresim çdo përpjekje të shteteve anëtare të OKB-së për vazhdimin e njohjes ndërkombëtare të Kosovës si dhe mbështetjen e mëtejshme të anëtarësimit të saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare”. (Shkëmbi, 2018)

Pjesëmarrja e Shqipërisë nëpër shumicën e organizatave ndërkombëtare në nivel rajonal dhe ndërkombëtar bënë që çështja e Kosovës të jetë aktuale përherë. Përkrahja e shtetit amë të Kosovës nuk është e kufizuar dhe ipet nga secili nivel i përfaqësimit.

Gjatë shënimit të 10 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama, në mars të vitit 2019 kërkoi që Kosova të bëhej pjesë e NATO-së. Ai theksoi se përfshirja e Kosovës në NATO do të ishte një vlerë e shtuar për sigurinë. (Kallxo.com, 2019)

Kosova ka qenë objekt promovimi diplomatik edhe në fjalimin e Ministrit në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë Gent Cakajt, në Mbledhjen e Ministrave të Jashtëm të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës, të mbajtur në vitin 2019 në Helsinki. Cakaj theksoi se kjo organizatë do të jetë edhe më e suksesshme në rajonin e Ballkanit nëse edhe Kosova bëhet pjesë e saj. Anëtarësimi i Kosovës në KIE do të ishte në interes si të vetë Kosovës, ashtu dhe të organizatës. (MEPJ - Albania, 2019)

Veprime të tilla sikur të tre përfaqësuesve më të rëndësishëm në politikën e Jashtme të Shqipërisë kanë bërë edhe zyrtarët tjerë përfaqësues të secilit institucion të Republikës së Shqipërisë. Shqipëria dhe Kosova kanë zhvilluar bashkëpunimin duke ndërtuar edhe përfaqësi të përbashkëta diplomatike. Në shkurt të vitit 2019 në Kopenhagë është inauguruar edhe një Konsullatë e përbashkët Kosovë – Shqipëri. (MFA - Kosovo, 2018)

Shqipëria ka rëndësi të madhe për Kosovën, pasi ajo ka më të konsoliduar diplomacinë dhe rrjetin diplomatik; gjithashtu ka pjesëmarrje në shumicën e nismave dhe organizatave ndërkombëtare. Prandaj, Shqipëria ka shërbyer si avokate e çështjes së Kosovës për të fituar njohje të reja, për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare e në këtë mënyrë ka ndikuar në forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës.

Vendet arabe për Palestinën, ndonëse janë shumë shtete, me homogjenitet të çelikosur kulturor si shumicë dërmuese, për shkak të shumë interesave të secilit shtet dhe elitave drejtuese politike, nuk kanë ndikim aq të madh në dhënien e ndihmës ndaj palestinezëve, sa mund të thuhet zakonisht.

Hillel Frisch, profesor i Studimeve Politike dhe Studimeve të Lindjes së Mesme në Universitetin Bar-Ilan, thekson se një nga arritjet e pakta të Yasser Arafatit, si lider destruktiv i Lëvizjes Palestineze, ishte aftësia e tij për të arritur një masë pavarësie nga shtetet arabe që ndërhyjnë në çështjet palestineze, përderisa kërkonte dhe merrte mbështetjen e tyre në forume ndërkombëtare. (Frisch, 2018)

Kjo nënkupton se jo rrallë herë shtetet arabe e kanë shfrytëzuar çështjen palestineze për realizimin e interesave të tyre rajonale e ndërkombëtare.

Ndërsa arkitektura shtetërore arabe dobësohet, udhëheqjes palestineze po i bëhet gjithë e më e vështirë ta shesë “luftën për Palestinën” si qëllimi kryesor i ditës në botën arabe. Kriza e vazhdueshme në Siri po merr më shumë vëmendje sesa çështja e përhershme palestineze. Së fundi, përderisa shtetet e mëdha arabe sunite po përpiqen të sigurojnë stabilitetin e tyre dhe merren me kërcënimin në rritje të Iranit, kauza palestineze është bërë dytësore për ta. (Romirowsky, 2018)

Po ashtu, shumë shtete arabe, veç e veç, duke ndjekur interesat shtetërore dhe të elitave politike, por edhe të ndikuara në raportet e veçanta në mes të SHBA-së dhe Arabisë Saudite,

Arabi Saudite-Izrael kundër Iranit, rolit moderues të Egjiptit dhe raportet e mira të tij diplomatike me Izraelin etj., nuk kanë arritur të kenë një qëndrim aq unik mbi Palestinën, në aspektin veprues, përtej atij deklarativ.

Megjithatë, së fundi, Mbreti Salman i Arabisë Saudite ka bërë të qartë se ai nuk e ka ndalur mbështetjen e Mbretërisë për Palestinën. Ai ka kundërshtuar publikisht djalin e tij, Princin e kurorës Muhamed bin Salman, megjithëse kjo nuk e ka ndalur Muhammedin të bashkëpunojë me Izraelin për të përballur Iranin dhe Islamin politik. Pozicioni i Mbretit Salman tregon se Palestina mbetet një çështje emocionuese për udhëheqësit edhe nëse ato janë bërë më pragmatike në qëndrimin e tyre ndaj Izraelit. (Dorsey, 2018)

Një lidhje e veçantë Iran-Palestinë, ndonëse me dallime sektare, është prezente. Edhe Izraeli e ka akuzuar Iranin për mbështetje financiare dhe ushtarake ndaj krahut radikal të Hamasit në Palestinë, por edhe urrejtjet e mëdha irano-izraelite, deklaratat e dikurshme të ish-presidentit Ahmedinexhad, e bëjnë raportin edhe më specifik të Palestinës me Iranin. Bota arabe ka mbështetur vazhdimisht njohjet dhe anëtarësimin e Palestinës në organizatat ndërkombëtare.

Në momentin kur filloi Pranvera Arabe dhe kur nisi rreziku i sigurisë kombëtare të shteteve, mbështetja ditore mbi Palestinën pësoi rënie edhe pse nuk u ndalë në tërësi. Natyrisht, lufta për ndikim Arabi Saudite-Iran ka vendosur çështjen palestineze në mes. Ndërsa Arabia Saudite i kundërvihet ndikimit iranian në rajon, ajo ka rritur bashkëpunimin dhe ka ripohuar marrëdhëniet e saj të forta me AP-në. Megjithatë, pas një marrëveshjeje të Iranit që mbështeti qëndrimin e Teheranit në rajon, AP-ja ka flirtuar me Iranin mbi Arabinë Saudite. Në luftën Rijad-Teheran për hegjemoninë rajonale, palestinezët duket të jenë një tjetër futboll politik. (Rumley & Rasgon, n.d.)

Për të vazhduar më tej në aspektin komparativ Palestinë-Kosovës, duhet të trajtohen në mënyrë koncize edhe pengesat që Serbia ia bënë Kosovës në rrugëtimin e saj, por edhe barrierat që Izraeli përpiqet vazhdimisht t'ia krijojë Palestinës.

5.9. Serbia dhe Izraeli si pengesa për Kosovën dhe Palestinën

Serbia dhe Izraeli kanë ndikim në shumë shtete me ndikim global e lokal. Prandaj, lobimi i tyre përkthehet në bllokim për shtetet që i kontestojnë. Serbia duke pasur aleatë të fortë si Rusinë dhe Kinën, ngjashëm si Izraeli me aleatin – superfuqinë globale SHBA-në, kanë bërë që të kenë efekte bllokuese për Kosovën dhe Palestinën, ndonëse jo për të ndalur shumë procese që kanë synuar.

Si Serbia, si Izraeli, kanë bërë përpjekje maksimale, kanë lobuar dhe kanë përdorur fuqinë e tyre diplomatike, për të penguar Kosovën dhe Palestinën në anëtarësimin në organizatat rajonale, ndërkombëtare e globale. Herë kanë përdorur mjete direkte, herë mjete indirekte. Herë kanë shfrytëzuar protestën, shprehjen e deklaratave të zemërimit etj.; kanë kërcënuar me dalje nga organizatat ku kanë bërë pjesë edhe vetë, sikurse ka ndodhur edhe me daljen e Izraelit nga UNESCO pas anëtarësimit me të drejta të plota të Palestinës.

Serbia ka bërë një lobim proaktiv në vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, duke filluar nga vendet e Amerikës Latine, pesë vendet e Bashkimit Evropian, Kinën etj., duke i falënderuar dhe inkurajuar që të vazhdojnë për të mos e njohur Kosovën dhe duke e përsëritur se është pjesë e sovranitetit dhe integritetit territorial të Serbisë.

Gjatë ditëve të votimit për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe para këtij procesi, Serbia, bashkë me aleatët e saj të mëdhenj, kanë lobuar kundër votimit, anëtarësimit, pjesëmarrjes dhe njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Ngjashëm ka bërë edhe Izraeli, duke shfrytëzuar edhe diplomacinë e shkëlqyeshme aktuale me SHBA-të.

Izraeli krahasuar me Serbinë, ka ndikim politik, ekonomik, shkencor e kulturor, shumë më me peshë se vetë Serbia, prandaj në këtë kontekst, Palestina ka pasur më shumë vështirësi, sesa Kosova. Serbia ka pasur si pengesë edhe barrën e përgjegjësisë nga e kaluara mbi vrasjet e shumë civilëve, dënimet për krime të luftës të strukturave të saj shtetërore dhe parashtetërore në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ndërsa Izraeli e ka pasur rolin e viktimës së Holokaustit, në një prej ngjarjeve më johumane dhe më të tmerrshme që kanë ndodhur në historinë e popujve.

Duke qenë se Serbia ka pasur vlerësimin nga Bashkësia Ndërkombëtare, si agresore e jashtme, me krime lufte ndaj popullatës civile në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, Izraeli nuk e

ka pasur aq këtë barrë historike, pavarësisht akuzave të vazhdueshme për sjellje të vrazhdë ndaj palestinezëve. Izraeli për shkak të tragjedisë së pakontestueshme ndaj popullit hebraik në kohën e sundimit nazist gjerman, i ka bërë në faj edhe shumë shtete evropiane, që s'kanë mundur të ndalin një tragjedi të tillë, apo edhe kanë kontribuar fatkeqësisht në këtë tragjedi.

Në një aspekt, pas ndërhyrjes ajrore e të armatosur të NATO-s në Serbi, kjo e fundit gjithmonë është paraqitur para Bashkësisë Ndërkombëtare, si “viktimë e agresionit të NATO-s”, por nuk ka arritur kurrë të paraqes përmasat e tragjedisë reale si i ka ndodhur popullit hebre nën nazistët.

Pra, Izraeli, jo vetëm se ka pasur fuqinë më të madhe të ndikimit politik, shkencor, teknologjik, ushtarak mbi shtetet dhe organizatat ndërkombëtare e globale, për ta bllokuar Palestinën, por e ka pasur edhe arsyetimin dhe kapitalin moral pas tragjedisë famëkeqe të Holokaustit. Ndërsa, Serbia, të paktën këtë të fundit, nuk ka arritur ta ketë. Po ashtu, raporti Serbi-Rusi, nuk është më i ngushtë krahasuar me raportin e Izraelit me SHBA-në.

5.9.1. Mjetet e politikës së jashtme të Serbisë dhe Izraelit

Izraeli gjatë lobimit për ta penguar anëtarësimin, pjesëmarrjen dhe njohjen ndërkombëtare të Palestinës nga shtetet dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, kryesisht ka përdorur mjetet politike e diplomatike, por edhe ushtarake, sikurse është situata e sulmeve sporadike në Republikën Arabe të Sirisë.

Izraeli duke u arsyetuar me të qenët e vetme në mesin e dhjetëra shteteve arabe përreth, ka arritur të krijojë diskursin e “viktimës së vetmuar” në rajonin e Lindjes së Mesme. Duke u paraqitur edhe si viktimë e terrorizmit, me vendet që kanë ndarë këtë kërcënim të përbashkët, ka arritur të merr mbështetjen e pakursyer.

Pas anëtarësimit të Palestinës në UNESCO, Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara braktisën organizatën me pretekstin se organizata po përdorë gjuhën e paragjykitimit ndaj Izraelit. UNESCO votoi disa rezoluta ku në mes tjerash futi qytetin e Hebronit si pjesë të trashëgimisë botërore që i takon territorit të Palestinës. Territori i këtij vendbanimi dhe disa të tjera janë të kontestuara në mes të Izraelit dhe Palestinës. (Kraemer, 2019)

Viteve të fundit diplomacia serbe ka vënë në plan të parë kundërlobimin e njohjes së Kosovës. Përpos të ashtuquajturës Zyre për Kosovën brenda Qeverisë së Serbisë, ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë merret aktivisht me Kosovën. Diplomacia serbe ka hartuar një strategji kundërlobimi ndaj Kosovës, duke përdorur një sërë metodash për të fituar partnerë në këtë kauzë. Serbia i ka targetuar shtetet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, por edhe ato që e kanë njohur duke angazhuar njerëz me ndikim që të llobojnë tek këto shtete. (Berisha, 2018, p. 7) Kjo i ka shkaktuar presion Kosovës në rrugën e saj drejt njohjes dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.

Izraeli ka shfrytëzuar edhe mjetet diplomatike të vetë anëtarësimit paraprak në organizata ndërkombëtare, në mënyrë që të bëhet faktor pengues i Palestinës për anëtarësim të mëvonshëm në këto organizata. Ngjashëm ka vepruar në disa raste, me mjete thuajse të njëjta të politikës së jashtme, edhe Serbia. Dyja shtetet, si Izraeli, si Serbia, kanë falënderuar dhe shprehur mirënjohje e kanë organizuar vizita, në shtetet që nuk i kanë njohur Palestinën dhe Kosovën.

Edhe pse Kosova dhe Serbia kishin arritur një marrëveshje në vitin 2013 për të mos penguar përfaqësimin rajonal dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare të Kosovës, Serbia nuk e ka respektuar atë. E ashtuquajtura Zyre për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, ka hartuar edhe strategji për të penguar njohjen e Kosovës nga shtetet e ndryshme (Indeksonline, 2018)

Serbia po ashtu e ka shfrytëzuar diplomatikisht, edhe incidentin më të vogël, duke e gjeneralizuar e stërzmadhuar në seancat e OKB-së, e duke e shfrytëzuar edhe “luftën globale ndaj terrorizmit”, për t’i fajësuar shumicën shqiptare, herë me terma të nacionalizmit, herë me terma të fundamentalizmit islamik.

Serbia, trazirat e 17 marsit 2004, sulmet e pakontrolluara ndaj Kishave Ortodokse Serbe, pavarësisht rrethanave dhe interpretimeve të shumta mbi motivet e masave të revoltuara, i kanë interpretuar në arenën ndërkombëtare, si sulme të “fondamentalistëve islamikë” kundrejt “serbëve të krishterë”. Aq shumë i kanë shfrytëzuar këto trazira të marsit, sa që kanë thirrur ambasadorët e shteteve të ndryshme në Serbi, duke ia transmetuar edhe me video- regjistrime, këto pamje, e duke u ndalur sidomos në momentin e shembjes së kryqit nga turmat e zemëruara,

me qëllim që të paraqesin anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, si rrezik për trashëgiminë kulturore botërore, pak muaj para se të dilej në votim se a do të pranohej Kosova në UNESCO, apo jo.

Edhe Izraeli shfrytëzonte ndërprerjen e vizitave diplomatike, qoftë për të vizituar një vend tjetër, apo edhe kur vendoste ndonjë zyrtar i një shteti tjetër ta vizitonte Izraelin, për shkak të pakënaqësisë ndaj vendimit për njohjen e shtetit të Palestinës. Një rast i tillë ndodhi jo më larg se në vitin 2015, në mes të Izraelit dhe Suedisë.

Një vizitë e planifikuar në Izrael nga Ministria e Jashtme suedeze Margot Wallström është anuluar, pasi asnjë zyrtar izraelit nuk ishte i përgatitur ta pranonte, njoftonte Radio Suedia News... arsyeja e vërtetë është se Wallström nuk ishte i mirëpritur në Izrael. Zyrtarët izraelitë kanë refuzuar të takohen me të dhe do të ishte e turpshme që Ministri i Jashtëm të vizitonte vendin jozyrtarisht (RadioSweden, 2015). Suedia kishte njohur Palestinën një vit më herët.

Një nga mjetet e tjera diplomatike të Serbisë për pengimin e njohjeve ndërkombëtare, është tërheqja e paraleleve të Kosovës me çdo rast separatist, secesioni apo të vetëvendosjes. Kështu, Serbia në rastin e Katalonisë, ka akuzuar Perëndimin dhe botën për standarde të dyfishta. Ministri i Jashtëm i Serbisë akuzoi fuqitë botërore për përdorim të standardeve të dyfishta duke refuzuar të pranojë referendumin e pavarësisë katalonase, ndërsa në një masë të madhe mirëpritën një Kosovë separatiste. (Reuters, 2017)

Serbia si mjet tjetër të politikës së Jashtme, e më pak Izraeli, ka pasur edhe deklaratat publike mbi tërheqjet e njohjeve dhe krijimin e konfuzioneve diplomatike e mediatike.

5.9.2. Tërheqja e njohjeve

Ka pasur disa herë polemika, sidomos gjatë vitit 2018, rreth tërheqjes së njohjeve ndërkombëtare të Kosovës nga disa shtete. Ministri i Punëve të Jashtme, Ivica Daçiq, duke shfrytëzuar mjetet diplomatike kundër Kosovës, është raportuar nga mediet se ka falënderuar shtetet që kanë tërhequr njohjet për Kosovën. Një deklaratë e tillë është drejtuar ndaj Surinames:

“Falënderim të veçantë nga Serbia”, ka thënë Daçiq, në një konferencë të përbashkët për media me ministren e jashtme të Surinamit, Yildiz Deboras Polak-Beil, duke shtuar se “ishte

vendim jashtëzakonisht i rëndësishëm që Surinami pranoi argumentet e Serbisë, kur është fjala për çështjen e Kosovës dhe ka tërhequr njohjen e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës”. Serbia ka nënshkruar marrëveshje për heqjen e vizave me Surinamen, gjithashtu. (Zëri, 2018)

Po ashtu, ka pasur disa herë reagime dhe kumtesa si kundërpërgjigje nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, duke i cilësuar deklaratat e Serbisë për tërheqjen e njohjeve, si “lajme të rrejshme”. Tashmë është konfirmuar që pohimet e Serbisë në lidhje me gjoja tërheqjen e disa njohjeve nga vendet sikurse Guinea Bissau, Liberia, Gana, nuk kanë qenë asnjëherë të vërteta, përpos se në trillimet dhe imagjinatën e disa figurave të vetmuara në Beograd. (Koha.net, 2018)

A mund të ketë tërheqje të njohjes ndërkombëtare? Pranimi i shteteve sipas të Drejtës Ndërkombëtare paraqet një akt politik dhe si i tillë nuk ka edhe ndonjë ndalesë për tërheqjen e njohjes, thotë Mark Ellis, drejtor ekzekutiv i Shoqatës Ndërkombëtare të Avokatëve me seli në Londër. Komentet e tij, pasojnë deklaratat e shefit të diplomacisë së Serbisë, Ivica Daçiq, sipas të cilit, Republika e Surinamit ka tërhequr vendimin për njohjen e shtetit të Kosovës. (RFE/RL, 2017)

Ndonëse në literaturën shumicë flitet për mostërheqje të njohjeve, në fakt, edhe teoritë mbi të, kanë filluar të evoluojnë dhe nuk mungojnë edhe interpretimet për “de-njohje” (ang. *de-recognition*). Një metodë e trajtimit të problemit të shteteve të dobëta ose joefektive në një rajon, që ka si precedentë historikë dhe teorikë, është de-njohja e ekzistencës së një shteti në atë territor. (Delaney, 2008)

De-njohja gjithnjë e më shumë po ri-interpretohet, ndonëse *de jure*, nga shumica pranohet se është e pakthyeshme në parim. *De facto*, njohja si akt politik, mund të jetë e komentueshme në shumë perspektiva.

Tërheqja e njohjes *de facto* është e mundur sipas ligjit ndërkombëtar vetëm në bazë të faktit se nëse shteti i njohur nuk ka përmbushur kushtet paraprake për shtetësinë. Në një rast të tillë, shteti njohës mund të tërhiqet nga njohja duke komunikuar një deklaratë tek autoritetet e njohura të deklaruara ose me një deklaratë publike. (Shekhar, 2018)

Tërheqja e njohjes *de jure* nuk është e vlefshme në asnjë rast. Edhe pse njohja është një akt politik, por *de jure*, për nga natyra dhe statusi, ai është i orientuar drejt legalitetit. Por disa

juristë mendojnë se njohja *de jure* mund të tërhiqet, sepse është një akt politik. Por në fakt nuk është kështu. Mund të tërhiqen vetëm ato njohje *de jure* kur një shtet më pas humb çdo element thelbësor të shtetësisë. Në një rast të tillë shteti që tërhiqet nga njohja duhet të dërgojë qëllimin e tij të shprehur tek autoriteti në fjalë që lëshon një deklaratë publike në atë masë. (Shekhar, 2018)

Tërheqja e njohjes shfrytëzohet nga Serbia edhe si mjet politik për të akuzuar se Kosova është shtet i dështuar. Nuk është aq e rëndësishme deklarata e një shteti që e konteston dhe e pengon njohjen ndërkombëtare të një shteti që është shkëputur nga një trup i përbashkët (me kolonizim, pushtim apo vetëvendosje) për de-njohje, në vetë aktin e shfuqizimit të njohjes paraprake ndërkombëtare, sa është me efekte diplomatike, për shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën.

Për të realizuar qëllimet e saj kundër Kosovës, Serbia pos tjerash, ajo ka përdorur edhe armët të cilat prodhohen në Serbi si dhuratë për shtetet që tërheqin njohjen e Kosovës. (AlsatM, 2018)

Një diçka tjetër që ia vlen të komentohet në këtë pjesë kapitulli është se, zakonisht deklaratat e de-njohjeve ndërkombëtare, të mediatizuara shumë si deklarata politike e diplomatike të krerëve të Serbisë, janë për shtetet mjaft larg gjeografikisht prej Kosovës. Fakti se ka deklarime për shtete të largëta që e kanë de-njohur Kosovën, flet edhe për një shfrytëzim të mjetit indirekt diplomatik nga ana e Serbisë, për ta paraqitur Kosovën si shtet të dështuar, që destabilizon rajonin, portretizimin e një shteti të dështuar dhe pa të ardhme të mëvetësishme etj.

Prandaj, de-njohja përveç si akt i ç’njohjes ndërkombëtare dhe tërheqjes, duhet të shikohet edhe në perspektiva të mjetit shtesë diplomatik, të shteteve që kontestojnë rajonet, provincat apo territoret e shkëputura nga to.

Në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare, bëhen dallime në mes të statusit të një shteti dhe njohjes. Ndonëse nuk njihet në literaturë praktika e ç’njohjeve, ekziston “ftohja apo prishja e marrëdhënieve diplomatike”, varësisht se si rrjedhin ngjarjet dhe zhvillimet politike.

De-njohja varet shumë nga shkalla e propagandës së shtetit prej nga është shkëputur apo ndarë një shtet i ri. Sa ma e madhe është fuqia dhe interesi i një shteti që e njeh një shtet të ri

me shtetin prej nga është shkëputur shteti i fundit, ekziston mundësia e revokimit të njohjes, në kuptimin e ndërprerjes apo pezullimit të marrëdhënieve diplomatike, deklaratave kundërshtuese të shtetit të ri në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara, duke ruajtur pozicionin pak a shumë apo të ngjashëm me gjuhën më të “ashpër” të shtetit që nuk e pranon shkëputjen e një pjese të dikurshme që e konsideron edhe sot si pjesë të integritetit të vet territorial.

Në media ka qarkulluar një letër diplomatike e de-njohjes nga Guinea Bisao. Ky shtet e ka njohur Kosovën më 10 janar 2011, por në letrën e datës 21 nëntor 2017, thuhet se pas një shqyrtimi të kujdesshëm, ka revokuar apo tërhequr njohjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Ndërsa Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës, e ka mohuar de-njohjen, duke e publikuar një letër tjetër diplomatike, përkatësisht një notë verbale, sipas së cilës, Guinea Bisao e njeh Kosovën. (Koha.net, 2017)

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka njoftuar se ka pranuar zyrtarisht Notën Verbale nga Ambasada e Republikës së Guinea-Bissau-t në Bruksel, që mban datën 24 janar 2018, nëpërmjet të cilës është rikonfirmuar njohja e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran. Sipas një njoftimi të MPJ-së, vendimi ishte marrë nga ish-Presidenti i këtij shteti, Malam Bacai Sanhá, më 10 janar 2011. (Sertolli, 2018)

Shtetet mund të përdorin mjete të ndryshme të prishjes, ndërprerjes, pezullimit, tensionimit dhe zbehjes së marrëdhënieve të mira diplomatike me shtetin që dikur e kanë njohur, si: ndalimi i vizitave, sanksionet direkte apo përkrahja e sanksioneve etj. Sidoqoftë, ashtu siç ndryshon e drejta ndërkombëtare, njohja ndërkombëtare, po ashtu mund të ndryshojnë praktikatat e shteteve që njohin apo de-njohin një entitet e shtet të ri.

VI. PJESA EMPIRIKE

Në këtë kapitull do të paraqiten gjetjet e hulumtimit sasior dhe cilësor. Hulumtimi sasior është realizuar duke plotësuar pyetësin 100 pjesëmarrës. Respondentët ishin të ndryshëm dhe i takonin të gjitha kategorive të synuara në projektin hulumtues. Në të dhënat cilësore janë realizuar dy lloje të intervistave me dy kategoritë e synuara dhe me disa subjekte. Gjithsej janë realizuar 15 intervista. Duhet të përmendim që të gjithë pyetësit dhe intervistat janë realizuar në gjuhën shqipe dhe angleze.

6.1. Të dhënat sasiore

Të dhënat sasiore të cilat janë grumbulluar përmes pyetësorëve do të paraqiten në grafikone dhe tabela të ndryshme.




Figura 1

Sipas të dhënave, aspekti gjinor i përfaqësimit të pyetësit është i përbërë nga 59% të pjesëmarrësve meshkuj, ndërsa 41% e tyre i takojnë gjinisë femërore.




Figura 2

Bazuar në të dhënat që kemi grumbulluar dhe që janë paraqitur në figurën nr.2, vërehet një pjesëmarrje e respondentëve me moshë të ndryshme. Mosha dominante e paraqitur është ajo e grupmoshës 30-49 vjeç me 43%, 29 % e respondentëve i takojnë grupmoshës 50-64, 18% e tyre janë nga grupmosha 18-29 vjeç dhe 11% e pjesëmarrësve janë nga grupmosha mbi 65 vjeç.




Figura 3

Nga figura nr.3, vërejmë se 28% e respondentëve janë të angazhuar si Ekspert, aktivistë të shoqërisë civile, dhe punonjës mediesh dhe në po të njëjtën përqindje kemi kontribut në punonjësit e institucioneve kërkimore-shkencore, , 23 % e të anketuarve janë staf diplomatik dhe 21 % e tyre kanë përgjegjësi në institucione ekzekutive.




Figura 4

Duke pasur parasysh që numri i njohësve për të dy problematikat, atë të Kosovës dhe Palestinës është i kufizuar, atëherë pyetësi është plotësuar nga pjesëmarrës prej nacionalitete të ndryshme. 32 % e pjesëmarrësve i takojnë nacionalitetit shqiptar, ndërkaq 29 % atij arab/palestinez. Nga nacionaliteti serb në hulumtim kanë marrë pjesë 13 pjesëmarrës, ndërkaq 6 të tjerë ishin izraelit. Pjesëmarrës me nacionalitet amerikan ishin vetëm 5%. Në pyetësor me 15% kanë marrë pjesë edhe nacionalitetet tjera të botës. Shumica e pjesëmarrësve në anketim janë arritur përmes formës online.




Figura 5

Nga të dhënat që janë paraqitur në grafikun nr.5, vërejmë se shumica absolute e pjesëmarrësve në anketim apo 74% e tyre mendojnë se Kosova dhe Palestina, trajtohen nga komuniteti ndërkombëtar si raste të ndryshme. 20 % e të anketuarve konsiderojnë se Kosova dhe Palestina janë pjesërisht të ngjashme, ndërsa si raste të ngjashme Kosovën dhe Palestinën i vlerësojnë vetëm 6 % e pjesëmarrësve. Bazuar në këto rezultate konstatohet që në masë të konsiderueshme vërtetohet hipoteza jonë e parë.




Figura 6

Sipas figurës nr.6, të anketuarit theksojnë që për Kosovën sfida kryesore për anëtarësim në OKB është arritja e një marrëveshje finale me Serbinë. 57% e respondentëve e shohin si zgjidhje këtë alternativë. 29% e respondentëve theksojnë si sfidë për anëtarësim në ON rritjen e numrit të njohjeve, ndërkaj, 9% e tyre pohojnë se për anëtarësim duhet plotësuar kriteret që burojnë nga karta e OKB-së dhe 5% e respondentëve vënë theksin sfidues në sovranitet, stabilitet shoqëror dhe institucional që përcaktojnë anëtarësimin në OKB.

Në rastin e Palestinës, nga të dhënat vërejmë se 67% e të anketuarve e shohin si sfidë kryesore arritjen e një marrëveshje finale me Izraelin si rrugë të vetme për anëtarësim të Palestinës në OKB. 10% nevojën e rritjes së numrit të njohjeve të shtetit, 9% e tyre theksojnë plotësimin e kriterëve që burojnë nga karta e OKB-së, dhe vetëm 3% mendojnë se sovraniteti, stabiliteti shtetëror dhe institucional garanton anëtarësim në OKB. Në krahasim me Kosovës vërejmë se edhe në këtë proces varësia e Palestinës nga Izraeli është shumë më e lartë se varësia e Kosovës nga Serbia. Respondentët në këtë rast, vërtetojnë hipotezën nr.2 edhe pse jo në tërësi.




Figura 7

Sipas të dhënave të figurës nr.7 shihet se 74% e vërtetojnë hipotezën nr. 1.3, sipas së cilës ndikimi i orientimit gjeopolitik për anëtarësim në ON është shumë i lartë për anëtarësim në ON, ndërkaj 23% e të anketuarve mendojnë se orientimi gjeopolitik ndikon pjesërisht në anëtarësim të shteteve në ON. Vetëm 2% e respondentëve theksojnë se ai orientim nuk ndikon për anëtarësim në ON.



Figura 8

Sipas të dhënave të figurës nr.8 repozidentët konsiderojnë se numri i njohjeve ndikon shumë për anëtarësim në ON të Kosovës dhe Palestinës. 73% e tyre kanë vlerësuar se njohjet ndikojnë shumë, ndërsa ndikimin e pjesërisht të njohjeve e kanë vlerësuar 23%, dhe vetëm 4% e të anketuarve mendojnë që numri i njohjeve nuk ndikon aspak për anëtarësim në këtyre shteteve në organizata ndërkombëtare.




Figura 9

Grafikoni 9, tregon se SHBA-të dhe aleatët e saj luajnë rol të rëndësishëm për anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në ON. Në rastin e Kosovës, 74% e pjesëmarrësve mendojnë që SHBA-të llojnë intenzivisht, 23 % e tyre theksojnë se ato llojnë pjesërisht, dhe 3% e pjesëmarrësve mendojnë që SHBA-të nuk llojnë për anëtarësim të Kosovës në Organizata Ndërkombëtare. Asnjë respondent nuk ka zgjedhur alternativin se SHBA-të llojnë kundër anëtarësimit të Kosovës në Organizata ndërkombëtare.

Në rastin tjetër, të dhënat nga figura 9, tregojnë se 49% e respondentëve pohojnë se SHBA-të janë kundër anëtarësimit të Palestinës në Organizata Ndërkombëtare, 47% e tyre mendojnë që SHBA-të nuk llojnë për anëtarësim të Palestinës, ndërkaj 3% e pjesëmarrësve theksojnë se SHBA-të llojnë pjesërisht, vetëm 1% e pjesëmarrësve mendojnë që SHBA-të llojnë intenzivisht për anëtarësim të Palestinës në Organizata Ndërkombëtare. Nga krahasimi mund të vërejmë se Kosova dhe Palestina janë sfera të ndryshme të interesit për SHBA-të, përderisa Kosova mbështetet nga SHBA-të, Palestina nuk ka përkrahjen e tyre.




Figura 10

Përgjigjet e të anketuarve në këtë pyetje theksojnë se Rusia është kundër anëtarësimit të Kosovës në Organizata Ndërkombëtare me një përqindje të lartë prej 86%, ndërkaj vetëm 14 % e të anketuarve mendojnë që Rusia nuk lobon kundër anëtarësimit të Kosovës në Organizata

Ndërkombëtare. Duhet të theksojmë që asnjë respondentë nuk ka vlerësuar se Rusia lobon pjesërisht apo intenzivisht për anëtarësimin e Kosovës në ON.

Në anën tjetër, pjesëmarrësit në anketim me 11% pohojnë se Rusia lobon inteznivisht, dhe 68% e pjesëmarrësve tjerë kanë zgjedhur alternativën që tregon se Rusia lobon pjesërisht për anëtarësimin e Palestinës në Organizatat Ndërkombëtare. 19% e tyre mendojnë që Rusia nuk lobon për anëtarësim, ndërsa vetëm 2% e pjesëmarrësve mendojnë që Rusia është kundër anëtarësimit të Palestinës në ON. Të dhënat tregojnë për dallimet që Kosova dhe Palestina kanë në aleanca. Në bazë të rezultateve të figurës nr.9 dhe nr.10, konstatohet që vërtetohet gati tërësisht hipoteza 1.1., sipas së cilës anëtarësimi në ON, varet nga shkalla e përkrahjes së Kosovës dhe Palestinës nga dy superfuqitë globale, SHBA-të dhe Rusia.




Figura 11

Pritja e organizatave ndërkombëtare për një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë përbënë 64% të pengesës për anëtarësim të Kosovës në këto mekanizma. 15% e pengesës së synimeve të Kosovës vijnë nga fushata agresive e Serbisë kundër Kosovës në këtë proces, 12% e respondentëve vënë theksin te numri i pamjaftueshëm i njohjeve si pengesë për anëtarësim në ON, dhe 9% e tyre theksojnë se mungesa e konsolidimit të brendshëm ekonomik, politik dhe juridik të shtetit është pengesë për anëtarësim të Kosovës në ON.

Në rastin e Palestinës respondentët e shohin fushatën agresive të Izraelit si pengesë me 38%, ndërsa 47% e tyre theksojnë që pengesë kryesore për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare për Palestinën është arritja e marrëveshjes në mes të saj dhe Izraelit. 7% e të anketuarve theksojnë se numri i pamjaftueshëm i njohjeve dhe mungesa e konsolidimit të brendshëm, ekonomik, politik dhe juridik të shtetit është pengesë. Nëse krahasojmë të dhënat shohim se sikurse në rastin e Kosovës edhe në atë të Palestinës si pengesë kryesore për anëtarësim në ON paraqitet pritja për një marrëveshje me Serbinë përkatësisht me Izraelin. Në këtë rast vërtetohet pjesërisht hipoteza nr. 1.4., sipas së cilës njohja dhe anëtarësimi në ON stagnon me shkallën e pritshmërisë për marrëveshje në mes të palëve.




Figura 12

Në bazë të të dhënave të respondentëve nga figura nr.12, vërejmë se shumica absolute apo 49% e tyre theksojnë që shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën dhe Palestinën pengojnë shumë anëtarësimin e tyre në ON. 48% e respondentëve theksojnë se këto shtete pengojnë pjesërisht, dhe 3% theksojnë se këto shtete nuk pengojnë anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në Organizata Ndërkombëtare.




Figura 13

Sipas të dhënave, respondentët theksojnë se Serbia ka ndikim të pjesshëm në anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. 69% e pjesëmarrësve pohojnë se Serbia ndikon pjesërisht, 28 % e tyre mendojnë se Serbia ndikon shumë në këtë proces. Vetëm 3% e respondentëve kanë theksuar se Serbia nuk ka aspak ndikim.

Në rastin e Ndikimit të Izraelit, figura tregon se 61% e pjesëmarrësve pohojnë se Izraeli ka shumë ndikim në shtetet tjera rreth pengimit të Palestinës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. 33% e tyre theksojnë se Izraeli ka ndikim të pjesshëm, ndërkaq vetëm 3% e pjesëmarrësve mendojnë që nuk ka aspak ndikim. Në këtë grafikon vërehet se fuqia e Izraelit për të penguar Palestinën është shumë më e lartë se ajo e Serbisë për të penguar Kosovën. Përgjigjet e respondentëve të paraqitura në këtë grafikon verifikojnë një pjesë të hipotezës nr. 2, duke e përkrahur atë jo plotësisht.




Figura 14

Sipas figurës, 49% e respondentëve theksojnë se kanë ndikuar kontestet e brendshme të shteteve në mos njohje dhe mos anëtarësim të Kosovës në organizata ndërkombëtarë, 47% e tyre mendojnë se ato kanë ndikuar pjesërisht dhe 4% e pjesëmarrësve mendojnë që kontestet e brendshme nuk kanë ndikuar fare. Në rastin e Kosovës, këto rezultate konfirmojnë deri diku hipotezën nr. 3.

Bazuar në të dhënat e kësaj figure po ashtu vërejmë se 19% e respondentëve pohojnë se kontestet e brendshme të shteteve kanë ndikuar në mosnjohje dhe mos anëtarësim të Palestinës në ON. 35% e respondentëve theksojnë se pjesërisht kanë ndikuar, ndërsa 46% e tyre theksojnë se kontestet e brendshme të shteteve nuk kanë ndikuar në anëtarësimin e Palestinës në ON. Këtu vërejmë dallimin në mes të Kosovës dhe Palestinës, ku në rastin e Kosovës impakti i kontesteve të brendshme në njohje dhe anëtarësim është shumë më i lartë sesa në rastin e Palestinës. Ndërkaq, në rastin e Palestinës, hipoteza konfirmohet minimalisht.




Figura 15

Sipas figurës nr.15, shohim së të anketuarit mendojnë që lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare ndikon në fuqizimin e synime për anëtarësim në ON. 73% e të tyre mendojnë që ndikon përfshirja e Kosovës në traktate ndërkombëtare, ndërkaq për ndikim të pjesshëm mendojnë 15%, 12% e të anketuarve mendojnë që marrëveshjet ndërkombëtare nuk fuqizojnë synimet e Kosovës për anëtarësim në Organizata Ndërkombëtare.

Në rastin e Palestinës, 58 e pjesëmarrësve mendojnë që përfshirja në traktate ndikon në anëtarësim në ON, 37% e tyre theksojnë se ndikon pjesërisht, ndërkaq vetëm 5 % e respondentëve pohojnë se përfshirja në traktate nuk ka ndonjë ndikim për anëtarësim në ON.




Figura 16

Nga 100 subjekte të anketuara, 75% e tyre vlerësojnë se Kosova mund të jetë aktorë i përgjegjshëm ndërkombëtar, ndërsa 20% pohojnë se ajo mund të jetë pjesërisht e përgjegjshme ndërkombëtarisht. Vetëm 5% e të anketuarve vlerësojnë se Kosova nuk mund të jetë aktorë i përgjegjshëm ndërkombëtar.

Në figurën numër 16 janë të paraqitura të dhënat që tregojnë me 34% të pjesëmarrësve mendojnë se Palestina nuk mund të jetë aktorë i përgjegjshëm ndërkombëtarisht, ndërsa 54% e tyre theksojnë se ajo pjesërisht mund të jetë e përgjegjshme, ndërsa 12% të pjesëmarrësve vlerësojnë se Palestina mund të jetë aktorë i përgjegjshëm ndërkombëtar. Nëse bëjmë krahasim me Kosovës respondentët kanë dhënë sinjale se Kosova mund të jetë aktorë me përgjegjësi në arenën ndërkombëtare, ndërsa për Palestinën kanë theksuar se ajo mund të jetë pjesërisht e përgjegjshme.




Figura 17

Nga të dhënat që figura nr.17 tregon, vlerësojmë se anëtarësimi i Kosovës në organizata tjera në 72% të të anketuarve tregon se ndikojnë shumë për anëtarësim në OKB. 19% e pjesëmarrësve theksojnë se ndikojnë pjesërisht, dhe 9% vlerësojnë se nuk ndikon anëtarësimi në këto organizata për anëtarësim të Kosovës në OKB.

Në rastin e Palestinës, të dhënat tregojnë se 51% e të anketuarve theksojnë se anëtarësimi i Palestinës në organizatat tjera ndërkombëtare ndikon shumë për anëtarësim në OKB, 37% vlerësojnë se ndikon pjesërisht, ndërsa 12% e pjesëmarrësve theksojnë se anëtarësimi në organizatat tjera nuk ndikon fare në rrugën e Palestinës për anëtarësim në OKB.




Figura 18

88% e respondentëve theksojnë se Kosova pjesërisht është e përfshirë në nismat rajonale, në krahasim me 8% të cilët theksojnë se Kosova është e përfshirë në këto nisma dhe 4% e respondentëve theksojnë se Kosova nuk është e përfshirë në nisma rajonale të shteteve.

Sipas figurës nr.18, vërehet se respondentët në përqindje të lartë theksojnë se Palestina është e përfshirë në nisma rajonale, 59% e respondentëve mendojnë se ajo është e përfshirë, 37% e tyre theksojnë se pjesërisht është përfshirë dhe vetëm 2% theksojnë se Palestina nuk është e përfshirë në nisma rajonal. Në krahasim me Kosovës vërehen rezultate që tregojnë se Palestina është më e përfshirë në nisma rajonale sesa Kosova.




Figura 19

Bazuar në të dhënat e figurës së mësipërme vërejmë se respondentët kanë theksuar se 48% e qëllimeve të përgjithshme ndërkombëtare të Kosovës janë realizuar pjesërisht. Përdërisa, pjesa tjetër që po ashtu është 49% e të anketuarve theksojnë se këto qëllime nuk janë realizuar. Vetëm 3% e respondentëve kanë pohuar se qëllimet e politikës së jashtme të Kosovës janë realizuar.

Në rastin e Palestinës, 12% e respondentëve theksojnë se qëllimet e politikës së jashtme janë realizuar, përkundër 55% të tyre që vlerësojnë se ato qëllime janë realizuar pjesërisht, dhe 33% e respondentëve që theksojnë se qëllimet e politikës së jashtme të Palestinës nuk janë realizuar.

6.2. Të dhënat cilësore

Intervistat janë instrument tjetër i përdorur për realizimin e hulumtimit shkencor. Gjatë hulumtimit kemi përdorur 15 intervista, me pyetje të ndryshme për dy kategori të ndryshme të pjesëmarrësve. Të dy intervistat janë të modelit gjysmë të strukturuar dhe të gjithë të intervistuarit e kategorisë së njëjtë i janë përgjigjur pyetjeve të njëjta.

Në intervista morën pjesë 15 të intervistuar, që vijnë nga universitete të njohura të botës. Me shumicën e konsiderueshme të tyre, intervista është realizuar përmes internetit, ndërkaq ka patur ca raste kur kemi realizuar edhe intervista përmes takimeve direkte. Të intervistuarit janë nga shtete dhe kontinente të ndryshme dhe përfaqësojnë institucione kredibile ndërkombëtare. Lista e emrave të të intervistuarve është vendosur në shtojcën e fundit, bashkë me shtojcat e tjera, ndërsa brenda punimit, të cituarit janë të intervistuar anonimë. Përgjigjet e tyre janë të strukturuar e të inkuorpuara në tekstin vijues, me disa nga përgjigjet më relevante për konfirmim të hipotezave tona.

6.2.1. Pozicioni ndërkombëtar i Kosovës dhe Palestinës

Pozicioni ndërkombëtar i Kosovës dhe Palestinës, duket i njëjtë për shkak se të dyja vendet kanë njohje të pjesshme dhe nuk janë anëtare të plota të OKB-së, ngase pesë shtete si anëtare të përhershme e kanë fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit.

Sipas njërit nga të intervistuarit, duhet ta kuptojmë që në fillim të përdorimit, togfjalëshin “komunitet ndërkombëtar”. *Komuniteti ndërkombëtar është i përbërë kryesisht nga grupime shtetesh që ndajnë interesa të ndryshme gjeopolitike. Ai përbëhet nga tre pole të rëndësishme: Poli Amerikan i kryesuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Poli Rus dhe ai Kinez. Shtetet si India, Pakistani, Gjermania, Franca, Brazili, Irani, Turqia, etj., kanë rëndësinë e tyre, por individualisht, ato janë të pafuqishme të diktojnë politikat globale pa ndihmën apo influencën e një prej tre poleve të sipërpërmendura.*

Në vazhdim të kësaj, elaboron: *Trajtimi i çështjeve të palestinezëve dhe kosovarëve nga secili pol i sipërpërmendur varet nga interesat gjeostrategjike të secilit prej tyre. Ajo çfarë është e rëndësishme të përmendet është fakti se polet asnjëherë nuk kanë pozicion të njëjtë rreth një*

çështjeje pasi edhe interesat e tyre gjeostrategjike nuk janë të njëjta. Interesi parësor i secilit pol është të parandalojë, dobësojë ose të shkatërrojë dominancën e poleve të tjera duke, (1) iu bashkuar polit me të dobët ose, (2) duke u konfrontuar direkt me polin me të fortë. Për shembull, kur një çështje favorizon SHBA-në dhe penalizon (direkt ose indirekt) Rusinë, është shumë e mundur që Kina t'i bashkohet kësaj të fundit kundër SHBA-ve. Edhe nëse një çështje favorizon apo fuqizon SHBA-të pa penalizuar dy polet e tjera, përsëri këto të fundit do të reagojnë kundër SHBA-ve për të parandaluar, dobësuar, ose shkatërruar hegjemoninë amerikane. Historia apo veprimet që Kosova dhe Palestina kanë ndërmarrë nuk përcaktojnë trajtimin e tyre të ndryshëm në komunitetin ndërkombëtar. Me apo pa vullnetin e tyre për to këto përcaktime i bëjnë tre polet e mësipërme.

Sipas respondentit nga intervista gjysmë e strukturuar, si tërësi, komuniteti ndërkombëtar nuk mund ta trajtojë me të njëjtin standard Kosovën dhe Palestinën. Kjo për faktin se krijimi i standardit është i varur nga interesat gjeopolitike të tri superfuqive (SHBA-ve, Ruisë dhe Kinës) të cilat kanë interesa të ndryshme në të dy vendet.

I intervistuari në një rast kur pyetet për pozicionet e Fuqive të Mëdha, deklaron:

Pozicionimi i SHBA-së, Ruisë, dhe Kinës në çështjen e Kosovës diktohet nga interesat gjeopolitike të secilit pol në rajonin tonë. Për SHBA-të, pavarësia e Kosovës do të thotë ulje e ndikimit rus në Ballkan dhe Evropën Perëndimore dhe një rritje të influencës amerikane në rajon. Për arsye se SHBA është tashmë një hegjemon, si Rusia ashtu dhe Kina bashkohen kundër pavarësisë së Kosovës për të parandaluar dhe dobësuar shtrirjen e influencës amerikane në rajon dhe më gjerë. Do të ishte e ndershme të thuhej se veprimet e Ruisë dhe Kinës, individuale ose në bashkëpunim, synojnë pikë së pari të dobësojnë ose shkatërrojnë influencën amerikane në çdo cep të globit. Të qenit hegjemon, ashtu siç çdo hegjemon apo perandori para saj, e bën Amerikën shënjestër të çdo (shteti) fuqie në ngritje. Me pak fjalë, të qenit hegjemon është në të njëjtën kohë edhe tragjedia e politikës së jashtme të SHBA-ve.

Rreth zhvillimeve historike të tragjedisë palestineze për shtetkrijim e shtetndërtim, respondentit në hulumtim, thotë:

Duhet pasur parasysh gjithashtu se interesat gjeopolitike të poleve ndryshojnë në kohë në varësi të ndryshimeve në balancën e fuqisë rajonale dhe botërore dhe në varësi të faktorëve

gjeografikë. Ky ndryshim vihet re më së miri në rastin e Palestinës në gjashtë dekadat e kaluara. Siç dihet botërisht, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe Fuqitë e Mëdha i ofruan palestinezëve mundësinë për të krijuar shtetin e tyre përmes Planit të Ndarjes të vitit 1947, por si palestinezët ashtu dhe arabët e hodhën poshtë planin e OKB-së dhe kërkuan zhdukjen e shtetit të Izraelit. (Me pak fjalë, palestinezët po kërkojnë sot përmes sakrificave njerëzore atë që iu dha në tavolinë në vitin 1947.)

Se në çfarë pozicionesh gjindet edhe Izraeli në historinë e saj dhe motivet e relacionit të ngushtë SHBA-Izrael dhe anasjelltas, i intervistuari në hulumtim thotë:

Mbijetesa kombëtare dhe dalja e Izraelit përmes luftërash rajonale si një faktor i rëndësishëm gjeopolitik pas luftës gjashtë-ditore në vitin 1967 e komplikoi edhe çështjen e krijimit të një shteti palestinez, pasi Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) më së fundi gjetën tek Izraeli një aleat të fortë dhe të besueshëm për të balancuar shtetet e tjera të rajonit dhe për të ndaluar ekspansionin sovjetik në rajon. Arsyeja përse Izraeli është një partner i besueshëm i SHBA-së ka të bëjë më shumë me faktin e të qenit i vogël për ekspansion, por i fortë për të balancuar shtetet e tjera, sesa me fenë predominuese (besimin fetar) të këtij shteti. Për këtë arsye, tashmë, SHBA nuk mbështet krijimin e një shteti palestinez pa aprovimin e Izraelit, pasi SHBA nuk mund të rrezikojë prishjen e kësaj aleance kaq vitale në aspektin gjeostrategjik. Ky interes amerikan i vendos automatikisht si Rusinë ashtu edhe Kinën në anën e kundërt të çështjes, duke tentuar të ulin influencën izraelite, dhe si rrjedhojë edhe atë amerikane, në rajon.

Kur tërheq paralelizmin e Palestinës me Kosovën, i intervistuari përpiket të ndajë mësimet e pësimit që mund t'i ketë Kosova, në rast se "palestinizohet":

Të njëjtat ndryshime gjeopolitike mund të ndodhin edhe përkundrejt çështjes së Kosovës, për mirë ose për keq. Në arenën ndërkombëtare dhe me ligjin ndërkombëtar, Kosova njihet edhe si protektorat i OKB-së. Nëse rasti i Palestinës do të na shërbente si shembull, ai duhet t'i mësojë Kosovës se gjëja më e rëndësishme për të duhet të jetë njohja ndërkombëtare. Nëse Kosova, ashtu si edhe Palestina, do të kërkojë "gjithçka ose asgjë", ajo mund të rrezikojë të bëhet një "Palestinë e dytë".

Po si trajtohen Kosova e Palestina në komunitetin ndërkombëtar? Cila është qasja globale ndaj këtyre dy vendeve? Pse janë aq të ndryshme dhe si interpretohet kjo me gjuhën e marrëdhënieve juridike ndërkombëtare? Një nga të intervistuarit tanë, teksa përgjigjet, thekson:

Në këtë rast Kosova dhe Palestina trajtohen shumë ndryshe. Megjithatë, kjo nuk është aq shumë për shkak të standardeve të ndryshme. Arsyeja për të cilën trajtohen shumë ndryshe është sepse ato në fakt janë situata shumë të ndryshme edhe sipas ligjit ndërkombëtar. Palestina është një rast i dekolonizimit. Ajo njihet si e drejtë për shtetësi. Megjithatë, kjo është penguar nga okupimi i Izraelit. Kosova, nga ana tjetër, është një rast i shkëputjes. Pasi kjo shihet si një rast i shkëputjes së njëanshme (duke përdorur këtu termin 'unilateral' që në terma të thjesht juridik përshkruan aktin e shkëputjes pa dakordim midis palëve), prandaj bie në një kategori mjaft të ndryshme sipas ligjit ndërkombëtar.

Më tutje, i intervistuari vazhdon me shqyrtimin analogjik, për të gjetur dallime të tjera Kosovë-Palestinë:

Fakt tjetër është edhe marrëdhënia që Kosova dhe Palestina kanë me Serbinë dhe Izraelin. Kosova praktikisht është e pavarur dhe ka kontroll efektiv të shumicës së territorit të saj, përderisa Palestina nuk ka fuqi të bëjë një gjë të tillë. Kjo nënkupton se Kosova është më e avancuar se Palestina në kuptimin e pavarësisë shtetërore, por ky pozicion nuk i garantohet Kosovës automatikisht në të ardhmen. Komuniteti ndërkombëtar Kosovën e trajton si projekt të shteteve euroatlantike, SHBA-ve dhe vendeve të Evropës Perëndimore, ndërkaq Palestina ballafaqohet me Izraelin dhe SHBA-të.

6.2.2. Gjeopolitika e Fuqive të Mëdha dhe roli i faktorëve kulturorë

Një tjetër intervistues, gjersa pyetet për diferencimin në qasje të komunitetit ndërkombëtar ndaj Kosovës e Palestinës, pohon:

Si Kosova dhe Palestina, trajtohen nga shtetet e tjera në funksion të politikës; e drejta ndërkombëtare në fund të fundit është mjaft e politizuar dhe kryesisht varet nga teket e shteteve. Si rezultat, mënyra në të cilën trajtohen entitetet secesioniste është më shumë çështje politike sesa e principeve. Në veçanti, fuqia e ushtruar nga pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, do të thotë se anëtarësia në Kombet e Bashkuara është tërësisht e varur nga disponimi

politik i këtyre shteteve; Deklarata e Kartës së OKB-së për të drejtën e vetëvendosjes është praktikisht e pafuqishme.

Përkritazi me plotfuqishmërinë e superfuqive në Këshillin e Sigurimit, i intervistuari gjatë zbatimit të intervistës, konstaton:

Roli i superfuqive dhe anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit është shumë i madh; ato pos mundësisë ta vetojnë anëtarësimin e cilitdo shtet, edhe mund të ndikojnë në anëtarësim në disa organizata përmes pushtetit që kanë aty si p.sh. SHBA-ja për Kosovën në Bankën Botërore (BB) dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Në anën tjetër, Palestina ka probleme edhe kur anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, kur ajo e bënë atë SHBA-të tërhiqen. Kjo ndodhi në rastin e pranimit të Palestinës si anëtar në UNESCO.

Se deri në ç'masë ndikojnë elementet e kulturës dhe ideologjisë për të bërë dallimet e rastit të Kosovës dhe Palestinës, i intervistuari vazhdon më tej:

Ndikimi i faktorëve kulturorë e ideologjikë që bëjnë dallime midis Kosovës dhe Palestinës, vjen si trashëgimi e Luftës së Ftohtë, ku shtetet që e njohin Kosovën janë kryesisht aleate të SHBA-së dhe Perëndimit, kurse shtetet që e njohin Palestinën kryesisht kanë qenë aleate të Bashkimit Sovjetik. Kjo ndërlidhet edhe me anëtarësimin në disa organizata si Banka Botërore dhe FMN, por edhe BE, ku anëtarësimi varet nga politikat tregtare (d.m.th. zbatimi i politikave liberale dhe tregtisë së lirë). Trashëgimia historike dhe ideologjike mund ta parandalojnë Kosovën që të anëtarësohet në disa organizata si OBI, ku shumë anëtarë nuk e njohin Kosovën. Kjo vërehet në rastin e Kosovës ku shtetet anti-SHBA edhe pse islame, hezitojnë ta njohin pavarësinë e vëllezërve të tyre nga feja. Ndërsa Palestina ka përkrahjen e fuqishme të shteteve me sfond islam, dhe, hë për hë ka edhe mbështetjen e shteteve që mbështillen rreth boshteve të civilizimeve të tyre që janë anti-perëndimore. Faktorët historikë, ideologjikë dhe kulturorë mund të kenë ndikim në anëtarësimin e Palestinës dhe Kosovës në OKB vetëm në rastin kur ato nuk konfliktohen me interesat gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha. Këta faktorë mund të jenë të rëndësishëm në rritjen ose stopimin e njohjeve, por nuk janë vendimtar për anëtarësimin e Kosovës dhe Palestinës në OKB.

Faktori gjeografik po ashtu ndikon në gjeopolitikat rajonale. Lidhur më shumë me të, i intervistuari i radhës, shprehet:

Shtrirja gjeografike luan rol, sepse Kosova synon dhe ka mundësi të anëtarësohet në BE dhe NATO, kurse Palestina nuk e ka atë mundësi. Faktori gjeografik është me rëndësi në të dy rastet pasi ai ndikon edhe në balancën e pushteteve në të dy rajonet. Si hegjemon, SHBA-ja është një fuqi që mbështet status quo. Ajo gjithmonë ka interes parësor mbajtjen e balancës rajonale me qëllim parandalimin e daljes së superfuqive rajonale që do të prishnin balancën dhe sfidonin Amerikën. Çdo politikë e jashtme, dhe çdo gjë që SHBA bën në arenën ndërkombëtare, është gjithmonë në shërbim të interesit parësor të sipërpërmendur.

Se si superfuqitë globale nuk duan askush t'i sfidojë ato, i intervistuari tjetër në hulumtim, potencon si në vijim:

Një Palestinë e pavarur do të limitonte influencën izraelite në rajon dhe do të rriste influencën arabe. Kjo e fundit do të shihej me dyshim nga SHBA-të, pasi pavarësia e Palestinës do të ringjallte gjithashtu edhe shpresën dhe ëndrrën panarabe në Lindjen e Mesme. Pan-Arabizmi do të mund të krijonte një front shumë të fuqishëm që do të mund të sfidonte edhe influencën Amerikane në rajon. Por pavarësisht se kjo do të ndihmonte çështjen arabe, kam frikë se shtetet arabe individualisht do të preferonin të sakrifikonin për Palestinën, pasi secili shtet është i pasigurt në lidhje me fatin e vetvetes. Jo vetëm kaq, por shumë nga shtetet arabe kanë luajtur me çështjen palestineze për interesat e tyre, përfshirë këtu Jordaninë, Arabinë Saudite, Egjiptin etj. Nga ana tjetër, në rastin e Kosovës, Rusia është fuqia botërore më e shqetësuar pasi pavarësia e Kosovës do të rriste influencën amerikane në rajon në kurriz të asaj ruse, sidomos kur kjo pavarësi do të pasohej nga një koalicion apo konfederatë pan-shqiptare. Pra, faktorët gjeografikë lidhen ngushtë me interesat gjeopolitike.

6.2.3. Impakti i sovranitetit të brendshëm në sovranitetin e jashtëm

Sovraniteti i brendshëm dhe i jashtëm janë kriteret esenciale për matjen e aftësisë vepruese të shtetit si subjekt ndërkombëtar. Se si ndikon sovraniteti në anëtarësim, kemi këtë prononcim nga i intervistuari:

Sovraniteti i brendshëm nuk ndikon thelbësisht për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, por rregullat e tyre të brendshme dhe lloji i organizatës. Në OKB nuk ndikon sovraniteti i brendshëm shumë, p.sh. Tajvani ka sovranitet të brendshëm më shumë se Kosova,

por është detyruar të heqë dorë nga anëtarësia në OKB. Kurse Somalia është anëtare e OKB-së dhe nuk e kontrollon tërë territorin e vet, dhe nuk ka shtet efektiv.

Sovraniteti i brendshëm ka ndikim në të ardhmen e Kosovës si shtet i pavarur, por ai nuk është vendimtar. Ndryshe nga Palestina e cila nuk gëzon as pavarësi de jure dhe as de facto, Kosova ka një pavarësi de facto pasi ajo gëzon të drejtën e vetëqeverisjes së kondicionuar nën protektoratin e OKB-së. Problem me këtë lloj pavarësie është vetë statusi i protektoratit, pasi ai mund të ndryshojë në të ardhmen si për mirë, por edhe për keq. Kosova, por edhe çdo shtet tjetër, nuk e ka luksin që të lërë të ardhmen e saj në dorë të fatit. Për këtë arsye, Kosova duket të ketë si qëllimin e saj kryesor marrjen e pavarësisë de jure dhe njohjen nga Këshilli i Sigurimit dhe mbarë komuniteti ndërkombëtar.

Në tërheqjen e dallimeve dhe ngjashmërive Kosovë-Palestinë, një nga të intervistuarit në hulumtim, përshkruan dhe zbërthen llojin e njohjeve që kanë dyja shtetet:

Sa i përket njohjeve, arsyeja pse Palestina ka më shumë njohje lidhet me llojin e njohjeve: ndërkohë që për Kosovën njohjet kanë të bëjnë me njohjen si shtet sovran dhe të pavarur, në rastin e Palestinës njohjet i referohen zgjidhjes së një problemi kolonial, pra jo njohjen e saj si shtet sovran dhe të pavarur. Numri i njohjeve të Palestinës është më i madh ngase ajo është njohur thuajse “në bllok” nga shtetet myslimane si dhe nga ish-shtetet aleate të BRSS-së, shtetet në zhvillim (Bota e tretë), por edhe disa shtete tjera me qeveri të majta. Kurse Kosova, përveç Perëndimit, nuk ka ndonjë “bllok” tjetër mbrapa vetes.

Se si varet dhe mosvaret sovraniteti i brendshëm me atë të jashtëm, i intervistuari i radhës, deklaron:

Sovraniteti i brendshëm është parakusht formal për sovranitetin e jashtëm. Historikisht mungesa e sovranitetit të brendshëm rrallë ka ndikuar sovranitetin e jashtëm. Njohja e shtetit është thjesht një akt politik dhe kështu edhe mungesa e plotë e sovranitetit të brendshëm nuk duhet të pengojë një shtet që të njihet. Prandaj, si një çështje e dekolonizimit, Palestina fillon me një avantazh automatik. Shtetet janë shumë më të gatshme të pranojnë rastet për pavarësi për territoret koloniale sesa ato për territore secesioniste. Kjo shpjegon pse Palestina ka më shumë njohje, edhe pse nuk i plotëson kriteret për shtetësi aq qartë sa Kosova bazuar në Konventën e Montevideos.

Bazuar në pohimet e të intervistuarve në përgjigjen e mësipërme konfirmohet pothuajse në tërësi hipoteza 1.2.

6.2.4. Rruga sfiduese drejt OKB-së

Kosova dhe Palestina kanë synime për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Ato, sfidat i kanë të njëjta, por aleatët e ndryshëm. Në ndërkohë që Palestina ka aleat Rusinë, Kosova SHBA-të dhe vendet perëndimore.

Më tutje, një nga responentët e intervistave të thella, sqaron:

OKB sipas definicionit ia mban anën shteteve anëtare dhe rrjedhimisht shtetet jo-anëtare janë të diskriminuara. Qasja e OKB-së përcaktohet nga përçarjet e brendshme aty, sidomos në Këshillin e Sigurimit. Kjo nënkupton se shtetet që pretendojnë të anëtarësohen pa harmonizim të qëndrimeve brenda Këshillit të Sigurimit, veçanërisht SHBA-ve, Rosisë dhe Kinës, pasi Mbretëria e Bashkuar dhe Franca do të ndiqnin shembullin e SHBA-ve, e kanë shumë të vështirë anëtarësimin aty.

Sfidat për anëtarësim janë të shumta, duke filluar nga njohjet/marrëveshjet me shtetet në kundërshtim, e deri te vetoja. Domethënë, edhe nëse ka njohje nga Serbia, p.sh., anëtarësimi i Kosovës në OKB mund të vetohet nga Rusia ose dhe Kina.

Mbi kufijtë e mundshëm të Palestinës në raportet dhe marrëdhëniet e saj formale me OKB-në, një nga të intervistuarit e tjerë, analizon si më poshtë:

Palestina është më larg anëtarësimit në OKB, dhe ndoshta statusi i tanishëm i vëzhguesit është pika kulmore që mund të arrijë, ndërsa Kosova mund të prekë anëtarësimin e plotë nëse arrihet një marrëveshje midis Serbisë dhe Kosovës dhe atë nuk do ta kundërshtonte Rusia dhe Kina. Çështja e anëtarësimit / pranimit të Palestinës në organizatat ndërkombëtare është e lidhur drejtpërdrejt edhe me politikën e konfliktit Izrael-Palestinë dhe se si është i përshtatur ai në kontekstin më të gjerë gjeopolitik. Palestina është anëtare e UNESCO-s, ndërsa Kosova është anëtare e Bankës Botërore dhe e FMN-së. Kjo krijon anomali interesante në mënyrën se si ato trajtohen brenda pjesëve specifike të sistemit të OKB-së.

Se cili mund të jetë ndonjë model për të ndjekur Kosova dhe Palestina, i intervistuari tjetër, shprehet si në vijim:

Izraeli është shembulli perfekt për të dy shtetet sa i përket sfidave. Rruga e Izraelit është shembulli më i mirë për Palestinën dhe Kosovën. Kjo do të thotë krijimin e qeverive që kanë në mendje dhe zemër interesin kombëtar, jo atë personal të politikanëve, dhe diplomacinë me të gjithë superfuqitë botërore, përfshirë këtu edhe Rusinë dhe Kinën. Aktualisht, Kosova e as Palestina nuk duhet të harxhojnë energjitë e tyre për anëtarësim në OKB, por të angazhohen denjësisht që t'i përmirësojnë marrëdhëniet e tyre me fqinjët, e aq më tepër me "armiqtë" e tyre të gjejnë zgjidhjen e duhur. Kështu këto shtete do të dëshmonin se pavarësia e tyre nuk do të ndikonte balancën e pushtetit në rajon.

6.2.5. Roli i organizatave rajonale

Sipas të intervistuarve, roli i organizatave rajonale për Kosovën është më ndryshe se ndaj Palestinës. Kjo e fundit përbën një problem global që lidhet me dinamikën e sigurisë dhe gjeostrategjinë e Lindjes së Mesme me të gjitha pasojat e tyre, kurse rasti i Kosovës është një rast thellësisht evropatlantik dhe lidhet me zgjidhjen e problemeve në sferën e interesit evropian, me përjashtim të Rusisë dhe të çdo fuqie tjetër jashtë Evropës. Lindja e Mesme nuk e ka një status të tillë.

Roli me rëndësi në marrëdhëniet dhe skenën ndërkombëtare e globale kanë NATO dhe BE-ja. Se çfarë është brenga e NATO-s dhe BE-së, i intervistuari përgjigjet:

Qasja mes NATO-s, e BE-së në një anë dhe OBI-së në anën tjetër dallon, për shkak të natyrës së tyre. NATO dhe BE janë më shumë të brengosura për stabilitet dhe qasja ndaj Kosovës, Palestinës dhe të gjitha shteteve tjera në fqinjësi, niset nga kjo konsideratë.

Ndërsa për BE-në, i intervistuari në hulumtim, thotë:

BE ka marrë rolin ndërmjetësues mes Kosovës e Serbisë dhe e përdorë mundësinë e anëtarësimit dhe fondeve të para-anëtarësimit si karrotë për të dyjat. E deri diku edhe NATO e bën të njëjtën gjë. Kurse kjo mundësi nuk ekziston në Palestinë/Izrael, edhe pse BE-ja është e përfshirë aty në ndërmjetësim. Për dallim nga kjo, OBI nuk ka ndonjë proces dhe "mandat" të ngjashëm dhe është e limituar në këtë aspekt. Gjithashtu, dallimi tjetër është se NATO dhe BE formalisht janë neutral ndaj statusit të Kosovës, dhe kanë marrëdhënie edhe me Kosovën edhe me Serbinë, e qasje të ngjashme kanë edhe ndaj Palestinës e Izraelit. Kurse OBI nuk është neutrale

ndaj statusit të Palestinës, ku Palestina është anëtare, dhe - edhe pse e mbështetet zgjedhjen me dy shtete - shumica e anëtareve nuk e njohin Izraelin, dhe kanë bërë thirrje për bojkot ndaj Izraelit. Dhe sa i përket Kosovës, mbi 20 shtete në OBI nuk e njohin Kosovën, por të gjitha - duke përfshirë edhe Palestinën - e njohin Serbinë. Kështu që qasja e OBI-së është më asimetrike, dhe në rastin e Palestinës është në favor të shtetit jo-anëtar të OKB-së (Palestinës), kurse në rastin e Kosovës është në favor të shtetit anëtar të OKB-së (Serbisë) e në dëm të shtetit që kërkon njohje (Kosovës). Në OBI ka shumë shtete anëtare që nuk e njohin Kosovën, dhe kjo e vështirëson anëtarësimin e mundshëm të Kosovës aty.

Një tjetër i intervistuar për këtë studim, përkitazi me raportet e BE-së me Kosovën dhe Lindjen e Mesme, shprehet:

NATO dhe BE-ja e konsiderojnë Kosovën pozitivisht, ndërkaq, OBI dhe organizata të tjera rajonale në Lindjen e Mesme janë të "lumtur" që kanë Palestinë për arsye të dukshme politike. Bashkimi Evropian ka ndërmarrë një sërë iniciativash për ndërmjetësim të negociatave Kosovë-Serbi, të cilat akoma nuk kanë treguar rezultate. Ndërkaq OBI dhe organizatat e ndryshme në Lindje të Mesme shpesh kanë keqpërdorur me rastin e Palestinës, duke e përdorur atë për qëllime të brendshme apo të jashtme politike.

Roli i organizatave rajonale është i rëndësishëm po ashtu, por me limite. Se deri ku janë kufijtë dhe fushëveprimi i tyre, një nga të intervistuarit thekson:

Roli i organizatave rajonale ndaj Kosovës dhe Palestinës diktohet edhe nga interesat gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha. Asnjë nga organizatat rajonale nuk ka fuqi të bëjë ndryshime thelbësore pa miratimin e SHBA-së, Rusisë, dhe/apo Kinës. Organizatat ndërkombëtare dhe ato rajonale në fund të fundit janë një pasqyrim i preferencave të anëtarit apo partnerit të tyre më të fuqishëm. Organizatat rajonale shpesh faktorizohen duke bërë pengesa në procese, sesa duke kërkuar për zgjidhje të problemeve në rajonet e tyre.

Duke krahasuar Palestinën dhe Kosovën, edhe në një pikë tjetër, ku ndërfiten kultura, gjeografia dhe organizatat ndërkombëtare, njëri nga të intervistuarit në hulumtim, thotë:

Për këtë arsye Kosova dhe Palestina shihen dhe trajtohen në mënyrë të ndryshme. Kjo është për shkak se ato janë parë ndryshe. Kjo nuk është vetëm në aspektin e pozicioneve të tyre sipas ligjeve ndërkombëtare, por edhe të pozicioneve të tyre gjeografike. Kosova mbështetet

fuqimisht nga Shtetet e Bashkuara dhe nga shtete të tjera perëndimore dhe është pranuar gjerësisht nga shtetet evropiane. Kjo do të thotë se ajo gëzon pranim më të madh në BE dhe NATO. Palestina ka më shumë mbështetje në botën islame. Kjo padyshim ka të bëjë me natyrën e mosmarrëveshjes dhe faktin se Izraeli është një protagonist. Marrë parasysh të gjitha faktet, organizatat globale, si OKB-ja dhe mekanizmat e saj vazhdimisht kanë bërë thirrje që shtetet si Kosova dhe Palestina të përfshihen në organizata rajonale dhe të tentojnë të gjejnë zgjidhje paqësore me shtetet që akoma kanë mosmarrëveshje.

6.2.6. Negociatat si zgjedhje për zgjidhje

Negociatat janë mjete të diplomacisë ndërkombëtare, të cilat fuqizojnë palët drejt objektivave të tyre në mënyrë paqësore. Për këtë, një nga të intervistuarit, thotë:

Impakti i negociatave për anëtarësim në organizata ndërkombëtare për Kosovën dhe Palestinën është i njëjtë, por vështirësitë janë të ndryshme. I njëjtë sepse pa pëlqimin e Serbisë (sido që të merret ai pëlqim, me forcë ose me dëshirë dhe përmes koncesioneve ndaj Serbisë) Kosova nuk mund të ketë njohje universale dhe anëtarësim të plotë në organizatat ndërkombëtare. Njëjtë vlen edhe për Palestinën. Në fakt, arsyeja kryesore pse Izraeli nuk njeh Kosovën është sepse frikësohet se mund të shërbejë si precedent për Palestinën.

Po në komparacion të Izraelit dhe Serbisë, që kanë të bëjnë direkt problemet e Palestinës dhe Kosovës, i intervistuari tjetër i radhës, thotë:

Vështirësitë janë të ndryshme, sepse Serbia pafundësisht është më e dobët se Izraeli në planin global gjeostrategjik. Kjo nënkupton se presioni i Perëndimit ndaj Serbisë mund të sjellë dhe ka sjellur rezultate më pozitive për Kosovën. Ky nuk është rasti me Izraelin sepse ndikimi i Izraelit në planin global është kolosal për shkak se paraqet të vetmin aleat serioz të Perëndimit në atë pjesë të botës, i cili efektivisht mund të frenojë dhe kontrollojë synimet hegjemonike të Iranit, por edhe të akterëve tjerë lokalë.

Sipas një të intervistuari në këtë hulumtim, ofertat e Serbisë ndaj Kosovës për shkëmbim terriore, duhet të bëhen në këmbim të njohjes ndërkombëtare të Kosovës nga Rusia, Këshilli i Sigurimit dhe shumica e komunitetit ndërkombëtar, dhe kjo është një mundësi e artë për Kosovën. Është për t'u habitur se si Serbia do ta pranonte këtë zgjidhje, pavarësisht se si do te rindaheshin

disa territore. Ndoshta nëse Kosova e pranon propozimin serb, këta të fundit nuk do ta braktisinin atë.

Për pengesat nga ana shqiptare e kosovare, për pranimin e kësaj oferte, ai vazhdon:

As “patriotizmi” shqiptar nuk ka për të lejuar që Kosova të pranojë këtë ofertë serbe. Në fund, si Serbia ashtu edhe Kosova do të presin fatin e tyre të diktuar nga luftërat e Fuqive Botërore për të avancuar interesat e tyre gjeostrategjike në rajon. Gjithsesi, një qeverisje patriotike, fuqizimi i shtetit të Kosovës dhe diplomacia e fqinjësisë së mirë (duke i qëndruar larg asaj shqiptare) dhe të zgjuar me fqinjët dhe Fuqitë e Mëdha, do t’i rrisnin shumë shanset e pavarësisë së Kosovës.

Vendet rajonale kërkojnë nga Kosova stabilitet dhe fqinjësi të mirë. Nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha duan që pavarësia e Kosovës të mos sjellë ndryshime në balancën e pushtetit rajonal. Që kjo frikë të mos ekzistojë, Kosova duhet të qëndrojë sa më larg Shqipërisë dhe idesë së “Shqipërisë së Madhe”.

Dhe ta themi hapur dhe drejt – shton i intervistuari, Kosova e fitoi pavarësinë falë sakrificave të saj dhe mbështetjes amerikane, jo falë ndonjë akti të Shqipërisë. Shqipëria nuk e ka në dorë fatin e Kosovës. Ajo mund ta ketë atë për keq nëse e godet apo përcjell tek vendet fqinje, me apo pa vetëdije, frikën e “Shqipërisë së Madhe”, e cila shpesh përdoret kundër vetë Kosovës.

Për rëndësinë që kanë negociatat e Kosovës me Serbinë, i intervistuari si pjesë e kampionit të këtij hulumtimi, thotë:

Vazhdimi i negociatave me Serbinë është i domosdoshëm dhe krucial për të ardhmen e Kosovës. Këto negociata nuk duhet të jenë pa objektiva dhe duhet të zhvillohen mbi parimin e trajtimit të barabartë dhe zgjidhjes së kompromisit. E njëjta gjë me peshë dyfish më të lartë vlen për Palestinën. Negociatat e deritashme janë keqpërdorur nga Serbia për të bërë fushatë kundër njohjes së Kosovës. Kurse nëse ka ndonjë marrëveshje përfundimtare me njohje nga Serbia në negociata, ajo mund të ndihmojë në anëtarësim në organizata rajonale por jo domosdoshmërisht në OKB. Kurse në rastin e Palestinës, një njohje e saj nga Izraeli do ta hapte rrugën për anëtarësim në OKB, kurse kjo njohje nuk është e domosdoshme për anëtarësim në organizata rajonale.

Në rastin e Palestinës, negociatat duke u referuar në të drejtën ndërkombëtare, rezolutat e AP-së dhe KS-së së OKB-së janë të favorshme, ndërkaj në rastin e Kosovës një gjë e tillë është

më e komplikuar. Kjo për faktin se Kosova ka shpallur pavarësinë, efektivisht kontrollon territorin, është e njohur nga shumica e shteteve demokratike të botës dhe ka marrë një mendim këshillues nga GjND-ja, se pavarësia e saj nuk bie në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. GjND-ja dha këtë mendim pasi formalisht pranoi kërkesën nga AP-ja e OKB-së me kërkesë të Serbisë. Prandaj, në rastin e Palestinës referimi në të drejtën ndërkombëtare është i favorshëm për palestinezët, dhe jo i favorshëm për hebrenjtë, ndërkaq, referimi në rezoluta të OKB-së në rastin e Kosovës është e pafavorshme për udhëheqësit e shtetit të Kosovës; është i papranueshëm për shkak të vendimit të GjND-së. Palestinezët pos ndërtimit të një autoriteti kredibil dhe atdhetar, duhet përmes negociatave dhe kompromisit të tentojnë zgjidhjen e problemit të ekzistencës së shtetit të tyre. Përmes negociatave, Kosova dhe Palestina mund të arrijnë synimet e tyre për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

6.3. Diskutim

Rezultatet e hulumtimit empirik bazuar në përgjigjet e pjesëmarrësve pas aplikimit të pyetësorëve dhe intervistave, pasqyrojnë qëndrime mjaft të ngjashme apo të përafërta, duke u përgjigjur shumica thuajse njësoj për shumë nga çështjet e parashtruara në këtë studim.

Si pjesëmarrësit që plotësuan pyetësorin, ekspertët, politikanët, zyrtarët shtetërorë etj., si ata që kanë plotësuar intervistën, nuk kanë dallime të konsiderueshme në përgjigjet e tyre. Opinioni i tyre në përgjithësi nuk është thellësisht i ndarë, sa për t'i regjistruar si dallime të mëdha të qëndrimeve të respondentëve në temat e trajtuara.

Ka qëndrime të ndryshme nga pjesëmarrësit e ndryshëm, por jo deri në atë shkallë, sa të jenë përgjigjet aq të diferencuara.

Ndonjë pjesëmarrës i intervistave, nuk iu është përgjigjur direkt pyetjes në intervistë, duke u zhvendosur në rrethanat historike apo të ngjashme, prandaj përgjigjet e tilla janë shfrytëzuar si burim informacioni të përgjithshëm për trajtesën, por pa e konsideruar të rëndësishëm validitetin për pyetjen e caktuar dhe pa e marrë parasysh si kriter për të verifikuar apo kundërshtuar një hipotezë.

Nëse bëjmë një rikapitullim të shumicës së respondentëve, 100 pjesëmarrës me pyetësorë dhe 15 pjesëmarrës me intervista, përgjigjet e tyre i konfirmojnë hipotezat në masë të konsiderueshme, por edhe ndonjë hipotezë bie pjesërisht, si ajo e ndikimit të kontestimeve të brendshme në vendimet për njohjen e një shteti të ri.

Janë zhvilluar intervista me dy lloje të ndryshme formulimesh e tematikash, por nuk janë gjetur dallime në përmbajtjen, mënyrën dhe çfarë kanë deklaruar rreth aspektit komparativ në mes të Kosovës dhe Palestinës.

Në përgjigjet e pjesëmarrësve të pyetësorit, shumica e tyre kanë konfirmuar hipotezën kryesore: "Kosova dhe Palestina pavarësisht se kanë disa ngjashmëri, me gjasa, janë raste të ndryshme sepse edhe Bashkësia Ndërkombëtare i trajton si të tilla." Kjo konfirmohet në mënyrë të konsiderueshme.

Nga të dhënat që janë paraqitur në studim, mund të vërejmë se shumica dërmuese e pjesëmarrësve në anketim, apo 74% e tyre mendojnë që Kosova dhe Palestina trajtohen si raste të ndryshme nga Komuniteti Ndërkombëtar; 20 % e të anketuarve konsiderojnë se Kosova dhe

Palestina janë pjesërisht të ngjashme, ndërkaq si raste të ngjashme Kosovën dhe Palestinën i vlerësojnë vetëm 6 % e pjesëmarrësve.

Këto përqindje konfirmojnë hipotezën kryesore të këtij studimi. Pjesëmarrësit konsiderojnë dhe vlerësojnë se Kosova dhe Palestina vlerësohen si raste të ndryshme.

Edhe grupi i pjesëmarrësve në hulumtim përmes pyetësorit, që kanë deklaruar se Kosova dhe Palestina janë pjesërisht të ngjashme, 20 përqind prej tyre, po ashtu nuk e mohojnë se Kosova dhe Palestina janë raste të ndryshme, por vetëm kanë dalluar nga grupi i parë i pjesëmarrësve në vlerësimin e shkallës së ndikimit.

Në bazë të përgjigjeve të pjesëmarrësve nga intervistat, po ashtu konfirmohet hipoteza kryesore, por jo krejtësisht. Njëri nga të intervistuarit, deklaron: “Arsyeja për të cilën trajtohen shumë ndryshe është sepse ato në fakt janë situata shumë të ndryshme edhe sipas ligjit ndërkombëtar. Palestina është një rast i dekolonizimit. Ajo njihet si e drejtë për shtetësi. Megjithatë, kjo është penguar nga okupimi i Izraelit. Kosova, nga ana tjetër, është një rast i shkëputjes. Pasi kjo shihet si një rast i shkëputjes së njëanshme (duke përdorur këtu termin 'unilateral' që në terma të thjesht juridik përshkruan aktin e shkëputjes pa dakordim midis palëve), prandaj bie në një kategori mjaft të ndryshme sipas ligjit ndërkombëtar.” Por ka pasur edhe një të intervistuar tjetër që është shprehur në këtë formë:

“Përsa i përket pyetjes suaj, nisur nga shpjegimi i mësipërm, mund të them me bindje se komuniteti ndërkombëtar (tre polet) e trajton Kosovën dhe Palestinën me të njëjtin standard, bazuar gjithmonë në interesat gjeopolitike të secilit pol.”

Hipotezën kryesore mund ta mbështesim edhe nga analiza e deklaratave të politikanëve vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë theksuar se Kosova është “sui generis”, pra i llojit të veçantë, dhe nuk mund të përdoret si rast i ngjashëm për asnjë rajon, situatë, kontest apo separatizëm tjetër në botë.

Disa dallime të kauzës së shqiptarëve të Kosovës dhe palestinezëve kanë ndikuar po ashtu që të mos trajtohen njësoj dyja vendet dhe dy popujt. Gjersa palestinezët kanë pasur forca politike që kanë shfrytëzuar gjuhën religjioze, simbolikat fetare etj., në Kosovë, janë shmangur nga identifikimi me atë apo këtë religjion. Ka pasur dallime edhe të kontekstit të tyre historik, raportit me fqinjët etj.

Si diskutim, komentim dhe përfundim të hipotezës së parë kryesore, mund të konstatojmë se konfirmohet hipoteza kryesore, por jo në mënyrë kategorike.

Hipoteza 1.1. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare i Kosovës dhe Palestinës varet nga shkalla e përkrahjes së superfuqive globale ndaj dyja vendeve.

Shumica e respondentëve kanë deklaruar se SHBA-të kanë rol të rëndësishëm për anëtarësimin apo jo të Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare.

Në rastin e Kosovës, këtë mendim e përkrahin 74% e pjesëmarrësve, ndërsa 23 % e tyre theksojnë se SHBA-të llojnë pjesërisht, dhe 3% e pjesëmarrësve mendojnë që SHBA-të nuk llojnë për anëtarësim të Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Asnjë pjesëmarrës nuk ka zgjedhur alternativën se SHBA-të llojnë kundër anëtarësimit të Kosovës në ON.

Nëse bëhen bashkë 74 përqind e respondentëve me 23 përqind të tyre, gjithsej 97 përqind, sërish rezulton se hipoteza 1.1 konfirmohet si e bazuar edhe nga hulumtimi empirik. Vetëm 3 përqind prej tyre kanë pohuar se SHBA nuk lobon për anëtarësim të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Në anën tjetër, të dhënat e hulumtuara tregojnë se, 49% e të anketuarve vlerësojnë se SHBA-të janë kundër anëtarësimit të Palestinës në ON; 47% e tyre mendojnë që SHBA-të nuk llojnë për anëtarësim të Palestinës, ndërsa 3% e pjesëmarrësve theksojnë se SHBA-të llojnë pjesërisht, dhe vetëm 1% e pjesëmarrësve mendojnë që SHBA-të llojnë intensivisht për anëtarësim të Palestinës në organizatat ndërkombëtare.

Nga krahasimi mund të vërejmë se Kosova dhe Palestina janë të kundërta, përderisa njëra mbështetet nga SHBA-të dhe aleatët, dhe tjetra nuk ka përkrahjen e tyre.

Edhe për Rusinë, shumica e pjesëmarrësve kanë deklaruar se ajo është kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Rezultatet e anketimit pohojnë se Rusia është kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare, me një përqindje të lartë prej 86%, ndërsa vetëm 14% e të anketuarve mendojnë që Rusia nuk lobon kundër anëtarësimit të Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Duhet të theksojmë që asnjë respondent nuk ka vlerësuar se Rusia lobon pjesërisht apo intensivisht për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare.

Në rastin e Palestinës, pjesëmarrësit në anketim me 11% pohojnë se, Rusia lobon intensivisht, dhe 68% e pjesëmarrësve mendojnë se, Rusia lobon pjesërisht për anëtarësimin e Palestinës në organizatat ndërkombëtare; 19% e tyre mendojnë që Rusia nuk lobon për anëtarësim, ndërkaq vetëm 2% e pjesëmarrësve mendojnë që Rusia është kundër anëtarësimit të Palestinës në organizatat ndërkombëtare. Të dhënat tregojnë për dallimet që Kosova dhe Palestina kanë në aleatë.

Hipoteza 1.1 konfirmohet po ashtu, por jo plotësisht. Një pjesë e saj mund të kundërshtohet, pasi që kemi rastin kur Kosova synonte lobimin amerikan për anëtarësim në UNESCO, por pavarësisht mbështetjes së SHBA-ve, sërish Kosova nuk u anëtarësua. Ky është shembull se si kjo hipotezë konfirmohet, por jo plotësisht.

Po ashtu, kjo konfirmohet edhe nga përgjigjet e të intervistuarve kur deklarojnë:

Roli i superfuqive dhe anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit është shumë i madh; ato pos mundësisë ta vetojnë anëtarësimin e cilitdo shtet, edhe mund të ndikojnë në anëtarësim në disa organizata përmes pushtetit që kanë aty si p.sh. SHBA-ja për Kosovën në Bankën Botërore (BB) dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Në anën tjetër, Palestina ka probleme edhe kur anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, kur ajo e bënë atë SHBA-të tërhiqen. Kjo ndodhi në rastin e pranimit të Palestinës si anëtar në UNESCO.

Hipoteza 1.2. Numri i njohjeve, anëtarësimeve dhe statusi i Palestinës në OKB për dallim nga Kosova, është më i lartë dhe më i avancuar, me gjasa nga trajtimi i Palestinës si rast dekolonizimi, ndërsa në rastin e Kosovës, numri i tyre është më i ulët nga trajtimi i saj si rast i shkëputjes nga një shtet sovran.

Duke krahasuar kontekstet historike dhe të shumë aspekteve të së Drejtës Ndërkombëtare, mund të konstatojmë se Kosova dhe Palestina janë raste të ndryshme edhe nga normat ndërkombëtare. Hipoteza konfirmohet nga intervistat e ekspertëve...

Nga përgjigjet e respondentëve të intervistave, kemi vërejtur se shumica prej tyre pohonin se Kosova është rast secesioni, ndërsa Palestina si rast dekolonizimi.

Disa dallime të Palestinës dhe Kosovës, i thekson edhe njëri nga të intervistuarit në hulumtim, ku ndër të tjerash, pohon:

Sa i përket njohjeve, arsyeja pse Palestina ka më shumë njohje lidhet me llojin e njohjeve: ndërkohë që për Kosovën njohjet kanë të bëjnë me njohjen si shtet sovran dhe të pavarur, në rastin e Palestinës njohjet i referohen zgjidhjes së një problemi kolonial, pra jo njohjen e saj si shtet sovran dhe të pavarur. Numri i njohjeve të Palestinës është më i madh ngase ajo është njohur thuajse “në bllok” nga shtetet myslimane si dhe nga ish-shtetet aleate të BRSS-së, shtetet në zhvillim (Bota e Tretë), por edhe disa shtete tjera me qeveri të majta. Kurse Kosova, përveç Perëndimit, nuk ka ndonjë “bllok” tjetër mbrapa vetes.

Përgjigjet nga hulumtimi kualitativ, e konfirmojnë hipotezën gati se plotësisht.

Hipoteza 1.3. Anëtarësimi i Kosovës dhe Palestinës në organizata ndërkombëtare varet nga lloji i orientimit të tyre gjeopolitik. Me gjasa, Kosovën e njohin më shumë shtetet e Orientimit Perëndimor, liberal dhe demokratik, ndërsa Palestinën, shtetet autoritariste dhe me botëkuptime më antiamerikane.

Nga përgjigjet e respondentëve me pyetësorë, por edhe me intervista, konfirmohet pjesërisht në shumicën e tyre, kjo hipotezë. Njëri nga të intervistuarit shprehet: Si Kosova dhe Palestina, trajtohen nga shtetet e tjera në funksion të politikës; e drejta ndërkombëtare në fund të fundit është mjaft e politizuar dhe kryesisht varet nga teket e shteteve... në veçanti, fuqia e ushtruar nga pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit, do të thotë se anëtarësia në Kombet e Bashkuara është tërësisht e varur nga disponimi politik i këtyre shteteve...

Se orientimi gjeopolitik ndikon shumë, kanë theksuar 74% e respondentëve për orientimin gjeopolitik të Kosovës dhe Palestinës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, ndërkaq 23% e të anketuarve theksojnë se orientimi gjeopolitik ndikon pjesërisht në anëtarësim të shteteve në ON. Vetëm 2% e respondentëve theksojnë se ai orientim nuk ndikon për anëtarësim në ON.

Të dhënat më lart tregojnë se kjo hipotezë konfirmohet gati se plotësisht.

Hipoteza 1.4. Njohja dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare stagnon me shkallën e pritshmërisë për marrëveshje në mes të dy palëve.

Pritja e organizatave ndërkombëtare për një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë përbënë 64% të pengesës për anëtarësim të Kosovës në ON. 15% e pengesave për realizimin e synimeve të Kosovës rrjedhin nga kundër-fushata agresive e Serbisë, 12% e respondentëve vënë theksin te numri i pamjaftueshëm i njohjeve, dhe 9% e tyre theksojnë se mungesa e konsolidimit ekonomik, politik dhe juridik të shtetit është pengesë për anëtarësim të Kosovës në ON.

Në rastin e Palestinës 47% e respondentëve theksojnë se pengesë kryesore për anëtarësim të Palestinës në ON është arritja e marrëveshjes në mes të saj dhe Izraelit. Fushata agresive e Izraelit shihet si pengesë nga 38% e tyre, 7% e të anketuarve theksojnë se numri i pamjaftueshëm i njohjeve dhe mungesa e konsolidimit, ekonomik, politik dhe juridik të shtetit është pengesë. Nëse krahasojmë të dhënat shohim se sikurse në rastin e Kosovës edhe në atë të Palestinës si pengesë kryesore për anëtarësim në ON paraqitet pritja për një marrëveshje me Serbinë përkatësisht me Izraelin.

Gjithashtu, sipas rezultateve të paraqitura në figurën nr.6, shihet se 57% e respondentëve për anëtarësim të Kosovës në OKB si sfidë kryesore vlerësojnë arritjen e një marrëveshje finale me Serbinë; në rastin e Palestinës, vërejmë se 67% e të anketuarve arritjen e një marrëveshje finale me Izraelin e shohin si rrugë të vetme për anëtarësim të saj në OKB.

Por ka pasur edhe pjesëmarrës në intervistë, të cilët kanë lënë të kuptohet se, hipoteza mund të konfirmohet gati plotësisht:

... Kosova mund të prekë anëtarësimin e plotë nëse arrihet një marrëveshje midis Serbisë dhe Kosovës dhe atë nuk do ta kundërshtonte Rusia dhe Kina. Çështja e anëtarësimit / pranimit të Palestinës në organizatat ndërkombëtare është e lidhur drejtpërdrejt edhe me politikën e konfliktit Izrael-Palestinë dhe se si është i përshtatur ai në kontekstin më të gjerë gjeopolitik.

...Pa pëlqimin e Serbisë Kosova nuk mund të ketë njohje universale dh anëtarësim të plotë në organizatat ndërkombëtare. Njëjtë vlenë edhe për Palestinën.

Në fund, hipoteza 1.4, mund të vërtetohet gati plotësisht, qoftë duke u bazuar në të dhënat e nxjerra nga pyetësi, qoftë nga intervistat.

Hipoteza 2. Krahasuar me Serbinë, ndikimi i presionit diplomatik të Izraelit kundër Palestinës është shumë më i lartë nga përkrahja e fuqishme e diplomacisë amerikane.

Sipas të dhënave, 69% e respondentëve theksojnë se Serbia ka ndikim të pjesshëm në anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare; 28 % e tyre mendojnë se Serbia ndikon shumë në këtë proces dhe vetëm 3% kanë theksuar se Serbia nuk ka aspak ndikim.

Në rastin tjetër, 61% e pjesëmarrësve pohojnë se Izraeli ka shumë ndikim në shtetet tjera rreth pengimit të Palestinës për anëtarësim në ON; 33% e tyre theksojnë se Izraeli ka ndikim të pjesshëm, ndërkaj vetëm 3% e pjesëmarrësve mendojnë që nuk ka aspak ndikim.

Pjesëmarrësit në intervistë gjithashtu vërtetojnë këtë hipotezë:

Sa i përket anëtarësimit në OKB, ndërkaj, roli i SHBA-ve dhe i Rusisë është vendimtar, si për Kosovën ashtu edhe për Palestinën. Roli i superfuqive dhe anëtarëve të përhershëm të Këshillit të Sigurimit është shumë i madh sepse ato mund ta vetojnë anëtarësimin e cilitdo shtet. Por edhe mund të ndikojnë në anëtarësim në disa organizata përmes pushtetit që kanë aty si p.sh. SHBA-ja në BB dhe FMN. Edhe kjo hipotezë, konfirmohet pjesërisht.

Hipoteza 3. Mosnjohja, mosanëtarësimi dhe kundërshtimi i një shteti të kontestuar varet nga shkalla e kompleksitetit të kontesteve të brendshme të shtetit njohës.

Nga të dhënat e pyetësorëve 49% e respondentëve theksojnë se kanë ndikuar kontestet e brendshme të shteteve në mosnjohje dhe mosanëtarësim të Kosovës në ON; 47% e tyre mendojnë se ato kanë ndikuar pjesërisht, dhe 4% e pjesëmarrësve mendojnë që kontestet e brendshme nuk kanë ndikuar fare.

Po ashtu, vërejmë se 19% e respondentëve pohojnë se kontestet e brendshme të shteteve kanë ndikuar në mosnjohje dhe mosanëtarësim të Palestinës në ON. 35% e respondentëve theksojnë se pjesërisht kanë ndikuar, ndërkaj 46% e tyre theksojnë se kontestet e brendshme të shteteve nuk kanë ndikuar në anëtarësimin e Palestinës në ON.

Për shkak të problemeve të brendshme, shtetet hezitojnë të njohin entitetet secesioniste. Ndërkohë që për Kosovën njohjet kanë të bëjnë me njohjen si shtet sovran dhe të pavarur, në rastin e Palestinës njohjet i referohen zgjidhjes së një problemi kolonial, pra jo njohjen si shtet sovran dhe të pavarur. Kjo hipotezë po ashtu konfirmohet, pjesërisht.

PËRFUNDIME

Studimi që ne kemi ndërmarrë nuk është qartësim i të gjitha dilemave në lidhje me trajtesën që kemi zhvilluar. Trajtesa ofron një mundësi tjetër me këndvështrim të ri në krahasimin e anëtarësimit të Kosovës dhe Palestinës në organizatat ndërkombëtare. Studimi synon për të parë pengesat me të cilat ballafaqohet Kosova dhe Palestina në rrugën e tyre për subjektivitet ndërkombëtar. Disertacioni me titull "Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare: aspekt komparativ në mes të Kosovës dhe Palestinës" është i gjerë dhe mund të krahasohet, analizohet e studiohet në këndvështrime të ndryshme.

Krahasimi i Kosovës dhe Palestinës në fushën e anëtarësimit, njohjes, subjektivitetit dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi, nënkupton identifikimin e dallimeve dhe ngjashmërive në mes të dyja vendeve.

Në kalkulum total të ngjashmërive dhe dallimeve të rastit të Kosovës dhe Palestinës, nga studimi i literaturës, zbatimi i metodologjisë kuantitative dhe kualitative, mund të përfundojmë se më shumë ka dallime sesa ngjashmëri ndërmjet tyre. Kosova dhe Palestina janë raste të ndryshme në rrugëtimin e tyre për pavarësi, njohje, anëtarësim dhe rritje të subjektivitetit ndërkombëtar, por edhe me disa ngjashmëri të dukshme.

Sa i përket ngjashmërive, si Kosova, si Palestina, iu kanë nënshtruar një shtypjeje sistematike të të drejtave dhe lirive individuale e kolektive. Synimet e tyre janë të ngjashme për sa më shumë dhe sa më shpejt anëtarësim në organizata ndërkombëtare; anëtarësimi me të drejta të plota në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Të dyja shtetet kontestohen në rendin juridik ndërkombëtar dhe dyjat përpiqen për fuqizim të subjektivitetit të tyre.

Në kontekstin historik, gjegjësisht në pjesën e parë të shekullit XX, Kosova dhe Palestina po e ndryshonin fatin e tyre edhe me shpërbërjen e ish-Perandorisë Osmane. Të dyja vendet ishin pjesë e saj.

Ngjashmëria tjetër në mes tyre në planin demografik dhe kulturor është edhe identiteti islam i popullsisë shumicë.

Në rrafshin ndërkombëtar, Palestina ballafaqohet me lobimin aktiv të Izraelit kundër anëtarësimit të saj në organizata ndërkombëtare, ngjashëm si Kosova që ballafaqohet me Serbinë.

Kosova dhe Palestina përtej ngjashmërive të vogla, kanë dallime shumë të mëdha. Ato janë të manifestuara në shumë ngjarje e procese.

Meqë Kosova dhe Palestina janë raste të shteteve të kontestuara, kemi arritur në përfundim që bashkësia ndërkombëtare e shteteve nuk i njeh dhe nuk i trajton si raste të njëjta. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj si rezultat i shkëputjes nga Serbia, ndërsa Palestina trajtohet si rast i dekolonizimit.

Në rrafshin ndërkombëtar Kosova ka njohje më pak se Palestina, por ajo njihet si shtet i pavarur dhe sovran, ndërsa Palestina njihet si zgjidhje e një problemi kolonial, por jo si shtet sovran dhe i pavarur.

Në rritjen e numrit të njohjeve të Kosovës rëndësi të veçantë ka orientimi gjeostrategjik i Kosovës. Shumica absolute e shteteve që kanë raporte të mira me SHBA-të kanë njohur pavarësinë e Kosovës, përjashtoj këtu Izraelin i cili për shkak të Palestinës nuk e njeh atë. Qeveria e Izraelit ka raporte me atë të Kosovës dhe zyrtaret e të dy palëve realizojnë vizita dhe takime.

Kosova dhe Palestina nuk kanë ndonjë raport diplomatik. Në rastin tjetër, shumë shtete që e njohin Palestinën nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, dhe shtetet që nuk kanë raporte të mira me SHBA-të ose janë më shumë të lidhura me Rusinë ose Kinën nuk kanë njohur pavarësinë e Kosovës.

Kosovën e kanë njohur shumica e vendeve demokratike të botës dhe kjo është rezultat direkt i ndikimit të SHBA-ve. Palestina edhe pse ka njohje më shumë se Kosova, nuk ka subjektivitet shumë më të lartë ndërkombëtar.

Duke u bazuar në të dhënat sasiore dhe cilësore, arrijmë në përfundim se Fuqitë e Mëdha luajnë rol kyç në anëtarësimin e plotë e potencial të Kosovës dhe Palestinës në OKB dhe organizatat tjera ndërkombëtare.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është plotësisht i varur nga orientimi gjeostrategjik i Kosovës dhe Palestinës. Kosova ka zgjedhur rrugën e saj euroatlantike dhe mbështetet në SHBA-të dhe vendet e Evropës perëndimore, ndërsa Palestina është e kundërta

e kësaj. Anëtarësimi i Kosovës në OKB aktualisht është sfidues për shkak të shfrytëzimit të së drejtës së vetos nga Rusia dhe Kina, aleatet e Serbisë, përkrahësit e Palestinës, si dhe rivalët e SHBA-ve. Në rastin e Palestinës anëtarësimi në OKB pengohet nga SHBA-të, dhe pa një marrëveshje të Palestinës me Izraelin një anëtarësim i plotë i saj nuk mund të shihet si mundësi.

Në shtetet si Kosova dhe Palestina, rol të madh luan numri i njohjeve, anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe arritja e marrëveshjeve me subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Sovraniteti i brendshëm i Palestinës është i varur nga Izraeli, për dallim që Kosova ka sovranitet të brendshëm dhe kufij të qartë me Serbinë dhe vendet fqinje. Rritja e numrit të njohjeve dhe forcimi i tyre me njohje nga organizatat ndërkombëtare është shumë me rëndësi për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe Palestinës.

Në rastin e Palestinës, Izraeli pengesat i vendosë kryesisht tek anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare. Ndërkaq, Serbia i vë pengesa Kosovës edhe në njohje ndërkombëtare të shtetit.

Palestina për dallim nga Kosova, e ka statusin e shtetit jo-anëtar vëzhgues në OKB. Ndërsa, Kosova ende nuk ka aplikuar për anëtarësim në këtë organizatë dhe raportet e rregullta në Këshill të Sigurimit, për Kosovën i prezanton përfaqësuesi i UNMIK-ut, ndonëse edhe një përfaqësues i Kosovës e merr fjalën po ashtu. Prej pesë shteteve anëtare të përhershme të KS të OKB-së, Palestinën e njohin vetëm dy, ndërsa Kosovën tri prej tyre.

Kosova dhe Palestina përfundimisht janë dy raste të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare, kontekstit më të ri historik; numrin e njohjeve, anëtarësimeve, llojit të tyre; elementeve të shtetit si: popullsia, territori, qeveria, aftësia për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare, ushtria; raporti me fqinjët, lloji i metodave dhe mjeteve politike të përdorimit, raporti me OKB-në, BE-në, KE-në, NATO-në, OBI-në etj.

Prej të gjitha hipotezave të prezantuara në këtë studim e të hulumtuara me metodologji të kombinuar kualitative dhe kuantitative, duke aplikuar pyetësin dhe intervistat me ekspertë, studiues, OJQ, media etj., shumica e tyre nuk janë konfirmuar plotësisht, ndërsa njëra nga to është hedhur poshtë.

REKOMANDIME

- Qeveri adekuate dhe objektiva të qarta - Kosova dhe Palestina si subjekte shtetërore, njëri derivat i procesit të dekolonizimit e tjetri i shkëputjes, duke qeverisur mirë, ato duhet të ndërtojnë dokumente afatgjate që tregojnë për rrugën se si do të realizohen qëllimet në planin e brendshëm dhe të jashtëm.
- Qeveritë duhet të ndajnë prioritetet, njërin për negociatat për zgjidhje të problemeve me Serbinë dhe Izraelin, dhe tjetrin për realizimin e qëllimeve në politikën ndërkombëtare.
- Në rastin e Kosovës urgjentisht duhet të ndryshohet kursi i politikës së jashtme, duhet të përmirësohet rrjeti i shërbimit të jashtëm diplomatik, dhe e njëjta gjë vlen edhe për Palestinën.
- Në rrjetin diplomatik të Kosovës duhet të përfshihen më shumë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, në veçanti pjesëtar të komunitetit serb, ndërsa në atë të Palestinës, duhet të përfshihen pjesëtarë të konfesionit katolik e të tjerë. Kjo e fundit, sidomos për shkak të një stereotipi që disa vende e konsiderojnë Palestinën si vend fundamentalistësh islamikë.
- Forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar - Kosova dhe Palestina duhet të imponohen me pjesëmarrje në nisma rajonale dhe ndërkombëtare. Me forcimin e sovranitetit të jashtëm rritet edhe subjektiviteti ndërkombëtar i shteteve.
- Vazhdimi i negociatave - Kosova dhe Palestina, aktualisht të vetmen rrugë për realizimin e synimeve të tyre për anëtarësim në OKB e kanë përmes arritjes së një marrëveshjeje me Serbinë dhe Izraelin. Në rastin e Kosovës, kjo dallon në nuanca, për shkak se fuqia e Serbisë është pakrahasimisht më e vogël se ajo e Izraelit, dhe faktori ndërkombëtar mund të frenojë sjelljet e Serbisë karshi Kosovës. Por edhe Kosova mund të pengojë Serbinë për anëtarësim në BE nëse nuk arrihet një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Në rastin e Kosovës dhe Serbisë palët janë të varura nga njëra-tjetra në synimet për integrim evropian. Ndërkaq, për realizimin e synimeve të Kosovës për anëtarësim në OKB dhe mekanizmat e saj, duhet që të vazhdohet dialogu me Serbinë me objektiva të qarta. Në rastin e Palestinës kjo gjë është më vështirë e arritshme, por nuk është e pamundur.

- Zgjidhja e konfliktit Palestinë – Izrael, duhet të arrihet përmes një procesi të paqes të udhëhequr nga SHBA-të, me pjesëmarrje të Egjiptit dhe të Arabisë Saudite. Kosova dhe Palestina duhet të zhvillojnë negociatat me Serbinë dhe Izraelin për të zgjidhur problemet në mënyrë paqësore, duke u ndërmjetësuar veçmas nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Rusia, Gjermania, Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia.
- Kosova dhe Palestina pavarësisht se janë raste të ndryshme, në kuptimin e respektimit të së drejtës për vetëvendosje, duhet të trajtohen njësoj nga faktori ndërkombëtar, pasi legjimitetin për ta qeverisur si njërën, si tjetrën, nuk e kanë më Serbia dhe Izraeli.
- Kosova dhe Palestina për të rritur numrin e njohjeve, duhet të gjejnë rrugë diplomatike me shtetet mike që kanë ndikim në shtete të caktuara që kundërshtojnë Pavarësinë e Kosovës dhe Palestinës.
- Palestina duhet të ndjekë një politikë sekulariste dhe laike, në mënyrë që të mos ketë politizime të religjionit, sidomos në një kontekst ku feja është temë shumë e ndjeshme, si historikisht, si aktualisht.
